

LAJMI GËZUAR

**PERËNDIA TË DO,
MIKU IM
MYSLIMAN**

Samy Tanagho

**Shtëpia Botuese
TENDA
Prishtinë
2002**

Titulli i veprës: Perëndia të do miku im mysliman

Titulli original: God love's you my dear myslim

Autori: Samy Tanagho

Boton: Shtëpia Botuese TENDA

Editor: Mr. Femi Cakolli

Përktheu: Hilki Berisha

Lektor: Besim Kryeziu

Korrektor: Muzafer Ramiqi

Shtypi: Multi Graphics, Prishtinë

Disegn: Tomor Ajeti

Realizimi: Laliva

Viti i shtypit: 2002

Tirazhi: 3000 copë

Copyright: © Tenda

Formati: 19 x 12 cm.

Botimi i parë: 2002

Print in Kosova

ISBN:

Citimet e Biblës janë marrë nga Bibla, Diodati i Ri: përdorur me leje

Citimet e Kuranit janë marrë nga Kurani: Përkthimi i Sherif Ahmetit

Botimi në origjinal: G.S.W.E., Inc.

3800 South Fairview Road

Santa Ana, California 92704

Copyright 2002 by Samy Thanago

Botimi i revizuar

ISBN 0-9676661-9-8

Print in USA

Për të kontaktuar shërbesën tonë ndaj myslimanëve:

Mesazhi: (714) 979-4422

Fax: (714) 979-8916

e-mail: samytanagho@muslimministry.com

www.muslimministry.com

Adresa:

Shtëpia Botuese TENDA

rr. Nazim Gafurri nr.76/A

Prishtinë, Kosovë

Tel. 044118088

E-mail: Tenda_al@yahoo.com

Të gjitha të drejtat e këtij botimi për gjuhën shqipe i mban Shtëpia Botuese TENDA, andaj ndalohet me ligj shumëzimi dhe fotokopjimi si dhe përdorimi i paautorizuar i këtij libri, si tërësi apo pjesë e tij, pa lejen paraprake të botuesit!

**LAJMI GËZUAR:
PERËNDIA TË DO MIKU IM MYSLIMAN**

Ekzistojnë ngjashmëri të konsiderueshme ndërmjet Biblës dhe Kuranit për sa i përket persononalitetit të Jezus Krishtit. Dhe kur i ekzaminojmë paralelet ndërmjet tyre dhe domethënien e tyre, ky proces do të na shpie në një kuptim të plotë. Sepse ka diçka më të thellë dhe më personale që Perëndia dëshiron që ne të kemi, e cila është përtej besimeve religjioze: është të përjetuarit e dashurisë së mrekullueshme të Perëndisë dhe shpëtimit. Është marrëdhënia e dashur me Perëndinë e gjallë. Vetëm të njohurit e Perëndisë në mënyrë personale mund të përmbushë etjen tonë shpirtërore.

Mik i dashur, mënyra për të njohur dashurinë e Perëndisë personalisht, që do ta ndaj në këtë libër me ju, nuk është synuar kurrë nga Perëndia të jetë vetëm për një grup të veçantë njerëzish. Të kuptuarit dhe zbatimi personal i të vërtetës së Perëndisë është e drejtë e përbashkët e gjithë njerëzve - për t'u ndriçuar dhe gjallëruar shpirtërisht!

**“DO TË MË KËRKONI DHE DO TË MË GJENI, SEPSE DO TË MË KËRKONI
ME GJITHË ZEMRËN TUAJ!**

(JEREMIA 29:13)

PËRMBAJTJA

Përmbajtja
Parathënie
Prologu
Dedikim
Hyrje

Pjesa e parë

Dëshmia e Kuranit lidhur me autencitetin e Shkrimeve.....

Kapitulli 1
Besueshmëria e Biblës
Kapitulli 2
Proklamimi mysliman se Bibla është ndryshuar.....
Kapitulli 3
Ungjilli është Lajmi i Mirë i Perëndisë.....
Kapitulli 4
A ka ardhur Muhamedi të themelojë një religjion të ri?.....

Pjesa e dytë

Adami në Kuran dhe në Bibël

Kapitulli 5
Adami në islam
Kapitulli 6
Rezultatet e rënies
Kapitulli 7
Pajtimi është i mundur

Pjesa e tretë

Abrahami në Kuran dhe në Bibël.....

Kapitulli 8
Jeta e Abrahamit
Kapitulli 9
Ungjilli predikuar Abrahamit dhe nëpërmjet tij.....

Pjesa e katërt

Jezusi në Kuran dhe Bibël

Kapitulli 10
“Krishti Jezus” (Al-Masih, Isa) Mesia i vajosur i Perëndisë.....
Kapitulli 11
Jezus Krishti, “Fjala e tij” (Kalimatuhuu)
Kapitulli 12
Jezus Krishti, “Shpirti nga Perëndia” (Ruhun Minhu)
Kapitulli 13
Perëndia shpengoi birin e Abrahamit.....

Pjesa e pestë

Përse ishte e domosdoshme që Jezusi të vijë?

Kapitulli 14
Problemi i mëkatit
Kapitulli 15
Perëndia vetë erdhi tek ne në personin e Jezusit.....
Kapitulli 16
Mishërimi i Jezusit

Pjesa e gjashtë

Cilësitë unike të Jezusit.....

Kapitulli 17
Lindja virgjër e Jezus Krishtit.....
Kapitulli 18
Pamëkatshmëria e Jezus Krishtit.....
Kapitulli 19

Veçori tjera unike nga jeta e Jezusit.....	
<i>Pjesa e shtatë</i>	
Kryqëzimi dhe ringjallja e Jezus Krishtit	
Kapitulli 20	
Kryqëzimi i Krishtit sipas islamit.....	
Kapitulli 21	
Kryqëzimi dhe ringjallja e Krishtit sipas Ungjillit.....	
<i>Pjesa e tetë</i>	
Ngritja dhe kthimi i Jezus Krishtit	
Kapitulli 22	
Ngritja e Jezusit	
Kapitulli 23	
Ardhja e dytë e Jezusit.....	
Kapitulli 24	
Veçanshmëria e Jezusit përmbledh përfundimin.....	
<i>Pjesa e nëntë</i>	
Legjenda e tre perëndive në krishterim	
Kapitulli 25	
A adhurojnë të krishterët tre Perëndi?	
Kapitulli 26	
Të kuptuarit e Tre-unitetit të Perëndisë.....	
Kapitulli 27	
Jezus është Bir i Përjetshëm i Perëndisë në një sens unik shpirtëror....	
<i>Pjesa e dhjetë</i>	
Ç'Perëndi sundon universin?	
Kapitulli 28	
Jezusi pranonte adhurim.....	
Kapitulli 29	
Perëndia është dashuri.....	
Kapitulli 30	
Jezusi është Unik sepse është Shpëtimtari ynë.....	
Shtojca	
Literatura	
Referencat.....	
Mirënjohjet	
Lidhur me autorin.....	

PARATHËNIE

Libri “Perëndia të do miku im mysliman”, i autorit amerikan Samy Tanagho, është ribotuar katër herë gjer tani. Autori i këtij libri ka jetuar dhe vazhdon që të jetojë në mesin e myslimanëve, kurse ai u specializua në Universitetin e Kairo me temën mbi Sheriatin Islam, dhe ky lloj kualifikimi paraqet seriozitetin e këtij autori për t’u marrë me çështje të tilla islame dhe krishtere siç është rasti në këtë libër me dimensione apologetike.

Në radhë të parë ky libër tejet i veçantë prezanton një kulturë komunikimi të një teologu të krishterë drejtuar lexuesit mysliman, duke tejkaluar barriera ndërkulturore, andaj edhe titullimi “Perëndia të do miku im mysliman”, është një simbiozë e shëndoshë doktrinare. Askush nuk mund ta patrianizojë atributet apo cilësitë e Perëndisë. Kush mund ta pronësojë dashurinë e Perëndisë për vete dhe ta sanksionojë për të tjerët. Libri synon që të mësojë se Perëndia e do secilin në mënyrë të barabartë dhe pavarësisht prej bindjeve, dallimeve dhe veprave të tyre, por ne duhet pasur një vëmendje virgjër në atë se si është shfaqur dhe zbuluar Perëndia përmes Birit të tij Jezus Krisht duke e dhënë Hirin dhe Dashurinë për gjithë njerëzimin.

Autori në këtë libër ka përdorur një metodë shkrimi dhe argumentimi që është më tepër praktike sesa simbolike, më tepër pragmatike sesa spekulative. Ky libër ofron mori temash specifike të cilat shumë prej tyre kanë pasur një trajtim historik nga të dy religjionet e mëdha botërore (krishterimi dhe islami), disa prej tyre janë krahasime, disa prej tyre janë analiza të reja etj. Mbi të gjitha këto çështje autori bazohet në një historiografi të pasur teologjike, historike dhe filozofike, qoftë ajo hebreje, arabe, greke, amerikane etj.

Autori ka treguar një zell të madh shkencor dhe një pozicion të qartë autorial në librin e tij “Perëndia të do miku im mysliman”. S. Tanagho dëshiron që të vendos një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me lexuesin e tij mysliman, si një individ, gjithmonë duke treguar respekt dhe dashuri ndaj tij, dhe gjithmonë duke hetuar Shkrimet e shenjta, profetët, thellësinë e Perëndisë në dobi të lexuesit të tij, në mënyrë që ai të mund të zgjedh, të dallojë dy gjëra e motive të ndryshme, dy persona e qëllime të ndryshme, dy shkrime dhe interpretime të ndryshme, dy destinime dhe vullnesa të ndryshme, dy rrugë dhe jetë të ndryshme, prandaj autori synon që të vë në pah unitetin absolut dhe bashkësimin e Perëndisë ndaj njeriut.

Në këtë libër gjenden shumë përgjigje, si: A ka ardhur Muhamedi që të themelojë një religjion të ri; Çfarë janë mendimet themelore të Muhamedit ndaj Krishtit dhe pse nuk besonte se Bibla është ndryshuar ndonjëherë; cilat janë disa nga mendimtarët e hershëm islam të cilët e pohonin natyrën hyjnore të Krishtit etj.

Editori: Mr. Femi Cakolli

PROLOGU

Samy Tanagho studioi Ligjin dhe Religjionin Islam për katër vjet në Universitetin Ain Shams (Shkollë e Ligjit) në Kairo, Egjipt.
Ai aplikoi Ligjin në Kairo si një prokuror.
Atje pati mundësinë e studimit të islamizmit dhe ndikimin e tij ndaj ligjit dhe strukturës sociale të botës arabe.

DEDIKIM

**Ua dedikoj librin tim të gjithë myslimanëve të çmuar,
të cilët me sinqeritet kërkojnë ta njohin
dhe ta përjetojnë Perëndinë e Gjallë
(në arabisht: *Allah Al-Hayy*)**

HJRJE

Çdonjëri në këtë botë e kërkon dashurinë, por për shumë kjo është dëshmuar ndryshe. Bitëlsat kënduan "krejt çka iu nevojitet është dashuria", dhe prapë ata u ndanë! Shumë çifte mendojnë se e kanë gjetur dashurinë, por pastaj ajo ju vjedhjet dhe ata dyshojnë nëse ishte dashuri e vërtetë pas të gjithave. Unë dëshiroj t'iu tregoj për DASHURINË E VËRTETË, për një dashuri të pakushtëzuar që mund t'iu revolucionarizojë jetën tuaj. Në fakt ky është tregimi më i madh i dashurisë në historinë njerëzore - Dashuria e Perëndisë për JU! Perëndia ju do aq shumë, miku im mysliman, sa që dëshiron t'iu përfaqon, sikurse një baba që e përfaqon fëmijën e tij. Po, Perëndia dëshiron që ti të bëhesh fëmijë i tij. Ai dëshiron të ketë një marrëdhënie të afërt me ty bazuar në dashurinë e ndërsjellë e jo në frikë!

Personalisht e kam shijuar dashurinë e thellë të Perëndisë. Në 25 vjet e kaluara, unë kam takuar mijëra të krishterë të vërtetë (ndjekës të Krishtit), që e kanë përjetuar dhe vazhdojnë edhe më tutje ta përjetojnë këtë dashuri. Dëshira ime është që shumë myslimanë ta dinë dhe ta përjetojnë dashurinë e thellë dhe personale të Perëndisë për ta. Ky përmallim më ka nxitur për t'iu shkruar. Në Bibël lexojmë: "*Dhe ne njohëm dhe besuam dashurinë që Perëndia ka për ne. Perëndia është dashuri!*" (1Gjoni; 4:16).

Dëshiroj t'iu paraqes disa fakte të rëndësishme lidhur me Jezus Krishtin ("Isa", "Al-Masihu" në Kuran) të gjetura në Kuran dhe në Ungjill. Këto fakte të pamohueshme do t'iu ndihmojnë ta zhvillonin një opinion të informuar lidhur me atë se kush është Jezusi me të vërtetë. Lutja ime është që ju të keni një mendje të hapur dhe një sinqeritet të thellë gjatë kërkimit tuaj për të vërtetën. Gjithashtu, unë lutem që ju të kërkonin nga Perëndia t'iu udhëheq para, gjatë, dhe pas leximit të këtij libri. Gjetja e shtegut të drejtë që mund t'iu udhëheq për ta kuptuar vullnetin e Tij në jetën tuaj dhe çfarë kërkon nga ju, duhet të jetë caku i të gjithëve.

Gjënë e parë kryesore që do t'iu inkurajoja për ta bërë është t'i lexoni në formë lutjesh vargjet e Shkrimit të Shenjtë që i kam përmendur në këtë libër dhe të lejoni Perëndinë t'iu tregojë të vërtetën. Bibla na zbulon neve që Perëndia na fton në një marrëveshje miqësie me Vetveten.


ZEMRA E PERËNDISË

Miku im mysliman, të lutem merre në konsideratë zemrën e Perëndisë ndaj teje. Në Ungjill, te Mateu kap. 18, ne zbulojmë nga fjalët e Jezusit një copëz të dashurisë së Perëndisë për njerëzit e humbur, që nuk janë të sigurtë në krahët e Perëndisë. Ai mëson një shëmbëlltyrë:

Si mendoni? Në qoftë se një njeri ka njëqind dele dhe njëra prej tyre humb rrugën, a nuk do t'i lërë ai të nëntëdhjetë e nëntat mbi male për të kërkuar atë që humbi rrugën? Dhe nëse i ndodh ta gjejë, unë ju them në të vërtetë se ai do të gëzohet më shumë për këtë, se sa për të nëntëdhjetë e nëntat që nuk kishin humbur rrugën. Kështu është dëshira e Atit tuaj që është në qiej, që asnjë nga këta të vegjël të mos humbasë" (Mat.18: 12-14).

Si ilustrim të mëtejshëm të zemrës dhe dashurisë së Perëndisë ndaj teje, dëshiroj të ndajë një ngjarje të vërtetë të një çifti të pasur amerikan. Ata u ulën me këshilltarin martesorë në zyrë e tij për t'iu zgjidhur problemet martesore. Me zemërim burri tha: "Unë nuk i kuptoj problemet e gruas sime. Unë i kam dhuruar asaj një unazë diamanti në përvjetorin e dasmës, kam blerë një shtëpi në plazh, i kam dhënë para për të shpenzuar për çdo muaj". Pasi i numëroi të gjitha ato që i kishte dhënë asaj, gruaja u përgjigj, "Po është e vërtetë Xhek, ti më ke dhënë çdo gjë." Duke rrjedhur lotët nga sytë e saj ajo vazhdoi: "Çdo gjë përveç vetvetes!"

Në këtë libër ju do të shihni se si në fakt Perëndia ju ka dhënë dhuratën përfundimtare të dashurisë - Vetveten!



Samy Tanagho

***" Do të më kërkoni dhe do të më gjeni, atëherë kur
më kërkoni me gjithë zemrën tuaj "***
(Jeremia 29:13)

PJESA E PARË

**DËSHMIA E KURANIT
LIDHUR ME VËRTETËSINË E SHKRIMEVE KRISHTERE**

KAPITULLI 1 **BESUESHMËRIA E BIBLËS**

Në të gjitha faqet e Kuranit dëshmohet për vërtetësinë e Shkrimeve krishtere. Hebrejntë dhe të krishterët përshkruhen në Kuran si "Ithtarët e Librit". Shkrimi hebre është "Tevrati"; Shkrimi i të krishterëve është "Ingjili". Kurani flet me nderim dhe respekt për Tevratin (DHIATA E VJETËR), Zeburin (PSALMET) dhe Ingjilin (UNGJILLI apo DHIATA E RE). Këto shkrime të shenjta e kanë statusin e Fjalës autentike të Perëndisë.

Ju lutem mos e besoni asnjërin që thotë se nuk duhet lexuar Biblën sepse është anuluar me ardhjen e Kuranit. Miku im i nderuar mysliman, nuk ekziston asnjë varg në Kuran që dëshmon se Bibla është bërë e pavlefshme me ardhjen e Kuranit. Për më tepër, nuk ekziston asnjë thënie autoritative në Hadithe që e përkrah këtë deklaratë. Vetë Kurani i urdhëron myslimanët ta shprehin besimin në Bibël. Ne lexojmë në S. 2:136: "Ju thuani "Ne i besuam Allahut, atë që na është u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Ishakut, Jakubit dhe pasardhësve, atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetë atij i jemi bindur."

KEQKUPTIMI LIDHUR ME BIBLËN

Shumë myslimanë gabimisht mendojnë dhe mësojnë sikur Kurani erdhi për t'i zëvendësuar Shkrimet e shenjta hebreje krishtere (Bibla). Ekziston një keqkuptim se ajo është ndryshuar, vjetruar ose është humbur. Ekzistojnë shumë libra të krishterë që prezantojnë fakte vendimtare, duke provuar që Bibla (Dhiata e Vjetër dhe e Re) është complete, autentike, dhe Fjalë e pandryshuar e Perëndisë. Me gjithë këtë, ndihem i detyruar që shkurt t'i adresoj këto thënie dhe t'iu siguroj me disa fakte që dëshmojnë se Bibla nuk është e ndryshuar.

Kurani i konfirmon Shkrimet e shenjta të mëparshme:

Shumë vjet para kohës së Muhamedit (350 vjet pas Krishtit) ekzistonte një kanon uniform i Biblës. Kurani nuk i akuzon të krishterët për ndryshimin e fjalëve të shkruara në Shkrimet e tyre të shenjta, në të kundërtën, Kurani deklaron se (Kurani) është shpallur për konfirmimin e Shkrimeve të mëparshme, e jo për t'i zëvendësuar ato. S. 5:48 thotë: "Ne edhe ty ta zbritëm librin (Kuranin) e vërtetë që është vërtetues i librave të mëhershëm dhe garantues i tyre..."

Kurani dëshmon që Tevratit, Zeburi dhe Ingjili janë Fjalë të Zotit. Dëshmia e Kuranit nuk është e dyshimtë. S. 3:3-4 flet, "Ai ta zbret ty (Muhamed) librin me argument që është vërtetues i librave të mëparshme. Ai e zbriti më parë Tevratin dhe Ingjilin, udhërrëfim për njerëz..."

Referencat e Kuranit lidhur me Tevratin:

Sa i përket Tevratit (Dhiata e Vjetër), ne lexojmë në S. 5:44: "Ne e zbritëm Tevratin, në të cilin është udhëzimi i drejtë dhe drita. Sipas tij gjykuan ndaj atyre që ishin jehudi, pejgamberët që ishin të bindur, gjykuan edhe dijetarët e devotshëm e paria fetare, ngase ishin të obliguar ta ruanin librin e Allahut dhe ishin mbrojtës të tij". Në këtë varg "udhëzimi" i referohet udhëheqjes (drejtimit), dhe "dritë" i referohet një ndriçimi shpirtëror të siguruar nga Perëndia (Allahu). Vargje të tjera në Kuran që diskutojnë për Torën janë këto:

S. 2:87 thotë: "Ne i patëm dhënë Musait librin dhe pas tij patëm dërguar shumë pejgamberë ..."

Ju lutem lexoni tek S. 4:58, S. 28:43, S. 32:23, S. 40:53-54, dhe S. 45:16.

Referencat e Kuranit ndaj Zeburit dhe Ingjilit:

Për Zeburin (Psalmet), Kurani flet në S. 21:105, "Ne kemi shënuar në Zebur..." Lidhur me Ingjilin (Ungjillin), Kurani deklaron në S. 5:46 që Krishti e konfirmon Torën si të vërtetë dhe që Ungjilli i Krishtit përmban udhëheqje, dritë dhe këshillime. Ajo thotë: " Ne vazhduam gjurmët e tyre (të pejgamberëve) me Isain, birin e Merjemës, vërtetues i Tevratit që kishin më parë. Atij i dhamë Ingjilin, që është udhëzimi i drejtë dhe dritë, që është vërtetues i Tevratit që kishin pranë, që ishte udhëzues e këshillues për të devotshmit." Ju lutem gjithashtu lexoni S. 57:27.

Rëndësia e leximit të Ungjillit:

Lexues i nderuar mysliman, për ta përjetuar një marrëdhënie të drejtë dhe të plotë me Perëndinë, ti duhesh ta lexosh Ungjillin (Dhiatën e Re). Kjo do ta zmadhojë kuptimin tuaj për Isanë, Mesinë (Jezus Krishtin). Do të të ndihmojë gjithashtu për ta kuptuar Shpëtimin që Ai dëshiron ta shijosh përmes besimit në Të. Mos i besoni ata që ju thonë se është e panevojshme për ta lexuar Biblën. Opinioni i tyre është në kundërshtim vetë Kuranin. Kurani deklaron qartë se të gjithë myslimanët duhet t'i ndjekin dhe t'u binden Shkrimeve të mëparshme të Shenjta (Bibël). Suret e mëposhtme janë të qarta në këtë aspekt:

S. 2:136 thotë: "Ju thuani "Ne i besuam Allahut, atë që na është u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Ishakut, Jakubit dhe pasaardhësve, atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetë atij i jemi bindur "

S. 2:285: "I dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të Tij, e ashtu edhe besimtarët. Secili i besoi Allahut, engjëjve, shpalljeve të Tij, të dërguarve të Tij. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të dërguarit e Tij dhe thanë: "Iu përgjegjëm thirrjes (dhe respektoam urdhërin)"

S. 4:136 " O ju që besuat, besoni vazhdimisht Allahun, të dërguarit e Tij, librit që gradualisht ia shpalli të dërguarit të Tij dhe librit që e patë zbritur më parë. Kush nuk i beson Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij dhe botës tjetër, ai ka humbur tepër larg."

Sipas Kuranit të gjitha Shkrimet e Shenjta janë të barabarta:

Në S. 2:285 dhe 4:136 të cituara më lartë, vëreni që "Librat e Tij" është në shumës. Kjo nënkupton jo vetëm Kuranin, por edhe Shkrimet e tjera të Shenjta. Në S. 2:136, ju lutem dalloni frazën e rëndësishme, "Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre". Kjo është një urdhër i qartë që të gjithë myslimanët duhet t'i konsiderojnë të gjitha Shkrimet e Shenjta si zbulime të barabarta.

Siç lexojmë në S. 4:136 të lartëpërmendur, në qoftë se ndonjë mysliman injoron apo mohon ndonjë pjesë të shpalljeve të Perëndisë, ai ka "shkuar larg së vërtetës". Gjithashtu, Perëndia do ta dënonte si të pabesë, ashtu siç lexojmë në S. 40:70-72: "Ata janë që përgënjështruan librin dhe atë me çka Ne i dërguam të dërguarit tanë, e më vonë ata do të kuptojnë. Atyre do t'u vihen prangat dhe zingjirët në qafat e tyre e do të zhyten në ujën e valë dhe pastaj do të digjen në zjarr."

Kurani gjithashtu thekson atë çfarë hebrenjtë dhe të krishterët, që jetuan në kohën e Muhamedit, menduan për Kuranin. Mund të lexoni për këtë në S. 2:91: " Dhe kur atyre u thuhet "Besoni atë që e shpalli Allahu", ata thonë: "Ne besojmë atë që na u shpall neve", kurse e mohojnë atë pas tij, edhe pse është vërtetues i atij, që e kanë ata dhe është i vërtetë "

Kurani e konsideron Biblën të jetë e dalluar:

S. 10:94 është një urdhër i dhënë Muhamedit (dhe myslimanëve) ta konsiderojnë Biblën si burim primar të ndriqimit: "Po, nëse je në dyshim për këtë që të zbritëm ty, atëherë pyeti ata që lexojnë librin para teje". Ky varg shumë qartë i udhëzon besimtarët myslimanë t'i referohen Biblës kur ngriten pyetje lidhur me kuptimin e Kuranit. Është e qartë nga ky varg, se në rast të çdo dyshimi për zbulime të caktuara në Kuran, Muhamedit i urdhërohet nga Perëndia të konsultohet me hebrejtë dhe të krishterët që i lexonin Shkrimet e tyre të Shenjta. Ashtu që S. 10:94, është një urdhër për Muhamedin për të testuar besueshmërinë e mesazhit të tij nga përmbajtja e Shkrimeve të Shenjta të hebrejve dhe të krishterëve.

Miku im i nderuar, Kurani nuk pohon që Perëndia e dërgoi (Kurantin) për ta parandaluar korruptimin, ose ndryshimin apo zëvendësimin e Fjalës së Shenjtë të Perëndisë që gjendet në tërë Biblën (Tevrat dhe në Ingjil). Në të kundërtën të gjitha vargjet e cituara më herët, e konfirmojnë autencitetin biblik.

Kurani pranon që judenjtë e posedojnë Fjalën e Perëndisë:

Ekzistojnë edhe shumë vargje në Kuran që dëshmojnë se Tora ishte në dispozicion në një formë të pafalsifikuar gjatë kohës së Muhamedit. Për shembull, një konflikt ishte ngritur në mes të hebrejve në Medina, dhe i kishte ardhur në vëmendje të Muhamedit. Kurani i drejtohet Muhamedit: "E si kërkojnë ata gjykimin tënd, kur ata kanë Tevratin, në të cilin është vendimi i Allahut ..."(S. 5:43). Merrni në konsideratë gjithashtu, S. 2:101 që deklaron: "E kur u erdhi atyre ndonjë i dërguar prej Allahut, vërtetues i asaj që e kishin ata...". Këto vargje mësojnë qartë se hebrejtë e Medinës e kishin Torën e vërtetë (Dhiatën e Vjetër) në posedim në kohën e Muhamedit dhe ishte e besueshme për t'i zgjidhur konfliktet e tyre.

Keni parasysh që gjatë gjithë historisë së tyre, hebrejtë i kanë njohur vetëm Shkrimet në Librat e Dhiatës së Vjetër, sikurse i njohim ne sot. Kurani kurrë nuk deklaroi që Tora ishte një libër i ndryshëm nga Ai që vetë hebrejtë e pranuan si Torë

Kurani pranon që të krishterët e posedojnë Fjalën e Perëndisë:

Kurani gjithashtu e konfirmon autencitetin biblik në lidhje me Dhiatën e Re. S. 5:47 flet "Që ithtarët e Ingjilit të gjykojnë sipas asaj që Allahu e zbriti. E kush nuk gjykon sipas asaj që Allahu e zbriti, të tillët janë mëkatarë të dalë jashtë rrugës së Zotit". Si pritet që të krishterët të gjykojnë me Ingjil përveç nëse e kishin në posedim? Bota e krishterë e ka njohur vetëm një Ingjil, që ekzistonte shekuj më parë para kohës së Muhamedit dhe vazhdon të ekzistojë deri sot. Kurani kurrë nuk deklaroi që Ungjilli ishte një libër i ndryshëm pres asaj që të krishterët e shfrytëzonin në kohën e Muhamedit. Dhe Kurani kurrë nuk i akuzoi hebrejtë dhe të krishterët për ndryshim të tekstit aktual të dorëshkrimeve biblike.

Referenca plotësuese për Torën dhe Ungjillin:

Kurani e konfirmon përkrahjen ndaj Torës dhe Ungjilit dhe i nxitë hebrejtë dhe të krishterët ta njohin autoritetin e Shkrimit të tyre të Shenjtë (Biblën). Thuhet në S. 5:68: "Thuaj: "O ithtarë të librit, ju nuk jeni asgjë derisa të mos zbatoni Tevratin, Ingjilin dhe atë që ju zbriti nga Zoti juaj..."
Kjo S. është shembull i qartë për të dëshmuar se hebrejtë dhe të krishterët e kishin Fjalën e Zotit (Tevratin dhe Ingjilin) para shkruarjes së Kuranit.

Pasi që hebrenjve dhe të krishterëve iu kërkohet t'i observojnë urdhërat që ekzistojnë në Shkrimet e tyre, në qoftë se Libri i tyre kishte humbur, do të ishte e pamundur për ta për t'i njohur urdhërimet që duhet t'i zbatonin. Apo në qoftë se Bibla ishte ndryshuar më herët, ata do të shkonin larg rrugës së drejtë në qoftë se do t'i zbatonin.

Kur ka indikacione para se gjithash në Kuran që Muhamedi të ketë menduar për Shkrimet e Shenjta të cilët hebrenjtë dhe të krishterët i kishin në posedim, ishin diçka tjetër nga Librat e shenjtë origjinale që Perëndia iu kishte zbritur atyre.

Kurani në S. 5:47 e shfrytëzon termin "Ingjil" (Ungjill), e është i njëjti term që ndjekësit e Jezusit e shfrytëzuan. Ju lutem referohuni tek Marku 1:1 "Fillimi i Ungjillit të Jezus Krishtit ... " Në fakt, arabët e krishterë ende e përdorin fjalën arabe "Ingjil."

Dijetarët e hershëm myslimanë e përkrahën integritetin e Biblës:

Me qindra vjet pas vdekjes së Muhamedit, shumë prej dijetarëve të mirënjohur myslimanë e mbrojtën integritetin e Biblës. Atë Tabari ishte një ish krishterë, jeta e të cilit karakterizohet me mbrojtjen e islamit para hebrenjve dhe të krishterëve përderisa ai ishte në Bagdad (kryeqytet i botës muslimane në kohën e tij). Ai shkroi nën drejtimin e sundimit të Kalifit Abasid Mutauakil (846-861 pas Krishtit). Në asnjë moment nuk i akuzoi hebrenjtë apo të krishterët me korruptimin e Shkrimeve të tyre. Ai njohu që Tora dhe Ungjilli autentik ngeli në duart e hebrenjve dhe të krishterëve. Ai shkroi një libër të famshëm, të quajtur "Libri mbi religjionin dhe perandorinë", në të cilin ai tha: "Për sa i përket Ungjillit që është në duart e të krishterëve, pjesa më madhështore e saj është historia e Krishtit, lindja dhe vdekja e Tij."

Një dijetar tjetër, Al Gazali (1058-1111 pas Krishtit), ishte konsideruar njëri prej teologëve më të mëdhenj myslimanë në historinë e islamit. Në shkrimet e tij kurrë nuk e sfidoi integritetin e Biblës. Përveç kësaj ai shkroi traktate mbi Trinitetin, në të cilat ai citoi shumë vargje prej Biblës, pa dyshuar besueshmërinë e tekstit.

KAPITULLI 2

SHPALLJA E MYSLIMANËVE SE BIBLA ËSHTË NDRYSHUAR

Çdo akuzë se Bibla është ndryshuar ngrit një sërë pyetjesh që kërkojnë përgjigje nga ata myslimanë që i bëjnë këto pyetje. Kur ka ndodhur ky ndryshim i Shkrimit të Shenjtë?

A. Para kohës së Muhamedit?

Të gjitha vargjet e cekura në kapitullin e mëparshëm dëshmojnë qartë se Muhamedi nuk ka besuar që Bibla të jetë ndryshuar në kohën e tij.

B. Pas vdekjes së Muhamedit?

Nuk është e mundur që Bibla të ketë ndryshuar pas vdekjes së Muhamedit sepse në vjet 600 pas Krishtit, krishterimi tashmë ishte përhapur në Azi, Afrikë dhe Evropë.

Një komplot i pamundur:

Nuk është racionale për të supozuar se të krishterët dhe hebrenjtë në mbarë botën të takohen dhe të pajtohen për ndryshimet e Shkrimeve të tyre të Shenjta. Historia dëshmon (sikurse edhe Kurani në S. 2:113) se hebrenjtë dhe të krishterët në mes tyre kanë pasur diferenca të mëdha doktrinale. Dhe ata kanë qenë në mospajtim për shumë çështje religjioze.

Gjithashtu lexojmë në shumë vargje në Kuran se të krishterët ishin të ndarë në shumë sekte, sikurse në S. 3:19 dhe S. 98:4. Prandaj në qoftë se Shkrimet ishin ndryshuar për ta ndryshuar doktrinën, së paku një prej shumë sekteve brenda judaizmit apo krishterimit në atë

kohë do të protestonin. Deri sot nuk ekziston ndonjë shënim historik për ndonjë akuzë apo mosmarrëveshje të tillë.

Dëshmi tjera lidhur me saktësinë tekstuale të Biblës:

Në vijim, Jezusi kurrë nuk i akuzoi të krishterët për ndryshimin e Shkrimit. Në të kundërtën, Ai citoi prej shumë librave të Shkrimit të Shenjtë të hebrenjve (Tora, Psalmet dhe Profetët) kur iu foli atyre. Dhe, gjatë kohës së Muhamedit, shumë dijetarë të krishterë të sinqertë (abisianitët), të cilët myslimanët i donin dhe u shoqëronin me ta, do t'i paraqisnin përpjekjet e ndryshimeve të Shkrimit.

S. 5:82 i përshkruan këta të krishterë "Gjithqysh ti do të vëresh se jehuditë dhe ata që i përshkruan Zotit shok (idhujtarët) janë njerëzit me armiqtësi më të fortë kundër besimtarëve (myslimanëve), ndërsa do të vëresh se më të afërmit si miq për besimtarët janë ata që thanë : "ne jemi nesara-krishterë". Këtë ngase prej tyre (të krishterëve) ka dijetarë dhe të devotshëm, dhe se ata nuk janë kryeneç."

Vëreni që ky varg i përshkruan këta të krishterë si "dijetarë dhe të devotshëm". Pasi që këta krishterë të devotshëm i dinin mjaft mirë shpalljet që iu ishin dhënë nga Perëndia, ata do ta zbulonin çdo përpjekje të falsifikimit. Nga vargu gjithashtu kuptojmë se "ata nuk janë kryeneç" që nënkupton se ata bënë një jetë të perëndishme. Kështu që ata nuk do të bënin një mëkat të tillë të tmerrshëm të ndryshimit apo ndryshimit të Shkrimeve të tyre të Shenjta.

Mungesa e dëshmive për ndryshim tekstual:

Gjithashtu, sipas S. 5:66 ekzistonin një numër i madh i hebrenjve dhe të krishterëve që nuk bënin kompromise, që ishin besnik dhe të patundur në Ligj dhe në Ungjill. Andaj një grup i tillë i palëkundur do t'i paraqiste çdo përpjekje të ndryshimit të Shkrimeve të tyre të Shenjta. Ky varg e thekson "është një grup i drejtë prej tyre ..."

Si shtesë, prej kohës së Muhamedit e tutje, shumë hebrenj dhe të krishterë në vendet e pushtuara nga myslimanët përqaftuan islamin. Pasi që myslimanët kishin respekt për Shkrimet e Shenjta të judenjve dhe të krishterëve; judenjtë dhe të krishterët që u bënë mysliman do t'i mbanin edhe më tej Shkrimet e tyre të Shenjta. Ende nuk është zbuluar ndonjë tekst që ndryshon prej Biblës së sotme.

Në qoftë se hebrenjtë dhe të krishterët kanë bashkëpunuar ta ndryshojnë Biblën, sigurisht ndonjë prej këtyre të konvertuarëve myslimanë do të ishin në gjendje për të prodhuar kopje të pandryshuara të Librave të Shenjta. Në fakt, me qindra dorëshkrime ekzistojnë sot që nga shekulli i katërt dhe i pestë (islami filloi në shekullin e gjashtë). Këto dorëshkrime përputhen me përkthimet e sotme të Shkrimeve. Ndonjë mospërputhje mund të jetë e imtë dhe nuk ndikon në ndonjë doktrinë thelbësore. Andaj, Dhiata e Re e kohës së Muhamedit është e njëjtë me Dhiatën e Re sot.

Krahasimet e përkthimeve biblike na zbukojnë saktësinë tekstuale:

Përveç kësaj, ata që e kishin përqaftuar krishterimin në Azi, Afrikë, dhe Evropë nuk kishin gjuhë të përbashkët. Bibla qarkullonte në mbarë botën dhe në shumë gjuhë të ndryshme. Kjo do të bënte të pamundur çdo përpjekje të falsifikimit të Shkrimit të Shenjtë. Dhe krahasimet e këtyre përkthimeve biblike në gjuhë të ndryshme na zbulojnë saktësi të plotë të tekstit biblik

Duke sfiduar bazën e akuzimeve:

Këto rrethana e bëjnë të pamundur që judenjtë dhe të krishterët të jenë mbledhur së bashku për ndryshimin e Shkrimeve të tyre të Shenjta. Andaj ne kërkojmë sqarim nga ata njerëz që pohojnë se Bibla është ndryshuar, dhe i pyesim:

- Kur dhe ku ndodhi ndryshimi?
- Kush ishin fajtorët?
- Si e arritën marrëveshjen?
- Në qoftë se ekzistonte një Bibël origjinale që ndryshoi, ku është tani që të mund ta krahasojmë? Dhe në qoftë se është ashtu, çfarë ndryshime specifike tekstuale i ishin bërë dorëshkrimit origjinal?

SI ISHTE NDRYSHUAR BIBLA?

Sipas historisë, në kohën kur Muhamedi jetoi, judaizmi dhe krishterimi ishin përhapur në mbarë botën. Prandaj, do të ishte e pamundur për çdo kënd apo për ndonjë grup që t'i mbledhin të gjitha Librat e Shenjtë, dorëshkrimet dhe shkrimet që përmbanin referenca Shkrimore nga të gjitha kishat, sinagogat, bibliotekat dhe shtëpitë për t'i bërë ndryshimet. Pastaj zëvendësimi do të duhej të kthehej pa u diktuar. Si kanë mundur ata që ta bindnin çdonjërin që e kishte Biblën për ta ndryshuar atë në një version të revizionuar (ndryshuar), pastaj t'i shkatërrojnë të gjitha Biblat origjinale, dhe të mos lëjnë asnjë evidencë?

Fjala e Perëndisë është e pandryshuar:

Fjala e Zotit është e pandryshuar mu ashtu siç Zoti fillimisht e ka paraqitur origjinalisht në Shkrimet e Shenjta të judenjve dhe të krishterëve. Vetë Kurani shpall vazhdimisht se askush nuk mund ta ndryshojë fjalën e Zotit. S. 6:34 deklaron: "S'ka kush që ndryshon fjalët e Allahut..." S. 10:64 "Fjalët (premtimet) e Allahut nuk mund të pësojnë ndryshim..." S. 6:115 dhe 18:27 citojnë: "S'ka kush që të ndryshojë fjalët e Tij..."

Në vijim të saj, Bibla thekson që Fjala e Zotit nuk ndryshon. Në Dhiatën e Vjetër, tek Isaia 40:8 lexojmë: "Bari thahet, lulja vyshket, por Fjala e Perëndisë tonë mbetet përjetë". Shembull tek Dhiata e Re gjendet tek Lluka 16:17: "Qielli dhe toka do të kalojnë, por fjalët e mia nuk do të kalojnë" (Mateu 24:35).

Andaj, kushdo që pohon se Bibla është ndryshuar apo ndryshuar, de fakto e quan Perëndinë gënjeshtar dhe e akuzon atë si të paafte për ta mbrojtur dhe ruajtur Fjalën e Tij.

Vetëm interpretimet e Fjalës së Perëndisë mund të korruptohen:

Abdullah Ibn Abbas ka dhënë mendimin lidhur me temën "Tahrif" (siç është dokumentuar nga Imam Al Buhariu): "Fjala "Tahrif" (korruptim) nënkupton ta ndryshosh një gjë prej formës origjinale, dhe nuk ka asnjë njeri që mund të ndryshojë edhe një fjalë të vetme prej asaj që rrjedh nga Perëndia, ashtu që hebrenjtë dhe të krishterët mund të korruptojnë vetëm duke keqprezentuar kuptimet e Fjalës së Zotit." (Për të lexuar më tepër për Abdullah Ibn Abbass-in ju lutem referohuni indeksit të këtij libri).

Ne e kemi edhe një pyetje të rëndësishme për t'ua bërë atyre që pohojnë se teksti biblik është ndryshuar. Çfarë mund të jetë përfitimi?

SI KANË MUNDUR TË PËRFITOJNË JUDENJTË DHE TË KRISHTERËT NGA NDRYSHIMI I MUNDSHËM I SHKRIMEVE TË TYRE?

Në shërbim të çfarë qëllimi do të ishte nëse judenjtë dhe të krishterët i kanë ndryshuar Shkrimet e tyre? Pse pastaj ata do të vazhdonin t'i besonin Shkrimeve të tyre? Në qoftë se e kanë bërë këtë, si kanë mundur t'i përcjellin te fëmijët e tyre? Kjo është iracionale dhe nuk ofron para se gjithash kurrfarë përfitimi.

Bibla kurrë nuk përmbante profeci lidhur me Muhamedin:

Disa myslimanë pohojnë që judenjtë dhe të krishterët i kanë ndryshuar Shkrimet me qëllim që t'i humbin profecitë lidhur me Muhamedin. Por pse? Çka do të shpresonin judenjtë dhe të krishterët të fitojnë duke bërë ashtu? Nëse këto profeci ishin fillimisht në Bibël, pse nuk do ta ndjeknin pastaj ata Muhamedin? Gjithashtu me t'u bërë myslimanë ata do të përfitonin me ndarjen e plaçkave që iu kishin dhënë myslimanëve gjatë pushtimit të Persisë, Sirisë, Palestinës, Egjiptit, dhe shumë vende të tjera.

Në qoftë se profeci të tilla lidhur me Muhamedin kanë ekzistuar, pse do të sjellnin vuajtje judenjtë dhe të krishterët mbi vetveten dhe të dashurit e tyre këtu në tokë dhe përherë duke eliminuar dhe si rrjedhim tjetërsimin e Fjalës së Zotit? Në fakt tundimi do të ishte më i madh për t'i futur profecitë për Muhamedin sesa për ta eliminuar ndonjë. Për shembull, me t'u bërë mysliman, ata do t'i mënjanoreshin statutit të disfavorshëm si minoritet në kohën kur Muhamedi vdiq dhe kur islami po përhapej në mënyrë të shpejtë.

KAPITULLI 3

UNGJILLI ËSHTË LAJMI I MIRË I PERËNDISË

Ungjilli e furnizon racën njerëzore me zbulime të qarta të shkruara nga Perëndia lidhur me atë se si mund të "shpëtohem" nga ferri dhe të përjetojmë jetën e përjetshme me Perëndinë. Fjala "ungjill" nuk i referohet një libri dhënë Jezusit nga Perëndia, por i referohet Lajmit të Gëzuar të dashurisë së Perëndisë rreth çdonjërit, lajm që erdh tek ne përmes Jezus Krishtit.

Zbulim i gjallë nga Perëndia:

Ne e dimë nga të lexuarit e Ungjillit se Jezus Krishti, një person i gjallë, është zbulim perfekt i Perëndisë për racën njerëzore (Heb. 1:1-4). Ne lexojmë në Ungjill se "Jezusi shkante kudo nëpër Galile...duke predikuar Ungjillin e mbretërisë dhe duke shëruar çdo sëmundje dhe lëngatë në popull. Pas kësaj, Jezusi i autorizoi apostujt e tij, të fuqizuar përmes Shpirtit të Perëndisë, për të bartur këtë Lajm të Mirë tek popujt e tjerë, e pastaj edhe në mbarë botën (Veprat 1:8 dhe Mateu 18:18-20).

Frymëzimi hyjnor vjen nga Perëndia:

Është vetëm një "Ungjill" dhe vetëm një Krisht. Perëndia i inspiroi apostujt e Jezusit përmes udhëheqjes së Shpirtit të Shenjtë për të na treguar për personin, jetën dhe mësimet e Jezusit. Bibla bën të ditur se "I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi, që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer, tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë " (2Timoteut 3:16-17). Ky varg nënkupton që Perëndia frymëzoi fjalët dhe mendimet e Tij përmes të Dërguarve të Tij të zgjedhur. Perëndia është Autori përfundimtar i mesazhit dhe doktrinës së Ungjillit. "Sepse asnjë profeci nuk ka ardhur nga

vullneti i njeriut, por njerëzit e shenjtë të Perëndisë kanë folur, të shtyrë nga Shpirti i Shenjtë" (2 Pjetrit 1:19-21).

Një dijetar i krishterë David W. Shenk e sqaron "frymëzimin hyjnor" kështu: "Frymëzimi hyjnor nuk do të thotë diktim hyjnor. Të krishterët nuk besojnë se profetët që e folën apo e shkruan Fjalën e Perëndisë ishin (të pamendë) gypa nga të cilat Fjala e Perëndisë rrjedhte. Në të gjitha shkrimet biblike, personaliteti i shkrimtarëve të ndryshëm është evident... Veprimtaria frymëzuese e Perëndisë nuk e mënjanon përfshirjen njerëzore në këtë proces. Gjurma e personalitetit njerëzor është pjesë e përmbajtjes së zbulimeve biblike. Bibla është një shpallje mahnitëse në gjuhën njerëzore dhe formave mendore. Bibla është një dramë mahnitëse e zbulimit të Perëndisë ndaj njerëzve, dhe profetët e frymëzuar të Perëndisë shprehën këtë zbulim në gjuhën njerëzore dhe në format mendore"¹.

Katër prezetime të Ungjillit të Perëndisë:

Librat individuale të dishepujve - Mateut, Markut, Lukës dhe Gjonit - janë dëshmi të jetës dhe mësimëve të Jezusit. Jezusi iu dha siguri që Shpirti i Shenjtë do ta udhëhiqte shkrimin e tyre. "Por Ngushlluesi, Fryma e Shenjtë, që Ati do ta dërgojë në emrin tim, do t'iu mësojë çdo gjë dhe do t'iu kujtojë të gjitha këto që ju thashë" (Gjoni 14:26). Shikoni gjithashtu Gjonin 16:13, Lukën 1:1-4 dhe 2Pjetrin 1:16-21.

Lexues i nderuar, kur e studioni "Ungjillin e Gjonit", ju jeni duke e studiuar Lajmin e Mirë të mbretërisë së Perëndisë të mësuar nga Jezusi dhe autoritativisht lidhur me Gjonin. Gjoni ishte shoqëruar i afërm i Jezusit. Çdonjëri prej shkrimtarëve prezenton një aspekt të ndryshëm të karakterit të Jezusit, Mesisë. Jezusi prezentohet si "Mbret" tek Mateu. Ai prezentohet si "Shërbëtor" tek Marku. Jezusi përshkruhet si "Njeri i përsosur" nga Luka. Ai shpallet si "Bir i Perëndisë" tek Gjoni (njëri nga dëshmitarët okular të vdekjes dhe ringjalljes së Jezusit).

Ju lutemi vëreni që apostull Gjoni na siguron që dishepujt në fakt ecën dhe biseduan me Jezusin: "Atë që ishte nga fillimi (Jezusi), atë që dëgjuam, atë që pamë me sytë tanë, atë që vështruam dhe që duart tona e prekën lidhur me Fjalën e jetës - këtë po jua shpallim lidhur me Fjalën e Jetës. Jeta u shfaq dhe ne e pamë dhe dëshmojmë për të, dhe ju shpallim... (1Gjoni 1:1-3). Të gjithë dishepujt shkruan një mesazh, që është Ungjilli (Lajmi i Mirë) të cilin Jezusi ia prezantoi botës. Jezusi për më tepër, profetizoi shtatëmbëdhjetë herë për përhapjen e Ungjillit (shembuj Mateu 24:14 dhe 26:13, Luka 21:33 dhe Veprat 1:8).

Përveç katër prezetimeve të Ungjillit, Dhiata e Re përmban gjithashtu mësimë dhe letra të frymëzuara, të shkruara nga apostujt e Jezusit grupeve të ndryshme të krishterë, dhe përfundimisht të gjithë besimtarëve (p.sh 1Korintasve 2:1-14). Edhe Kurani e pranon që Perëndia i frymëzoi shumë të dërguar (S. 21:7).

Mbase mund të habitesh, miku im, pse ekzistojnë shumë përkthime të ndryshme (versione) të Biblës. Myslimanët nuk i zënë besë asnjërit prej përkthimeve të Kuranit arab dhe në fakt as nuk e konsiderojnë si Fjalë reale të Zotit. Në anën tjetër, të krishterët e njohin besueshmërinë e përkthimeve të Biblës përderisa e japin mësimin dhe kuptimin e gjuhës origjinale.

Miku im mysliman, dëshmia më e rëndësishme se Ungjilli është hyjnor është kur lexohet në formë lutjesh. Atëherë Perëndia me të vërtetë do të të flasë përmes faqeve të Fjalës së Tij - dhe do e ndryshojë jetën tuaj.

SIGURIA E BIBLËS

Disa prej faqeve të ardhshme paraqesin shkurtazi disa prej dëshmimeve për sigurinë e Biblës. Ju lutem kuptoni që ekzistojnë me qindra libra të shkruara që prezantojnë dëshmi

përfundimtare që përkrahin autencitetin dhe besueshmërinë e Biblës. Një libër mjaft i popullarizuar është "Dëshmia e re që kërkon vendim", nga Xhosh Mekdouelli.

Njerëzit shpeshherë pyesin "Si mund ta dimë me siguri që ndonjë shkrim është prej Perëndisë?" Bibla i paralajmëron lexuesit "Provoni të gjitha, mbani të mirën" (1Selanikasve 5:21).

Pamarrë parasysh opinionin e miqve, të familjes apo të shoqërisë, fati ynë individual qëndron në peshore. "Zgjidhja" jonë e Librit të Shenjtë duhet të konsiderohet me kujdes dhe duke u lutur. Perëndia na ka dhënë mendjen të testojmë gjëra të tilla. Të injorosh këtë dhuratë për shkak të presionit të tjerëve do të ishte një ofendim për Atë që na krijoi. Atëherë çfarë lloj testesh (provash) ekzistojnë për të shikuar në qoftë se ndonjë gjë është në mënyrë mbinatyrore e frymëzuar nga Perëndia? Janë tri lloj provash kryesore:

1. A është PROFETIKE dhe e VËRTETUAR?

Kjo është prova më e rëndësishme. Në Bibël, Perëndia zbuloi që prova për profeci të vërtetë është se duhet të realizohet 100% me saktësi. Profetë që nuk ishin 100% të sigurtë konsideroheshin fals dhe duhej të gurëzoheshin me vdekje (Ligji i Përtërirë 18:20). Dikush duhet ta bëj pyetjen: "Pse është një provë e tillë në Bibël dhe në asnjë "Libër tjetër religjioz"? Dhe pse Bibla përmban një numër të madh të profecive specifike HISTORIKE (të vërtetuara) përderisa librat tjerë nuk përmbajnë gati asnjë? Sigurisht, vetëm Libri i Shenjtë i një Perëndie të gjithëdijshëm mund ta prezentojë të VËRTETËN totale.

2. A është e BESUESHME?

Dëshmia për besueshmërinë e dorëshkrimeve biblike e tejkalon aq tepër dëshminë ndaj të gjitha shkrimeve të tjera të lashta. "Në kontrast të numrit total të mbi 5000 dorëshkrimeve të njohura sot, të Dhiatës së Re, librat tjerë historikë dhe religjioz të botës së lashtë zbehen në rëndësi", shkruan Geisler dhe Nix³. Ju lutemi shihni diskutimin e plotë në dy librat klasike: *Nga Perëndia tek ne: Si e morëm Biblën tonë*, nga Norman Geisler dhe William Nix, dhe *Dokumentet e Dhiatës së Re: A janë të besueshme?* Ju sigurisht do të bindeni për besueshmërinë e Biblës pasi t'i lexoni ato⁴.

3. A është e QËNDRUESHME?

E tërë Bibla është në harmoni edhe pse gjashtëdhjetë e gjashtë librat e saj ishin shkruar nga katërdhjetë autorë që erdhën nga prapavija të ndryshme edukative dhe kulturore. Ata jetuan në tre kontinente të ndryshme (Afrikë, Azi dhe Evropë) dhe shkruan në tri gjuhë të ndryshme. Dhe Bibla përmban shumë tema kontraverse që u shkruan për një periudhë për më tepër se 1500 vjet. Duke marrë parasysh këtë, dikush mund të presë që një libër i tillë të përmbajë kontradita, joqëndrueshmëri në mesazhin e saj, simbolizëm, përmbajtje, dhe më e rëndësishmja, në përfundimin e tregimit. Sepse kush mund të gjejë katërdhjetë autorë sot në një dhomë e të pajtohen 100 % së paku në një pikë kontraverse? Kurse Bibla është e qëndrueshme pikë për pikë nëpër tërë tekstin e saj. Ky unitet, vetvetiu, është mrekulli.

DËSHMIA PROFETIKE

Në Bibël, tek Isaia 46:9-10, Perëndia deklaroi se Ai është jashtëkohor : "...Unë jam Perëndia dhe nuk ka asnjë tjetër; jam Perëndia dhe askush nuk më ngjet mua, Unë shpall fundin që në fillim, dhe shumë kohë më parë gjërat që ende nuk janë bërë..."

Për të provuar, supozojmë, ndonjë punë të Shenjtë konsiderata e parë duhet të jetë: "Çfarë dëshmie ka aty?" A janë fjalët dëshmi? Sigurisht që jo, sepse çdo gjë mund të paraqitet të

jetë e vërtetë. A janë besimet dëshmi? Njerëzit mund të jenë të indoktrinuar të besojnë çdo gjë. Megjithatë, në qoftë se dikush do të mund të parathoshte (profetizonte) të ardhmen me saktësi të plotë, (paralajmërimet e tij specifike janë realizuar dhe verifikuar historikisht), do të mund të vërtetohej që informacioni erdh nga Perëndia. Mendo për këtë. Në qoftë se dikush apo diçka të paralajmëronte në mënyrë të saktë të ardhmen përveç Përëndisë, sot nuk do të ekzistonte lotoja apo industria e bixhozit. Vetëm Perëndia e posedon aftësinë për të NJOHUR tërësisht atë që do të vijë. Për të analizuar e ndonjë punë që pohohet se është "nga Perëndia", pyetja e parë do të duhej të ishte: "çfarë evidence ekziston aty, që e dëshmon frymëzimin hyjnor apo profecinë"? Së pari, le t'i kosiderojmë profecitë biblike të realizuara, që janë historikisht të dëshmuara. Bibla përmban me qindra profeci pralajmëruese të shkruara përpara me qindra vjet më herët për njerëz apo ndonjë ngjarje. Vetëm Perëndia mund ta shkruajë historinë përpara!

PROFECITË BIBLIKE

Profecitë historike:

Vetëm Bibla në mënyrë mahnistëse paralajmëron ngjarje të sakta historike shekuj më herët realizimit të tyre. Dhe këto profeci mbështetën nga dëshmitë arkeologjike. Më lejoni t'iu jap vetëm një shembull: Profeti Isaia (tek Isaia 44:28) paralajmëroi 150 vjet më herët se do të lindte një mbret emri i të cilit do të ishte "Kiri". Ky mbret do t'i çlironte hebrenjtë nga robëria e babilonasve, për t'u kthyer në atdheun e tyre dhe për të ndërtuar kombin dhe tempullin e tyre. Isaia e dha këtë paralajmërim atëherë kur hebrenjtë ishin të fuqishëm dhe Babilonia ishte vetëm një krahinë e vogël në Perandorinë Asiriane. Çdo gjë që Isaia tha për Kirin u realizua. Kiri, një mbret pagan, në fakt u dha të holla hebrenjve të robëruar për të rindërtuar qytetin dhe tempullin e tyre. Kjo ofertë nga një mbret pagan kurrë nuk është bërë më herët dhe nuk është bërë deri tani. Kjo profeci e emëroi mbretin dhe dekretet e tij shumë më herët se që mbreti dhe mbretëria e tij kishin ekzistuar!

Profecitë Mesianike:

Ekzistojnë 332 profeci specifike në Dhiatë të Vjetër lidhur me lindjen, jetën, shërbesën, gjykimin, kryqëzimin, vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit. Çdonjëra prej tyre ishte realizuar 100 % me saktësi në jetën e Jezus Krishtit. Për shembull, lokalizimi ekzakt i lindjes së Mesisë ishte profetizuar të jetë në qytetin Betlehem (Mikea 5:2). Dhe konsideroni probabilitetin e rastit të ndonjë njeriu që do t'i përmbushte 8 prej 332 profecive. "Kemi gjetur se gjasat për ndonjë njeri që ka jetuar në tokë gjer në kohën e tashme dhe t'i përmbushë të gjitha 8 profecitë është 1 në 1017 (10 në fuqinë e 17-të)."⁵ Ju lutem shikoni diskutimet e mëtejshme në kapitullin e 10.

Profecitë shkencore:

Formë tjetër e profecive janë edhe informatat shkencore të gjetura në Bibël. Urtësia u ishte dhënë autorëve biblikë 2000 apo më shumë vjet më herët para se shkenca moderne ta zbulonte. Një shembull nga astronomia është: *Bibla përshkruan përafërsisht 3000 vjet më herët se dielli e ndjek një trajektore rrotulluese nëpër univers. "Ai (dielli) del nga një skaji i qiejve dhe rrotullimi i tij arrin deri në skajin tjetër; asgjë nuk mund t'i fshihet nxehtësisë së tij" (Psalm 19:6). Ne sot sigurisht e dimë që kjo është fakt. Bibla përshkruan që Toka është e rrumbullakët (Isaia 40:22). Dhe Toka "mbahet" në asgjë në hapësirë (Jobi 26:7).*

Në librin e tij, *Shkenca dhe Bibla*, Dr Henri Morris identifikon shumë prej profecive shkencore të gjetura në Bibël. Ju mund ta merrni parasysht këtë libër të fascinuar për informata më të detalizuara.⁶

Shumë liderë religjioz kanë pohuar që shkrimet e tyre janë shkrime të shenjta. Por ASNJËRI nuk i qëndroi provës së profecisë së saktë totale. Vetëm Bibla e kalon këtë provë.

Profecitë e saj të realizuara, të detalizuara, na shtyjnë të konkludojmë autencitetin e saj pa dyshim. Do të lexoni më tepër nëpër tërë këtë libër lidhur me profecitë e realizuara. Një libër i shkëlqyeshëm referues është: *Çdo profeci e Biblës*, nga John, F. Walvoord.⁷

BESUESHMËRIA

Dëshmia e dokumenteve të vjetra/dorëshkrimeve:

Sot të krishterët posedojnë shumë dorëshkrime të vjetra të Biblës që datojnë shumë gjenerata para se Muhamedi të niste religjionin islam. Këto dorëshkrime ishin shkruar shumë më herët se Kurani të ishte shkruar. Çuditërisht, Bibla e sotme nuk dallon prej këtyre dorëshkrimeve të lashta biblike:

1. Codex Vaticanus (daton nga 325-350 para Krishtit):

Ky dorëshkrim përfshin të gjitha librat e Biblës deri në Librin e Dhiatës së Re të hebrenjve (deri tek hebrenjve 9:14).⁸ Pjesa e ngjitur e Dhiatës së Vjetër është përfshirë nga një dorë e mëvonshme.⁹ Codex Vaticanus sot lokalizohet në Bibliotekën e Vatikanit.

2. Codex Alexandrinus (daton nga viti 400 para Krishtit):

Ky dorëshkrim përmban gati tërë Biblën. Ky dorëshkrim i ruajtur mbahet në Muzeun Britanik.¹⁰

3. Codex Sinaiticus (daton nga viti 350 para Krishtit):

Ky dorëshkrim e përmban tërë Dhiatën e Re dhe një pjesë të Dhiatës së Vjetër. Gjithashtu gjindet në Muzeun Britanik.¹¹

Fakti se këto dorëshkrime ekzistuan së paku 200 vjet më herët se Muhamedi ta formojë islamin nënkuptohet që i vetmi Libër i Shenjtë në dorën e të krishterëve në kohën e Muhamedit konsistoi prej të njëjtës Dhiatë të Vjetër dhe të Re që ne sot e kemi.

DHIATA E VJETËR (TORA)

Pergamenat e Detit të Zi:

Dorëshkrimet e Dhiatës së Vjetër në tërësi, përveç librit të Esterit, janë gjetur në vitin 1947 në një seri të shpellave mes pjesës veriperëndimore të Detit të Zi. Dokumentet janë vendosur në këto shpella rreth vitit 70 pas Krishtit nga një sekt i hebrenjve të njohur si esenët, që i vendosën pergamenat në qypa argjilore dhe i fshehën nëpër shpella afër gërmadhëve të sotme në Kumran Khibetit.

Pas shqyrtimit shkencor, shumë pergamene u dëshmuar të jenë shkruar së paku 200 vjet para vendosjes së tyre në shpellë rreth vitit 70 pas Krishtit. Dokumentet qëndruan të fshehura, të mbrojtura, dhe të harruara për së paku 2000 vjet. Kur u zbuluan në vitin 1947, pergamenat u krahasuan shkronjë për shkronjë me Shkrimin e Shenjtë hebre, të sotmin (Torën), dhe për habi duke mos treguar asnjë dallim.¹² Kjo demonstroi që Dhiata e Vjetër ishte trashëguar pa gabime. Gjithashtu kjo tregoi që profecitë për Jezus Krishtin ishin bërë shumë më herët se Ai të vinte.¹³

Septuaginta :

Septuaginta është përkthim grek i Torës hebreje (Dhiata e Vjetër).¹⁴ Ky version ishte transkriptuar diku rreth vitit 270 para Krishtit dhe është dokumentuar mirë në historinë hebreje dhe sekulare. Përmbajtja tregon saktësi konsistente me Dhiatën e Vjetër, të ditëve të sotme. Dhe më kryesorja, të gjitha profecitë e ardhjes së Mesisë ishin përkthyer nga hebraishtja në greqisht gati 300 vjet para se të lindej Krishti!

DHIATA E RE

Kopje të shumta të dorëshkrimeve:

Sot afërsisht i kemi rreth 24.000 dorëshkrime të herëshme të pjesëve të Dhiatës së Re. Këto dorëshkrime greke të Dhiatës së Re (Ungjilli) mbijetuan nga aq herët sa edhe shekulli i parë pas Krishtit. Ato formojnë përmbajtjen e Dhiatës së Re që e kemi sot. Dhe në kundërshtim me besimet popullore mes shumë myslimanëve, nuk ekziston një burim alternativ i dëshmimeve që sugjerojnë që jeta dhe mësimet e Jezus Krishtit ishin të ndryshme me ato që përshkruhen në Bibël. Nuk ekziston as edhe një grimë e dëshmimeve.

Në vijim të shumë dorëshkrimeve ekzistuese (kopje të shekullit të parë), intergriteti i tekstit të Dhiatës së Vjetër është themeluar gjithashtu duke aplikuar tri principet themelore të historiografisë. (Shikoni diskutimin e tekstit bibliografik, provën interne, provën eksterne në *Dëshminë e re që kërkon vendim*, të përmendur më herët).

KAPITULLI 4

A KA ARDHUR MUHAMEDI TË THEMELOJË NJË RELIGJION TË RI?

Shumë mësues myslimanë, pohojnë që misioni i Muhamedit ishte për të themeluar një religjion të ri dhe për të zëvendësuar sistemin e Vjetër religjioz të hebrenjve dhe të krishterëve. Megjithatë, sipas vetë Kuranit, misioni i Muhamedit nuk ishte për të formuar një religjion të ri por për të ruajtur religjionin e Abrahamit në Torë (Dhiata e Vjetër). Disa prej vargjeve kuranore janë:

"Pastaj, ty të shpallëm: "Ndiqe fenë e drejtë të Ibrahimit sepse ai nuk ka qenë nga idhujtarët..." (S. 16:123).

"Thuaj: "Vërtet Zoti më udhëzoi në rrugë të drejtë, që është fe e drejtë, fe e Ibrahimit, që ishte larg besimeve të kota. Ai nuk ishte idhujtar..." (S. 6:161).

"Thuaj: "Allahu e tha të vertetën, pra ndiqni fenë e pastër të Ibrahimit, sepse ai nuk u takonte idhujtarëve..." (S. 3:95).

"Kush ka fe më të mirë se ai që sinqerisht i është bindur Allahut dhe, duke qenë bamirës, e ndjek fenë e drejtë të Ibrahimit? Allahu e zgjodhi Ibrahimin të zgjedhurin më të ngushtë..." (S. 4:125).

VETË KURANI THOTË QË MUHAMEDI NUK KA ARDHUR TË MËSOJË DOKTRINA TË REJA

Kurani shpesh herë pohon që Muhamedit iu është dhënë shpallja për të konfirmuar atë që më herët është shpallur në Librat e Shenjtë të hebrenjve dhe të krishterëve. Nuk pohon për ta korrigjuar, zëvendësuar, për ta shtuar, apo për ta anuluar. Disa prej vargjeve të tilla kuranore janë:

"E para tij ishte libri i Musait, si një prijës dhe mëshirë, e edhe ky është libër (Kurani) që vërteton (librin e Musait), që është në gjuhën arabe për t'u tërhequr vërejtjen atyre që nuk besuan, kurse myzhde për besimtarët..." (S. 46:12).

"Ty (Muhamed) nuk po të thuhet tjetër përveç asaj që u është thënë të dërguarve para teje..." (S. 41:43).

"Ai u përcaktoi juve për fe atë që i patë përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musën dhe Isain. Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të..."(S. 42:43)

"Thuaj "Unë nuk jam risimtar prej të dërguarve, e nuk e di se çka do të bëhet me mua e as me ju....(S. 46:9).

PJESA E DYTË

ADAMI NË KURAN DHE NË BIBËL

KAPITULLI 5 **ADAMI NË ISLAM**

Lexues i nderuar, ngazëllimi kryesor i kësaj pjese është për të shikuar dëshirën e zemrës së Perëndisë për bashkësi me njerëzit (që të lidhet me ne personalisht)!

Adami u krijua përsosurisht nga Perëndia:

Para se gjithash, Kurani citon që Perëndia e krijoi Adamin në gjendje perfekte. Ne lexojmë në S. 95:4 që "Vërtet, ne e krijuam njeriun në formën më të bukur". Dhe Kurani në S. 2:30 deklaron që Adami ishte zëvendësues i Perëndisë ("Khalifah"). Abdullah Jusuf Ali, një përkthyes i famshëm dhe komentator i Kuranit, e komentoi këtë varg në *Kuptimi i Kuranit të Shenjtë*.¹ Në vijim, ne lexojmë në S. 15:29 "E kur ta përsos atë dhe t'i jap atij shpirtin që është krijesë e imja..."

Dëshira e Perëndisë për të bashkëvepruar me njerëzit:

Ne lexojmë në S. 2:31 "E Ai (Zoti) ia mësoi Ademit të gjitha emrat (e sendeve)..." Ky varg dëfton që Zoti bisedoi me Adamin disa herë dhe Adami kishte një marrëdhënie personale, direkte dhe të mrekullueshme me Perëndinë. Prandaj, shohim që ekzistonte intenca origjinale e Perëndisë transedent të Gjithëpushtetshëm të lidhej personalisht me njerëzit që Ai i krijoi. Çfarë Perëndi i mahnitshëm, i hirshëm dhe të përlulur kemi! Adami dhe Eva kishin mundësi të përjetojnë shoqërinë perfekte me Perëndinë.

Kushtet perfekte të Adamit dhe Evës:

Sipas Kuranit, Perëndia iu dha Adamit dhe Evës kushte perfekte. Ai i krijoi ata në Kopshtin qiellor. Perëndia iu dha atyre çdo gjë që kishin nevojë për t'u kënaqur dhe për të jetuar një jetë të drejtë. S. 2:35 thotë "E ne i thamë: "O Adem, ti dhe bashkëshortja juaj banoni në xhennet, dhe hani lirisht nga frutat e tij kah të doni..."

Satani tundoi Adamin dhe Evën:

Kurani na bën të ditur që Satani tundoi dhe mashtroi Adamin dhe Evën, dhe ata dështuan për ta përfaqësuar Perëndinë. Ata nuk iu bindën Zotit dhe mëkatuan. Qartë shihet në S. 2:36: "Po djalli i bëri që ata të dy të mashtrohen në atë (xheneti) dhe i nxorri ata nga ajo që ishin në te, e Ne u thamë: "Zbritni (dilni), jeni armik i njëri-tjetrit, e ju deri në një kohë në tokë keni vendbanim dhe dëfrim". (Ju lutem lexoni gjithashtu S. 7:22 -24). Kurani pra, thotë që ata u krijuan në qiell dhe përjetuan paqen dhe gëzimin përderisa nuk iu bindën Perëndisë dhe ishin nxjerrur nga qielli.

Rënia e Adamit dhe Evës dhe e tërë njerëzimit:

Ekzistojnë pika të pajtimit mes Biblës dhe Kuranit në lidhje me rënien e Adamit dhe të Evës. Ata hëngrën prej frytit të ndaluar. Vëreni gjithashtu se në S. 2:36, forma e përdorur është imperativi "Zbritni" (në arabisht "ahbituu")². Dijetari i mirënjohur mysliman dhe komentator i Kuranit, Pickthall, tha: "Këtu urdhëri është në shumës, duke iu adresuar racës së Adamit."³

Abdullah Jusuf Aki sqaron frazën në S. 2:36 "Zbritni, ju (gjithë njerëz)" në përkthimin dhe komentimin e popullarizuar të Kuranit: "Vendimet e Allahut janë rezultat i veprave të njerëzve. Vëreni tranzicionin në arabisht prej numrit njëjës në S. 2:33 në atë shumës në S. 2:35, dhe shumësinë këtu që e kam dhënë unë në anglisht: "Të gjithë ju njerëz". Qartë Adami është tipi për gjithë njerëzimin..."⁴

Dënimi i Allahut u zgjerua për gjithë njerëzimin:

Kurani e mëson rënien e Adamit dhe e implikon edhe tërë racën njerëzore në këtë rënie. Në S. 2:38, lexojmë që i njëjti urdhër dhënë Adamit dhe Evës i ishte dhënë edhe pasardhësve të tij: "Dilni prej atyhit të gjithë (jami)."

Vëreni që fjala "jami" është shfrytëzuar në S. 2:38: "(Zbritni prej atyhit të gjithë jami)". Kjo fjalë arabe është shfrytëzuar për të kuptuar "mikpritës, mbledhje (grumbullim), të gjithë, së bashku, tërësisht"⁵ Prandaj, urdhëri për t'u larguar prej Kopshtit, kishte për qëllim ta mbulojë tërë njerëzimin. Hadithi e konfirmon këtë të vërtetë⁶.

Është fakt që në Kuran dhe Hadithe ekziston dokumentimi që i referohet përgjegjësisë së Adamit si përfaqësues i tërë racës njerëzore. Adami ishte njeriu i parë i krijuar. Ne të gjithë morëm fill nga ai. Ishte nga kjo pikë e origjinës që njerëzimi ka pasur për t'u ballafaquar me problemin përfundimtar të saj: rezultatit e rënies së Adamit në mëkat.

KAPITULLI 6 REZULTATET E RËNIES

Sipas Ungjillit, kur Perëndia e krijoi njeriun, qëllimi i tij ishte që njeriu të mund të përjetonte bashkësinë konstante dhe të mrekullueshme me Të. Ashtu që Perëndia e vendosi njeriun në Kopshtin e Edenit. Bibla flet që Perëndia vinte në kopsht dhe komunikonte me njeriun.

Mëkati i Adamit na largoi nga Perëndia:

Qëllimi i Perëndisë për njeriun ishte i përmbushur përderisa Adami ecte në bashkësi me Perëndinë. Por ne lexojmë që Adami nuk u bind dhe që mëkati hyri në racën njerëzore. Marrëdhënia e Adamit me Perëndinë ishte thyer si rezultat i mëkatit. Kjo ndarje është gjithmonë efekt i mëkatit.¹ Profeti Isaia na tregon "Ja, dora e Zotit nuk është tepër e shkurtër për të shpëtuar, as veshi i tij nuk është tepër i rënduar për të ndëgjuar. Por paudhësitë tuaja kanë shkaktuar një ndarje" (Isaia 59:1-2). Askush s'mund t'i bëj dritë mëkatit të Adamit duke thënë thjeshtë se ai vetëm harroi urdhërin e Perëndisë. Adami nuk ka mundur ta harrojë të vetmin urdhër që Perëndia ia dha. Adamit iu është dhënë liria për të zgjedhur. Në momentin kur Adami dhe Eva hëngrën nga pema e ndaluar, ata qëllimisht kundërshtuan dhe shkelën autoritetin e Perëndisë. Mëkati i tyre ishte një akt mospërfillës kundër Perëndisë së Gjithëpushtetshëm.

Mëkati infektoi gjithë njerëzimin:

Mëkati i Adamit dhe Evës kishte ndikim infektues në mbarë racën njerëzore. Efekti i mëkatit të tyre u bë universal dhe i gjithë njerëzimi u zhyt në një botë ku mëkati dhe vdekja mbretërojnë. Mik i nderuar, mëkati u bë pjesë integrale e natyrës së tyre njerëzore si një rezultat i menjëhershëm i mëkatit dhe mosbindjes së Adamit.

Adami zgjodhi të rebelohej:

Perëndia e krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së tij. Ai i dha atij lirinë e zgjedhjes dhe ai zgjodhi për t'u rebeluar kundër Perëndisë në personin e Adamit. Si pasojë, Adami shtrembëroi imazhin e Perëndisë tek njeriu. Natyra njerëzore u robërua nën fuqinë e mëkatit, duke u bërë qenësishet i ndryshuar dhe i paaftë për ta pastruar vetveten në gjendjen që ishte para rënies. Muhamedi tha: "Satani vrapon në trupin e bijve të Adamit sikurse që gjaku qarkullon në të..."²

Gjithashtu Muhamedi tha: "Satani qarkullon në mendjen njerëzore sikurse gjaku që qarkullon në të..."³

Mëkati i Adamit e shkatërroi natyrën njerëzore:

Mëkati në mënyrë të përhershme infektoi natyrën njerëzore. Në Torë (Zanafilla 2:17) ne lexojmë që Perëndia e paralajmëroi Adamin për pasojat shkatërruese: "...sepse nëse hani nga ajo, ti do të vdesësh me siguri". Njerëzimi i rënë i përjeton efektet e mëkatit për ditë përmes egoizmit, xhelozisë, zilisë, urrejtjes etj. Asnjë prej pasardhësve të Adamit nuk mund të bëjë një jetë të pastër dhe të pamëkatshme për të cilën Perëndia e krijoi për të jetuar. Sipas Kuranit të gjithë njerëzit janë robër të fuqisë së mëkatit, siç përmendet edhe më poshtë:

- S. 12:53: "...epshi është shumë nxitës për mëkatin"
- S. 16:61: "Sikur Allahu t'i dënonte njerëzit për shkak të mizorisë së tyre, nuk do të linte mbi tokë asnjë gjallesë tjetër..."

Sigurisht që çdonjëri prej nesh mund të dëshmojmë që ne jemi të prirur për të kënaqur epshin e mishit. Ndonjëherë ne dhunojmë ndërgjegjën tonë dhe i lëshohemi natyrës sonë egoiste.

Pasojat shkatërruese të mëkatit:

Siç u përmend më lartë, Perëndia e krijoi Adamin si një qenie njerëzore perfekte. Dhe ne lexojmë në Torë (Zanafilla 2:17) që Perëndia paralajmëroi Adamin për pasojat shkatërruese të mëkatit. Rënia ka prekur çdo pjesë të natyrës sonë. Trupi ynë përjeton një vdekje fizike, shpirti ynë përjeton një vdekje shpirtërore duke humbur marrëdhënien me Perëndinë; dhe shpirti ynë dhe fryma janë përjetësisht të ndarë nga Perëndia, me dënim dhe keqardhje.

Bibla na bën të njohur që "...me anë të një njeriu të vetëm mëkati hyri në botë dhe me anë të mëkatit vdekja, po ashtu vdekja u shtri tek të gjithë njerëzit, sepse të gjithë mëkatuan" (Romakëve 5:12). Të gjithë njerëzit mëkatojnë sepse mëkati tani është pjesë integrale e natyrës njerëzore. Mëkatshmëria e përshkon njerëzimin si në mënyrë individuale ashtu edhe kolektive.

Është e dukshme që rrethanat e jetës nuk e sollën mëkatin tek njeriu, por përkundrazi është njeriu ai që e solli mëkatin në botë. Është e qartë që pasardhësit e Abrahamit i trashëguan të gjitha karakteristikat e natyrës së rënë. Si pasojë, ne të gjithë u bëmë subjekt i dënimit të Perëndisë, për shkak se mëkatet tona janë bërë kundër Tij. Ai është i Shenjtë dhe i Drejtë dhe nuk mund ta tolerojë mëkatin. Ashtu që lexojmë në Ungjill, Romakëve 6:23: "Paga e mëkatit është vdekja".

Megjithatë, siç do të shohim në faqet e ardhshme të këtij libri, Perëndia e siguron mjetin shërues për ne. Edhe është një shërim i shkëlqyer!

KAPITULLI 7 **PAJTIMI ËSHTË I MUNDUR**

Lajmi i Mirë që Perëndia dëshiron që ju ta dini është " Perëndia është dashuri" (1 Gjonit 4:16). Natyra e tij është dashuri. Ju me siguri do ta zbuloni këtë fakt të mahnitshëm derisa e përfundoni leximin e këtij libri. Dhe Ai dëshiron, të dashur, një marrëdhënie personale me ju!

Plani i Perëndisë për shpëtimin e njerëzimit:

Perëndia planifikoi një mënyrë për ta shpëtuar njerëzimin, kjo është, për ta restauruar marrëdhënien tonë me Të. Shenjtëria e Perëndisë kërkoi drejtësi (dënimin tonë) ndaj mëkatarëve,

përderisa dashuria e Tij kërkonte mëshirë dhe falje për ta. Për këtë arsye, Jezus Krishti (Fjala e Gjallë e Perëndisë) u bë mish dhe, në kryq, i vuajti pasojat e mëkatit tonë. Gjykimi i plotë i Perëndisë kundër mëkatit ra mbi Jezusin. Krishti në mënyrë vullnetare, në vendin tonë, pagoi dënimin kundër mëkatit, që ne është dashur për ta paguar, për të gjitha mëkatet që i kemi bërë, dhe do t'i bëjmë, kundër Perëndisë. Ungjilli deklaroi: "Sepse, ashtu si erdhi vdekja me anë të një njeriu, kështu erdhi dhe ringjallja e të vdekurve me anë të një njeriu. Sepse, ashtu sikur të gjithë vdesin në Adamin, kështu të gjithë do të ngjallën në Krishtin" (1Korintasve 15:21-22).

Jezusi, i vetmi njeri i pamëkatshëm/perfekt:

Ungjilli, tek Luka kap. 4, na mëson se Satani e tundoi Jezusin për të vepruar pavarësisht prej vullnetit të Perëndisë dhe për t'i pranuar mbretëritë e botës prej Satanit. Përkundër, Adamit dhe Evës, Jezusi kishte fitore komplete kundër tundimeve të Satanit për mëkat. Në Ungjill, Jezusi njihet si njeri i përsosur, i cili çdo moment të jetës së Tij ia nënshtroi plotësisht vullnetit të Perëndisë. Të gjithë profetët dhe të gjithë njerëzit gjatë tërë historisë njerëzore i janë lëshuar tundimeve të Satanit dhe kanë mëkatuar rregullisht. Jezusi ishte i vetmi përjashtim. Sipas mësimave të të dy librave, Kuranit dhe Biblës, Jezusi ishte i vetmi njeri që jetoi pa bërë asnjë mëkat të vetëm.

Dhurata e hirit nga Perëndia erdhi nëpërmjet Jezusit:

Në Ungjill, Romakëve kap. 5 i ballafaqon shkeljen e një njeriu (Adamit) dhe pasojave vdekjeprurëse të saj për njerëzimin, me dhuratën e një njeriu (Jezusi) dhe rezultatet shpenguese të tij për njerëzimin. Aty thuhet:

"Mirëpo hiri nuk është si shkelja; nëse në fakt për shkak të shkeljes së një njeriu të vetëm vdiqën shumë, shumë më tepër hiri i Perëndisë dhe dhurata me anë të hirit e një njeriu, Jezu Krishtit, i teproi për shumë të tjerë. Sa për dhuntinë, nuk ndodhi si për atë një që mëkatoi, sepse gjykimi prodhoi dënimin nga një shkelje e vetme, por hiri prodhoi shfajësimin nga shumë shkelje. Në fakt, në qoftë se prej shkeljes së këtij njeriu të vetëm vdekja mbretëroi për shkak të atij njeriu, akoma më shumë ata që marrin bollëkun e hirit dhe të dhuratës së drejtësisë do të mbretërojnë në jetë me anë të atij njerit, që është Jezu Krishti. Prandaj, ashtu si për një shkelje të vetme dënimi u shtri mbi të gjithë njerëzit, ashtu edhe me një akt të vetëm drejtësie, hiri u shtri mbi gjithë njerëzit për shfajësimin e jetës. Në fakt, ashtu si nga mosbindja e një njeriu të vetëm të shumtët u bënë mëkatarë, ashtu edhe nga bindja e një të vetmi të shumtët do të bëhen të drejtë" (Romakëve 5:15-19).

Si të bëhemi shpirtërisht të gjallë:

Bibla flet lidhur me "krijimin" (që është lindja origjinale e jetës), dhe pastaj "degjenerimin" (që është koha kur njeriu ra dhe u bë i vdekur shpirtërisht), dhe "rigjenerimin" (kur njerëzit ringjallen shpirtërisht përsëri). Lidhur me mësimin për rigjenerimin, Jezusi deklaroi: "Në të vërtetë po ju them, nëse një nuk ka rilindur, nuk mund ta shoh mbretërinë e Perëndisë" (Gjoni 3:3). Për shkak të natyrës sonë mëkatarë dhe mëkateve tona individuale, ne jemi shpirtërisht të vdekur dhe të mënjanuar nga prezenca e Shenjtë e Perëndisë.

Megjithatë, në qoftë se besoni në atë çfarë Jezus Krishti (Al Masih Isa) bëri për ju në kryq, dhe i rrëfeni mëkatet e juaja dhe pendohuni, ju do të rilindeni! Ju do të keni hyrje në prezencën e Perëndisë. Kjo nënkupton që ju do të filloni ta përjetoni marrëdhënien paqësore, personale dhe të gjallë me Krijuesin tuaj!

Rastësisht, mik i nderuar, nëse dyshoni çfarë lidhje ka vdekja e Jezusit me jetën shpirtërore të re, merre parasysh një farë. Fara vetëvetiu është e padobishme, por pasi është mbjellur ajo vdes dhe vetëm pastaj sjellë frute.

Ç'nëkupton të jesh i "rilindur":

Çfarë nënkupton kur ti bëhesh i "rilindur"? Ju do të jeni krijesë e re në zemrën tuaj dhe të transformuar nga thellësia e qenies suaj. Shpirti i Shenjtë do vijë të banojë në ju, dhe Perëndia do të të jap: një zemër të re, dashuri dhe dëshira të reja, fuqi dhe qëllim të ri, një pikëpamje të re për njerëzit përreth jush, natyrë të re, dhe një destinacion të ri! Bibla deklaron: "Prandaj nëse dikush është në Krishtin, ai është një krijesë e re..." (2Korintasve 5:17). Adami ishte kryesori i krijimit të Vjetër, kurse Krishti udhëheqësi i krijimit të ri.

Perëndia shikon zemrën:

Bibla na mëson që Perëndia është i shqetësuar për zemrat tona e jo për ritualet tona. Jezusi iu referua një profecie nga profeti Isaia: "Ky popull (hipokritët religjioz hebrenj) po më afrohet me gojë dhe më nderon me buzët; por zemra e tyre rri larg meje. Dhe më kot më nderojnë, duke i mësuar doktrina që janë urdhërime nga njerëzit " (Mateu 5:8-9).

Merrni në konsideratë dy njerëz që përpiqen të afrohen tek Perëndia. Njëri i shfaqti të gjitha ritualet që i kishte mësuar nga mësuesit e tij religjioz. Ai i memorizoi dhe i shqiptoi të gjitha lutjet e rekomanduara në arabisht, ai përkulej me lëvizje të duhura trupore, ai lante trupin e tij për pastrim. Megjithatë, ai mbante një mëkat në zemrën e tij. Personi tjetër nuk i kishte mësuar kurrë ritualet dhe lutjet e rekomanduara. Por duke i pranuar mëkatet e tij, ai në mënyrë të përlurur i kërkoi Perëndisë me gjithë zemrën e tij për ta falur dhe udhëhequr. Sipas Biblës, Perëndia me siguri do ta dëgjonte dhe do t'i përgjigjej lutjes së personit të dytë.

Shpirti i Shenjtë banon në të krishterët:

Kush është me të vërtetë i krishterë? Të gjithë besimtarët dhe ndjekësit e vëretë të Krishtit e përjetojnë një lindje të re. Kini parasysh se ekzistojnë shumë njerëz që pohojnë të jenë të krishterë, ose për shkak se i kanë prindërit të krishterë, apo kanë një edukim të krishterë, apo ishin të lindur brenda një kombi të krishterë të supozuar, apo besojnë që krishterimi është një religjion i mirë. Apo, ata ndjekin një kishë, apo tentojnë të bëjnë vepra të mira, apo pajtohen me besimet krishtere në mënyrë intelektuale. Mirëpo, asnjëra prej këtyre gjërave nuk mund ta bëjë dikë krishterë të vërtetë apo fëmijë të Perëndisë. Vetëm ata njerëz që përjetojnë rilindjen bëhen të krishterë të vërtetë. Dëshmia e rilindjes është prezenca e Shpirtit të Shenjtë Brenda tyre, që konfirmon se ai person është fëmijë i Perëndisë.

Mëshira e Perëndisë e shfaqur përmes Jezusit:

Çfarë Perëndie i dashur! Ai na shfaqti mëshirën e tij përmes Jezus Krishtit. Edhe Kurani na bën të njohur se Jezusi është mëshira e Perëndisë. "Për ta bërë atë...Mëshirë nga ana e jonë..." (S. 19:21).

Për shkak të Jezusit, ne në fakt mund ta shkëmbejmë gjykimin me falje! Mund ta shkëmbejmë mëkatin tonë për drejtësinë e Jezusit! Ne lexojme në Bibël:

"Ai ju dha jetë edhe juve, që ishit të vdekur në fajë dhe në mëkate, në të cilat keni ecur dikur, sipas ecjes së kësaj bote, sipas prijësit të pushtetit të erës, sipas frymës që vepron tani në bijtë e mosbindjes, ndërmjet të cilëve edhe ne dikur jetuam në lakmitë e mishit tonë duke i plotësuar dëshirat e mishit dhe të mendjes, dhe ishim prej natyre bij të zemërimit, ashtu si edhe të tjerët. Por Perëndia, që është i pasur në mëshirë, për shkak të dashurisë së tij të madhe me të cilën na deshi, edhe atëherë kur ishim të vdekur në fajë, na dha jetë me Krishtin..." (Efesianëve 2:1-5).

Jezusi na pajton me Perëndinë përjetësisht!

Jezus Krishti na ofron mundësinë për t'u lindur në familjen shpirtërore të Tij. Jezusi është i gjallë tani. Dhe përmes bashkësisht tonë me Të, Ai (vetë) na restauron për jetën e përjetshme, që Perëndia kishte për qëllim për Adamin dhe pasardhësit e tij për ta përjetuar. Dhe, siç u citua më herët, përmes Adamit ne të gjithë e humbëm jetën e përjetshme. Për këtë arsye, Perëndia e dërgoi Jezusin, i cili vullnetarisht erdhi të na sjellë sërish në një marrëdhënie të përjetshme me Perëndinë. Jezusi e bëri këtë duke vdekur në vendin tonë me qëllim që t'i largojë mëkatet tona. Çfarë lajm i mahnitshëm dhe i mirë. Jezusi na pajton me Perëndinë përjetësisht!

Bibla deklaron: "Të gjitha këto janë nga Perëndia që na pajtoi me veten përmes Jezus Krishtit... duke mos ua numëruar njerëzve mëkatet e tyre..." (2Korintasve 5:18-19). Bibla gjithashtu thotë: "...mburremi në Perëndinë, nëpërmjet Zotit tonë Jezu Krisht, me anë të të cilit kemi marrë pajtimin" (Romakëve 5:11).

PJESA E TRETË

ABRAHAMI NË KURAN DHE NË BIBËL

KAPITULLI 8 **JETA E ABRAHAMIT**

Abrahamit i është dhënë titulli si në Kuran ashtu edhe në Bibël "mik i Perëndisë". S. 4:25 na mëson: "...Allahu e zgjodhi Ibrahimin të dashurin (mikun) më të ngushtë".

Abrahami "miku i Perëndisë":

Në Ungjill, tek Jakobi 2:23, ne shohim gjithashtu që Abrahami përshkruhet si "mik i Perëndisë". Titulli supozon një marrëdhënie mjaft të ngushtë me Perëndinë. Kjo nënkupton që Perëndia ka ndarë me Abrahamin mjaft prej planeve sekrete për të ardhmen se përndryshe nuk do t'ia zbulonte dikujt që është vetëm shërbëtor i Tij. Bibla gjithashtu e quan Abrahamin "ati i gjithë atyre që besojnë" (Romakëve 4:11). Tek Galatasve 3:7, ne lexojmë: "Ta dini, pra, se ata që janë nga besimi janë bij të Abrahamit". Ne e shohim të njëjtin koncept në Kuran në S. 3:95, që iu bën thirrje myslimanëve "...ndiqni fenë e pastër të Abrahamit..."

Abrahami model i besimit për myslimanët dhe të krishterët:

Abrahami është shembull i "religjionit" të vërtetë dhe model për myslimanët (ju lutem shikoni S. 2:130). Abrahami është gjithashtu model për të krishterët e vërtetë. Të gjithë besimtarët e vërtetë në Ungjill e kanë "besimin shfajësues" sikurse Abrahami e kishte. Abrahami ishte një prototip i religjionit të vërtetë që do të vinte, përmes besimit të tij në Perëndinë. "Abrahami i besoi Zotit, dhe kjo iu llogarit për drejtësi" (Zanafilla 15:6).

BIRI I PREMTUAR - ISAKU APO ISMAILI?

Perëndia i premtoi Abrahamit një bir. Abrahami ishte plotësisht i vetëdijshëm për pamundësinë fizike të tij dhe të gruas së tij, Sarës, për të pasur fëmijë aq vonë në jetë. Ajo ishte shterpë. Por Abrahami besoi që Perëndia do ta përmbushte premtimin e Tij në mënyrë mbinaturore. Bibla mëson që ky bir i premtuar ishte Isaku. (Ju lutem lexoni tek Zanafilla 17:15-21).

Referencat e Kuranit për "birin e premtuar":

Perëndia e urdhëroi Abrahamin për të sakrifikuar birin e tij. Referenca e vetme lidhur me sakrificën e birit të Abrahamit është në S. 37:99-107, që flet: "Ne e gëzuar atë me një djalë që do të jetë i butë. Dhe kur arriti ai (djali) që me të (Ibrahimin) të angazhohet në punë, ai (Ibrahimi) tha: "O djali im, unë kam parë në ëndërr të pres ty..."

At Tabari, një historian dhe teolog prominent myslimano-arab, e indentifikon Isakun si "djalin" që do të sakrifikohet në S. 37:101, që thotë: "Ne e gëzuar atë me një djalë që do të jetë i butë". Vëreni që ky varg nuk thotë drejtëpërsëdrejti cili djalë ishte, por indikon që është i njëjti djalë lindja e të cilit është përshkruar si "Lajm i Gëzuar."

Ju lutem i kushtoni tërë vëmendjen Isakut në Kuran. Vetëm dy vargje pas përmendjes së sakrificës, lindja e Isakut përshkruhet si lajm i gëzuar në S. 37:109-113: "Selam (shpëtim e paqë) pastë Ibrahim...dhe Ne e gëzuar atë me Isakun... dhe ne i dhuruam bekim atij dhe Isakut..." Më herët në Kuran, në S. 29:27, ne lexojmë "Dhe ne i dhuruam atij Isakun dhe Jakobin, e në pasardhësit e tij shpallëm pejgambërllekun dhe librin e Shenjtë...." Lindja e Isakut është parathënë si lajm i gëzuar (lajm i mirë) gjithashtu në S. 11:71: "Ne e përgëzuar atë me Isakun, e pas Isakut Jakobin." Ne gjithashtu lexojmë për shpalljen e engjëjve Sarës lidhur me lindjen e Isakut si lajm i gëzuar, në S. 51:28-30: "...I dhanë myzhde për një djalë...e gruaja e tij nisi të bërtasë e i ra shuplaka fytyrës së vet e tha: "Unë jam një plakë që nuk lind!"

Referencat e kufizuara të Kuranit lidhur me Ismailin:

Kurani në fakt nuk përmban referenca lidhur me lindjen e Ismailit. Dhe nuk parathotë që Abrahami do jetë ati i Ismailit. Askund në Kuran në mënyrë specifike nuk citohet që Ismaili i ishte premtuar Abrahamit me emër, sikurse Isaku. Shumë pak është folur për Ismailin në Kuran, sikurse edhe për nënën dhe fëmijët e tij. Vëreni që lindja e Ismailit kurrë nuk është shpallur si lajm i gëzuar. Është e dukshme që biri për të cilën u dha lajmi i mirë dhe ai që do të sakrifikohet, siç përmendet në S. 37:99-107, nuk është Ismaili por Isaku. (Ju lutem lexoni Zanafillën 17:19)

Kurani është i heshtur, kurse Hadithi i ndarë, lidhur me identitetin e birit që do të sakrifikohet:

Abdullah Jusuf Ali, në komentimin e njohur ndërkombëtar të Kuranit, bëri një pohim të rëndësishëm lidhur me S. e mësipërme, 39: 99-107 (i vetmi varg që i referohet sakrificës së birit të Abrahamit). Aliu thotë: "Në këtë mënyrë biri i lindur sipas Traditës Myslimane në Hadith, megjithatë, nuk janë unanim në këtë pikë, ishte i parëlinduri i Abrahamit, respektivisht Ismaili "² Ju lutem vëreni fjalimin e kufizuar të Aliut: "Sipas Traditës Myslimane" dhe "që, megjithatë, nuk janë unanim në këtë pikë." Nga kjo pohimet e Aliut se Ismaeli ishte biri që do të sakrifikohet, shohim se nuk është i bazuar mbi dëshminë nga Kurani, por nga Traditat, që ai thekson se nuk janë të njëzëshme lidhur me këtë pikë.

Biri i premtuar i Abrahamit është Isaku:

Referencat nga Kurani supozojnë mjaft fuqishëm që Isaku (jo Ismaili) është biri i shpallur nga Perëndia për t'u sakrifikuar. Në fakt, një prej rrëfimeve më të famshme dhe eksplicite në Shkrimet hebreje dhe krishtere, është urdhërimi i Perëndisë dhënë Abrahamit për të sakrifikuar Isakun (Zanafilla 22:1-2, Jakobi 2:21). Në qoftë se Muhamedi ka besuar që ajo çfarë është shkruar në Shkrimet hebreje dhe krishtere ishte jo korrekte, ai me siguri do ta indentifikonte në Kuran që biri që do të sakrifikohet ishte Ismaili dhe jo Isaku.

Perëndia vendosi "profetërinë" në bijtë e Izraelit:

Perëndia i do arabët, hebrenjtë, dhe të gjithë njerëzit në mënyrë të barabartë, dhe Ai dëshiron të ketë marrëdhënie me çdo njerin prej tyre. Por, Perëndia na zbuloi që bekimet e Tij në botë do të vijnë përmes pasardhësve të Isakut.

Perëndia zgjodhi për t'ia zbuluar profecitë popullit të Izraelit. Është e rëndësishme të lexohen vargjet në Kuran që konfirmojnë mësimin biblik se "profetëria" ishte kufizuar në bijtë e Izraelit. Për shembull, S. 45:16 pohon: "Ne u patëm dhënë beni israilëve librin dhe peygamberllëkun dhe aftësinë për të gjykuar në mes të njerëzve, i patëm furnizuar ata me të mira dhe i patëm dalluar ata nga njerëzit e tjerë." Gjithashtu, S. 29:27 pohon: "Dhe ne i dhuruam atij Isakun dhe Jakubin, dhe në pasardhësit e tij peygamberllëkun dhe librin e shenjtë..."

Këto vargje në Kuran janë në pajtim të plotë me atë çfarë Perëndia shpalli në Torë (në Zanafillën 19:17) kur Perëndia i tha Abrahamit: "Sara gruaja jote do të lindë një bir, dhe ti do ta quash Isak; dhe unë do të caktoj besëlidhjen time me të, një besëlidhje të përjetshme me pasardhësit e tij." Gjithashtu në Torë (Zanafilla 26:4; 28:14), Perëndia i premtoi Isakut dhe Jakobit që përmes farës së tyre të gjithë njerëzit e botës do të bekohen. Ky premtim ishte plotësuar përfundimisht kur Jezusi (Mesia) erdhi përmes linjës së tyre familjare.

NJË PROVË E VËSHTIRË E BESIMIT TË ABRAHAMIT

Perëndia e sprovoi besimin e Abrahamit në mënyrë të fuqishme në Torë, në Zanafillë në kapitullin 22: "Mbas këtyre gjërave Perëndia e vuri në provë Abrahamin dhe i tha: "Abraham; Ai u përgjegj: Ja ku jam; dhe Perëndia tha: Merr tani birin tënd, birin tënd të vetëm, atë që ti do, Isakun, shko në vendin e Moriahve dhe sakrifikoje në një nga malet që do të të tregoj" (Zanafilla 22:1-2). Abrahami me siguri ka menduar për urdhërin shokues dhe jo të zakonshëm të Perëndisë. Sepse, Perëndia i ka premtuar Abrahamit që nëpërmjet birit të tij, Isakut, ai do të ketë shumë pasardhës. Pasardhësit e tij duhej të ishin "të shumtë sa yjet e qiellit dhe si rëra që është në breg të të detit dhe që nuk mund të numërohen dot" (Hebrenjve 11:2, Zanafilla 15:5 dhe 32:12). Dhe Zanafilla 21:12 dëshmon që përmes Isakut do të dalin pasardhësit që do të mbajnë emrin tënd.

Abrahami i besoi Perëndisë:

Abrahami besoi që Perëndia është përherë besnik. Ai besoi që premtimet e Perëndisë do të realizoheshin dhe që përmes Isakut ai do të kishte shumë pasardhës. Pa dyshim Abrahami mendoi: Si mund t'i kem pasardhësit e premtuar nëse e sakrifikoj birin tim, Isakun, ashtu siç Perëndia më ka urdhëruar? Për shkak se Abrahami i besoi premtimeve të Perëndisë, besnikërisë së Tij, dhe drejtësisë së Tij, ai konkludoi që e vetmja mënyrë që Isaku do të lindte pasardhës (në qoftë se duhet të sakrifikohet) do të ishte në qoftë se Perëndia do ta sillte prapa nga të vdekurit. Abrahami erdhi në përfundim që pasi Perëndia i dha atij birin kur ishte natyralisht e pamundur ta ketë, atëherë Perëndia do të mund ta ngritte birin e tij nga të vdekurit në jetë.

Abrahami e kaloi sprovën e tij të madhe:

Bibla na bën mjaft të qartë që Abrahami e kaloi sprovën e tij të madhe duke vendosur ta sakrifikojë Isakun. Në Bibël lexojmë: "sepse Abrahami mendonte se Perëndia ishte i fuqishëm sa ta ringjallte edhe prej së vdekurish; prej të cilëve edhe e mori atë përsëri si një lloj figure" (Hebrenjve 11:17-19). Kurani shfaq harmoni me përfundimet e Abrahamit. S. 2:260 pohon, "Përkujto kur Ibrahim tha: "Zoti im më mundëso të shoh se si i ngjall të vdekurit..."

KAPITULLI 9

UNGJILLI I PREDIKUAR ABRAHAMIT DHE NËPËRMJET TIJ

Ne e shohim dukshëm Abrahamin në dy librat, në Kuran dhe në Bibël. Në S. 16:23 ne lexojmë: "Ndiqu fenë e drejtë të Abrahamit, se ai nuk ka qenë nga idhujtarët". Dhe në Zanafillën 12:3 dhe 22:18, ne lexojmë që Perëndia i premtoi Abrahamit, "Përmes pasardhësve të tu të gjithë popujt e botës do të bekohen."

Besëlidhja e Perëndisë me Abrahamin:

Në Bibël, në Zanafillën 17:4-6, Perëndia i tha Abrahamit: "Sa për mua, ja unë po bëj një besëlidhje me ty: ti do të bëhesh babai i një shumice kombesh..." Abrahami e konsideroi atë pse ai duhej të ishte udhëheqës për njerëzimin dhe atë i besnikëve. Ashtu që Abrahami e shikoi statusin e tij të zgjedhur si një reflektim të lavdisë madhështore të Perëndisë në qiell. Ai nënkuptoi që ishte thjesht një "model" i babait Qiellor. Pasi që Abrahami ishte një model, atëherë lindja e mrekullueshme e Isakut, sakrifica, dhe ringjallja nga të vdekurit (sikurse edhe pasardhësit e

shumtë) është një model i një realiteti madhështor që do të vinte. Abrahami e kuptoi që Biri i Ngritur i tij do të ishte burim i bekimeve të mëdha të botës.

Abrahami e parashikoi Lajmin e Mirë (Ungjillin):

Perëndia ia zbuloi mikut të Tij, planin e Tij të Shpëtimit dhe bekimet e ardhshme për njerëzimin. Abrahami e parashikoi zemrën e Ungjillit. Sepse ne lexojmë tek Gjoni kapitulli 8, që Jezusi u tha judenjve: "Abrahami, ati juaj, ngazëllohej në shpresën që të shihte ditën time; e pa dhe u gëzua" (Gjoni 8:56). Ashtu që Abrahami kuptoi: që Ati qiellor gjithashtu do të ketë një Bir të lindur në këtë botë në mënyrë të mrekullueshme. Biri do të ofrohej si një sakrificë Perëndisë nga duart e Atit të Tij. Biri do të ngritej nga të vdekurit, dhe Biri i ngritur do të ishte burim i bekimeve të botës.

Biseda profetike në mes të Abrahamit dhe Isakut:

Ne lexojmë në Zanafillën 22:7-8, që Isaku foli dhe e pyeti atin e tij, Abrahamin: "Ja zjarri dhe druri, por ku është qengji për sakrificicën?" Abrahami nuk e dinte që qengji do të zëvendësohej. Abrahami me të vërtetë besonte që do të duhej të sakrifikonte birin e tij. Ashtu që Abrahami iu përgjigj Isakut: "Djali im, Perëndia do ta sigurojë vetë qengjin për sakrificicën". Fjalët origjinale në hebraisht janë: "Perëndia jep nga Vetvetja Qengjin për sakrificicën" Me fjalë të tjera, përgjigjja e Abrahamit ndaj Isakut ishte në esencë: "Biri im, duhet t'i bindem Perëndisë dhe të ofroj ty si qengj i sakrificës për Perëndinë. Dua që ti të dish që Perëndia do ta jep nga vetvetja qengjin si sakrificë. Dhe kështu, Ati Qiellor do të sakrifikojë ndonjë ditë Birin e Tij si sakrificë për shpëtimin e botës. "

Një parashikim i Qengjit të Perëndisë:

Përmes këtij përjetimi, Perëndia ia zbuloi mikut të tij, Abrahamit, në atë mënyrë, që një ditë Ai do të dërgonte Birin e Tij për të vdekur për mëkatet e botës. Këtu e shohim një parashikim të ardhjes së Qengjit të Perëndisë. Vëreni që pas shekujve të sakrifikimit të kafshëve në Tempullin e judenjëve, erdh Gjoni Pagëzuesi dhe proklamoi ardhjen e Jezusit. Gjoni 1:29 pohon: "Të nesërmen, Gjoni e pa Jezusin që po vinte drejt tij dhe tha: "Ja qengji i Perëndisë, që heq mëkatet e botës! Sa e mahnitshme është për ta kuptuar që 2000 vjet pasi Perëndia i kërkoi Abrahamit për ta sakrifikuar birin e tij, Isakun, në malin Moriah, Perëndia e sakrifikoi Birin e Tij. Dhe Jezusi ishte sakrifikuar në atë mal të njëjtë, Malin Moriah. Zanafilla 22 është pra një parashikim i kryqëzimit të Jezus Krishtit sipas planit të Perëndisë për shpengimin e njerëzimit.

Drejtësia e Abrahamit rezultoi nga besimi i tij:

Me gjithë mëkatet e Abrahamit, të përshkuara në Bibël dhe në Kuran (S. 26:82), Perëndia e fali Abrahamin dhe e shpalli atë të drejtë. Besimi i Abrahamit në Perëndinë (dhe në aftësitë e Zotit për t'i bërë ato që i ka premtuar) është pranuar nga Perëndia si bazë për drejtësinë e tij. Zanafilla 15:6 thotë: "Dhe ai i besoi Zotit, që ia vuri në llogari të drejtësisë." Abrahami varej nga drejtësia e Perëndisë, mirësia, dhe besnikëria e Perëndisë. Për këtë arsye, besimi i tij e madhështoi Perëndinë. Statusi i drejtë i Abrahamit para Perëndisë nuk ishte nga devotshmëria e tij personale, por erdh nga besimi i tij në Perëndinë besimit në fuqinë e Perëndisë, hirit, dhe besnikërisë. Ju lutemi lexoni këtë sqarim të qartë të këtij parimi të besimit tek Romakët 4:20-25: "Madje as nuk dyshoi nga mosbesimi në lidhje me premtimin e Perëndisë, por u përforcua në besim duke i dhënë lavdi Perëndisë, plotësisht i bindur se atë që ai kishte premtuar ishte edhe i fuqishëm ta bënte. Prandaj edhe kjo iu numërua atij për drejtësi. E po nuk u shkrua vetëm për të, që kjo i ishte numëruar, por edhe për ne, të cilëve do që të na numërohet, neve që besojmë në atë

që ka ringjallur prej të vdekurve Jezusin, Zotin tonë, i cili u dha për shkak të fyerjeve tona dhe u ringjall për justifikimin tonë."

Kush janë bijtë e vërtetë të Abrahamit?:

Bibla pohon që bijtë e vërtetë të Abrahamit janë ata që e kanë besimin e Perëndisë, pa e marrë parasysh racën apo origjinën. Libri i Galatasve na sqaron: "Kështu Abrahami e besoi Perëndinë dhe kjo iu numërua për drejtësi." Andaj, kuptoni, që ata që besojnë në Perëndinë janë bij të Abrahamit. Shkrimi e parashikoi që Perëndia do t'i shfajësonte johebrenjtë përmes besimit, dhe ia shpalli Ungjillin më parë Abrahamit: "Të gjitha kombet do të bekohen përmes teje." Ashtu që ata që besojnë janë të bekuar së bashku me Abrahamin, njeriun e besimit. (Galatasve 3:6-9).

Galatasve 3:13-14 vazhdon të thotë: "Krishti na shpengoi na mallkimi i ligjit... që bekimi i Abrahamit t'u vijë johebrenjve me anë të Jezus Krishtit, që ne të marrim premtimin e Frymës me anë të besimit." Me fjalë të tjera, ashtu sikurse Abrahami ishte "shpëtuar përmes besimit" (Zanafilla 15:6, Romakëve 4:2-5), bijtë e vërtetë të Abrahamit janë ata që besojnë në Perëndinë dhe në premtimet e Tij, dhe jo ata që bazohen në aftësitë e tyre për t'i zbatuar ligjet e Perëndisë. Çdonjëri që ka besim të tillë e pranon bekimin e "shfajësimit."

"Mesia" erdhi përmes linjës së Abrahamit:

Abrahami e pa që më parë ardhjen e birit të tij të Madh, Jezusit, të cilin e dinte se do të jetë Biri i Perëndisë (Mesia). Për këtë arsye Jezusi quhet biri i Abrahamit (Mateu 1:1). Siç u përmend edhe më lart, Perëndia i premtoi Abramit që "tërë kombet e botës do të bekohen te pasardhësit e tu" (Zanafilla 22:18).

Galatasve 3:16 na e sqaron kuptimin e këtij premtimi që Perëndia ia bëri Abrahamit: "Dhe premtimet iu bënë Abrahamit dhe pasardhjes së tij. Shkrimi nuk thotë: "Edhe pasardhësve" si të ishin shumë, por të një të vetme: "Dhe pasardhjes sate", pra Krishtit."

Bibla na tregon qartë se Jezusi, Mesia, që rrjedh nga Abrahami, erdhi në tokë për ta realizuar planin e shpëtimit. Ardhja e Jezusit e përmbushi premtimin e Perëndisë ndaj Abrahamit për bekimin e të gjitha kombeve. Duke besuar në Të, njerëzit nga të gjitha kombet mund t'i pranojnë bekimet e Perëndisë. Ata do të bekohen me jetën e përjetshme me Perëndinë tonë të dashur!

Dashuria sakrifikuese e Perëndisë për ne:

A ke menduar ndonjëherë, miku im, pse Perëndia i kërkoi Abrahamit t'ia përkushtojë birin e tij në vend se delet, tokën apo shtëpitë e tij? Sepse biri i njeriut është më i çmueshëm në zemrën e tij se çdo gjë tjetër. Në qoftë se Abrahami do mund t'ia jipte birin e tij Perëndisë, atëherë ai do të ishte i përgatitur t'i jipte Perëndisë gjithçka dhe çdo gjë. Andaj mënyra më e mirë e Perëndisë për ta sprovuar dashurinë e Abrahamit për Të (dhe besimit në Të) ishte për ta urdhëruar atë ta sakrifikojë birin e tij. Abrahami e konfirmoi dashurinë e Vërtetë për Perëndinë kur ishte gati për ta dhënë birin e tij si sakrificë. Dhe Perëndia e konfirmoi dashurinë sakrifikuese të Tij për ne në të njëjtën mënyrë. Kjo është në fakt ajo çfarë Perëndia dëshiron që ju ta zbuloni, miku im i nderuar mysliman. Ai e shfaq dashurinë perfekte të Tij për ju. Te Romakët kapituli 8 lexojmë: "Sepse ai që nuk e kurseu Birin e vet, por e dha për të gjithë ne, qysh nuk do të na dhurojë të gjitha gjërat bashkë me të?" (Romakëve 8:32). Këtu e shohim zemrën e përflakur të Perëndisë me dashuri për njerëzimin.

Perëndia i do dhe i shpengon mëkatarët:

Abrahami sigurisht ka menduar që ajo çfarë Perëndia i urdhëroi atij për të bërë ishte jo më tepër se çfarë Perëndia ishte gati për të bërë për të. Ju lutem më lejoni t'iu bëj një pyetje: A mendoni që Perëndia do të kërkonte një shfaqje më të madhe të dashurisë nga njeriu sesa që Perëndia do t'i jipte njeriut? A do të kërkonte Ai një demonstrim më të madh të dashurisë nga ne sesa që Ai do ta demonstronte për ne? Ungjilli na tregon tek Romakët 5:8 "Por Perëndia e tregon dashurinë e tij ndaj nesh në atë që, kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne". Dhe vetë Jezusi mësoi në Ungjillin e Gjonit: "Askush s'ka dashuri më të madhe nga kjo: të jap jetën e vetë për miqtë e tij." (Gjoni 15:13). Perëndia na dhuroi ne formën më madhështore të dashurisë. Kjo dashuri është më e fuqishme se vdekja dhe përveç kësaj e mundi vdekjen në kryq! Ndjekësit e vërtetë të Krishtit e dinë më siguri që Perëndia ishte i gatshëm për të na dhënë më të mirën e Tij dhe nuk tërhoqi asnjë të mirë nga ne.

Një ilustrim i dashurisë sakrifikuese të Perëndisë:

Dashuria e Perëndisë për ne mund të ilustrohet duke i krahasuar dy udhëheqës militarë. Njëri udhëheqës kishte një qëndrim të ftohtë dhe i dërgonte trupat e tij në betejë përderisa ai rrinte mënjandë luftës. Ai vështronte nga një vend i sigurtë derisa njerëzit e tij e jepnin jetën e tyre në betejë. Lideri tjetër, para se gjithash, i urdhëroi trupat e tij në betejë, dhe iu bashkangjiti atyre në vijën e parë të frontit për t'i udhëhequr në fitore. Ai është i gatshëm për ta lënë jetën e tij për shkak të njerëzve të tij. Lideri i dytë në shikim të parë na shfaq një pamje se si Perëndia i ka udhëhequr njerëzit e tij në fitore, edhe me dhënien e Vetës së Tij për shkak të tyre.

PJESA E KATËRT

JEZUSI NË KURAN DHE NË BIBËL

KAPITULLI 10
"KRISHTI JEZUS" (AL MASIH, ISA)
MESIA I VAJOSUR I PERËNDISË

Kurani në s. 4:171 i jep Jezusit në tre tituj të dallueshëm: "... Mesihu Isa, bir i Merjemës, ishte vetëm i dërguar i Allahut. Ishte fjalë e tij (Kalimatuhu), ...dhe ishte frymë (shpirt) nga Ai (Ruhun Minhu)...."

Jezusi është Mesia në Kuran dhe në Hadith:

Në Kuran, Jezusi referohet si Al- Masih, "Mesia". Nyja e shquar "Al" e dallon në mënyrë pozitive Jezusin nga të gjithë profetët e tjerë. Ndonjëherë, ai referohet vetëm me këtë titull pa e përmendur emrin e tij, sikurse në S. 4:172. Në Kuran titulli "Mesih" i është dhënë Jezusit më shumë se dhjetë herë. Për shembull, në S. 3:45, ne lexojmë që engjëlli Gabriel së pari iu shfaq Marisë dhe i kërkoi që emri i birit të saj të jetë "Jezus Krisht" (Al-Masih Isa).

Jezusi quhet "Al-Masih" edhe në Hadithe. Dijetarët myslimanë sikurse Al-Baidavi dhe Zamakshari pranojnë që titulli, "Al Masih", i përmendur shumë herë në Kuran, nuk rrjedh nga një rrënjë arabe.

Al Baidavi, duke komentuar në S. 3:45, thotë që fjala "Krisht" (Al-Masih) ishte në origjinal fjalë hebreje (Mashih). Vëreni që Kurani nuk e sqaron kuptimin e titullit "Mesia". Prandaj, duke mos dhënë një shpjegim të këtij titulli, në mënyrë të nënkuptueshme pajtohet me atë çfarë është shkruar për Mesinë në shkrimet krishtere (që Kurani e konfirmon dhe e respekton në të gjitha faqet e saj).

Është e rëndësishme ta kuptojmë këtu që Bibla është shkruar në gjuhën greke. Fjala greke për Al-Masih apo "I Vajosuri" është "ho Christos", nga e cila rrjedh edhe fjala angleze "Christ". Prandaj, kudo që fjala "Christ" është përdorur në përkthimet anglishte të Dhiatë së Re, nënkupton të njëjtën si Al Masih. Të gjithë dijetarët myslimanë pajtohen në këtë pikë.

Tek Luka, 24:44, Jezusi e indentifikon veten si Mesih dhe iu tha dishepujve të tij: "Këto janë fjalët që unë ju thoja kur isha ende me ju: se duhet të pëmbushen të gjitha gjërat që janë shkruar lidhur me mua në ligjin e Moisiut, në profetët dhe në psalmet".

Profecitë e ardhjes së Mesisë:

Dhiata e Vjetër është shkruar ndërmjet viteve 400 deri 1500 para ardhjes së Krishtit në tokë. Përmban shumë profeci të frymëzuara të Një Shpëtimtari Madhështor, që një ditë do të dërgohej në tokë nga Perëndia. Ai është quajtur "Mesia". Çuditërisht, Dhiata e Vjetër përmban më se 300 referenca për ardhjen e Mesisë, e që të gjitha ishin përmbushur në jetën e Jezusit.¹ Ekzistojnë 61 profeci të mëdha në Dhiatën e Vjetër lidhur me ardhjen e Jezusit, të cilat Jezusi i përmbushi 100 % me saktësi të plotë! Shumë libra janë shkruar në kuadër të kësaj teme. Një libër i shquar rekomandues për profecitë mesianike është: *Të gjitha profecitë mesianike në Bibël*, nga Herbert Lockyer.² Nuk mund të thuhet që "profecitë e përmbushura" lidhur me Jezusin ishin të fabrikua sepse shumë prej profecive lidhur me të ishin plotësisht jashtë kontrollës njerëzore. Ju lutem merrni parasysh shembujt e mëposhtëm:

- Vendi i tij i lindjes:

Jezusi ishte lindur në Betlehem, paralajmëruar nga profeti Mikea rreth 700 vjet para ardhjes së Krishtit (Mikea 5:2). Përmbushja historike e kësaj profetësie gjindet tek Mateu 2:1, 6 dhe Gjoni 7:42.

- Mënyra e lindjes:

Jezusi ishte lindur nga një e virgjër, ashtu siç ishte profetizuar nga profeti Isaia shtatë shekuj më herët: "Prandaj vet Zoti do t'iu japë një shenjë: Ja, e virgjëra do të mbetet me barrë dhe do të lindë një fëmijë të cilin do ta quajë Emanuel" (Isaia 7:14). E shohim këtë përmbushje historike të kësaj profetësie në Mateun 1:18-25, dhe Luka 1:26:35.

- Torturat ndaj tij para kryqëzimit:

Ekzistojnë profeci specifike të ndryshme lidhur me rrahjet e Jezusit, talljet, dhe fyerjet tjera. Shikoni Isaia 50:6 (realizuar te Mateu 26:67-68 dhe në 27:26).

- Vdekja e tij me anë të kryqëzimit:

Psalmi profetik mesianik 22 e përshkruan vdekjen në kryq me fjalë të vetë Jezusit. Është shkruar nga Davidi 1000 vjet para ardhjes së Krishtit. Vargu 16 thotë: "Më kanë shpuar duart dhe këmbët" (Psalmi 22:16). Ky psalm është veçanërisht i rëndësishëm për shkak se është shkruar 600 vjet para se kryqëzimi të përdorej si ekzekutim. Edhe një profeci tjetër lidhur me "shpuarjen" e Jezusit është në Zakaria 12:10, e përmbushur në Gjonin 19:34 dhe Mateun 27:35.

- Misioni i tij në tokë:

Detajet e vdekjes dhe varrimit të Jezusit ishin profetizuar nga Isaia rreth 700 vjet para Krishtit tek Isaia kapitulli 53, që gjithashtu sqaron misionin e Mesisë: "Por ai u tejshpua për shkak të shkeljeve tona, u shtyp për paudhësitë tona; ndëshkimi për të cilin kemi paqen është mbi të, dhe për shkak të vurratave të tij ne jemi shëruar. Ne të gjithë endeshim si dele; secili prej nesh ndiqte rrugën e vet, dhe Zoti bëri që të bjerë mbi të paudhësia e ne të gjithëve." (Isaia 53:5-6).

Kurani konfirmon se Perëndia ia zbuloi Psalmet Davidit:

Miq të nderuar myslimanë, Kurani na informon në S. 2:136: "Ju thuani: Ne i besuam Allahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Isakut, Jakubit dhe pasardhësve, atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre..." Davidi është njëri prej profetëve të referuar në S. 2:136. S. 4:163 na informon: "Davudit i patëm dhënë Zeburin", dhe S. 21:105 pohon: "Ne e kemi shënuar në Zebur..." (Gjithashtu shiko S. 17:55).

Psalmet mesianike:

Së bashku si besimi hebrej dhe ai i krishterë kanë interpretuar disa psalme të jenë mesianike. Në fakt, psalmet iu referuan aq shumë ardhjes së Mesisë sikurse ngjarjet të ndodhnin në atë kohë. Shumë prej vargjeve në psalme përshkruajnë detajet e ngjarjeve gjatë jetës dhe vdekjes së Jezusit. Dhe ato ishin shkruar disa qindra vjet para ardhjes së Krishtit. Ju lutem shikoni disa shembuj të profecive mesianike mahnitëse dhe përmbushjet e tyre, të shkruara menjëherë më poshtë:

- Psalmi 41:9: Profeci e Dhiatës së Vjetër: Mesia do të tradhëtohej nga një mik.

Përmbushja në Dhiatën e Re: Mateu 26:47-50 (Jezusi është tradhëtuar nga Juda dhe arrestuar).

- Psalmi 69:21: Profeci e Dhiatës së Vjetër: Mesisë do t'i ofrohet uthull e thartë për t'ia

larguar etjen (në kryq)

Përmbushja në Dhiatën e Re: Gjoni 19:28-30 (Jezusi në kryq tha: "Jam i etur", dhe uthulla e thartë iu ofrua buzëve të tij).

- Psalmi 110:1: Profeci e Dhiatës së Vjetër: Mesia është Zot i Davidit. Ai do të qëndron me lavdi në krahun e djathtë të Perëndisë.

Përmbushja në Dhjatë e Vjetër: Mateu 22:41-45 (Jezusi i reciton fjalët e Psalmi 110:1 dhe ia drejton vetvetës).

Profecitë mesianike në librin e Isaisë:

Ne e lexojmë një profeci të mrekullueshme tek Isaia 9:5: "Sepse na ka lindur një fëmijë, një djalë na është dhënë. Mbi supet e tij do të mbështetet perandoria dhe do të quhet Këshilltar i admirueshëm, Perëndi i fuqishëm, Atë i përjetshëm, Princ i paqës."

Sipas një profecie tjetër nga Isaia, Mesia do të quhej "Emanuel". (Emanuel është një emër hebre që nënkupton "Perëndia është me ne"). Te Isaia 7:14 lexojmë: "Prandaj vetë Zoti do t'iu japë një shenjë: Ja, e virgjëra do të mbetet me barrë dhe do të lindë një fëmijë të cilën do ta quaj Emanuel." Përmbushja e kësaj profecie shihet në Mateun 1:21-23 dhe Luka 7:16: "Perëndia e vizitoi popullin e vet...."

Një shembull tjetër i profecisë mesianike është në kapitullin e 50 të librit të Isaisë, që e përshkruan vdekjen e Mesisë dhe poshtërimin që e përjetoj nga armiqët e tij. Vargu 6 thotë: "I paraqita kurrizin tim atij që më rrihte dhe faqet e mia atij që më shkulte mjekrën; nuk ia fsheha fytyrën time poshtërimin dhe të pështyrave." Kjo profeci u realizua në Mateun 26:67: "Atëherë e pështynë në fytyrë, e goditën me shuplaka; dhe disa të tjerë i ranë me grushta."

Jezusi është "Biri i Perëndisë" dhe "Biri i njeriut":

Jezusi e quajti veten "Biri i Perëndisë", sikurse është në Ungjill, tek Mateu 26:63-64. Jezusi gjithashtu e quajti veten "Biri i njeriut". Ai i përdori këto tituj për ta bërë evidente natyrën e tij njerëzore sikurse edhe hyjnore. Ju lutem merrni në konsideratë:

- Në gjuhën siriane (aramaishte), që ishte gjuha amëtare e tij, shprehja "Biri i njeriut" është përdorur vazhdimisht për të nënkuptuar njeriun.

- Ai e përmbushi premtimin (tek Zanafilla 3:15), që një njeri nga pasardhësit e Adamit, nga fara e gruas, do ta shtypë kokën e gjarpërit (Satanit). Ky premtim u përmbush nga vepra e Jezusit në kryq.

- Danieli 7:13 e përdor titullin "Biri i Njeriut" për të treguar ardhjen e Mesisë, i cili është hyjnor.

- Të dy së bashku, edhe Dhiata e Vjetër edhe Dhiata e Re e mësojnë natyrën njerëzore-hyjnore të Mesisë (Krishtit).

Mohimi i Jezusit nga populli i tij:

Profeci të ndryshme për më tepër paralajmëruan edhe mohimin e Jezusit nga populli hebre (shiko Psalmi 118:22 dhe Isaia 8:14). Jezusi iu referua Psalmi 118:22 kur ai fliste për të qenurit i mohuar nga vetë populli i tij (Mateu 21:42 dhe Marku 12:10-11). Ne lexojmë për përmbushjen e kësaj profecie në 1Pjetri 2:7 dhe Romakëve 9:32-33.

Krishterimi është për të gjithë njerëzit dhe për ta gjithë racat:

Fatkeqësisht, në kohën e Jezusit, shumë prej hebrenjve menduan se premtimet e Perëndisë ishin të dedikuara vetëm për ta. Ata e kishin gabim. Perëndia deklaroi në Ungjill që të gjithë besimtarët janë një në Krishtin. Të pasurit besim në Krishtin i tejkalon të gjitha dallimet midis njerëzve. Galatasve 3:28 thotë: "Nuk ka as Jude, as Grek, nuk ka as skllav as të lirë, nuk ka

as mashkull as femër, sepse të gjithë jeni një në Jezus Krishtin." (shikoni gjithashtu Romakëve 3:29-30).

Udhëheqësit religjioz hebrej e kishin gabim kur pritën që me ardhjen e tij, Mesia do ta ngriste popullin e tyre. Ata gjithashtu gabonin kur besonin që Mesia do ta emëronte vetveten si një mbret tokësor. Jezusi deklaroi: "Mbretëria ime nuk është nga kjo botë." (Gjoni 18:36).

Shpallja e një Lajmi të Mirë të mahnitshëm:

Profetët e Dhiatës së Vjetër e shpallën me gëzim Shpëtimtarin e Madh, Mesinë e Perëndisë. Çfarë momenti i madh në historinë e njerëzimit kur Lajmi i Mirë ishte shpallur! Al-Masihi do të ishte Shpëtimtar dhe Zotërues i të gjithë njerëzimit. Për këtë arsye fjala e Perëndisë na tregon që lindja e tij është "Lajmi i mirë". Kjo ngjarje lokalizohet tek Luka kap. 2. Një engjëll i shfaqet një grupi të barinjve në fushat e Betlehemit, dhe lavdia e Perëndisë shkëlqeu rreth tyre, dhe engjëlli e bëri këtë proklamim të mrekullueshëm:

"Mos druani, sepse unë po ju lajmëroj një gëzim të madh për të gjithë popullin; sepse sot në qytetin e Davidit lindi për ju një Shpëtimtar, që është Krishti, Zoti. Dhe kjo do t'iu vlejë si shenjë: ju do të gjeni një fëmijë të mbështjellur me pelena, të shtrirë në një grazhd. Dhe menjëherë engjëllit iu bashkua një shumicë e ushtrisë qiellore, që lëvdonte Perëndinë, duke thënë: "Lavdi Perëndisë në vendet më të larta, dhe paqe mbi tokë njerëzve mbi të cilët qëndron mirëdashja e tij" (Luka 2:8-13).

Kurani e konfirmon këtë Lajm të Mirë:

Është mjaft e qartë se Kurani pajtohet me Ungjillin lidhur me identitetin e Mesisë. Është mjaft interesante për ta vërejtur se Kurani jo vetëm se pajtohet me Biblën lidhur me atë që Al-Masihi (Mesia) është Jezusi, biri i Marisë, por Kurani gjithashtu e konfirmon deklarin biblik që lindja e Jezusit është lajm i mirë. Këtë e pohon në S. 3:45: "Oj Merjeme, Allahu të përgëzon me fjalën e vet, emri i të cilit është Mesih, Isa, bir i Merjemës, i famshëm në dynja e ahiret dhe nga të afërmit (e Zotit). "

Kundërshtimi i lajmit të mirë:

Shumë njerëz në këtë botë nuk kanë dëgjuar kurrë apo kuptuar pse Perëndia e deklaroi lindjen e Mesisë të jetë Lajm i Mirë. Sigurisht që Satani dëshiron që askush të mos dijë për "Lajmin e Gëzuar" të Perëndisë për njerëzimin. Të lexojmë tek 2Korintasve kap. 4:3-6:

"Dhe, në qoftë se ungjilli ynë është ende i mbuluar me vel, ai është i mbuluar për ata që humbin, të cilëve Perëndia i këtij shekulli ua verboi mendjet e atyre që nuk besojnë, që drita e ungjillit të lavdisë së Krishtit, që është shëmbëllimi i Perëndisë, të mos ndriçojë tek ata. Sepse ne nuk predikojmë, pra, veten tonë, por Jezu Krishtin, Zotin, dhe jemi shërbëtorët tuaj për hir të Jezu Krishtit, sepse Perëndia që tha: "Le të ndriçojë drita në errësirë", është i njëjti që shkëlqeu në zemrat tona për të na ndriçuar në njohurinë e lavdisë së Perëndisë, në fytyrën e Jezu Krishtit."

Jezusi erdhi për mëkatarët:

Satani është duke punuar rëndë për t'i parandaluar njerëzit nga të kuptuarit e natyrës dhe misionit të Jezusit, siç është zbuluar nëpër tërë Biblën. Kur mësuesit religjioz judenj i pyetën dishepujt e Jezusit, "Pse mësusi juaj hanë me mëkatarët?" Jezusi u përgjigj: " Nuk janë të shëndoshët që kanë nevojë për mjekun, por të sëmurët; unë nuk erdha për të thirrur të drejtët, por mëkatarët për pendim. (Marku 2:17)

IDENTITETI UNIK I JEZUSIT

Ne mësojmë nga Bibla që Jezusi, Ai - Masihu, është zbulim i mëshirës dhe dashurisë së Perëndisë, dhe shpëtim për njerëzimin. Është shumë e qartë që Mesia i ardhur nuk do të jetë jo më pak se sa Biri i Perëndisë dhe Shpëtimtar i botës. Sidoqoftë, kur Jezusi u shfaq në mes të njerëzve, ai u pranua me reagime të ndryshme. Shumë njerëz e mohuan atë. Disa menduan për të vetëm si një profet. Dhe të tjerët ishin të pasigurtë lidhur me identitetin unik të tij. Për shembull, kryepriifti i judenjve e pyeti Jezusin: "Unë po të përbej për Perëndinë e gjallë të na thuash nëse ti je Krishti, Biri i Perëndisë" (Mateu 26:63). Në anën tjetër, ishin shumë njerëz që e njihnin Jezusin si "Mesinë" e paralajmëruar, "të vajosurin", dhe e ndoqën atë. Dy vargje nga Ungjilli janë:

"Pastaj Jezusi, mbasi arriti në krahinën e Cezaresë së Filipit, i pyeti dishepujt e vet: "Kush thonë njerëzit se jam unë, i Biri i njeriut?". Dhe ata thanë: "Disa Gjon Pagëzori, të tjerë Elia, të tjerë Jeremia, ose një nga profetët". Ai u tha atyre: "Po ju, kush thoni se jam unë?". Dhe Simon Pjetri duke u përgjigjur tha: "Ti je Krishti, Biri i Perëndisë të gjallë". (Mateu 16:13-16) Marta nga Betania i tha Jezusit: "Po, Zot, unë besoj se ti je Krishti, Biri i Perëndisë, që duhet të vinte në botë". (Gjoni 11:27)

Mrekullitë e Jezusit (shenjat dhe çudirat):

Gjatë misionit të tij në tokë, Krishti Jezus ekspozoi fuqi dhe autoritet të madh si asnjë më parë. Mrekullitë e bëra nga ai ishin shenja definitive që konfirmojnë se me të vërtetë ai është I Vajosuri i dërguar nga Perëndia për të qenë Shpëtimtar i botës. Për shembull, ne e lexojmë në Bibël qëllimin transformues të librit të Gjoni:

"Jezusi bëri edhe shumë shenja të tjera në prezencën e dishepujve të tij, të cilat nuk janë shkruar në këtë libër. Por këto gjëra janë shkruar që ju të besoni se Jezusi është Krishti, Biri i Perëndisë dhe që, duke besuar, ta keni jetën në emër të tij." (Gjoni 20:30-31)

Pastaj në librin e Veprave, ne e vërejmë një referencë tjetër të aftësive mbinatyrore të Jezusit:

"Ju e dini se ç'ka ndodhur në mbarë Judenë, duke filluar nga Galilea, pas pagëzimit që predikoi Gjoni: se si Perëndia vajosi me Frymën e Shenjtë dhe me fuqi Jezusin prej Nazareti, i cili e përshkoi vendin duke bërë mirë dhe duke shëruar të gjithë ata që ishin të pushtuar nga djalli, sepse Perëndia ishte me të." (Veprat 10:37-38)

Referencat lidhur me mrekullitë e Jezusit në Kuran:

Kurani flet që mrekullitë e shfaqura nga Jezusi janë "shenja të qarta" të fuqisë së Perëndisë. Këto shenja të qarta nuk iu ishin dhuruar të gjithë profetëve. Kurani në s. 2:253 citon: "Këta janë të dërguarit, disa prej tyre i dalluam nga të tjerët... Isait, birit të Merjemës i dhamë argumente..." Duke e komentuar këtë varg Ai Baidawi tha: "Perëndia i bëri mrekullitë e Jezusit dëshmi të preferimit të tij (mbi të gjithë profetët) sepse ato janë shenja të qarta dhe mrekulli të mahnitshme. Të gjitha ato mrekulli nuk ishin bërë nga askush tjetër.

Jezusi krijon qeniet e gjalla dhe ngjallë njerëzit nga të vdekurit:

Në Kuran, Jezusi pohon që ai krijon jetën, shëron njerëz, edhe leprozët, dhe i ngritë njerëzit nga të vdekurit! Në s. 3:49, Jezusi nga balta e bën shpendin dhe i jepë jetë duke i fryrë atij. Thuhet: "Unë kam ardhur nga Zoti juaj me argument, unë nga balta ju bëj diç si shpendi, i fryrë atij dhe ai me lejen e Allahut bëhet shpend, unë i shëroj të verbërit, të sëmurit në lëkurë, dhe unë me lejen e Allahut i ngjalli të vdekurit: unë ju tregoj për atë që hani dhe për atë që e depononi në shtëpitë e tuaja. Vërtet, kjo është fakt për ju nëse jeni besimtarë."

Jezusi vetë e shfaq fuqinë e madhe të Perëndisë:

Në Ungjillin e Lukës, 6:17-19, lexojmë që një grumbull i madh i njerëzve kanë ardhur për ta dëgjuar Jezusin dhe për t'u shëruar prej sëmundjeve të tyre. "Pastaj, pasi zbriti bashkë me ta, ndaloi në një vend të sheshtë, me turmën e dishepujve të vet dhe me një numër të madh njerëzish nga gjithë Judea, nga Jerusalemi dhe nga bregdeti i Tiros dhe i Sidonit, të cilët kishin ardhur për ta dëgjuar atë dhe për t'u shëruar nga sëmundjet e veta. Por edhe ata që i mundonin frymërat e ndyrë shëroheshin. "

Është habitëse, por edhe zhgënjyese për shumë dijetarë myslimanë, që Kurani askund nuk citon për ndonjë shenjë apo mrekulli të bërë nga Muhamedi. Në fakt, S. 28:48 i adresohet kësaj mungese, duke pohuar: "E kur atyre u erdhi e vërteta nga ana Jonë, ata thanë: "Përse nuk iu dha atij (Muhamedit) sikurse iu dha Musait (ndonjë mrekulli materiale)?" Kurani përshkruan që shumë njerëz nuk besuan në Muhamedin për shkak të mosbërjes së mrekullive. (Ju lutem shikoni gjithashtu edhe S. 20:133 dhe 29:50). Jezusi vetë e posedoi fuqinë e madhe të Perëndisë, dhe vetë Jezusi është i aftë për të shëruar shpirtërisht dhe fizikisht të gjithë ata që besojnë në të!

KAPITULLI 11 **JEZUS KRISHTI, "FJALA E TIJ"** **(KALIMATUHUU)**

Në Kuran, Jezusi quhet "Fjala e tij" (Kalimatuhuu) që thjesht do të thotë: Fjala e Perëndisë. S. 4:171 i përmban këto fjalë: "Mesihu Isa, bir i Merjemës, ishte i dërguar i Allahut. Ishte Fjalë e tij."

"Fjala e Perëndisë":

Ne gjithashtu lexojmë se çfarë i tha engjëlli Marisë, në S. 3:45, "Allahu të përgëzon me fjalën e vet, emri i të cilit është Mesih, Isa, bir i Merjemës..." Lexues i nderuar, vëreje që këtë Fjalë që Perëndia i dha Marisë nuk ishte një shprehje e thjeshtë, por ishte personi i vërtetë i Jezusit Krishtit. Pastaj në S. 3:39, Kurani pajtohet me Ungjillin rreth Gjon Pagëzuesit (profetit Jahja) që proklamoi "Fjalën" (Kalima) që do të vinte prej Perëndisë. Njëjtë në Ungjill, tek Gjoni 1:23-27, Gjon Pagëzuesi ishte dërguar nga Perëndia për ta përgatitur udhën dhe shpallur ardhjen e Mesisë. Një dijetar mysliman i shkolluar, Al Razi, duke komentuar në s. 3:39, që thotë, "...Jahjai do të vërtetojë fjalën e ardhur nga Allahu...", Razi sqaron se "Ajo çfarë është menduar nga "Fjala e Zotit" është Isa, paqa qoftë mbi të. Kjo është zgjidhja e shumicës së komentatorëve."¹

"Fjala e Perëndisë" është titull unik:

Në Kuran edhe në Ungjill, Jezusi është i vetmi person të cilit i është dhënë titulli unik, "Fjala e Perëndisë". Ne mund ta shohim qartë theksimin e hyjnisë së tij në këtë titull. A e ke vërejtur këtë, miku im? Personi i Jezusit është Fjala, dhe burimi i Fjalës është Perëndia Vetë. Ndërsa Kurani nuk jep sqarim për këtë titull, Bibla e bën këtë, siç do ta shihni.

Jezusi është zbulim i plotë i Perëndisë ndaj njeriut:

Pasi që Perëndia vetë e quan Jezusin "Fjalë e Perëndisë" në Bibël (dhe Kurani pajtohet), është e qartë andaj që personi i Jezusit duhet të jetë shprehja e vetme dhe perfekte e mendjes dhe vullnetit të Perëndisë. Kjo është ajo çfarë Ungjilli na tregon tek Kolosianët 1:15-19: "Ai (Jezusi)

është shëmbëllesha e Perëndisë së padukshëm..." Në fakt Fjala e Perëndisë (Jezusi) është zbulimi i vërtetë i Perëndisë ndaj njeriut. Ta njohësh atë është ta njohësh Perëndinë, dhe kjo është ajo çfarë Jezusi tha në Gjonin 14:9: "Kush më ka parë mua, ka parë Atin." Jezusi jo vetëm që sjell zbulimin dhe fjalët e Perëndisë tek njeriu; por vetë ai është ajo fjalë që zbriti nga qielli në tokë. (Gjoni 1:14)

Fjalët e Jezusit janë mbinatyrore:

Është e qartë përgjatë tërë Ungjillit që fjalët e Jezusit ishin fjalët e Perëndisë. Jezusi e foli fjalën e Perëndisë. Vëreni që Kurani e pranon efektin hyjnor të fjalëve të Jezusit, sikurse do ta zbulosh duke e lexuar këtë libër. Konsidero fjalët e fuqishme të Jezusit në Kuran dhe në Bibël:

- Jezusi i foli një lebrozi, "Pastrohu", dhe ai menjëherë u pastrua (Marku 1:40-45; S. 3:49).

- Jezusi i tha një paralitiku: "mëkatet tuaja të janë falur" dhe pastaj i dha mundësinë për të ecur (Marku 2:5).

- Jezusi e ngriti vajzën e vdekur në jetë kur i foli asaj: "vajzë, ngritu". (Marku 5:21-43, S. 3:49; S. 5:110).

- Jezusi e qetësoi furtunën duke thënë, "Pusho dhe fashitu", duke shfaqur autoritet mbi natyrën (Marku 4:35-41).

Fjalët mbinatyrore të Jezusit bënë atë çfarë vetëm Perëndia do të mund të bënte. Jo vetëm që fjalët e Jezusit historikisht shëruan të sëmurë, falën mëkatet e mëkatarëve, por edhe Jezusi i ngritur edhe më tutje na flet fjalë të tilla edhe sot!

NATYRA E PËRJETSHME E FJALËS SË PERËNDISË

Ndonëse Jezusi është Fjala e Perëndisë dhe Fjala e Perëndisë është e përjetshme dhe jo e krijuar, duket që Perëndia Atë dhe Fjala e tij, Jezusi, janë Një. Jezusi tha: "Unë dhe Ati jemi një". (Gjoni 10:36) Në qoftë se ndokush e mohon që ata janë një, atëherë ai person duhet të konkludojë që ekzistojnë dy entitete të veçanta që kanë jetuar nga përjetësia. Kjo është blasfemi sepse vetëm një Perëndi është i përjetshëm. Dhe në qoftë se ndokush thotë që "Fjala e Zotit" është e krijuar dhe për këtë nuk është e përjetshme, është njëjtë si të thuash se në një kohë Perëndia nuk ka mundur të flasë dhe më vonë pastaj e bëri këtë. Kjo do ta shkelte doktrinën që Perëndia është i pandryshuar.

"Fjala" ekzistoi çdoherë:

Ne e gjejmë sqarimin e qartë të titullit "Fjala" dhënë Jezusit në Kuran dhe Bibël. Sipas Ungjillit të Gjonit 1:1-4 "Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi. Ai (fjala) ishte në fillim me Perëndinë. Të gjitha gjërat u bënë me anë të tij (fjala), dhe pa atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë. Në atë ishte jeta, dhe jeta ishte drita e njerëzve."

Në këto vargje, Ungjilli na mëson se në fillim para se Perëndia t'i krijonte "të gjitha gjërat", Fjala tashmë ekzistonte. Jezusi gjatë tërë përjetësisë ka qenë Fjala e Perëndisë. Natyra e vetë Fjalës është ajo e Perëndisë. Për këtë arsye, Ai është hyjnor.

Fjala e përjetshme u bë mish:

Jezusi vetë është Fjala e Perëndisë që erdhi në tokë në formën njerëzore. Fjala e Perëndisë u bë njeriu Jezus Krisht, biri i Marisë. Gjoni 1:14 na zbulon: "Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne; dhe ne soditëm lavdinë e tij, si lavdia e të vetëmlindurit prej Atit, plot hir e të vërtetë."

Kur thuhet që "Fjala e bë mish" kjo nuk do të thotë që Fjala (Logos) pushoi të jetë Ai çfarë ishte. Fjala "egeneto" në Gjoni 1:14 ("u bë") sigurisht nuk nënkupton që Logosi u ndryshua

në mish ("sarx") dhe ndryshoi natyrën e tij esenciale. Kjo nënkupton që ai e mori këtë karakteristikë të veçantë. Ai e fitoi një formë plotësuese (formën njerëzore) pa e ndryshuar natyrën e tij qenësore në asnjë mënyrë. Ai ngeli Biri i pakufishëm dhe i pandryshuar i Perëndisë.

Perëndia komunikon me ne përmes Fjalës së tij të përjetshme:

Të lexojmë tek Hebrenjve kap. 1:1-3: "Perëndia, mbasi u foli së lashti shumë herë dhe në shumë mënyra etërve me anë të profetëve, së fundi, këto ditë na ka folur me anë të Birit... Ai, duke qenë shkëlqimi i lavdisë së tij dhe vula e qenies së tij..." Ne e kemi në Jezusin manifestimin më të plotë të mundur të Perëndisë ndaj njeriut. Përmes Jezusit Perëndia e manifestoi karakterin e tij dhe komunikoi me ne drejtpërsëdrejti. Gjoni 1:4, thotë: "Në atë ishte jeta, dhe jeta ishte drita e njerëzve." Miqtë tanë myslimanë dështojnë për ta bërë këtë lidhje në mes të Fjalës dhe jetës. Fjala e Perëndisë në mënyrë infinite ndryshon në konceptë nga "Fjala" jonë e komunikimit njerëzor. Është interesante që një dijetar mysliman eminent Dr. Qaradawi, shkroi për natyrën e Perëndisë: "Në qoftë se të dëgjuarit tanë është nga shqisa e të dëgjuarit që transmetohet nga ajri, të dëgjuarit e Perëndisë ndryshon nga të dëgjuarit tanë. Dhe në qoftë se të pamurit tanë i përfshinë gjërat përmes shqisës së të pamurit, dhe rrezet (e dritës), të pamurit e Perëndisë nuk është si e jona."² Kurani në s. 42:11 thotë: "Asnjë send nuk është si Ai..." Perëndia, sigurisht që është i Gjithëpushtetshëm.

KRISHTI ËSHTË SIKURSE "LIBRI I PERËNDISË"

Në s. 3:39, Jezusi quhet "Fjalë e Perëndisë". Al-Baidawi, një prej dijetarëve mysliman të famshëm, bëri një koment lidhur me këtë S.: "Jezusi quhet Fjalë e Perëndisë sepse ai është sikurse Libri i Perëndisë." Kjo është një deklaratë shumë e rëndësishme. Sipas mësimëve të dijetarëve myslimanë dhe besimeve myslimane, libri i Zotit, Kurani, që recitohet nga gjuhë të ndryshme, i cili është i shkruar në libër (Musaf) dhe i kujtuar në zemra, është i përjetshëm dhe ekziston në vetë Perëndinë. Nuk mund të ndahet apo veçohet nga Perëndia duke e transmetuar në zemrat tona apo duke e shkruar në letër.³

Fjala e Perëndisë sipas krishterimit:

Është fakt se Perëndia është i përjetshëm, fjala e Perëndisë është e përjetshme, dhe që Perëndia është Një. Perëndia e urëzoi (bashkoi) humnerën në mes të pakufizimit dhe kufizimit duke ia zbuluar fjalën e tij të përjetshme krijesave të tij të kufizuara.

Fjala e Perëndisë sipas islamit:

Myslimanët besojnë që Perëndia e manifestoi Fjalën e tij të përjetshme ndaj botës së tij të krijuar përmes librit të quajtur Kuran. Për myslimanët Fjala qëndron e përjetshme si brenda qenies së Perëndisë ashtu edhe brenda faqeve të Kuranit arabik. Më tutje myslimanët besojnë që Kurani i është shpallur Muhamedit në një vend dhe kohë të posaçme, gati katërmëdhjetë shekuj më herët. Për këtë arsye, për myslimanët, e pakufizuara dhe e kufizuara takohen brenda Kuranit arabik.

Fjala e shkruar dhe Fjala e Mishëruar:

Sipas krishterimit, Perëndia ia komunikoi Fjalën e tij të Përjetshme botës së krijuar në formën e shkruar (e tërë Bibla) dhe përmes Fjalës së gjallë të Inkarnuar (personi i Jezusit). Së bashku të dytë e reprezentojnë të vërtetën e përjetshme të njëjtë. Andaj edhe Bibla flet për Fjalën e përjetshme të Perëndisë "të bërë mish", si njeriu Jezus (Gjoni 1:14). Para se Fjala e përjetshme

të bëhej njeri, Jezusi (edhe para se edhe Maria të lindej), Fjala banonte përjetësisht në qenien e Perëndisë. Jezusi (Mesia) është Fjala e gjallë e përjetshme e Perëndisë në formën njerëzore.

A ËSHTË FJALA E PERËNDISË E KRIJUAR APO E PAKRIJUAR?

Myslimanët besojnë që Fjala e pakrijuar e Perëndisë (e pakrijuar si Perëndia) mund të bëhet libër i krijuar - pikërisht Kurani arabik. Një dijetar prominent Ibn Hazm e citon njërin prej dijetarëve udhëheqës Ibn Hanbal, duke thënë "Fjala e Perëndisë është njohuria e tij e përjetshme dhe prandaj është e pakrijuar".⁴ Dijetarët mysliman pajtohen se ekzistojnë dy aspekte (natyra) të Kuranit: njerëzore dhe hyjnore. Lidhur me Kuranin ata pohojnë:

- E përmban natyrën humane (fizike) sepse është e shkruar në libra nga duart e njerëzve, dhe u shfaq në historinë njerëzore, dhe është subjekt i konsumimit.

- E ka natyrën hyjnore (të përjetshme) sepse Kurani është njohuria e Perëndisë. Ekziston në Perëndinë vetë dhe nuk mund të ndahet apo veçohet nga Perëndia duke e shkruar në letër.

Njëri prej udhëheqësve të hershëm të botës muslimane, Kalif Mamun (786-833), besoi që Kurani ishte krijuar. Me plot domethënie ai deklaroi në një letër për guvernatorin e Bagdadit, që ata të cilët besojnë që Kurani është i pakrijuar janë "sikurse të krishterët kur pohojnë që Jezusi biri i Marisë ishte i pakrijuar sepse ishte Fjala e Perëndisë."⁵

Perëndia e dërgoi Birin e tij sikurse edhe udhëzimet e shkruara:

Mik i nderuar mysliman, unë lutem që ju do të vëreni që Perëndia, i motivuar nga dashuria e fortë për njerëzimin e "vdekur shpirtërisht", nuk ishte i kënaqur të dërgojë vetëm një libër. Ai gjithashtu zgjodhi ta prezentojë Vetën si Mjeku dhe Shpëtimtari ynë personal, në personalitetin e Jezusit. Ju lutem më lejoni ta ilustrojë. Imagjinoni një njeri duke u fundosur pa shpresë në oqean. Ai me mjaft vështirësi e mban kokën mbi ujë. Në qoftë se ju do të ishit ai njeri, cila do të ishte nevoja më urgjente e juaja? Për të hedhur ndonjëri një libër me udhëzime të notit, apo për dikë të zhytet në ujë dhe t'iu shpëtojë? Në Ungjill, Perëndia tha që raca njerëzore po fundosej në baltë nga mëkati, dhe Ai personalisht erdhi për të na shpëtuar!

KAPITULLI 12

JEZUS KRISHTI, "SHPIRTI NGA PERËNDIA" (RUHUN MINHU)

S. 4:171, tregon që "Mesihu, Isa, bir i Merjemës, ishte vetëm i dërguar i Allahut...dhe ishte Shpirt nga Ai (Ruhun Minhu)..." Në një përkthim tjetër mirë të pranuar të Kuranit, termi "Ruhun Minhu" gjithashtu është përkthyer "Shpirt nga Perëndia."

Sipas Kuranit Jezusi është Shpirti nga Perëndia:

Në Kuran, Jezusi është i vetmi të cilit i është dhënë titulli "Shpirt nga Perëndia." Perëndia përsëri është burim i Shpirtit sikurse është burim i Fjalës. Ky titull nuk është i sqaruar në Kuran. Sidoqoftë, ky titull e përkrah besimin e krishterë që Jezusi nuk ishte vetëm një krijesë e bërë nga balta, por ishte Shpirt i përjetshëm që e veshi mishin njerëzor. Kurani na tregon që Jezusi, Mesia, biri i Marisë, është "Shpirti nga Perëndia". Kjo deklaratë e konfirmon pre-ekzistencën e Jezusit para ngjizjes së tij mrekullore në tokë. Në traditat islamike (Hadithe), që përsëri është një dokumentim i fjalëve dhe i veprave të Muhamedit, Jezusi referohet si "Shpirti i Perëndisë".

Sipas Muhamedit, Jezusi është Shpirti i Perëndisë:

Në Al-Ahadith Al-Qudsiyyah (grupet më të respektuara të Haditheve) ne lexojmë, "Isa është shërbëtor i Allahut, apostull i tij, fjalë e tij, dhe shpirt i tij."¹ Në hyrje, autori e përshkruan autoritetin hyjnor të AL-Ahadith AL-Qudsiyyah: "Hadithi Kudsi, sidoqoftë, është një raport i asaj çfarë Perëndia tha, edhe pse jo domosdoshmërisht në fjalët e tij. Autoriteti hyjnor i shpallur apo i përfshirë në mënyrë të qartë në përmbajtjen e Hadithit Kudsi, i jep këtij grupi të Haditheve një karakter të veçantë dhe rëndësi për myslimanët dhe jomyslimanët gjithashtu."

"Shpirti i Shenjtë" në Kuran:

Kurani i referohet disa herë "Shpirtit të Shenjtë", sikurse në S. 2:87 dhe 2:253. Në s. 16:102, lexojmë: "Atë (Kuranin) e solli "Ruhul Kudus"- shpirti i shenjtë - plot vërtetësi nga Zoti yt, për t'i përforcuar edhe më ata që besuan, dhe për të qenë udhërrëfyes e myzhdë për myslimanët." është e nënkuptuar që Shpirti i Shenjtë vjen nga qielli dhe është pastër një shpirt. Në S. 4:171 Jezusi quhet "Shpirt që rrjedh nga Perëndia" (Ruhun Minhu). Shprehja ekzakte e njëjtë është përdorur përsëri në s. 58:22 ku thuhet që Perëndia i përforcon besimtarët e vërtetë me "Shpirtin e tij" (Ruhun Minhu).

"Shpirti nga Perëndia" është i përjetshëm:

Abdullah Yusuf Ali e definon termin "Shpirti nga Perëndia" në përkthimin dhe komentimin ndërkombëtar të shpallur, *Kuptimi i Kuranit të Shenjtë*. Ai komenton rreth s. 58:22: "Fraza e përdorur këtu është e fuqishme, "Shpirt nga vetvetja". Me fjalë tjera, "Shpirti nga Perëndia" është më i madh se "Shpirti i Shenjtë". Duke sqaruar se çka "Shpirti i Shenjtë" nënkupton, Ali tha: ...është Shpirt Hyjnor, që nuk mund ta definojmë në mënyrë më adekuate se sa që mund ta sqarojmë natyrën dhe atributet e Allahut në gjuhën njerëzore."² Ky është një koment mahnitës që qartë dhe në mënyrë të fuqishme indikon se "Shpirti nga vetja e tij" është vetë Shpirti i Perëndisë së Gjallë, i pakrijuar dhe i përjetshëm në esencë. Fjalët që Abdullah Yusuf Ali i përdori gjatë komenteve të tij nuk janë të turbullta. Ai e interpreton: "Shpirti nga Perëndia" duke u bazuar në sferën hyjnore dhe jo nga rregulla e krijuar. Gjithashtu "Shpirti nga Perëndia" është titull që Kurani i ofron Jezusit në S. 4: 171. Andaj, interpretimet e Abdullah Yusuf Ali lidhur me termin "Shpirti nga Perëndia" na bë të konkludojmë se Jezusi është Shpirti Hyjnor, të cilën nuk mund ta sqarojmë në gjuhën përkatëse njerëzore aq sa nuk mund ta sqarojmë natyrën dhe atributet e Perëndisë. Miku im i nderuar, në Kuran, janë përdorur fjalët ekzakte të njëjta për ta përshkruar Jezusin. Jezusi është "Ruhun Minhu, Shpirt nga Perëndia." Prandaj, në esencë dhe në natyrë, ai është Perëndi. Këtu përsëri e shohim se Jezusi është Perëndia që u shfaq në mishin njerëzor.

KAPITULLI 13

PERËNDIA SHPENGOI BIRIN E ABRAHAMIT

Ne mund të lexojmë në Kuran tregimin e Abrahamit. Perëndia e udhëzoi Abrahamin të sakrifikuar të birin e tij. Ashtu siç ishte duke e bërë këtë sakrificë, Perëndia intervenoi. Këto fjalë të rëndësishme mund të lexohen në Kuran, në s. 37:104-107: "Ne e thirrëm atë: "O Ibrahim!" Ti tashmë e zbatove ëndrrën!... Ne e shpaguam atë (birin e Abrahamit) me një të therrur të rëndësishëm."¹

Perëndia e siguroi zëvendësimin e sakrificës:

Në tregimin e Abrahamit të përshkruar në Kuran, në s. 37, Abrahami po shkonte ta sakrifikonte birin e tij por Perëndia e liroi birin e tij. Sidoqoftë, a e lejoi pastaj thjesht Perëndia Abrahamin ta merrte birin e tij dhe të shkonte? Jo, një ofertë sakrifikuese ishte e nevojshme. E vetmja mënyrë me të cilën biri i Abrahamit do të mund të lirohej ishte duke u zëvendësuar me një sakrificë tjetër. Perëndia e deshi birin e Abrahamit, andaj edhe e shpagoi atë. Perëndia e siguroi sakrificën, dashin, të ofrohej në vend të tij (Zanafilla 22:13). Vëreni që ishte Perëndia Ai, që e siguroi sakrificën zëvendësuese. Në s. 37:107, mund të lexohen këto fjalë të rëndësishme: "...Ne e shpaguam atë me një të therrur të rëndësishëm."

Të njëjtën gjë, mik i nderuar, e bëri Perëndia kur na shpengoi me sakrificën që vetë e siguroi. Dhe motivi i tij për këtë ishte dashuria!

Një sakrificë "përtej vlerësimit":

Në Ungjill, Jezusi (Al Masih Isa) është ai të cilin i dërguari Jahja (Gjon Pagëzuesi) e proklamoi në Gjonin 1:29, "Ja, qengji i Perëndisë, që heq mëkatin e botës!" Profeti Isaia, i frymëzuar nga Perëndia, profetizoi për ardhjen e Mesisë si një qengj sakrifikues: "keqtrajtuar dhe i përlur, nuk e hapi gojën. Si një qengj që e qojnë në therrtore, si një dele e heshtur përpara atyre që e qethin nuk e hapi gojën." (Isaia 53:7) Përsëri s. 37:104, thekson: "dhe ne e shpaguam atë me një sakrificë të rëndësishme." Ajo çfarë ishte përshkruar në këtë varg si "*sakrificë e rëndësishme*", në versionet tjera të përkthimeve të pranuar të Kuranit është përdorur si "sakrificë e fuqishme", "sakrificë e madhe", "sakrificë e jashtëzakonshme" dhe "e vlefshme përtej vlerësimit".

Dashi i sakrifikuar reprezentoi një të vërtetë më të madhe:

Një pyetje logjike mund të jetë: çfarë lloj sakrifice është kjo që e meriton të quhet "e rëndësishme", "e fuqishme", "e vlefshme përtej vlerësimit"? Qartazi dashi që Perëndia e siguroi nuk kishte për qëllim t'i përshtatej këtij përshkrimi. Përgjigjja është qartë e theksuar në Bibël, në 1 Pjetrin 1:18-19: "Duke e ditur se jo me anë gjërash që prishen, si argjendi ose ari, jeni shpënuar² nga mënyra e kotë e të jetuarit të trashëguar nga etërit, por nga gjaku i çmuar i Krishtit, si të Qengjit të patëmetë dhe të panjollë." Një dijetar i krishterë D.C Halverson parashtron një pyetje spekulative: "Në qoftë se shpëtimi është një çështje e shpërblimit të atyre që bëjnë mirë, dhe në qoftë se qëllimi i Perëndisë ishte për ta sprovuar bindjen e Abrahamit, pse pastaj ekzistonte nevoja për një "sakrificë të rëndësishme"? A nuk ishte e mjaftueshme që Abrahami shkoi aq larg sa mundte (duke i zbatuar urdhërimet e Perëndisë)?"³

Sakrifica përfundimtare në kryq:

Ungjilli na tregon që për shkak se Perëndia na deshi aq shumë, ai na shpëtoi përmes sakrificës përfundimtare ("e vlefshme përtej vlerësimit" dhe "e rëndësishme") të Mesisë. Kurani e përshkruan Al-Masih Isanë si "Shpirti që rrjedh nga Perëndia." Jezus Mesia e mori vendin tonë dhe u sakrifikua në vendin tonë. Ai vdiq në kryq për të na liruar neve nga pagesa e dënimit për mëkatin tonë. Sakrifica më e vlefshme që Perëndia do të mund të na jipte është nga Vetvetja. Për këtë arsye ai erdhi në botën tonë në personalitetin e Jezusit për të na shpëtuar. Sakrifica e Qengjit është "përtej vlerësimit" sepse e reprezenton sakrificën nga vetja e tij, e cila është e një vlere të pafundme dhe e mjaftueshme për shpengimin tonë!

KUSH MUND TA SIGUROJË FLIJIMIN TONË?

Në s. 10:54 lexojmë: "Secili njeri që ka dëmtuar veten (duke mosbesuar), po të ishte e tij çdo gjë që ekziston në tokë, ai do ta flijonte atë (për të shpëtuar)..." "Flijimi" është definuar si çmimi i kërkuar për të paguar lirin e të robëruarit. Perëndia ishte i vetmi që kishte mundësi për ta siguruar flijimin për lirin tonë nga vdekja shpirtërore dhe dënimi. Në Torë, Perëndia i urdhëroi njerëzit të sakrifikojnë një kafshë, si qengjin, delen, apo cjamin me kusht që të jetë e pa të metë, për shlyerjen e mëkateve të tyre. Kafsha do të sillej tek prifti, i cili do të vendoste duart e tij mbi kokën e saj dhe do të rrëfente mëkatet e personit që e ka sjellë kafshën. Mëkatet do barteshin pastaj tek kafsha, të cilën prifti do ta therrte në fyt. Pastaj prifti do ta shpërndante gjakun e saj mbi altar për shlyerjen e mëkateve. Andaj dënimi për mëkat ishte paguar nga vdekja e kafshës si zëvendësim për personin. Në lexojmë në Bibël, "Cjapi do të mbartë mbi vete të gjitha padrejtësitë e tyre" (Levitiku 16:22).

"Jeta është në gjak":

Shkrimet e shenjta të judenjve e prezentuan bazën për mësimet e Ungjillit. Levitiku 17:11 na njofton, "Sepse jeta e mishit është në gjak, prandaj ju kam urdhëruar ta vini mbi altar për të bërë shlyerjen për jetën tuaj, sepse është gjaku që bën shlyerjen e fajit për jetën." Kjo është rëndësia e kryqit, miku im i nderuar mysliman. Jetë për jetë (shlyerja). Krishti e flijoi jetën e tij me qëllim të na dhurojë të drejtën për të jetuar përherë, duke na liruar nga të paguarit e dënimit për mëkatet tona.

Rëndësia e shlyerjes me gjak:

Sipas Muhamedit (regjistruar nga Al-Buhariu), flijimi i kafshës ishte një mjet i njohur, i caktuar në mënyrë hyjnore për të fituar faljen e Perëndisë.⁴ Myslimanët e festojnë një festë vjetore të ashtuquajtur "Kurban Bajrami" (Id-Adha). Në këtë ditë, kafshët sakrifikohen. Bota muslimane beson që kjo festë e përkujton gatishmërinë e Abrahamit për të ofruar birin e tij si flijim Perëndisë.

Derdhja e gjakut sjell tek falja:

Në Ungjill, Hebrenjve 9:22 thotë: "Sipas ligjit, gati të gjitha gjërat pastrohen me anë të gjakut, dhe pa derdhur gjak nuk ka falje." Një jetë për jetë. Krishti e dorëzoi jetën e tij për të na dhuruar të drejtën për të jetuar. Dhe vëreni që Efesianëve 1:7-9 thotë, "Në të e kemi shpengimin përmes gjakut të tij, faljen e mëkateve sipas pasurisë së hirit të tij, të cilën e bëri të teprojnë ndaj nesh me gjithë urtësinë dhe mençurinë. Dhe Ai e bëri të njohur tek ne misterin e vullnetit të tij sipas pëlqimit të tij, që ai e kish përcaktuar me veten e tij..."

Një ilustrim i shpengimit të Perëndisë për ne:

Është vështirë për ta kuptuar pse Perëndia zgjodhi të na shpengoi kur kjo kërkoi një sakrificë aq të madhe! Për ta ilustruar pse Perëndia flijoi birin e tij për të na shpëtuar (përmes kryqëzimit), mu kujtua një tregim i vërtetë i një princi kaukazian, që quhej Samuel. Ai jetoi rreth dyqind vjet më herët, dhe njerëzit e tij ishin vazhdimisht në luftë me turqit. Një natë ai planifikoi një sulm të befasishëm por armiku i tij po e priste. Planet e tij sekrete i ishin zbuluar armikut. Shumë prej ushtarëve të tij humbën jetën, dhe ultimativisht ai e humbi betejën. Samueli shpalli që tradhëtari do të dënohej me njëqind goditje kamxhikësh. Në fshehtësinë më të madhe, armata e Samuelit ndërromori një sulm tjetër por e njëjta gjë ndodhi. Përsëri armiku po e priste për ta

sulmuar. Ashtu që princi e humbi edhe një betejë tjetër, por kësaj radhe tradhëtari u zbulua. Ishte vetë nëna e Samuelit!

Dashuria e princit Samuel për fajtorin:

Çfarë duhej Samueli të bënte? Çfarë dileme e vështirë. Po ta lironte nënën e tij nga dënimi, ndjekësit e tij do të thonin se ai është i padrejtë. Ata do të kishin të drejtë. Alternativa do të ishte edhe më e vështirë. Si do ta merrte një vendim të drejtë, që sigurisht do të rezultonte me vdekjen e nënës së tij të dashur? Samueli iu drejtua popullit të tij: "Ne i humbëm dy beteja për shkak të tradhëtisë. Shumë prej njerëzve tanë vdiqën, dhe nuk ka arsyetim. Ligji është thyer dhe dënimi do të ekzekutohet sipas gjykimit tim - NJËQIND KAMXHIK! Drejtësia duhet të mirëmbahet." Nëna e princit u mbush me frikë të madhe ndërsa ajo po dërgohej në rrethin ku dënimi do të administrohej. Ekzekutuesi e ngriti kamxhikun e tij. Por para se goditja e parë të ekzekutohej, Samueli bërtiti: "Ndal! Ajo është nëna ime, dhe unë do ta marrë dënimin për të." Ai e mënjanoi veshjen e tij mbretërore dhe urdhëroi, "Ekzekutor, nuk guxon të më godasësh me forcë më të vogël sesa që do ta bëje për tradhtarin. Unë jam personi që do e marrë dënimin e saj. Zbatoje detyrën tënde - godit!"

Samueli e pagoi shpengimin në tërësi:

Kamxhik pas kamxhiku iu dha shpinës së Samuelit, përderisa nuk kaloi në tokë i pavetëdijshëm. Sidoqoftë, ai i mbijetoi këtij fshikullimi, përkundër të gjitha supozimeve. Princi Samuel e pagoi në tërësi dënimin për mbrojtjen e nënës së tij të dashur me qëllim që ta lironte atë! Në të njëjtën mënyrë, "Jezusi erdhi për ta paguar borxhin të cilën nuk e kishte sepse ne kishim borxh që nuk mund ta paguanim."

Jezus do të thotë "Shpëtimtar":

Perëndia ishte i vetmi me mundësi për ta siguruar shpengimin e mjaftueshëm për lirinë tonë nga vdekja shpirtërore. Ne lexojmë në Bibël që Jezusi erdhi për ta dhënë jetën e tij si shpengim (Mateu 20:28). Një dijetar i mirënjohur, Al-Kasemi, në komentimin e tij të famshëm, Mahasen at-Ta'aweel, komentoi në s. 3:45: "Emri Isa është një formë arabike nga fjala greke, që do të thotë Shpëtimtar dhe është ekuivalente me Joshua në hebraishte."⁵ Dhe vëreni që Ungjilli, tek Mateu kap. 1:21 thekson: "Dhe ajo do të lindë një djalë dhe ti do t'i vësh emrin Jezus, sepse ai do të shpëtojë popullin e tij nga mëkatet e tyre."

FLIJIMI I TIJ DHE SHFAJËSIMI YNË

Normalisht, kafshët që sakrifkoheshin në kohërat e Dhiatës së Vjetër, nuk ishin të barabarta në vlerë me shpirtërat njerëzor për të cilët ata flijoheshin. Në fakt çdonjëri person ishte më i vlefshëm dhe më i çmueshëm sesa të gjitha kafshët e flijuara. Këto sakrifica ishin një simbolikë (paralajmërim) e sakrificës së gjakut të çmuar të Krishtit. Sakrificat e kafshëve vetëm përkohësisht "mbulonin" mëkatet, ndërsa sakrifica e Jezusit "mënjanoi" të gjitha mëkatet tona, njëherë e përgjithmonë! Jezusi ishte e vetmja sakrificë të cilën Perëndia mund ta pranonte si të barabartë në vlerë me të gjitha shpirtërat njerëzor, i mjaftueshëm për shpengimin tonë. Perëndia premtonte të justifikojë dhe ta shpallë të drejtë çdo besimtarë që beson se Jezusi vdiq për mëkatet e tij në kryq. Në momentin kur besimtari beson në Jezusin si Shpëtimtar të tij, të gjitha mëkatet e tij janë të falura dhe të mënjanuara, dhe ai tashmë është i pajtuar me Perëndinë (Romakëve 5:1). Mëkatari nuk qëndron më fajtor para Perëndisë.

Shpëtimi është nga hiri i Perëndisë, jo me anë të veprave tona të mira:

Është një dhuratë falas nga hiri i Perëndisë që e "shfajëson" mëkatarin që beson. "Shfajësimi me anë të besimit" nënkupton që Perëndia e shpall besimtarin të jetë i drejtë jo në bazë të veprave të tyre për të arritur në qiell por në bazë të besimit dhe atë besimit në flijimin e Krishtit. Perëndia shpall që e ka pranuar flijimin e Krishtit si pagesë për fajet tona sipas drejtësisë hyjnore. Bazuar në veprat tona për të arritur në qiell mund vetëm të na denojë. Lexues i nderuar, më lejo të të pyes, çfarë shikon Perëndia kur shikon në ty? A i shikon ai veprat religjioze të përziera me mëkate? Apo e shikon drejtësinë e tij të atribuuar ty përmes besimit tënd në Krishtin? Ky është i vetmi standard i drejtësisë që Perëndia e pranon! Dhe dhurata e hirtë e Perëndisë është falas për çdonjërin!

Një ilustrim nga fëmijëria:

Mbaj mend kur si fëmijë vija në vështirësi në raste të ndryshme. Babai im posedonte një ndërtesë në të cilën jetonim ne në Egjipt dhe praktika e tij legale ishte në katin përdhësë. Ne jetonim lartë. Shumë herë unë i ftoja shokët për të lozur futboll, dhe ne luanim brenda korridorit të ndërtesës. Një herë topi ynë theu poçin elektrik dhe një herë tjetër e goditi njërin prej klientëve të babait tim. Ndonjëherë topi godiste xhamin e zyrës së babait tim. Ky shqetësim i madh i pengonte bisedimet e tij për biznes, duke mos i përmendur bërthimat tona të gëzuara kur ne shënonim gol. Kur babai im mbaronte punën dhe vinte në shtëpi, ai më shfaqte një shikim të caktuar që më tregonte se unë isha në gjendje të vështirë. Unë do vrapoja tek nëna ime duke qarë. Unë do fshihesha prapa saj, duke besuar që nëpërmjet saj do isha i sigurtë dhe i falur. Edhe pse ai ishte i zemëruar, shumë herë do të shikonte fytyrën e nënës sime të bukur dhe zemrën time të penduar dhe më lejonte të shkoj i padënuar. Herave tjera, nëna ime do më mbante në krahët e saj dhe do të më mbronte me trupin e saj ashtu që kur babai do afrohej të më qëllonte dora e tij të biente në të në vend se të biente në mua. Kjo kujtesë çdoherë më përkujton momentin kur vrapova tek Perëndia nëpërmjet besimit në Jezusin në shkurt të vitit 1976. Unë përjetova brenda zemrës dhe shpirtit tim faljen e Perëndisë. Jezusi më mbuloi me drejtësinë e tij. Miku im, që në atë moment madhështor kur ju e pranoni Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar, Perëndia do t'i shpallë mëkatet tuaja të pastruara nëpërmjet gjakut të Qengjit në kryq. Ai e llogarit drejtësinë e Krishtit në llogarinë tuaj. Lavdi Perëndisë! Ju do të jeni të shpenguar!

Shpëtimi është i menjëhershëm!

Lexues i nderuar, edhe në qoftë se je ti njëri prej mëkatarëve më të këqij, ju mund të jeni të falur dhe të "shpëtuar" që sot! Ju mund të gëzoheni duke ditur që e keni jetën e përjetshme me Perëndinë sot. Perëndia i Ungjillit u jep shpresë të mrekullueshme edhe mëkatarëve që e kalojnë tërë jetën e tyre në mosbesim ndaj tij dhe të cilët kurrë nuk akumuluan vepra të mira. Edhe kur Jezusi ishte i varur në kryq, ai i tha vjedhësit që gjendej afër tij: "Që sot do të jesh me mua në parajsë" (Luka 23:43). Perëndia e dinte që ky mëkatar (që e shfaqti besimin e tij në Jezusin) do të vdiste pa pasur mundësi të bëjë vepra të mjaftueshme të mira. Perëndia e dinte zemrën e tij besuese (penduese). Perëndia e pranoi vjedhësin në kryq edhe pse mëkatet e tij i tejkaluan veprat e tij të mira.

Krishteri i vërtetë nuk do të dëshirojë të vazhdojë në mëkat:

Sidoqoftë, falja e mëkatit, falas, që i krishteri e përjeton nuk i jep të krishterit të drejtë për të vazhduar të mëkatojë lirisht. Asnjë ndjekës i vërtetë i Krishtit nuk do të vazhdojë qëllimisht në mëkatin e tij. Apostulli Pal, i frymëzuar nga Shpirti i Shenjtë, sqaron:

"Atëherë, çfarë? Të mëkatojmë sepse nuk jemi nën ligj, por nën hir? Kështu mos qoftë! A nuk e dini ju se nëse e tregoni veten shërbëtor të atij që i bindeni, jeni shërbëtor të atij që i bindeni, qoftë mëkatit për vdekje, qoftë dëgjësës për drejtësi? Por qoftë falënderuar Perëndia, sepse ishit shërbëtorë të mëkatit, por iu bindët me zemër atij mësimi që iu është transmetuar. Dhe, mbasi u liruat nga mëkati, u bëtë shërbëtorë të drejtësisë." (Roamkëve 6:15-18).

Dhe tani, Krishti iu jep ndjekësve të tij të vërtetë dëshirë dhe fuqi për të bërë mirë. Në letrën e Titit 2:14 sqarohet që Jezusi "e dha veten për ne, për të na shpënguar nga çdo paudhësi dhe për të pastruar për vete një popull të veçantë, të zellshëm në vepra të mira."

Rritja shpirtërore për të krishterin është një proces:

Sikurse foshnja që rritet në një person të pjekur, ashtu edhe personi që bëhet i "rilindur" përmes besimit në Jezusin rritet në pjekuri. Të krishterët vazhdojnë të biejnë dhe të rrëzohen nga standardet perfekte të Perëndisë. Ata luftojnë kundër mëkatit, mishit, dhe Satanit, duke u rritur shpirtërisht në mënyrë graduale. Kur të krishterët pikëllohen për shkak të mëkateve, ata mund të gjejnë ngushëllim në premtimin e Perëndisë për t'i falur çdoherë kur ata i rrëfejnë dhe pendohen. Ky premtim madhështor gjendet tek 1Gjoni kap. 1:9: "Po t'i rrëfejmë mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi." Si të krishterë ne gëzohemi që Perëndia nuk na lë vetëm për të rënë. Shpirti i Shenjtë na fuqizon për t'i mbizotëruar tundimet, dhe ai na ndryshon për të qenë më tepër si Jezusi. Prandaj ne bëhemi më të dashur, më falës, më të gatshëm për t'u bindur, dhe për t'i shërbyer me gëzim. "Sepse Perëndia është ai që vepron në ju vullnetin dhe veprimtarinë, sipas pëlqimit të tij." (Filipianëve 2:13). Perëndia, i cili fillon vepra të mira në çdo besimtarë, është besnik për t'i përfunduar. Shpirti i Shenjtë duke punuar brenda tij prodhon vepra të mira dhe veti të mrekullueshme. Ne lexojmë në Bibël: "Por fryti i Frymës është: dashuria, gëzimi, paqja, durimi, mirëdashja, mirësia, besimi, zemërbutësia, vetëkontrolli." (Galatasve 5:22)

PJESA E PESTË

PËRSE ISHTE E DOMOSDOSHME QË JEZUSI TË VIJË?

KAPITULLI 14 **PROBLEMI I MËKATIT**

Në këtë kapitull, miku im, do të merremi me problemin e gjendjes sonë mëkatore dhe zgjidhjen e këtij problemi prej Perëndisë. Sepse mëkati është gjetur në zemrën e çdo personi, dhe nuk ka kurrfarë dyshimi që çdonjëri ka nevojë për shpëtim.

Gjendja mëkatore e njeriut:

Së pari le të shikojmë në disa vargje të Kuranit që e konfirmojnë mëkatshmërinë e çdo njeriu. Kurani në s. 12:53 thotë: "Epshi është shumë nxitës për të keqen..." Në s. 14:34: "Vërtet, njeriu është shumë i padrejtë dhe përbuzës." S. 100:6 flet: "Vërtet, njeriu është përbuzës ndaj Zotit të vet." Shikoi edhe vargjet tjera që e konfirmojnë natyrën mëkatore të njeriut (S. 13:1, S. 15:10-11). Dhe është e rëndësishme të përmendet se Bibla me siguri e konfirmon faktin se të gjithë kemi mëkatuar. Te Romakëve kap. 3:23, "Sepse të gjithë mëkatuan ..." Hadithet gjithashtu e vërtetojnë këtë të vërtetë - mëkatshmërinë e gjithë qenies njerëzore. Muhamedi, profeti i islamit, tha: "Satani qarkullon në mendjen e njeriut sikurse gjaku që qarkullon në të."¹

Ilustrim i efektit të mëkatit:

Mbi ekzaminimin e mbyllur, ne shohim që Kurani i atribuon mëkatet gjithë profetëve përveç Jezusit! Mik i nderuar mysliman, mëkati brenda natyrës sonë e manifeston veten në mendimet, veprat dhe fjalët tona. Kjo na bën të njollosur para Perëndisë.

Për shembull: në treg të është dhënë zgjedhja e tre mishërave të përzier. I pari përmban 50% mish lope dhe 50% mish derri. Tjetri ka 90% mish lope dhe 10% mish derri. I treti përmban 99% mish lope dhe 1% mish derri. Cilën nga këto do ta bleje? Si mysliman i devotshëm, ju do t'i refuzoni të gjitha. Çfarëdo sasi e derri, pa marrë parasysht sa e parëndësishme është e bën mishin "Haram" (të palejuar për ta ngrënë). Kjo është ngjashëm edhe me mëkatin. Pa marrë parasysht sa të vogla janë mëkatet tona, ato na vëjnë në një gjendje mospërfillëse ndaj Perëndisë dhe vullnetit të tij. Prandaj edhe bëhemi të papranuar në sytë e Perëndisë! Mëkati na bën të paaftë që ta pranojmë miratimin e shenjtë të Perëndisë dhe të padenjë për të hyrë në parajsë.

Ilustrime plotësuese të efektit të mëkatit:

Sipas besimeve dhe mësimave islamike, nëse ndonjëri do të pastronte trupin e tij si parapërgatitje për lutje, dhe ndodhë që para se të fillojë lutjen të ketë rënë në ndonjë ndyrësi, ritualisht ai do të konsiderohej i papastër. Dhe Perëndia nuk do t'i pranonte lutjet e tij. Tani nëse besoni që ndonjë ndyrësi e rënë në trupin tuaj fizik do t'iu diskualifikojë nga lutja, atëherë nuk do të ishte shumë e vështirë për ta kuptuar të vërtetën biblike që papastërtia e mëkatit brenda nesh na bën të papastër dhe na diskualifikon nga të afruarit me Perëndinë e shenjtë. Në qoftë se burri flet me një grua tjetër veç gruas qoftë edhe njëherë, ai do të konsiderohej jobesnik. Asnjë grua nuk do të toleronte besnikërinë parciale nga burri i saj. Në të njëjtën mënyrë, Perëndia i shenjtë e konsideron bindjen tonë të pjesëshme si mosbindje. Ai nuk mund ta tolerojë atë. Mik i nderuar mysliman, do ta pranoje një gotë me ujë nëse do t'i shtoja vetëm një pikë ngjyre në të? Me siguri do ta refuzonit. Në të njëjtën mënyrë Perëndia i pastër, i drejtë, i shenjtë nuk mund të na pranojë në qiell në baza të veprave tona të mira. Jetët tona përmbajnë akte të ndryshme egoiste dhe mëkatore të cilët veprat e mira nuk mund t'i fshijnë. Perëndia nuk do të lejojë asnjë person të ndryshuar apo të papastër të hyjë në parajsë.

Referencat e Kuranit lidhur me "Zjarrin e Ferrit":

Mbani mend se çfarë Kurani flet lidhur me zjarrin e ferrit në s. 19:71, "Nuk ka asnjë prej jush që nuk do t'i afrohet atij. Ky është vendim i kryer i Zotit tënd." Në përkthime të tjera të të njëjtit varg të Kuranit (në gjuhën angleze - shënim i përkthyesit), e lexojmë shprehjen "do të kaloni nëpër të" në vend të "t'i afroheni atij." Njerëzit pyesin nëse ky varg ka të bëjë vetëm me njerëzit e këqij apo për të gjithë? Çfarë nënkuptohet nga fraza "do të kalojmë nëpër të"? Suyuti na tregon që Muhamedi vetvetiu iu përgjigj kësaj pyetje duke thënë: "nuk ka të drejtë apo të çoroditur që nuk do të hyjnë në ferr."²

Kurani nuk ofron siguri të përrjetshme:

Tragjikisht, sipas Kuranit dhe Hadithit, asnjë mysliman nuk mund të jetë i sigurtë çfarë e pret pas vdekjes. Bazuar në Al Buhariun, profeti islam Muhamedi tha: "Përbetohem në Allahun, edhe pse jam i dërguar i Allahut, nuk e di çfarë do të bëjë Allahu me mua."³ Perëndia i Kuranit nuk i garanton besimtarit mysliman faljen e mëkateve, pranimin, apo premtimin e jetës së përrjetshme. Për shembull, Abu-Bakr Al-Sadik, kalifi i parë, konsiderohet nga të gjithë myslimanët si një prej myslimanëve më të mirë. Edhe Muhamedi e pranoi që Abu-Bakr Al-Sadik ishte më i afërmi i tij (duke qenë mysliman besnik), dhe iu tha besimtarëve që ta marrin Abu Bakrin si model. Për këtë arsye, myslimanët e zgjodhën atë si kalif pas vdekjes së Muhamedit ("Kalif" është titull për udhëheqësin primar të myslimanëve).

Lideri i ardhshëm i myslimanëve pas Muhamedit:

Sidoqoftë, merrni parasysh pasigurinë e Abu Bakrit lidhur me fatin e tij të përrjetshëm. Në mënyrë tragjike, ai ishte cituar duke thënë: "Betohem në Perëndinë që nuk ndihem i sigurtë nga dinakëria e Perëndisë edhe nëse njëra nga këmbët e mia është brenda në parajsë."⁴ Çfarë mirënjohje e thënë nga Abu Bakri! Ai dukej të ishte i frikësuar që Perëndia i tij mund ta ndryshonte mendjen. Abu Bakr Al Sadik gjithashtu tha, kur ringjallja, parajsa, apo ferri përmendeshin para prezencës së tij: "Do të doja të ishja një lis i ngrënë nga kafshët, do të doja që kurrë të mos isha lindur."⁵ Dukshëm, ai ishte i frikësuar nga Perëndia. Frika nuk është habitëse sepse Perëndia në islam sipas fjalëve të Kuranit dhe Muhamedit, nuk e vendos në besimtarin sigurinë lidhur me jetën e përrjetshme.

Çfarë duhet të bëjë një gjykatës i drejtë?

Mëkatet tona, që nuk e përfillin vullnetin dhe ligjin e Perëndisë, medoemos duhen të jenë ofendim për Perëndinë dhe të dëmshme për njeriun, të cilin Perëndia e krijoi dhe e deshi. Pasi që Perëndia është i shenjtë dhe i drejtë, mëkatari e meriton gjykimin e Perëndisë. Perëndia nuk do të ishte i ndershëm dhe i drejtë përderisa nuk do ta dënonte mëkatarin. Vetëm pendimi, që është një kthim në vendin e bindjes, nuk mund t'i largojë mëkatet e kaluara. As që mund ta kënaqë shenjtërinë dhe drejtësinë e Perëndisë, edhe në qoftë se duhet t'i shtojmë veprat tona të mira në të. Mik mysliman, të lutem më lejo të të jap një ilustrim që sqaron se një pikëllim i thjeshtë dhe veprat e mira nuk mund ta fitojnë faljen e Perëndisë. "Imagjinoni një të ri i cili është sjell para gjyqit dhe është dënuar për dhunim. Ai i drejtohet gjyqit: Pendohem dhe më vjen shumë keq për atë çfarë kam bërë dhe më kurrë nuk do ta përsëris. Hirësia juaj, ju premtoj që do sillem mirë dhe do të kem respekt për të gjitha femrat që do t'i takoj gjatë gjithë jetës sime. Do t'i ndihmoj fqinjës sime, një gruaje të vjetër, për ta pastruar shtëpinë. Do të shpenzoj mjaft kohë dhe para për t'i ndihmuar viktimat e dhunimit. Gjithashtu hirësia juaj, mund të dëshmoj që kam bërë shumë, shumë vepra të mira para dha pas këtij krimi. Hirësia juaj, më të vërtetë më vjen keq për të keqën që ia bëra kësaj gruaje dhe më vjen shumë keq që e theva ligjin. Pasi që kam bërë shumë vepra të

mira dhe planifikoj të bëj edhe më, kërkoj nga ju të më jepni falje. Më falni për dhunimin e kësaj gruaje dhe më leni të lirë." Si mendoni që gjykatësi do të reagojë? Me siguri do të pajtoheni që gjykatësi do të përgjigjet: " Edhe pse i çmoj veprat tuaja të mira dhe pendimin, më duhet të mirrem me krimin tuaj duke e lëshuar dënimin."

Perëndia do të gjykojë mëkatet e çdo personi:

Lexues i dashur mysliman, do të jetë në të njëjtën mënyrë kur qëndrojmë para Perëndisë në ditën e gjykimit. Për shkak të shenjtërisë dhe drejtësisë së tij, ai duhet të mirret me mëkatet tona. Dënimi i përjetshëm është i sigurtë për ata mëkatet e të cilëve nuk janë të falura. Përsëri, pendimi dhe veprat e mira nuk e çrrenjosin efektin e mëkatit apo fajësinë. Në të vërtetë bindja kërkon vepra të mira, por, nuk mund t'i përdorim ato për t'i kompenzuar veprat tona të këqija. Me fjalë të tjera, veprat e mira janë kërkesë e bindjes, jo zgjidhje e mëkatit! Është përshkruar nga Al Buhariu që Muhamedi iu tha një grupi të njerëzve: "Veprat e asnjërit prej jush nuk do t'iu shpëtojnë (nga zjarri i ferrit)." Pastaj ata e pyetën: "Edhe ju nuk do të shpëtoheni nga veprat e juaja, o i dërguar i Allahut?" Ai u përgjigj, "Jo, as unë nuk do të shpëtohem) derisa dhe deri kur Allahu e vë mëshirën e tij mbi mua."⁶ Muhamedi gjithashtu tha: "Veprat e mira të çdo personi nuk do ta bëjnë atë të hyjë në Parajsë."⁷ Nuk ekziston asgjë çfarë njeriu mund të bëjë nga vetja e tij për të parandaluar gjykimin e Perëndisë. Drejtësia e Perëndisë kërkon që dënimi për mëkat të paguhet, dhe personi mëkatues e meriton të paguajë dënimin.

Jezusi na shpëtoi nga dënimi i ligjit:

Lajmi madhështor e i mirë i Ungjillit është se Mesia, Jezusi, e pagoi çmimin për mëkatet tona me derdhjen e gjakut të tij. Vdekja flijuese e tij në kryq e plotësoi gjykimin e Perëndisë ndaj mëkatit dhe e përmbushi kërkesën e ligjit të Perëndisë. Tek Kolosianëve 2:14, lexojmë: "Ai e zhvlerësoi dokumentin e urdhërimeve, që ishte kundër nesh dhe ishte kundërshtar, dhe e hoqi nga mesi duke e mbërthyer në kryq." Bindja ndaj Ligjit kurrë nuk do ta sillte shpëtimin. Ligji thjesht i tregoi mëkatari që ishte fajtor para Perëndisë. Ligji kërkonte bindje të përsosur. Njeriu nuk ishte i aftë të përsosej sepse mëkati na bëri të gabueshëm. Nën ligj ne ishim të dënuar. Sidoqoftë, Lajmi i Mirë është: "Por, kur u mbush koha, Perëndia dërgoi Birin e tij, të lindur prej gruaje, të nënshtruar ligjit, që të shpengonte ata që ishin nën ligj, që ne të fitojmë birërinë." (Galatasve 4:4-5)

Jezusi e pagoi dënimin për mëkatet tona:

Jezus Krishti e theu barrierën ndërmjet njeriut dhe Perëndisë. "Në këtë është dashuria: jo se ne e kemi dashur Perëndinë, por që ai na ka dashur ne dhe dërgoi Birin e tij për shlyerjen e mëkateve tona." (1Gjonit 4:10). Nga dashuria e pakrahueshme për ne, Perëndia e vendosi borxhin e mëkatit tonë mbi Jezusin. Dhe Jezusi me dëshirë e mori vendin tonë, duke u bërë flijim për ne. Prandaj, mëkatari do të shpëtohet menjëherë nëse e pranon me besim këtë dhuratë të mëshirës dhe hirit nga Perëndia. Në Bibël, tek Veprat e Apostujve 10:43, thuhet: "Për të bëjnë dëshmi të gjithë profetët, që kushdo që beson në të merr faljen e mëkateve me anë të emrit të tij".

Hiri i Perëndisë është një dhuratë falas:

Mbaj mend, miku i im, që asnjë prej nesh nuk mund të thotë me vetëdije të plotë: "Unë nuk jam mëkatari." Për shembull, në qoftë se thuani, "por unë mëkatoj vetëm një herë në javë," kjo do të shtonte mjaft mëkate deri në fund të jetës. Dhe kërkon vetëm një mëkat për t'u bërë mëkatari. (Në shtesë, siç u përmend më lart, natyra jonë mëkatore e rënë na garanton që çdonjëri do të mëkatojë në një kohë përsëri). Edhe në këtë gjendje lajmi i mrekullueshëm është se Jezusi u muar me problemin tonë të mëkatit dhe e siguroi zgjidhjen e saj njëherë e përgjithmonë. "Sepse të

gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë, por janë shfajësuar falas me anë të hirit të tij, nëpërmjet shpengimit që është në Krishtin Jezus." (Romakëve 3:23-24). Ne mund të konsiderohemi të pastër vetëm nga hiri dhe mëshira e Perëndisë. Perëndia e di që ne nuk jemi në gjendje për ta shpëtuar vetveten, andaj për shkak të dashurisë së thellë dhe mahnitëse të tij drejt nesh, ai na ofron shpëtimin si një dhuratë falas. "Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë, jo nga vepra, që të mos mburret askush." (Efesianëve 2:8-9)

Një ilustrim i dhuratës së hirshme të Perëndisë:

Perëndia dëshiron që ju të merrni dhe të përjetoni shpëtimin e tij. Ai dëshiron t'iu japë shpëtimin si dhuratë. Po provove ta fitosh me përpjekjet tua, nuk mundesh sepse nuk e meriton. Por nëse do të kërkonit nga Perëndia të t'iu shpëtojë nëpërmjet besimit tuaj në atë kush Jezusi është dhe në punën e kryer të tij në kryq, ai do të veprojë kështu me gëzim sepse ju do. Ky tregim do të na ndihmojë për të demonstruar dhuratën e hirtë falas të Perëndisë:

Njëherë ishte një grua e varfër dhe e uritur, e cila me të vërtetë kishte nevojë për ca fruta nga kopshti i mbretit. Ajo tentoi të paguajë kopshtarit e mbretit, por ai i refuzoi paratë. Çdo herë që provonte të blejë fruta, oferta e saj refuzohej. Por gruaja vazhdoi t'i kërkonte kopshtarit që t'i merrte paratë e saja. Pastaj një ditë princi, biri i mbretit, e ndëgjoi kërkesën e gruas. Pasi mësoi për rastin, princi i mirë i tha gruas: "Babai im nuk është tregtar por është mbret. Ai posedon çdo gjë që sheh. Ai nuk ka nevojë për paratë e juaja. Ju nuk mund t'i bleni frutat e tij, por ai do t'iu jep falas nëse me të vërtetë i kërkonti me sinqeritet." Sigurisht, gruaja me gëzim e pranoi ofertën e hirtë të mbretit. Pastaj princi zgjodhi një sasi të frutave më të mira dhe i ofroi gruas gjithëçka që kishte nevojë!

KAPITULLI 15 **PERËNDIA VETË ERDHI TEK NE NË PERSONIN E MESISË**

Sipas Biblës, Perëndia vetë erdhi tek ne në personin e Mesisë (Krishti apo "I Vajosuri). Ungjilli na mëson që Perëndia zgjodhi të hyjë në botën tonë nëpërmjet Jezusit duke u ngjizur në trupin e një virgjëreshe. Perëndia zgjodhi të jetojë në personin e Jezus Krishtit në trupin njerëzor. Por edhe në këtë formë tokësore, Jezusi qëndroi i pastër dhe i pamëkat derisa e manifestoi dashurinë e mrekullueshme të tij për racën njerëzore.

Perëndia është Perëndi i fuqishëm dhe Perëndi i përlulur:

Shumë myslimanë thonë që Jezusi hëngri, piu dhe fjeti derisa jetoj në tokë. Ata habiten, "Si mund Jezusi të jetë Zot, kur Zoti nuk ka nevojë të bëjë asnjë prej aktiviteteve njerëzore?" Është e vërtetë se Perëndia nuk ka nevojë të bëjë asnjë prej këtyre aktiviteteve njerëzore. Ju lutem merrni parasysh një analogji ndihmëse: mbreti nuk ka nevojë për të fjetur në vendin ku shërbëtori fle. Ai nuk ka nevojë të ha me ata apo të ndajë ushqimin e tyre. Ai me siguri nuk ka nevojë të kalojë nëpër përjetime aq përlulëse si këto. Por, ai mund të zgjedhë të bëjë këtë. Në qoftë se dëshiron të afrohet me shërbëtorët e tij dhe t'i përjetojë ndjenjat e tyre dhe përfundimisht t'i zgjedh problemet, ai mund të kalojë kohë nëpër ambientet e tyre. Mbreti gjithashtu mund t'i vesh veshjet e ushtarit dhe të qëndrojë më tutje mbret. Ngjashëm, Perëndia i Biblës është edhe shërbëtor - Mbret dhe ushtar - Mbret. Bibla na informon këtë, "Sepse ju e njihni hirin e Zotit tonë Jezus Krisht, i cili duke qenë i pasur, u bë i varfër për ju, që ju të bëheni të pasur me anë të varfërisë së tij." (2Korintasve 8:9) Mik i nderuar, kush prej nesh guxon t'i vë kufizime fuqisë dhe

vullnetit të Perëndisë. A nuk e kufizojmë ne Perëndinë kur themi se është e pamundur për Perëndinë ta manifestojë veten nëpërmjet formës njerëzore? Njeriu me siguri nuk mund të bëhet Perëndi i plotfuqishëm, por Perëndia me siguri mund të vijë në botën tonë në formën e njeriut dhe ta manifestojë veten përmes njeriut të përsosur, Jezus Krishtit.

Qeniet shpirtërore mund të marrin formë njerëzore:

Mbani mend që Kurani na tregon se Shpirti i Perëndisë mund të shfaqet në formën njerëzore. E kemi një shembull të këtij mesimi në s. 19:17: "Ne ia dërguam asaj Xhibrilin, e ai iu paraqit asaj njeri në tërësi." Fjala origjinale arabe "Ruhana" në këtë varg për fat të keq është keqpërkthyer në anglisht si "engjëlli ynë." Bibla dhe Kurani të dy e pranojnë se Perëndia ndonjëherë i dërgon engjëjt e tij, që janë në formë shpirtërore (ruh), në ngjashmëri ekzakte të shfaqjes njerëzore. Ashtu që nuk ekziston një argument i arsyeshëm kundër mundësisë që Jezusi, i cili njëjtë është Shpirti në formë, mori formë njerëzore aktuale.

Perëndia dëshiron të shoqërohet afër me njerëzit:

Shumë dijetarë myslimanë, siç është Asfi, kanë shënuar: "Perëndia nuk ka nevojë të shoqërohet në asnjë mënyrë me njeriun."¹ Natyrisht që kjo deklaratë është e vërtetë. Por, në Ungjill Perëndia e zbulon veten të jetë Perëndi i dashurisë që dëshiron që të na takojë në nivelin tonë dhe të identifikohet hirshëm me ne për së afërmi. Ai është Perëndi që përmallohet që ne të vijmë tek ai të na përqafojë dhe të komunikojë me ne përmes Shpirtit të tij që banon në ne. Ai dëshiron të na adaptojë si fëmijë të tij dhe të bëhet Ati ynë i dashur qiellor.

Perëndia është i plotfuqishëm dhe sovran:

Kurani thekson në s. 55:14 "Ai e krijoi njeriun nga balta e terrur si (enë balte) e pjekur." Kjo tregon që Perëndia e bëri Adamin në një kohë specifike duke e mbajtur në duart e tij baltën nga një vend specifik në tokë. Gjithashtu në Bibël, në Zanafillë, ne mësuam që Perëndia ecte dhe komunikonte me Adamin në kopshtin e Edenit (Zanafilla 3:8). Këto ngjarje nuk e kufizojnë Perëndinë sepse Perëndia është i Gjithëfuqishëm dhe sovran. Në të njëjtën mënyrë, mik i nderuar, mishërimi i Perëndisë (ardhja në formë të njeriut) në një kohë dhe vend specifik nuk e kufizoi atë. Ai më tutje ngelet Perëndi i plotfuqishëm dhe sovran që e mbush tërë universin me prezencën e tij dhe edhe më tutje dëshiron të ketë marrëdhënie me ne.

Perëndia ynë i dashur dëshiron të lidhet me ne personalisht:

Më lejoni t'iu ilustroj pse Perëndia zgjodhi të merr formë njerëzore të komunikojë personalisht me ne. Ju lutem konsideroni këtë situatë hipotetike: "Në qoftë se dëshironi të komunikoni me një zog dhe keni mundësi të pakufizuara dhe autoritet, cila do të ishte mënyra më e mirë për ju ta bëni këtë?" Përgjigjja është se ju do të bëheshit zog! Pastaj do të mund të lidheshit personalisht dhe të komunikoni në të njëjtin nivel. Ju lutem merrni parasysh këtë tregim si ilustrim të mëtutjeshëm:

"Lufta e Vietnamit shkaktoi që një familje të ndahet. Babai ishte i detyruar të qëndrojë në Vietnam, derisa gruaja dhe dy djemtë mundën të shkonin në Shtetet e Bashkuara për të jetuar. Për shtatëmbëdhjetë vjet, ata komunikonin në mes veti vetëm nëpërmjet letrave dhe fotografive. Babai mund t'i shikonte fëmijët të rriteshin vetëm nga distanca. Pastaj më në fund qeveria e Vietnamit dhe e Shteteve të Bashkuara hynë në një marrëveshje që i mundësoi babait të vijë në SHBA për t'i shikuar fëmijët e tij".

Tani çka nëse babai do t'i thoshte familjes së tij: "Unë nuk shoh me të vërtetë ndonjë nevojë të vijë t'iu shikoj në person. Komunikimi nëpërmjet letrave dhe fotografive ka qenë i

mjaftueshëm për këto shtatëmbëdhjetë vjet, dhe do të vazhdojë të jetë i mjaftueshëm për mua." Çfarë do të mendonit për një baba të tillë? Çfarë do të mendonit për Perëndinë po të kishte mundësi të komunikonte me krijesën e tij, por refuzon ta bëjë këtë? A do të ishte Perëndi personal dhe i dashur? Ne duhet të jemi në gjendje për të kuptuar tani pse Perëndia ynë i dashur zgjodhi të ketë marrëdhënie të ngushtë me ne duke ardhur në formë njerëzore, në personin e Mesisë.

Jezusi asnjëherë nuk e humbi natyrën e tij hyjnore:

Po, lexues i nderuar mysliman, me siguri Perëndia i Gjithëfuqishëm ka mundësi të shfaqet në personin e Mesisë, dhe të lidhet personalisht me njerëzimin, pa e zvogluar esencën e tij apo njollosur karakterin e tij hyjnor. Bazuar në Ungjill, jeta e Jezusit në tokë ishte një demonstrim perfekt i dashurisë së Perëndisë, faljes, shenjtërisë, zemërbutësisë, përluljes, fuqisë shëruese, pastërtisë, dhe shpëtimit. Jezus Krishti, si Fjalë e Perëndisë, nuk e humbi natyrën e tij hyjnore kur iu bashkua natyrës njerëzore. Bazuar edhe në Ungjill edhe në Kuran, ai i ngriti të vdekurit, shëroi leprozët, dhe iu dha dritë të verbërve. Ai kishte edhe shumë karakteristika tjera unike, që ju do t'i zbuloni në kapitujt e ardhshëm, të cilët nuk mund t'i atribuohen thjesht një qenie njerëzore. A mundet Krijuesi i diellit, tokës, dhe i gjithë universit, dhe i trupit njerëzor, të depërtojë në botën tonë dhe të përfaqësojë veten për të na shpëtuar pa e dobësuar qenien e tij në asnjë mënyrë? Natyrisht se mundet! "Jezusi i tha dishepujve të tij: "Gjërat e pamundshme për njerëzit janë të mundshme për Perëndinë." (Luka 18:27).

"Mishërimi" i Jezusit:

Myslimanët tjerë pyesin: "Nëse Jezus Krishti ishte Zot, si ishte e mundur për të që të mbytej? A mund Zoti të vdesë" Përgjigjja është se Perëndia nuk mund të vdesë por njeriu mundet. Perëndia Atë nuk ka formë të dukshme, por Jezus Krishti mori një formë të prekshme dhe erdhi në tokë. Personi i dytë i Trinisë (shiko sqarimin në kapitullin e nëntë), mori një natyrë plotësuese, natyrën njerëzore, e cila u vë në vdekje në kryq. Sidoqoftë, vdekja nuk mundi ta mbajë në varr. Tre ditë pasi vdiq, u ngrit nga të vdekurit dhe u kthye në tokë për rreth katërdhjetë ditë. Pastaj ai u ngrit në qiell. Shkoi në qiell në një formë të re në trupin e tij të lavdishëm. Për këtë arsye, ai ngelet çdoherë Perëndia - njeri, duke i pasur dy natyra të ndryshme.

Natyra njerëzore e Jezusit:

Ungjilli përmban shumë deklarata që dëshmojnë se trupi i Jezusit në tokë ishte trup i vërtetë njerëzor. Disa shembuj që e indikojnë natyrën njerëzore të tij janë: Jezusi ishte i uritur, i tunduar, dhe i kryqëzuar; ai ecte dhe bisedonte me dishepujt e tij; dhe ai e vuajti ankthin mental dhe dhimbjen fizike për shkakun tonë.

Natyra hyjnore e Jezusit:

Ungjilli gjithashtu përmban shumë deklarata që e dëshmojnë hyjninë e Jezusit. Disa prej shembujve janë:

- I Përrjetshëm (i përhershëm): Ai ekzistoi para se bota të formohej (Gjoni 8:58 dhe 17:5)
- I Gjithëpranishëm (i kudo pranishëm): Ai është prezent kudo në të njëjtën kohë (Mateu 18:20).
- I Gjithëdijshëm: Ai e demonstroi njohurinë e gjërave që mund të dihet vetëm nëse ai ishte Perëndi (Mateu 9:4, Luka 6:8, Gjoni 4:29).
- I Gjithëfuqishëm: Ai e demonstroi fuqinë dhe autoritetin e pakufizuar (mbinatyror) (Mateu 8:23-27 dhe 28:18, Marku 5:11-15).

Në fakt Jezusi, kishte atributet e njeriut, por ai kishte gjithashtu edhe atributet e Perëndisë. Krishti ndonjëherë vepronte në lidhje me njerëzoren e tij dhe herave të tjera në lidhje me hyjninë e tij.

Jezusi është plotësisht njeri dhe plotësisht Perëndi:

Disa njerëz pyesin: "Si është e mundur që natyra hyjnore të bashkohet me natyrën njerëzore?" Përgjigjja është: "Çkado që Perëndia i plotfuqishëm vendos të bëjë sipas urtësisë së pakufishme të tij, ai mund ta përmbush." Ungjilli na informon se marrëdhënia në mes të natyrës njerëzore dhe hyjnore të Jezusit është e atillë që as njerëzorja e tij nuk ndryshohet në hyjnoren e tij, e as hyjnorja e tij nuk humbet në njerëzoren e tij. Jezusi është plotësisht njerëzor dhe plotësisht hyjnor. Është e vërtetë se kjo natyrë e dyfishtë e Jezusit është e pakapshme për intelektin tonë të kufizuar njerëzor. Edhe më tutje ka shumë gjëra të tjera që ne nuk i kuptojmë plotësisht: "Si është e mundur për shpirtin dhe mishin të bashkohen në ne?" Fjala e Zotit na mëson qartë që ky bashkim i hyjnorës me natyrën njerëzore ndodhi në Krishtin me qëllim që të arrihet drejtësia e Perëndisë, duke e manifestuar dashurinë e tij për ne, dhe duke e realizuar shpëtimin tonë.

Njeriu u krijua në shëmbëllimin e Perëndisë:

Mik i nderuar mysliman, Perëndia zgjodhi për të na shpëtuar. Ai e realizoi këtë duke e shfaqur veten e tij në formë të njeriut perfekt (të pamëkat) për të qenë Shpëtimtari ynë personal. Perëndia nuk u "inkarnua" në bimë, zogjë, apo kafshë sepse ata nuk e mbajnë imazhin e tij. Por ne e dimë nga Tora, se Perëndia na krijoi në imazhin e tij. Zanafilla 1:26 thekson: "Pastaj Perëndia tha: Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë..." Kurani në s. 15:29 flet: "E kur ta përsosë atë (në formën e njeriut) dhe t'ia japë atij shpirtin..."

Një dijetar i krishterë, Bedru Kateregga, sqaron: "Njeriu i krijuar sipas shëmbëllimit së Perëndisë nuk nënkupton që Perëndia duket sikurse njeri apo që njeriu duket si Perëndia. Por kjo do të thotë që njeriu ka kualitete të thella të ngjashme me ato të Perëndisë."³ Për shembull, Perëndia e krijoi njeriun me aftësinë të jetë i dashur, i drejtë dhe i dhembshur. Dhe është interesant se shumë prej nesh e dimë se si duhet të sillemi më mirë dhe se mund të bëhemi njerëz më të mirë. Kateregga vazhdon të thotë: "Kjo është dëshmi e ngjasimit tonë me Perëndinë brenda vetëdijës sonë. Është një zë ngulmues në vetëdije që ne të bëhemi njerëz më të mirë, që ne nuk e bëjmë çdoherë atë çfarë dimë ta bëjmë, që ne me të vërtetë duhet të jemi më të dashur, më besnik, më të besueshëm, më të pastër, më tepër në ngjasim me Perëndinë."⁴ Mbani mend që në ngjasim me Perëndinë gjithashtu ne duhet të jemi bujar.

John Gilchrist, një teolog i krishterë, i respektuar, shkruan lidhur me shfaqjen e Perëndisë në formën njerëzore:

"Njeriu u krijua në atë mënyrë që t'i posedojë dhe manifestojë të gjitha atributet karakteristike të Perëndisë: shenjtërinë, dashurinë, pastërtinë, etj...Pyetja nuk është nëse Perëndia mund të kufizohet në formë njerëzore, por thjesht është a mundet njerëzimi të mbajë imazhin hyjnor. Përgjigjja është një "po" e pakualifikuar. Jezus Krishti shfaqti në plotësi atributet e përsosura të Perëndisë kur jetoi në tokë si njeri. Nuk kishte asnjë arsye pse Biri i Perëndisë të mos bëhej Bir i Njeriut. Në asnjë mënyrë karakteri i tij hyjnor nuk u njetos derisa eci në mesin tonë. Në të kundërtën, dashuria, hiri, falja dhe dhembshuria e Perëndisë ishin të gjitha të zbuluara në plotësi kur e la jetën e tij për të na shpënguar nga paudhësitë dhe të na përgatis për banimin qiellor."⁵

Jezusi është Ndërmjetësues i përkryer:

Jezusi, Mesia, është Ndërmjetësues i përkryer ndërmjet Perëndisë dhe njeriut. Vetëm Krishti do të mund të quhej i përkryer dhe flijim i pranuar nga Perëndia. Në të i shohim të gjitha karakteristikat e nevojshme që duhet të gjenden tek Ndërmjetësuesi (Shpëtimtari). Këto karakteristika janë:

Jezusi ishte njeri:

Ishte e domosdoshme që Shpëtimtari të lindte si njeri brenda ligjit të njëjtë që u thye nga çdo qenie njerëzore. Pasi që njeriu ishte ai që mëkatoi, del që ai i cili duhet të paguajë dënimin duhet të jetë njeri. Ishte esenciale që një qenie njerëzore të marrë vendin tonë dhe të vdesë si sakrificë për të paguar dënimin për mëkatet tona. Si njeri, Krishti mund të përfaqësonte njerëzimin. Lexojmë në Bibël që Jezusi "...u bë pjesëtar në po ato gjëra" (Hebrenjve 2:14). Për këtë arsye, Jezusi i kupton problemet tona dhe ai i ballafaqoi ato si qenie njerëzore derisa ishte në tokë. Jezusi si Dashamiri i ynë i kupton nevojat tona. Në Bibël lexojmë: "Sepse, duke qenë se ai vetë hoqi kur u tundua, mund t'u vijë në ndihmë atyre që tundohen" (Hebrenjve 2:18). Jezusi ndërmjetëson ndërmjet Perëndisë dhe njerëzve. Si përfaqësues i njerëzimit, ai ndërmjetëson për ne para Perëndisë; si përfaqësues i Perëndisë, ai na sjell shpëtimin e Perëndisë dhe na siguron për dashurinë e Perëndisë dhe faljen.

Jezusi ishte i pamëkat:

Në Torë (tek Levitiku), shohim qartë se ligji i Perëndisë kërkonte që sakrifica e flijuar në altar të jetë e pa të metë. Vetëm ai që është i pamëkat mund të kualifikohet si zëvendësim për fajtorin. Ai që na shpëton nga mëkatet nuk mund vetë të jetë mëkatar. Po të ishte mëkatar:

- Ai do të vdiste si dënim për mëkatet e tij dhe sigurisht jo për mëkatet e të tjerëve.
- Ai nuk do të përjetonte një marrëdhënie unike dhe të veçantë me Perëndinë.
- Ai nuk do të mund të ishte burim i drejtësisë dhe i jetës së përjetshme për ndjekësit e tij.

Mesia ishte Perëndia në mish:

Për t'i larguar mëkatet e botës, Shpëtimtari do të duhej të paguante çmimin e plotë. Kush përveç atij që është plotësisht i drejtë do të mund të kënaqë kërkesën e drejtësisë së vërtetë të Perëndisë? Sakrifica duhej të kishte një barasvlerë me numrin e shpirtërave që duhej të shpengoheshin. Asgjë përveç gjakut të Qengjit të përsosur të Perëndisë nuk mund të ishte e mjaftueshme për t'i pastruar të gjitha mëkatet e njerëzimit të bëra kundër Perëndisë! Prandaj Perëndia e dërgoi përsosmërinë e personifikuar. Krishti vdiq që ne të mund të kemi jetën e përjetshme. Vetëm Perëndia në mish mundi ta fitojë Satanin dhe t'i lirojë ata të cilët mbaheshin robër nga ai.

Sakrifica duhej të kishte një marrëdhënie të veçantë me Perëndinë:

Jezusi e ndan pikërisht natyrën e Perëndisë. Ne lexojmë për këtë misterie në Bibël tek Kolosianëve kap. 2:9, "Sepse tek ai banon trupërisht gjithë plotësia e Hyjnisë." Jezusi i vetmi kualifikohet si hallkë lidhëse ndërmjet Perëndisë dhe njeriut. Humnera në mes qiellit dhe tokës u urëzua me ardhjen e Jezusit. Asnjë përveç Jezus Krishtit nuk do të mund të jepte jetën shpirtërore të gjithë atyre që besojnë në të sepse Perëndia - Njeri Jezus është i gjallë sot në qiell! Çdo besimtar i tij do të bashkohet me të (i banuar nga Shpirti i tij i gjallë) dhe do të ndajë fitoren dhe lavdinë e tij. Çfarë trashëgimi e mahnitshme është duke na pritur, miku i im!

KAPITULLI 16 **MISHËRIMI I JEZUSIT**

Bazuar në Bibël, mishërimi i mbinatyreshëm i Jezusit (ardhja e Perëndisë në formën e njeriut) ishte plan i Perëndisë për t'i shpëtuar të gjithë njerëzit. Krishti çdoherë ekzistoi, por ai erdhi në një formë të prekshme kur u lind në Betlehem!

Kombinimi i natyrës hyjnore dhe njerëzore në Krishtin:

Në një profeci lidhur me Mesinë, profeti Isaia paralajmëroi kombinimin e hyjnore me njerëzoren në Krishtin. Tek Isaia kap. 9:6, lexojmë: "Sepse na ka lindur një fëmijë, një djalë na është dhënë. Mbi supet e tij do të mbështetet perandoria dhe do të quhet Këshilltar i admirueshëm, Perëndi i fuqishëm, Atë i përjetshëm, Princ i paqes." Na ka lindur një "fëmijë" (referencë për natyrën njerëzore të tij), i cili gjithashtu do të jetë "Perëndi i fuqishëm" (referencë për natyrën hyjnore të tij). Në Ungjillin e prezentuar nga Luka, lexojmë që engjëlli Gabriel (Xhebraili) iu shfaq virgjëreshës Mari dhe i tha: "Dhe engjëlli i tha: "Mos ki frikë, Mari, sepse ke gjetur hir para Perëndisë. Dhe ja, ti do të mbetesh shtatzënë dhe do të lindësh një djalë, dhe do t'ia vesh emrin Jezus. Ai do të jetë i madh dhe do të quhet Biri i Shumë të Lartit...." (Luka 1:30-32).

Biri i Perëndisë e përuli veten e tij:

Tek Filipianëve kap. 2:5-11 na sqaron që Biri i Perëndisë e përuli veten e tij për t'u bërë njeri dhe pastaj vdiq në kryq si zëvendësuesi i ynë. Thuhet: "...Jezus Krishti i cili, edhe pse ishte në trajtë Perëndie, nuk e çmoi si një gjë ku të mbahej fort për të qenë barabar me Perëndinë, por e zbrazi veten e tij, duke marrë trajtë shërbëtori, e u bë i ngjashëm me njerëzit; dhe duke u gjetur nga pamja e jashtme posi njeri, e përuli vetveten duke u bërë i bindur deri në vdekje, deri në vdekje të kryqit. Prandaj edhe Perëndia e lartësoi madhërisht dhe i dha një emër që është përmbi çdo emër, që në emër të Jezusit të përkulet çdo gju i krijesave (ose gjërave) qiellore, tokësore dhe nëntokësore, dhe çdo gjuhë të rrëfejë se Jezu Krishti është Zot, për lavdi të Perëndisë Atë."

Jezusi është plotësisht njeri dhe plotësisht hyjnor:

Këto vargje tek Filipianëve na zbulojnë të vërtetat lidhur me natyrën dhe veprën e Krishtit. Le të shqyrtojmë njëri prej frazave. "Edhe pse ishte në trajtë Perëndie" i referohet natyrës hyjnore të Krishtit. Ai e ndan vetë esencën e Perëndisë. Kur Krishti erdh në tokë, ai në mënyrë të përlulur mori një natyrë plotësuese (natyrën njerëzore) dhe u shfaq në botë si njeri. Pastaj ai kishte dy natyra, njëri hyjnore dhe tjetri njerëzore.

Jezusi iu nënshtrua vullnetit të Perëndisë:

Vargu vazhdon të thotë që Jezusi "e zbrazi veten e tij", që nuk nënkupton se ai e dorëzoi apo e lëshoi natyrën e tij hyjnore. Kjo nënkupton që ai vullnetarisht i la anash disa prej të drejtave mbinatyrore të tij, privilegjet, dhe pozitën, në nënshtrim të vullnetit të Perëndisë. Dhe "duke marrë trajtë shërbëtori", ai erdhi për t'u shërbyer njerëzve. Ai u "bë i ngjashëm me njerëzit" nënkupton që Jezusi ia nënshtrou veten limiteve njerëzore që të mund të jetë më të vërtetë njeri sikurse ne. Pastaj ai do të mund të demonstronte pamëkatshmërinë e tij duke e mbizotëruar çdo tundim (Hebrenjve 4:15). Vëreni që derisa Ai jetoi në tokë, lavdia e Krishtit ngeli e fshehur për shumicën e njerëzve. Ai e shfrytëzonte fuqinë e tij hyjnore vetëm sipas vullnetit të Atit. Ai nuk e përdori fuqinë e tij mbinatyrore për t'i lehtësuar vuajtjet e tij njerëzore apo për ndonjë fitim tjetër personal (Mateu 8:20).

Jezusit i pëlqeu të bëhet njeri:

Këto vargje tek Filipianëve kap. 2:5-11 na bëjnë të ditur dashurinë e pamasë të Perëndisë për ne dhe na inkurajojnë të kemi përrulje të mendjes, duke ndjekur shembullin e Krishtit. Sepse Biri i Perëndisë u sakrifikuva tepër kur vullnetarisht e la lavdinë (duke hequr dorë nga pozita e lavdisë së paramishërimit) dhe mori formën njerëzore. Jetoj si shërbëtor dhe pastaj vdiq për mëkatet tona. Prandaj " edhe Perëndia e lartësoi madhërisht dhe i dha një emër që është përmbi çdo emër...!" (Filipianëve 2:9).

QËLLIMI I MISHËRIMIT TË JEZUSIT

Tri qëllimet kryesore të ardhjes së Birit të Perëndisë në mish (në formën e njeriut) ishin:

1. E siguroi dashurinë supreme të Perëndisë për ne edhe në gjendjen tonë të rënë, sepse Perëndia nuk e braktisi racën njerëzore kur u infektua nga mëkati;
2. E përmbushi planin e Perëndisë duke e siguruar sakrificën e pranueshme nga vetja e tij në vendin tonë për t'i mënjeluar mëkatet tona; dhe
3. E bëri të njohur dënimin e ashpër të mëkatit nga Perëndia

Aspekte tjera të rëndësishme të mishërimit janë:

- Jezusi e shkatërroi veprën e Satanit (1Gjoni 3:8 dhe Kolosianëve 2:15)
- Jezusi na e zbuloi Perëndinë Atë, që të mund ta njohim dhe të kemi marrëdhënie me të (2 Korintasve 4:6).
- Jezusi na e siguroi një shembull për jetët tona, me jetën e tij në nënshtrim të plotë ndaj Perëndisë.
- Jezusi na demonstroi se si duhet t'i duam të afërmit tanë sikurse e duam veten tonë, sikurse edhe armiqtë tanë (Mateu 5:44)
- Jezusi na mësoi t'i shërbejmë njëri tjetrit. Për shembull kur u lau dhe u fshiu këmbët e dishepujve të tij, ai iu tha atyre: "Unë, në fakt, ju kam dhënë shembullin që siç kam bërë unë, bëni edhe ju." (Gjoni 13:15)

Hiri i mahnitshëm i Perëndisë ndaj nesh:

Mishërimi i Jezusit na i hapë sytë ndaj vlerës që Perëndia e vë në jetën e njeriut. Na siguron për dashurinë e fuqishme dhe të thellë që ka Perëndia për ju dhe për mua. Ai erdhi për ne derisa ne ishim ende në gjendjen tonë mëkatore dhe të rënë (Romakëve 5:8) Perëndia na deshi aq tepër sa "që nuk e kurseu edhe Birin e vet, por e dha për të gjithë ne..." (Romakëve 8:32). Sepse jeta e Jezusit ishte aq e çmueshme sa që e kualifikoi për të paguar atë që ishte e papaguar për mëkatet e mbarë botës. Ky është hiri i mahnitshëm i Perëndisë drejt nesh.

Njeriu kurrë nuk do të mund t'i paguante fajet e tij:

Njeriu tenton ta shpëtojë vetveten. Ai e di që ka mëkatuar dhe tenton të rregullojë gabimin që e ka bërë kundër Perëndisë. Sidoqoftë, gabimet e njeriut janë aq të mëdha sa që kurrë nuk do të mund t'i paguante. Vetëm Perëndia mund ta plotësojë kërkesën e tij personale për pagimin e mëkateve. Siç u përmend më lart, vetëm ai i cili ishte njëkohësisht Perëndi dhe njeri mund të arrijë shpëtimin tonë. Mëkati i njeriut rezultoi me ndarje nga Perëndia sepse njeriu mëkatar nuk mund të qëndrojë para Perëndisë. Ashtu që dashuria e Perëndisë ia zgjati hirin njeriut mëkatar përmes të vetmit mjet që Perëndia mund të përdorte, Birin e tij, Jezus Krishtin. Shpëtimi u përmbush nga Perëndia, sepse asnjë njeri nuk e kishte fuqinë dhe as të drejtën për ta fituar. Drejtësia kërkoi që dikush ta paguante dënimin për paudhësi.

Jezus Krishti i përmbushi kërkesat e ligjit:

Jezusi u kualifikua që ta merr pozitën tonë. Jezusi në formën e njeriut e mori tërë barrën (gjykimin) e mëkateve tona mbi veten e tij. Ai e përmbushi kërkesën e ligjit duke mos bërë kurrë mëkat dhe pastaj të vdesë si njeri (duke derdhur gjakun e tij) për të gjitha mëkatet kundër Perëndisë. Për këtë arsye, Shpëtimtari duhej të ishte njëkohësisht njeri dhe Perëndi, bashkë hyjnor dhe njerëzor. Krishti e përmbushi vullnetin e Perëndisë në vendin tonë. Në Krishtin e shohim së bashku gjykimin dhe mëshirën e Perëndisë në lidhje me mëkatet tona. E shohim Perëndinë së bashku si i "Drejtë" dhe "Shfajësues." Nëpërmjet sakrificës së Jezus Krishtit, Perëndia e përmbushi drejtësinë e vërtetë të Tij. Perëndia është i drejtë. Gjykuesi i mbarë botës duhej të vepronte drejt. Mëkati ishte mospërfillje e Ligjit të Shenjtë të Perëndisë sipas rregullës morale të Perëndisë. Prandaj, ishte e pamundur për Perëndinë të mirrej lehtë me mëkatin. Në qoftë se mëkatet tona do të mund të faleshin në përgjithësi, atëherë kjo duhet të jetë në baza që do ta kënaqte standardin perfekt të shenjtërisë dhe drejtësisë së Perëndisë.

Jezusi i shkëmbeu mëkatet tona për drejtësinë e tij:

Për ta theksuar, ne mëkatarët ishim të paafte për të shlyer këtë borxh. Shenjtëria dhe drejtësia e Perëndisë kërkoi pagesë që ishte e pamundur për njeriun. Andaj Perëndia vetë e pagoi borxhin duke e flijuar sakrificën përfundimtare. Ai e bëri këtë për shkak të dashurisë së tij perfekte për ju dhe mua. Në kryq, çmimi u pagua. Jezus Krishti i barti mëkatet tona. Biri Hyjnor e mori natyrën njerëzore mbi vetvete duke u bërë përfaqësues. Ai e dha jetën e tij për mëkatarët. Krishti është zëvendësimi që e barti dënimin për ne (shiko 1Pjetrit 2:24). Nëpërmjet vdekjes së Krishtit, kërkesa e drejtë e drejtësisë së Perëndisë u plotësua.

Jezusi vuajti tepër për të na shpenguar:

Jezusi vuajti jo vetëm dhimbjen torturuese fizike, por edhe agoninë shpirtërore të ndarjes nga Perëndia Atë. Marrëdhënia e tyre u shkatërrua sepse zemërimi i Perëndisë kundër mëkatisë ra mbi Jezusin në kryq. Kjo "ndarje" është përtej të kuptuarit tonë njerëzor. Nëpërmjet mishërimit të tij, ne mund të shohim se Perëndia e identifikoi veten me njeriun. Ati nuk u përmbajt nga sakrifica përfundimtare, jeta e Birit të tij Jezus, i cili e duroi vdekjen në kryq që ne të mund të shpëtohem nga ferri i përjetshëm dhe ndarja nga Perëndia.

Mrekullia e mahnitshme e Mishërimit:

Mishërimi i Krishtit na dërgon në një mrekulli të mahnitshme! Sikurse 1Timoteu thekson që: "...misteri i mëshirës është i madh: Perëndia u shfaq në mish." Çfarë mrekullie që Jezus Krishti u bë njeri dhe eci me ne. Gjoni 1:14 na zbulon, "Dhe fjala e bë mish dhe banoi ndër ne, dhe ne e soditëm lavdinë e tij..." Para se të ndajë më tepër nga Lajmi i Mirë me ju, lexues i nderuar, kam një sugjerim. A mund të ndalesh së lexuari dhe të thuash një lutje tani duke kërkuar Perëndinë të të udhëheq në të vërtetën e tij dhe në të kuptuarit e Fjalës së tij? Kjo gatishmëri do t'iu udhëheq në një marrëdhënie të mrekullueshme me Të përjetë!

PJESA E GJASHTË

CILËSITË UNIKE TË JEZUSIT

KAPITULLI 17 **LINDJA VIRGJËR E JEZUS KRISHTIT**

Ndërsa e hulumtojmë veçanshmërinë e Jezusit në Kuran dhe në Bibël, le ta bëjmë këtë me besim që Perëndia të na drejtojë si kërkues të sinqertë të së vërtetës.

LINDJA VIRGJËR SIPAS KURANIT DHE BIBLËS

Ngjizja e mbinatyrshe e Jezusit mësohet në Kuran. Në s. 19:16-34 thuhet:
“Përmendju në këtë libër (tregimin) për Mejremen...Ne ia dërguam asaj Xhibrilin, dhe ai iu paraqit asaj njeri në tërësi. Ajo tha: “Unë i mbëshetem të Gjithëmëshirshmit prej teje, nëse je që i frikohesh Atij”. Ai tha: “Unë jam vetëm i dërguar (melek) i Zotit tonë për të dhuruar ty një djalë të pastër”. Ajo tha: “Si do të kem unë djalë, kur mua nuk më është afuar njeri, e as nuk kam qenë e pamoralshme”. Ai tha: “Ja, kështu ka thënë Zoti yt; ajo për mua është e lehtë, e për ta bërë atë argument për njerëzit e edhe mëshirë nga ana e Jonë. Kjo është çështje e kryer”. Ajo e barti atë, prandaj u izolua në një vend të largët...”

Jezusi lindi nga Maria virgjër:

Siç u përmend më herët, një përkthim i saktë i fjalës arabe të Kuranit, “ruhana” është thjesht “Shpirti ynë”. Kurani mëson se Jezusi u ngjiz vetëm nga gruaja. Nëna e tij ishte “Maria virgjër”. Lindja virgjër e Jezusit përshkruhet gjithashtu në S. 3:45-47. Është një fakt i mrekullueshëm që ngjizja e mbinatyrshe e Jezusit mësohet në Kuran. S. 21:91 deklaron qartë: “Përkujto edhe atë që ruajti nderin e saj, e Ne e frymëzuam atë me shpirt (barrë) nga ana jonë dhe atë dhe të birin e saj; bëmë mrekulli për njerëzit.”

Bazuar në Ungjill, Jezusi nuk u ngjiz nga fara njerëzore, por me fuqinë e Shpirtit të Shenjtë të Perëndisë. Kjo mund të shihet qartë tek Luka kap. 1:26-36 dhe Mateu kap. 1:18-21. “(Maria) mbeti shtatëzënë nga Fryma e Shenjtë.” (Mateu 1:18). Bashkë Bibla dhe Kurani mësojnë si fakt lindjen e Jezusit nga gruaja e virgjër me vullnetin e Perëndisë nëpërmjet fuqisë së Shpirtit të Perëndisë. Jezusi ishte i vetmi Njeri në mbarë krijimin i lindur në këtë mënyrë unike, hyjnore.

Lindja mbinatyrore e Jezusit që mrekulli për gjithë njerëzit:

Është e mahnitshme që në Kuran vetëm lindja e Jezusit thuhet të jetë mrekulli për gjithë njerëzit! Thuhet dy herë që lindja (mbinatyrore) e Krishtit u bë qëllimisht nga Perëndia për t’u dhënë njerëzve mrekulli. S. 21:91: “...dhe atë dhe birin e saj e bëmë mrekulli për njerëzit.” S. 19:21: “...për ta bërë atë argument për njerëzit e edhe mëshirë nga ana e Jonë...” Ky dallim nuk bëhet në lidhje me lindjen e asnjë profeti tjetër. Është gjithashtu e rëndësishme të gjindet se nëna e Jezusit është e vetmja grua që përmendet me emër në mbarë Kuranin. S. 19 titullohet “Merjem”. Në fakt, emri i Marisë paraqitet disa herë në Kuran përderisa Eva, gruaja e parë që Perëndia e krijoi, nuk përmendet askund me emër.

Maria u lartësua mbi të gjitha gratë:

Bashkë Kurani dhe Bibla mësojnë që Maria ishte gruaja më e lartësuar në historinë e njerëzimit. Në s. 3:42 lexojmë: “Përkujto kur engjëjt i thanë: “Oj Merjeme, Allahu të dalloj ty... dhe të lartësoi mbi të gjitha gratë e botës.” Dhe tek Luka 1:42, Maria pranon një profeci: “Ti je e bekuar ndër gratë dhe i bekuar është fryti i barkut tënd!” Njeriu mund të pandeh përse Maria u lartësua mbi të gjitha gratë ndonjëherë. Arsyeja është e qartë. Sepse Perëndia e zgjodhi Marinë të jetë nëna e Njeriut më të përsosur, të veçantë (hyjnor) dhe unik që jetoi ndonjëherë në faqen e

tokës! Edhe Muhamedi deklaroi që lindja e Jezusit ishte e vetmja lindje në të cilën Satani nuk ka mundur të përzihet.¹ Mik i nderuar mysliman, a ke filluar të shohësh veçanshmërinë e Jezusit?

BIRËRIA SHPIRTËRORE E JEZUSIT NDAJ PERËNDISË ISHTE ARSYEJA PËR LINDJEN VIRGJËR

Ungjilli mëson që Jezusi ishte Biri hyjnor i Perëndisë, që ekzistoi gjatë tërë përjetësisë. Andaj, në qoftë se Biri hyjnor i Perëndisë do të vinte në ngjasim me njeriun, ai nuk do të mund të lindej nga babai dhe nëna njerëzore. Pasi që Jezusi është Bir i Perëndisë, ishte absolutisht e nevojshme që Jezusi të lindte nga një virgjëreshë përmes fuqisë së Shpirtit të Perëndisë. Dihet që jeta e racës njerëzore bartet nëpërmjet farës mashkullore.

Lindja e Jezusit ishte i vetmi përjashtim nga procesi normal i lindjes. Në fakt, kur Jezusi erdhi në këtë botë ishte një hyrje, jo krijim. Të gjithë njerëzit tjerë erdhën përmes bashkimit të mashkullit dhe femrës. Jezusi u ngjizë nga Shpirti i Perëndisë.

Mësimet të cilat na dërgojnë të kuptojmë që Jezusi është Bir i Perëndisë:

- Bashkë Bibla dhe Kurani mësojnë që u lind nga një e virgjër pa babë njerëzor.
- Bazuar në Kuran, Jezusi u ngjizë nga Shpirti i Perëndisë.
- Bazuar në Bibël, Jezusi u ngjizë me fuqinë e Shpirtit të Shenjtë.
- Kurani e quan Jezusin “Shpirt nga Perëndia”.
- Bibla mëson që Jezusi ishte Shpirti i përjetshëm dhe e veshi mishin njerëzor.
- Sipas Biblës dhe Kuranit, Jezusi s’është i lidhur me asnjë baba “fizik” njerëzor.

Andaj, meqë thelbi i Perëndisë është Shpirti, këto mësimet na ndihmojnë të kuptojmë që Perëndia është Ati i Jezusit. Kjo nënkupton që Jezusi është Bir i Perëndisë. Tani mund të shohim që birëria shpirtërore e Jezusit ndaj Atit e sqaron domosdoshmërinë e lindjes së virgjër dhe i dëshmon arsyet për këtë. Ju lutemi lexoni dhe merrni parasysh kapitullin e 27 që titullohet “Jezusi është Biri i përjetshëm i Perëndisë në një sens unik shpirtëror”.

Lindja e virgjër e Jezusit që profetizuar në Bibël:

Tek Zanafillën 3:15, është profetizuar se Mesia do të vjen nga fara e gruas (në vend që normalisht nga fara e mashkullit)! Andaj, ky varg është referenca e parë ndaj “lindjes së virgjër” të mbinatyrshe. Fakti që Jezusi kishte fillim unik të jetës së tij, dëshmon që ai është unik dhe hyjnor. Kjo është çfarë engjëlli Gabriel i tha Marisë kur erdhi për t’i sqaruar lidhur me ngjizjen mbinatyrore të Jezusit: “Ai do të jetë i madh dhe do të quhet Bir i shumë të Lartit... Shpirti i Shenjtë do të vijë mbi ty dhe pushteti i Shumë të Lartit do të të mbulojë me hijen e vet; prandaj i shenjtë që do të lind prej teje do të quhet Bir i Perëndisë.” (Luka 1:32-35).

KAPITULLI 18 **PAMËKATSHMËRIA E JEZUS KRISHTIT**

Asnjë njeri apo profet gjer tani s’ka guxuar të pohojë mosdështimin e tij. Vetëm Jezus Krishti kishte siguri të plotë në përsosshmërinë dhe pastërinë e tij. Prandaj, ai me guxim do të mund të pyeste: “Cili nga ju më bind për mëkat? Nëse flas të vërtetën, përse nuk më besoni?” (Gjoni 8:46).

PAMËKATSHMËRIA E JEZUSIT E DEMONSTRUAR NË KURAN

Është e qartë nga Kurani, nga Hadithi dhe nga Bibla se Jezusi ishte i vetmi njeri që jetoi pa bërë asnjë mëkat të vetëm gjatë tërë jetës së tij. Në s. 19:19, në Kuran lexojmë që engjëlli iu shfaq Marisë dhe tha: “Unë jam vetëm i dërguar i Zotit tënd për të dhuruar ty një djalë të pastër”. Në përkthime tjera (në gjuhën angleze-shënim i përkthyesit) të së njëjtës s. 19:19, Jezusi përshkruhet të jetë “më i pastërti” (Zakeyia). Al Baidawi e përshkruan frazën kuranore “një djalë të pastër” si “të pastër prej mëkateve”. Në përkthimin e Yusuf Ali të këtij vargu, Jezusi referohet si i “Shenjtë”; në përkthimin e Arberry ai përshkruhet i “pastër”; dhe në përkthimin e Pickhallit Jezusi referohet si i “pagabueshëm”. Këto janë përkthime botërisht të pranuar universalisht. Sipas Hadithit, jomëkatshmëria e Jezus Krishtit është mjaft e qartë. Ai është i vetmi person i painfluencuar ndonjëherë nga Satanai.¹

Muhamedi ra nën ndikimin e magjisë së ligë:

Në fakt ne mësojmë nga Al Buhariu se Muhamedi ra nën efektin e shpirtërave të këqij.² Ajsha raportoi një incident në të cilën Muhamedi imagjinonte se kishte marrëdhënie seksuale me gratë e tij kur aktualisht nuk kishte. Pastaj Muhamedi iu lut Allahut lidhur me këtë problem, dhe Allahu iu përgjigj lutjes së tij duke ia dërguar dy persona në ëndërr. Muhamedi e ndëgjoi njerin prej tyre t’i thoshte tjetrit: “Çfarë është gabim me këtë njeri (Muhamedin)?” Tjetri iu përgjigj, “Ai është nën efektin e magjisë”. Muhamedi mësoi nga kjo ëndërr identitetin e personit që e manifestoi magjinë, sikurse edhe materialin e përdorur dhe lokacionin. Sipas dijetarëve myslimanë, tregimi implikohet edhe është për shkak të ëndërrës që Zoti i dha Muhamedit, pasi kështu ai kishte mundësi për ta tejkaluar problemin e të qenurit nën ndikimin e magjisë së ligë. Në Ungjill ne shohim një kontrast. Jezusi demonstroi fuqi mbi të gjithë shpirtërat e këqinj. Për shembull, tek Marku kap. 5:1-12 lexojmë që Jezusi u takua me një person që kishte një shpirt të ndyrë. Me autoritet mbinatyor, Jezusi e urdhëroi shpirtin e ndyrë: “Frymë e ndyrë, dil prej këtij njeriu”. Njeriu u lirua menjëherë. Prandaj, miku im, Jezusi është i vetmi që mund të të mbrojë nga ndonjë sulm i Satanit apo shpirtërave të tij të këqij.

Pamëkatshmëria e Jezusit në Bibël:

Pamëkatshmëria e Jezusit mësohet përgjatë tërë Ungjillit. Për shembull:

- “Ai nuk bëri asnjë mëkat dhe nuk u gjet asnjë mashtrim nga goja e tij.” (1Pjetri 2:22).
- “Sepse ai bëri të jetë mëkat për ne ai që nuk njihnte mëkat, që ne të bëhemi drejtësia e Perëndisë në të.” (2Korintasve 5:21).

Prandaj, Jezus Krishti është personi i vetëm i përshkruar si i pamëkatë në Kuran, në Bibël, dhe në Hadith.

TË GJITHË MËKATUAN

Siç u cek më herët, është një çështje e lehtë për t’u vërtetuar nga Bibla, Kurani dhe Hadithi që të gjithë njerëzit mëkatuan. Mëkati korrrë fitore mbi çdo qenie njerëzore. Ju lutem merrni parasysh disa shembuj.

- **Në Ungjill:** Bazuar tek Romakëve kap. 3:10-12, “Nuk ka asnjëri të drejtë, as një...”
- **Në Hadith:** Një prej Haditheve më të besuara thotë: “Satani qarkullon në mendjen njerëzore sikurse gjaku që qarkullon në të.”³

- **Në Kuran:** Në s. 12:53 lexojmë, “Shpirti i (njeriut) është nxitës për të keqen...”

Referencat kuranore lidhur me mëkatet e profetëve:

Për të dëshmuar veçantinë e pamëkatshmërisë së Jezusit, është ndihmëse për të konsideruar që Kurani iu atribon mëkatet profetëve tjerë të mëdhenj. Këtu janë disa prej referencave të Kuranit:

Adami: “Atëherë me mashtrim i zbriti. Kur e shijuan pemën u zbulua vendturpi i tyre...Zoti i tyre i thirri: “A nuk ua ndalova ju dyve atë pemë...Ata të dy thanë: “Zoti ynë, ne i bëmë padrejtë vetvetës sonë...” (S. 7:22-23).

Abrahami: Abrahami tha: “Ai tek i cili kam shpresë se do të m’i falë mëkatet e mia në ditën e gjykimit.”

Jona: “Dhe atë e kafshoi peshku, zatën ai ishte që e meritoi qortimin.” S. 37:142).

Moisiu: Moisiu u lut: “Zoti im, unë e ngarkova veten e Ti më fal mua...” (S. 28:16).

Referencat kuranore ndaj mëkateve të Muhamedit:

Gjithashtu është e rëndësishme që Kurani i atribon mëkatet e Muhamedit. Këtu janë disa shembuj:

“Ashtu që Allahu të liroi prej mëkateve të mëparshme dhe atyre të mëvonshme...” (S. 48:2).

“...kërko falje për mëkatën tënd, të besimtarëve dhe të besimtareve...” (S. 47:19).

“Kërko falje për mëkatën tënd...” (S. 40:55).

Përsëritet në Hadith (Al Buhariu) që Muhamedi kishte thënë: “Beto hem në Allahun! Unë kërkoj falje ndaj Allahut dhe kthehem tek ai në pendim më tepër se shtatëdhjetë herë në ditë.”⁴ Nëpër tërë Hadithin mund të vërehen shembuj se si Muhamedi kërkonte falje. Al Buhariu e përshkruan këtë lutje të Muhamedit: “O Allah! M’i pastro mëkatet e mia me ujë të borës dhe të breshërit, dhe pastroje zemrën time nga të gjitha mëkatet sikurse një rrobë të bardhë nga ndyrësitë, dhe le të jetë një distancë e gjatë mes meje dhe mëkateve të mia, sikurse e ke bërë Lindjen dhe Perëndimin larg prej njeri tjetrit.”⁵ Në të vëretë ai vazhdoi të kërkonte falje deri në frymën e fundit.⁶

Kush është më i nderuari nga Perëndia?:

Nuk përmendet askund në Kuran, në Hadithe apo në Bibël, se Jezusi kishte nevojë për të kërkuar falje. Edhe Ayoub Mahmoud M., një shkrimtar i përmendur mysliman bashkëkohor, përmend se Jezusi ishte i lirë nga mëkati. Ai shkruan: “Jezusi prandaj është i lirë nga infektimi i të keqes dhe papastërtisë...kjo pastërti, të cilën Adami e kishte derisa nuk u prek nga gishti i Satanit, tani mund të vërtetohet vetëm në Jezusin.”⁷

Perëndia me siguri do të ishte më tepër i kënaqur me atë që është në të vërtetë i drejtë. S. 49:13 thotë: “S’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur...” Lexues i nderuar, ky person është Jezusi!

ARSYEJA PËR PAMËKATSHMËRINË E JEZUSIT

Në Ungjill (tek Gjoni 10:30), Jezusi tha: “Unë dhe Ati jemi një.” Jezusi dhe Ati nuk janë i njëjti person, por janë Një në esencë dhe natyrë (shiko kapitullin 9). Meqë Ati dhe Biri janë një, sikurse Jezusi tha, Biri e kryen çdoherë vullnetin e Atit të tij. Tek Gjoni 5:19, Jezusi tha: “Gjërat në fakt që bën Ati, i bën poashtu edhe Biri”. Meqë Perëndia Atë nuk mund të mëkatojë, e ditur se edhe Biri nuk mund të mëkatojë. Sepse Jezusi është një me Perëndinë, ai çdoherë e bëri vullnetin absolut të Perëndisë. Ai kurrë nuk veproi në mënyrë të pavarur sipas pëlqimit të tij. Për këtë arsye

ai kurrë nuk bëri asnjë mëkat të vetëm ndaj Perëndisë apo ndaj qenieve tjera njerëzore. Tek Gjoni 8:29, Jezusi tha: "...sepse bëj vazhdimisht gjërat që i pëlqejnë Atit." Jezus Krishti ishte i pamëkat gjatë tërë jetës së tij tokësore sepse ai ishte i pamëkat në natyrën e tij. Jezusi nuk e posedonte natyrën mëkatore që u transmetua nga Adami te pasardhësit e tij. Përsëri, ai nuk u ngjiz nëpërmjet bashkimit natyral të mashkullit dhe femrës por nga Shpirti i Shenjtë. Mund ta shohim tani përse Jezusi ishte Njeriu i vetëm në historinë njerëzore që bëri jetë të pamëkatshme sepse ai është Biri i Perëndisë!

Jezusi na pastron nga të gjitha mëkatet tona:

Biri i Perëndisë e demonstroi autoritetin e tij për t'i falur mëkatet. Për shembull, tek Marku 2:1-12, Jezusi e fali paralitikun nga mëkatet e tij dhe e shëroi. Dhe tek Mateu 9:6 Jezusi deklaroi vetë që kishte fuqi në tokë për të falur mëkate. Ju lutem vëreni këto fjalë të rëndësishme nga Al Baidawi lidhur me Jezusin: "Sepse nëpërmjet fjalëve të tij religjioni jeton, shpirti njerëzor jeton përjetësisht, dhe njerëzit janë të pastruar nga mëkati."⁸ Jezusi jo vetëm që është i pamëkat, por edhe i pastron të tjerët nga mëkatet e tyre. Kjo është përse ai erdhi në tokë. Nëpër tërë Biblën lexojmë që gjaku i Krishtit i derdhur në kryq na pastron nga të gjitha mëkatet! (1Gjoni 1:7). Myslimanët besojnë që duhen të jenë ritualisht të pastër. Ata pastrohen me ujë të pastër para se të luten. Nëse nuk mund të gjejnë ujë të pastër, mund të përdorin rërë. Dhe nëse rëra nuk mund të gjendet, atëherë personi mund të "afrohet" dhe të prek një objekt të pastër për të arritur qëllimin e pastrimit. Mik i nderuar, uji i pastër mund të pastrojë vetëm trupin tonë fizik, por konsideroni transformimin që ndodh kur ju "afroheni" në një sens shpirtëror dhe besoni në personin e vetëm të pastër – Jezusin. Në momentin kur ju e vendosni besimin tuaj në të, drejtësia e tij (pastërtia) do të vendoset mbi ju dhe do të jeni të denjë për të qëndruar dhe për t'u gjuhëzuar para Perëndisë së Plotfuqishëm!

KAPITULLI 19

VEÇORI TJERA UNIKE NGA JETA E JEZUSIT

Aftësia e Jezusit për t'i ngjallur të vdekurit mësohet në mënyrë të qartë, në Kuran dhe në Bibël, e është një fuqi që i takon vetëm Perëndisë.

Jezusi posedonte fuqi për të ngjallur të vdekurit (në Kuran):

Kurani pohon në gjuhë të qartë që Jezusi i ngjalli njerëzit nga të vdekurit. Jezusi u citua duke thënë në s. 3:49: "Dhe unë me lejen e Allahut ngjalli të vdekurit... Vërtet, kjo është fakt për ju nëse jeni besimtarë." S. 5:110 flet se Perëndia vetë flet për Jezusin se posedon fuqi për të ngjallur të vdekurit. Bazuar në Kuran, kjo fuqi i është dhënë vetëm Jezusit. Dhe mjaft me rëndësi, të gjithë komentatorët mysliman të Kuranit pajtohen që fuqia për të ngjallur të vdekurit i takon vetëm Zotit. "Kush i ngjall eshtrat duke qenë ata të kalbur? Thuaj: "I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i dijshtëm për çdo krijim." (S. 36:78-79).

Jezusi posedonte fuqinë për të ngjallur të vdekurit (në Bibël):

Ungjilli gjithashtu mëson qartë se Jezusi kishte fuqinë për të ngjallur të vdekurit. Një shembull është kur Lazari vdiq, mik i afërt i Jezusit. Jezusi i deklaroi motrës së Lazarit, Martës: "Unë jam ringjallja dhe jeta: ai që beson në mua, edhe sikur të duhej të vdesë do të jetojë. Dhe ai që jeton dhe beson në mua, nuk do të vdesë kurrë përjetë." (Gjoni 11:25-26). Pastaj Jezusi e ngriti Lazarin nga të vdekurit, duke demonstruar që ai erdhi për të mundur vdekjen dhe të jepë jetë të përjetshme kujtdo që beson në të. Jezusi dëshmoi se posedonte fuqi absolute mbi jetën dhe vdekjen! Mik i nderuar mysliman, edhe pse Bibla përmban të vërteta të zbuluara nga Perëndia, ne nuk "shpëtohem" nga doktrina e shkruar në libër, por "shpëtohem" nga Shpenguesi, Jezus

Krishti! Tani nëse jeni të sëmure, keni nevojë për mjekun dhe jo për libër mjekësor. Në qoftë se jeni paditur në gjyq, keni nevojë për avokatin e jo për librin e Ligjit. Në mënyrë të ngjashme, kur takoheni me armikun e fundit, vdekjen, keni nevojë për Shpëtimtarin. Ringjallja e tij nga vdekja pas tre ditëve në varr, e pushtoi fuqinë e vdekjes. Ai e siguroi udhën që kushdo që beson në të dhe e ndjekë atë, kalon përtej varrit në Parajsë.

Jezusi posedonte fuqinë mbi vdekjen:

Në Ungjill, Jezusi deklaroi që ka fuqi mbi vdekjen. Andaj lexojmë në Bibël:

“Në fakt si Ati ringjalli të vdekurit dhe u jep atyre jetën, po kështu edhe Biri i jep jetën kujtdo që do.” (Gjoni 5:21).

“Ky është vullneti i Atit që më ka dërguar, që unë të mos humbas asgjë nga të gjitha ato që ai më ka dhënë, por t’i ringjall ditën e fundit.” (Gjoni 6:39).

“Askush nuk mund të vijë tek unë, po që se Ati që më ka dërguar nuk e tërheq dhe unë do të ringjall atë në ditën e fundit.” (Gjoni 6:44).

Jezusi posedon aftësinë për të krijuar jetën:

Bazuar në Bibël, Jezusi ka aftësinë për të krijuar jetën, diçka që asnjë njeri i thjeshtë nuk do të mund ta bënte ndonjëherë. Dy shkrime të fuqishme që indikojnë fuqinë e tij krijuese janë: “Sepse në të u krijuan të gjitha gjërat, ato që janë në qiejt dhe mbi dhe, ato që janë të dukshme dhe ato që nuk duken... të gjitha gjërat janë krijuar me anë të tij dhe në lidhje me të.” (Kolozianët 1:16). Dhe: “Të gjitha gjërat u bënë me anë të tij, dhe pa të nuk u bë asnjë nga ato që u bënë.” (Gjoni 1:3).

Jezusi posedon aftësi të njohë të padukshmën:

Jezusi ka aftësi të njohë të padukshmën, sipas Kuranit dhe Biblës. Njohuria e të “padukshmes” (që nuk mund të shihet me sytë njerëzor) është kualitet hyjnor. Sikurse që citon Kurani: “Çelësat e fshehtësisë janë vetëm te Ai, atë (fshehtësinë) nuk e di kush përpo Tij.” (S. 6:59). Muhamedi sqaroi në Kuran se nuk posedonte njohurinë e të padukshmes: “Sikur ta dija të fshehtën, do të shumoja për vete të dobishmet, e nuk do të më prekte gjë e keqe...” (S. 7:188). (Shiko gjithashtu s. 6:50 dhe S. 11:31). Sipas Kuranit (në s. 3:49), Perëndia ia dhuroi aftësinë të dijë të padukshmen vetëm Jezusit. Jezusi kishte aftësinë të dinte edhe detajet e imta të jetës së njerëzve. Sipas Ungjillit, Jezusi i dinte edhe mendimet dhe qëllimet e zemrës së njerëzve, siç u diskutua tek Gjoni 2:24-25: “Por Jezusi nuk u zinte besë atyre, sepse i njihje të gjithë. Sepse ai e dinte ç’kishte përbrenda njeriut.” Gjithashtu nga Ungjilli mësojmë që Jezusi, si profet, paralajmëroi ngjarje specifike të ardhshme. Në vijim janë disa prej ngjarjeve që u realizuan siç paralajmëroi ai:

- Vdekja dhe ringjallja e tij (Mateu 16:21).
- Ardhja e Shpirtit të Shenjtë në Pentekost (Gjoni 16:7-15).
- Rënia e Jerusalemit (Luka 19:43:44).

Mbani mend që Jezusi i përdori këto tri paralajmërime për të bërë të qartë misionin e tij hyjnor!

DISA VETI TJERA UNIKE NGA JETA E JEZUSIT NË KURAN

Jezusi ishte vazhdimisht i shoqëruar nga Shpirti i Shenjtë:

S. 2:87 thotë: “Isait, birit të Merjemës i dhamë argumente (mrekulli) dhe e fuqizua me Shpirtin e Shenjtë...” Sipas Kuranit dhe shkrimeve të dijetarëve myslimanë, Jezusi ishte i vetmi personi i shoqëruar çdoherë nga Shpirti i Shenjtë (nga ngjizja deri në ngritjen e tij). Ne shohim Jezusin të ketë kapacitetin të përjetojë harmoninë e plotë dhe shoqërinë me Shpirtin e Shenjtë.

Jezusi është çdoherë i famshëm (suprem):

Jezusi është i vetmi i përshkruar si person i shquar në këtë botë dhe atë që do të vijë. Në Kuran (në s. 3:45), lexojmë: “Përkujto kur engjëjt i thanë: “Oj Merjeme, Allahu të përgëzon me fjalën e vet emri i së cilës është Mesih, Isa, bir i Merjemës, i famshëm në dynja e në ahiret dhe nga të afërmit e Zotit.”

Fjala arabe “uajih” në vargun e sipërm është përkthyer “i famshëm” edhe në përkthimet tjera të Kuranit. Duke komentuar rreth s. 3:45, një dijetar i mirënjohur, Shukani, sqaron që “i famshëm është fuqi dhe autoritet.”¹ Al Razi, një dijetar tjetër i spikatur mysliman, komenton në s. 3:45, “Jezusi dallohet (uajih) në këtë botë, sepse kërkesat e tij plotësoheshin, ai ngjalli të vdekur, shëroi të verbër... Jezusi është i famshëm në jetën që do të vijë sepse Ai (Perëndia) e bëri të ndërmjetësorë në emër të njerëzve të tij të vërtetë, dhe (Perëndia) e pranoi ndërmjetësimin e tij për ta.”²

Ungjilli pajtohet se Jezusi është ndërmjetësuesi ynë:

Në Ungjill lexojmë që Jezusi vazhdimisht ndërmjetëson për ndjekësit (besimtarët) e tij para Perëndisë Atë. “Mbase qëndron për jetë të jetës,... prandaj edhe mund të shpëtojë plotësisht ata që me anë të tij i afrohen Perëndisë, sepse gjithmonë rron që të ndërmjetësojë për ta.” (Hebrenjve 7:24-25). Gjithashtu në Ungjill lexohet: “Kush është ai që do t’i dënojë? Krishti është ai që vdiq, po për më tepër ai u ringjall; ai është në të djathtë të Perëndisë dhe ai ndërmjetëson për ne.” (Romakëve 8:34).

Gjithashtu lidhur me Jezusin si Ndërmjetësues i dashur lexojmë në letrën e 1 Timoteut 2:3-6:

“Sepse kjo është e mirë dhe e pëlqyer para Perëndisë, Shpëtimtarit tonë, i cili dëshiron që të gjithë njerëzit të shpëtohen dhe t’ia arrijnë njohjes të së vërtetës. Në fakt një është Perëndia, dhe një i vetëm është ndërmjetësi midis njerëzve dhe Perëndisë: Krishti Jezus njeri, i cili e dha veten si çmim për të gjithë...”

PJESA E SHTATË

KRYQËZIMI DHE RINGJALLJA E JEZUS KRISHTIT

KAPITULLI 20 **KRYQËZIMI I JEZUSIT BAZUAR NË ISLAM**

Në këtë kapitull do të parashtrojmë pyetjen nëse Jezusi ishte kryqëzuar apo jo, dhe, nëse Perëndia e parashikoi dhe lejoi kryqëzimin e tij.

Raportim i pasaktë i Kuranit ndaj kryqëzimit të Jezusit:

Shumë myslimanë mësojnë se Perëndia kurrë nuk do t'i lejonte judenjtë të kryqëzonin Jezusin, i cili nderohet në Kuran si një profet i lartë. Unë do të dëshiroja t'iu përkujtoj këtyre myslimanëve të dashur vargjet e Kuranit që mësojnë rreth të "dërguarve" (profetëve) të Perëndisë që ishin mbytur:

"...për shkak të thyerjes së besës së dhënë, mohimit të ajeteve të Allahut, të mbytjes së pejgamberëve pa kurrfarë të drejtë..." (S. 4:155).

"...saherë që u erdhi ndonjë i dërguar me çka nuk u pëlqeu juve, a nuk u bëtë kryelartë dhe disa prej tyre i përgënjeshtruat e disa i mbytet?" (S. 2:87) (Shikoni gjithashtu S. 2:91).

Në Kuran, ekziston vetëm një varg që flet lidhur me çështjen e kryqëzimit. Është S. 4:157-158, që thotë: "Për shkak të thënies së tyre: "Ne e kemi mbytur Mesinë, Jezusin, birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut". Por ata as nuk e mbytën as nuk e gozhduan, por atyre u ngjau...Ata me siguri nuk e mbytën atë...Përkundrazi, Allahu e ngriti atë pranë Vetes...."

Pyetja e parë që duhet ta ketë përgjigjen është: Kujt po i referohej Muhamedi kur tha, "Ata as nuk e mbytën as nuk e gozhduan (Jezusin)?" Nga konteksti përgjigja është, natyrisht, judenjtë e pabesë. Vëreni që ky varg nuk e mohon që Jezusi ishte mbytur, apo që ishte kryqëzuar. Thjeshtë deklaroi që "ata" (judenjtë) nuk e mbytën as e gozhduan Atë.

Kryqëzimi i Jezusit dhe plani mjeshëtor i Perëndisë për shpëtimin tonë:

Ungjilli na mëson se kryqëzimi i Jezusit ndodhi sipas "qëllimit të caktuar dhe paranjohorisë" së Perëndisë (Veprat 2:23). Kryqi ishte qendra e veprës shpëtuese të Perëndisë për ne! Le t'i konsiderojmë fjalët e Jezusit një javë para vetëflijimit të tij. Sipas ngjarjes nga Ungjilli, Pilati pohoi të ketë fuqinë e jetës dhe vdekjes mbi Jezusin. Pavarësisht prej kësaj, Jezusi deklaroi që Pilati po e kryente vullnetin e Perëndisë kur e dorëzoi atë për t'u kryqëzuar. Jezusi iu përgjigj Pilatit duke thënë: "Ti nuk do të kishë asnjë pushtet përmbi mua, po të mos të qe dhënë prej së larti..." (Gjoni 19:11).

Të krishterët e dinë dhe besojnë që ardhja, kryqëzimi dhe ringjallja ishin planifikuar nga Perëndia para se të krijohet bota. Qe një plan madhështorë (nga dashuria e madhe dhe hiri i Perëndisë) për njeriun e rënë për ta shpenguar dhe për ta pajtuar me veten e tij! Lidhur me planin shpëtues të Perëndisë, profeti Isaia paralajmëroi:

"Por i pëlqeu Zotit ta rrihte dhe ta bënte të vuante. Duke ofruar jetën e tij si flijim për mëkatin, ai do të shikojë pasardhës, do të zgjasë ditët e tij, dhe vullneti i Zotit do të ketë mbarësi në duart e tij" (Isaia 53:10). (Shiko gjithashtu Galatasve 4:4 dhe Zbulesa 13:8).

Ne gjithashtu lexojmë nga Kurani që Perëndia lejoi Jezusin për të vdekur, dhe e ngriti atë pas vdekjes. "Kur Allahu tha: "O Isa, Unë po të marr ty, po të ngris tek unë, po të shpëtoj prej atyre që nuk besuan. E ata që besuan ty do t'i ngrisë lart mbi ata që nuk besuan deri në ditën e kijametit..." (Sura 3:55). Fjala "unë po të marrë ty", në gjuhën origjinale arabe është "Inni mutawaffiika", që nënkupton "Unë do bëj të vdesësh". Ky varg konfirmon qartë që ishte Perëndia ai që lejoi vdekjen e Jezusit.

“TEORIA E ZËVENDËSIMIT”

Në përgjithësi, dijetarët myslimanë besojnë që Jezusi që zëvendësuar derisa u ballafaqua me arrestin dhe vdekjen. Ata besojnë që Perëndia ndryshoi fytyrën e një tjetri për të bërë të duket si Jezusi. Ashtu që kur judenjtë dhe romakët erdhën për ta arrestuar Jezusin, ata menduan që e arrestuan dhe e kryqëzuan gabimisht. Shumë prej dijetarëve myslimanë besojnë që mu në momentin e zëvendësimit, Jezusi e ngriti trupin e tij në qiell. Vëreni që dijetarët myslimanë nuk pajtohen lidhur me identitetin e personit që supozohet të ketë zëvendësuar Jezusin.

“Teoria e zëvendësimit sfidohet:

Dijetarët myslimanë e bazojnë besimin e tyre në teorinë e zëvendësimit në këtë varg të paqartë që citon: “...por atyre u përngjau...” (S. 4:157). Një dijetar i krishterë E.E. Elder komenton rreth këtij vargu dhe qartëson:

“Nuk përmendet ndonjë substituum këtu, apo në ndonjë vend tjetër në Kuran. Duket qartë që nuk mund ‘t’i referohet Jezusit”. Me siguri i referohet një gjëje tjetër që nuk përmendet. Tani fraza do të mund të përkthehej: ‘që një mosmarrëveshje, një hutim mes tyre’. Në këtë rast do të mund të nënkuptohej për kryqëzimin e tij. Ky varg do të mund të përkthehej në mënyrë të duhur, ‘ata nuk e mbytën as nuk e gozhduan - por kjo (kryqëzimi i Jezusit) u bë një mosmarrëveshje për ta’. Kryqëzimi i tij i hutoi ata. Ata e panë këtë ngjarje, por dështuan ta çmojnë qëllimin e brendshëm të tij. Ata përveç kësaj menduan që kishin fuqi mbi jetën e tij.”¹ Andaj, nuk është e mundur për të arritur një konkluzion përfundimtar lidhur me këtë varg të vetëm dhe të dyshimtë në Kuran. Një mënyrë e mundur për të interpretuar s. 4:157-158 është që judenjtë (mosbesues) deshën që kryqëzimi ta turpëronte Jezusin në sytë e botës. Talljen që ai do të vuante do ta shkatërronte atë pastaj në zemrat dhe sytë e njerëzve. Gjithashtu, vdekja e tij do ta bënte të pavlefshëm misionin e tij. Sidoqoftë, judenjtë dështuan të arrijnë qëllimin e tyre. Përkundrazi, përmes kryqëzimit, emri dhe personi i Jezus Krishtit u madhështua kur Perëndia e ngriti për të qenë me të. Në mënyrë ironie, kur Satani (përmes judenjve mosbesues) e vrau Jezusin, Perëndia Atë e lartësoi Krishtin. Në Ungill, lexojmë që në kryq Jezusi “zhveshi pushtetet dhe principatat, ua tregoi sheshit njerëzve, duke ngadhënjyer mbi ata në të.” (Kolosianëve). Përsëri, kryqëzimi në fakt e përmbushi planin e Perëndisë. Perëndia korri fitore në kryq duke e ngritur Jezusin nga të vdekurit!

“Teoria zëvendësimit” ekzaminohet:

Jo vetëm që mësimet e Kuranit lidhur me kryqëzimin janë të shkurta dhe të paqarta, por teoria e substituumit nuk mund të pranohet në vete në baza morale dhe logjike. Ju lutem merrni në konsideratë:

- Ç’Perëndi do të merrte një soditës të pafajshëm për t’ia ndërruar pamjen e tij që të dukej si Jezusi me qëllim që të jetë subjekt i arrestit dhe kryqëzimit në vend të Jezusit? “Teoria e substituumit” e portretizon Perëndinë të fajshëm për keqpërfaqësimin e një personi me një tjetër, që është çorientuese dhe e pandershme. E dimë që Perëndia nuk gënjen.
- Pse duhet një i pafajshëm për një krim të madh të vuaj kryqëzimin? Pse do të lejonte Perëndia një Zëvendësues i pafajshëm të vritej? Ai nuk ka qenë i detyruar t’u jipte judenjve dikë tjetër për t’u kryqëzuar. Kjo nuk përkon me karakterin e dashur, të drejtë dhe të mëshirshëm të Perëndisë.
- Disa myslimanë besojnë që kryqëzimi ishte një mënyrë e Perëndisë për ta shpëtuar Jezusin. Sidoqoftë, nëse motivi i Perëndisë ishte thjesht për ta shpëtuar Jezusin, ai do të

mund të demonstronte fuqinë e tij duke e përdorur një mrekulli më pak të komplikuar duke mos e përfshirë agoninë e kryqit, siç mund të jetë një ndërhyrje engjëlllore.

- Bazuar në mësimet e Kuranit dhe të Biblës, Jezusi do të mund të shpëtonte veten e tij sepse kishte aftësinë e njohjes së të padukshmes dhe fuqinë për të ngritur të vdekurit. Ai ishte i aftë të manifestonte mrekulli të papara, dhe ishte në shoqëri të vazhdueshme të Shpirtit të Shenjtë.
- Ungjilli përshkruan fjalët e Jezusit edhe në kryq. Të gjitha këto vargje konfirmojnë se personi në kryq do të mund të ishte vetëm Biri i Perëndisë. Një shembull i tillë është lutja e Jezusit për armiq të tij në Lukën 23:34: “O Atë, fali ata sepse nuk dinë ç’bëjnë.” A mund të imagjinoni një person të varur në kryq me qëndrim falës kundrejt atyre që po e kryqëzonin? Vetëm shërbëtori i shenjtë dhe i përlulur Jezus mund ta bënte këtë.
- Ç’Perëndi do të lejonte Marinë, nënën e Jezusit, të vuante në një mënyrë të tillë? Sepse ata qëndruan tek kryqi duke vështruar agoninë e një personi të cilët ata menduan të ishte Jezusi (Gjoni 19:25-27). A do të lejonte Perëndia ndjekësit e tij të kalojnë nëpër një eksperiencë torturuese për shkak të një iluzioni që ai vetë e kishte orkestruar?
- Bazuar në mësimet e Kuranit dhe Biblës lidhur me karakterin e pastër të Krishtit, ai nuk do të lejonte kurrë (edhe Judën) të merrte vendin e tij në kryq dhe të vuajë pasojat e misionit dhe të mësimt të tij.
- Si mund t’i injorojmë dëshmitë e dishepujve dhe ndjekësve të tij që e dëshmuar kryqëzimin? Ata e panë dhe besuan se Jezusi u kryqëzua? Dhe konsideroni këtë që shumica e dishepujve vdiqën me një vdekje martire sepse proklamuan që Jezusi vdiq në kryq dhe u ngjall nga të vdekurit. A do të dorëzonin jetën e tyre për të përkrahur një ngjarje të cilën e dinin të ishte gënjeshtërt?
- Më tepër se 1,5 miliardë njerëz në mbarë botën e bazojnë tregimin e tyre në historikun e kryqëzimit dhe të ringjalljes së Jezusit!

Mik i nderuar, a është e logjikshme për të besuar se Perëndia do të lejonte themelin e besimit të krishterë të bazohet në një keqidentifikim të cilën vetë Perëndia e orkestroj? Kjo është si të thuash se personi në kryq nuk është Jezusi. Një teori e tillë do të bënte Perëndinë autor të gënjeshtërsisë më të madhe në historinë e njerëzimit. Kjo nuk mund të qëndrojë. Për nga natyra, ai është një Perëndi i shenjtë dhe i drejtë që bën vetëm atë çfarë është e drejtë! (1Pjetri 1:15).

Islami nuk e mohon kryqëzimin:

Kërkoj nga ju, ju lutem, të njihni mik i nderuar, që *Islami nuk e mohon kryqëzimin, sikurse njerëzit zakonisht mendojnë.*

Sipas mësimet të dijetarëve myslimanë dihet se:

- Islami e pranon që judenjtë e komplotuan kryqëzimin e Jezusit.
- Islami e pranon që Jezusi ishte prezent në të Premtën e Mirë dhe që judenjtë kërkonin ta arrestonin atë.
- Islami e pranon faktin që personi i arrestuar iu shfaq judenjve të duket njëjtë si Jezusi, dhe personi që vdiq në kryq ishte i njëjtë si Jezusi. Secili që ishte në kryqëzim e njohën atë të jetë Jezusi.

E vetmja pjesë e kësaj ngjarje që Kurani e mohon është se personi që vdiq në kryq ishte në fakt Jezusi!

Besime të ndryshme myslimane lidhur me vdekjen e Jezusit:

Në vështrim të s. 4:157-158, dhe vargjeve tjera të shumta në Kuran, shumica e dijetarëve myslimanë besojnë që Jezusi nuk vdiq fare, porse Perëndia e ngriti atë lartë fizikisht në qiell, se u ngrit i gjallë në qiell. Ata besojnë se kjo është mënyra se si përfundoi jeta e Jezusit në tokë. Disa dijetarë të tjerë myslimanë të respektuar nuk pajtohen me këtë. Ata cekin që s. tjera në Kuran përshkruajnë vdekjen natyrore të Jezusit. Një prej vargjeve të tilla është S. 19:33, që e

diskuton vdekjen e Jezusit mjaft qartë. Në këtë varg, Jezusi tha: “Selami (shpëtimi) është me mua ditën kur u lindi, ditën kur të vdes dhe ditën kur do të dal i gjallë.” Sipas interpretimit të këtyre dijetarëve myslimanë, ky varg zbulon që Jezusi do të vdesë para se të sillet përsëri në jetë.

Siç shihet, ekzistojnë dy pikëpamje muslimane të papajtueshme. Derisa Kurani në mënyrë frekvente i referohet vdekjes së Jezusit, vargjet tjera raportojnë që ai u ngrit në qiell pa vdekur fare. Disa dijetarë myslimanë në përpjekje të pajtimit të këtyre pikëpamjeve mësojnë që Krishti do të vijë një ditë në këtë botë, e të bëjë shumë gjëra të mëdha dhe të mrekullueshme, dhe pastaj të vdesë. Vështirësia kryesore me këtë mësim është se askund në Bibël nuk thuhet se Jezusi do të vdesë në këtë kohë!

Vëreni që vargjet tjera në Kuran të cilët diskutojnë vdekjen e Jezusit e përdorin kohën e kaluar, duke dhënë diçka që tashmë kishte ndodhur. Për shembull, ne lexojmë një varg identik në s. 19:15 për Jahjanë (Gjon Pagëzuesin): “Selami (paqa) atij ditën kur u lind, ditën kur do të vdes dhe ditën kur do të ngritet i gjallë!”

Është fakt i njohur që Jahja vdiq dhe u varros. Dhe referenca e të qenurit të “kthyer në jetë përsëri” i referohet Ditës së Ringjalljes. Abdullah Jusuf Aliu komenton lidhur me këtë varg: “Kjo është folur sikurse në kohën e Jahjasë. Paqa dhe bekimet e Allahut ishin mbi të kur u lind ai; ato vazhduan kur ai ishte gati për të vdekur në një vdekje të padrejtë në duart e tiranëve, dhe ato do të manifestohen në mënyrë të veçantë në Ditën e Ringjalljes.”² Prandaj, bazuar në domethënien e vargut paralel, Jezusi vdiq në të njëjtën mënyrë.

Dijetari mysliman A.H. Obaray gjithashtu komenton rreth s. 19:33. Ai beson që Jezusi vdiq dhe nuk do të kthehet të vdesë. Ai shkruan: “Asnjë mysliman nuk do të ndryshojë vdekjen e Gjonit në të ardhmen. Të gjithë e din që Gjoni vdiq... Meqë asnjë nuk mund të ndërrojë vdekjen e Gjonit në të ardhmen, asnjë nuk mund të ndërrojë gjithashtu vdekjen e Jezusit në të ardhmen. Në fakt nuk ekziston asnjë varg i vetëm në tërë Kuranin të dëshmojë që Jezusi do të kthehet për të vdekur. Deklarata paralele me nderim të Gjonit i cili vdiq, dëshmon qartë që Jezusi vdiq gjithashtu.”³

Vargje tjera të tilla që flasin për vdekjen natyrore të Jezusit përfshijnë s. 3:55 dhe s. 5:117, që thotë, “... pasi që më morre mua...” Përkthime tjera të këtij vargu të Kuranit lexojnë “më more pranë vetës sate” dhe “bëre që të vdesë” (tawaffaitani).

Shprehja “tawaffaitani” sqarohet nga Dr. Mahamut Shaltut, president i fundit i Universitetit “Al Azhar”.⁴ “Jepet e drejta në këtë varg të pranohet kuptimi i vdekjes së zakonshme... nuk ekziston ndonjë mënyrë të interpretojmë ‘vdekjen’ si diçka që do të manifestohet pas kthimit të tij nga qielli... sepse vargu qartë e kufizon lidhjen me Jezusin... me njerëzit e tij në ditën e tij dhe lidhja nuk është me njerëzit që do të jetojnë në kohën kur ai do kthehet...”⁵ Shumë myslimanë tronditen me këtë varg që i referohet vdekjes së Jezusit.

Teori të ndryshme muslimane lidhur me vdekjen e Jezusit:

Abdullah Jusuf Aliu komentoi rreth s. 4:157; e cila thotë: “Por ata as nuk e mbytën as e gozhduan...” Aliu tha: “Fundit i jetës së Jezusit në tokë është aq tepër i përfshirë në shërbesë sa edhe lindja e tij.”⁶ Dhe lidhur me s. 4:55 e cila thotë: “Përkundër, Allahu e ngriti atë pranë vetës”, Aliu shkruan: “Ekziston një diferencë mes opinioneve për sa i përket interpretimit ekzakt të këtij vargu. Fjalët janë: “Judenjtë nuk e mbytën Jezusin, por Allahu e ngriti atë pranë vetës.” Një shkollë e mban atë që Jezusi nuk ka pasur një vdekje të zakonshme njerëzore, por edhe më tutje jeton në trup në qiell, që është një pikëpamje në përgjithësi e pranuar nga myslimanët. Të tjerët përkrahin atë që ai me të vërtetë vdiq, por jo në kohën kur kishte për t’u kryqëzuar, dhe ajo që “ai u ngritë” pranë Allahut nënkupton që në vend të të qenit i turpëruar si keqbërës, sikurse hebrenjtë tentuan, në të kundërtën u lartësua nga Allahu si dërgues i tij...”⁷

Dijetarë të ndryshëm myslimanë si Zamakshari, Ibn Abbas, dhe të tjerët flasin që ai qëndroi i vdekur për disa orë para se të ngritej në qiell. Maududi, një dijetar mysliman modern në Pakistan, komenton rreth s. 4:157: “Pas kësaj, Perëndia që mund të bëjë gjithçka dhe çdo gjë që

dëshiron, e ngriti Jezusin pranë vetës duke e shpëtuar nga kryqëzimi, dhe ai që ishte kryqëzuar pastaj ishte marrë në ndonjë mënyrë për Krishtin.”⁸ Vëreni paqartësinë e këtoq qëndrimi.

Daryabadi, një teolog tjetër i përmendur pakistanez thotë: “Nuk ishte Jezusi ai që u ekzekutua por një tjetër, ai që zëvendësuar në mënyrë mbinatyrore (si dhe në çfarë mënyrë është pyetje tjetër, dhe nuk preket nga Kurani) për të.”⁹ Ky qëndrim lidhur me kryqëzimin është gjithashtu i paqartë.

Kurani nuk e zhvlerëson ngjarjen biblike:

Për shkak të vargjeve të paqarta, të kufizuara dhe dukshëm kontradikore të Kuranit, shkollarët myslimanë janë të pasigurtë lidhur me përfundimin e jetës së Jezusit në tokë. Ata nuk pajtohen lidhur me atë nëse ai vdiq në tokë apo u ngriti i gjallë në qiell pa vdekur fare. Pasi këta dijetarë nuk kanë dëshmi definitive apo informacione specifike lidhur me rrethanat e kryqëzimit, konkluzionet e ndryshme të tyre përfshijnë spekulime dhe teori. Andaj, lexues i nderuar, meqë ekziston një konfuzion në mes shkollarëve myslimanë lidhur me vdekjen e Jezusit, islami e lejon mundësinë që ngjarja biblike të jetë e saktë. Siç u përmend më herët, islami e pranon dhe e njeh Biblën si burim primar të ndriçimit, e dhënë qartë në s. 10:94. Tani le të kalojmë në kapitullin tjetër dhe le të ekzaminojmë dëshminë biblike të kryqëzimit dhe ringjalljes së Jezusit.

KAPITULLI 21

KRYQËZIMI DHE RINGJALLJA E KRISHTIT SIPAS UNGJILLIT

Të gjitha ngjarjet e përshkruara në Bibël janë specifike dhe konsistente lidhur me këtë temë. Krishti që kryqëzuar, ai vdiq, dhe u ngriti nga të vdekurit.

Besimet themelore të krishterimit:

Për shkak të dëshmisë së qartë të Biblës lidhur me këto fakte, përreth dy mijë vjet të gjithë besimtarët e vërtetë të krishterë kanë besuar në kryqëzimin, vdekjen dhe në ringjalljen e Jezus Krishtit. Për shembull, apostulli Pjetri, duke iu folur judenjve pas shërimit të personit të çalë, guximshëm tha: “Le ta njihni të gjithë ju dhe mbarë populli i Izraelit se kjo u bë në emër të Jezus Krishtit Nazareanas, që ju e kryqëzuar dhe që Perëndia e ringjalli prej së vdekuri; me anë të tij ky njeri del para jush i shëruar plotësisht.” (Veprat 4:10).

Tek Gjoni 10:20 dhe Gjonin 17:1, për kryqëzimin u fol si për një “orë” të rëndësishme për të cilën Krishti erdhi. Misioni i Krishtit që për të vdekur në kryq si një sakrificë përfundimtare dhe e përsosur, një herë për të gjithë! Tek Luka 18-31-34, Jezusi u paralajmëron dishepujve të tij vdekjen dhe ringjalljen e tij: “Ja ne po ngjitemi në Jerusalem dhe të gjitha ato që shkruan profetët për Birin e njeriut do të përmbushen. Ai, pra do t’iu dorëzohet paganëve, do të fyhet e do të poshtërohet dhe do ta pështyjnë. Dhe, pasi ta fshikullojnë, do ta vrasin, por ai do të ringjallet të tretën ditë.”

PROFECITË E DHIATËS SË VJETËR LIDHUR ME KRYQËZIMIN E JEZUSIT

Ndonëse Dhiata e Re ishte shkruar pas kryqëzimit dhe përmban detaje lidhur me të, Dhiata e Vjetër ishte shkruar me qindra vjet para kryqëzimit dhe përmban profeci të mahnitshme rreth saj. Dy nga këto profeci specifike gjenden tek Isaia 53 dhe Psalmi 22, me sa vijon:

Vdekja dhe varrimi i Jezusit:

Isaia 53:9 na ofron detaje specifike shumë më herët se vdekja e Jezusit: “Kishin caktuar ta varrosnin bashkë me të pabesët, por kur vdiq e vunë me të pasurin...” Askush në kohën e Isaisë nuk mund të kuptonte domethënien e kësaj profecie. Nuk kishte aspak kuptim në vlerën njerëzore. Përshkrimi i varrimit të tij dukej të ishte një kontradiktë. A ishte varrosur me të pabesin apo ishte varrosur me një person fisnik dhe të pasur? Të dy qëndrimet e menduara kontradiktore lidhur me vdekjen e Jezusit në Isainë 53:9 u përmbushën. Së pari, Jezusi “ishte caktuar të varroseq bashkë me të pabesët” e përmbushi pjesën e parë të profecisë, meqë qe kryqëzuar midis dy vjedhësve. Dhe, sipas ligjit romak, kriminelët që kryqëzoheshin “cakttoheshin” për t’u hedhur në gropë që të digjeshin. Megjithatë, kjo nuk ndodhi me Jezusin. Pjesa e dytë e profecisë u përmbush kur Jezusi u varros në varrin e Jozefit nga Arimatea. Në Ungjill, tek Mateu 27:57-60 lexojmë: “Edhe si u ngrys, erdhi një njeri i pasur nga Arimatea, me emër Jozef, i cili ishte edhe vet dishepull i Jezusit. Ai shkoi tek Pilati dhe i kërkoi trupin e Jezusit. Atëherë Pilati dha urdhër që t’ia dorëzonin trupin. Dhe Jozefi, mbasi e mori trupin, e mbështolli me një pëlhurë të pastër, dhe e vendosi në varrin e vet të ri, që ai e kishte hapur në shkëmb; pastaj rrokullisi një gur të madh në hyrje të varrit dhe u largua.” Andaj, ajo çfarë u mendua të jetë një paradoks i pasqaruar në Isainë 53, u kuptua lehtë kur Jezusi erdhi dhe e përmbushi profecinë!

Ndarja e rrobave të Krishtit (Psalmi 22:18):

Një profeci tjetër lidhur me vdekjen e Krishtit mund të gjendet në Psalmin e Davidit 22:18 që përmban fjalët e Jezusit. Citojmë: “Ndajnë midis tyre rrobat e mia dhe hedhin short tunikën time.” Ky varg ishte misterioz dhe një enigmë për njerëzit në atë kohë. Dukej që profecia përmbante kontradiktë në vete. A i ndanë rrobat në mes tyre, apo hodhën short për të shikuar kush është fitues i rrobave?

Përmbushja e profecisë u dokumentua në Ungjillin e Gjonit 19:23-24. Kur ushtarët e kryqëzuan Jezusin, i morën rrobat e tij, i ndanë në katër pjesë, nga një për çdonjërin prej tyre. Por tunika ngeli. Ishte pa tegel dhe e thurur në një pjesë nga lart poshtë. Si rezultat, ushtarët i thanë njëri - tjetrit: “Le të mos e grisim, por të hedhim short kujt t’i bjerë.” Pastaj hodhën short për të shikuar se kush do ta fitojë. Kjo ndodhi që shkrimi i cili thotë “Ndajnë midis tyre rrobat e mia dhe hedhin short tunikën time” të përmbushet. Prandaj, kjo është çfarë ushtarët vepruan. Kjo profeci misterioze e Psalmi 22:18 që sqaruar dhe e përmbushur në letër, në këmbët e kryqit. Ekzistojnë edhe shumë detaje tjera të imta në këta dy kapituj profetikë. Psalmi mesianik 22, i njohur edhe si “Psalmi i kryqit”, ishte përshkruar 800 apo më tepër vjet para ardhjes së Krishtit. Dhe Isaia 53, e shkruar 700 apo më tepër vjet para Krishtit konsiderohet të jetë njëra prej shkrimeve më të thella teologjike përsa i përket torturave fizike të Jezusit dhe vdekjes zëvendësuese për ne.

Rastësisht, judenjtë të cilët e mohuan dhe nuk e pranuan Jezusin si Bir i Perëndisë dhe Shpëtimtar (në shekullin e parë në një çast kritik në historinë e religjionit të tyre), nuk guxuan t’i fshijnë asnjë nga profecitë e shumta mesianike nga shkrimet e tyre të shenjta që u përmbushën në Jezusin. Prandaj, si mund të dyshojnë për ndryshimin e saj kur 600 vjet më vonë islami u shfaq në skenë.

Historiku i kryqëzimit:

Kryqëzimi i Jezusit është një ngjarje mirë e vërtetuar në histori. Historianët modern pajtohen se Jezusi ishte një karakter historik i cili qe kryqëzuar. Edhe një prej shkrimtarëve më të njohur myslimanë në historinë e Egjiptit (i cili jetoi në shekullin e 19), Abas Mahmud Al Akad, shkroi një libër rreth jetës së Krishtit, në të cilën ai konfirmonte se ne mund të bazohemi në katër

Ungjijtë (librat e Mateut, Markut, Lukës dhe Gjonit) si një dëshmi historike për të kuptuar ç'ndodhi në jetën e Jezusit.¹

Përsëri, nuk është rationale për të besuar pohimin, bërë 600 vjet pas kryqëzimit të Krishtit, që personi i kryqëzuar nuk ishte Krishti por një person i ngjashëm i zëvendësuar për të. Një analogji mund të ishte nëse një person do të vinte pas qindra vjetëve prej tani dhe t'i tregonte botës që personi i vvarë në Amerikë në shekullin e njëzet nuk ishte Martin Luter Kingu, por një një tjetër i cili dukej në mënyrë ekzakte si ai. Mbase kryqëzimi i Krishtit është i dokumentuar historikisht dhe përkrahur nga shumë dëshmitarë okularë. Për më tepër, në qoftë se përshkrimet biblike dhe përshkrimet tjera historike të kryqëzimit janë të pavërteta, ne do të prisnim nga Kurani të ketë shumë vargje dëftuese se Jezusi nuk ka vdekur në kryq. Sidoqoftë, e vërteta e mrekullueshme është se nga 6000 apo më tepër vargje kuranore, nuk ekziston asnjë ajet që tregon qartë se Jezusi nuk ishte kryqëzuar, mirëpo as edhe një varg nuk dëfton se Ungjilli ishte jokorrekt në këtë pikëpamje.

Jezusi një shembull perfekt i asaj çfarë fjala “mysliman” nënkupton:

Kryqëzimi i Jezusit e demonstroi në fakt kuptimin e fjalës “mysliman”. Fjala “mysliman” nënkupton personin i cili nënshtrohet. Jezusi iu bind Perëndisë Atë gjer në fund. Jezusi e nënshtroi veten e tij vullnetit të Atit të tij (e dërgoi atë deri në kryq për t'u sakrifikuar), njëjtë sikurse biri i Abrahamit iu nënshtroi vullnetit të atit të tij. Kryqëzimi i Jezusit paraqet një nënshttrim ultimativ ndaj vullnetit të Perëndisë! Me përvetësimin, ne të krishterët e shohim kryqëzimin e Krishtit si një arsye për t'ia dhënë nderin më të lartë Jezusit, i cili vullnetarisht e mori vendin tonë dhe dënimin në kryq (Hebrenjve 12:2). Gjithashtu qëndrojmë në respekt ndaj fuqisë që e ngriti Jezusin nga të vdekurit dhe në realizimin e shpëtimit tonë! Lidhur me kryqëzimin, Kurani i injoron jo vetëm përshkrimet e Mateut, Markut, Lukës dhe Gjonit, por edhe të Dhiatës së Re. Gjithashtu dijetarët myslimanë nuk i përfillin as dëshmitë historike. Në anën tjetër, ekzistojnë shkrime të shumta jokrishtere që nga koha e Krishtit që e kanë diskutuar Krishtin dhe kryqëzimin e tij si një fakt historik.

Përshkrimet e historianit hebre Jozefi (37-100 pas Krishtit):

Jozef ben Matias, që një historian jude i lindur në një familje priftërore, që rrjedhte nga linja mbretërore e Judës. Ai u bë një farise i përkushtuar në studimin e ligjit të Perëndisë, dhe qytetar romak i quajtur “Flavius Jozefus”. Jozefi jetonte në një pjesë të Jerusalemit. Ai pastaj kishte hyrje në informatat e dorës së parë. Ai e dokumentoi historinë dhe traditën hebreje për Romën.² Ai s'kishte marrëdhënie me të krishterët, që i quanin atëherë sektë, nuk kishte arsye për që të fabrikonte përshkrimet e tij. Prapavija dhe kualifikimet e tij i bëjnë valide shkrimet dhe dokumentimet objektive në jetën e Jezusit (p.sh vdekja dhe kryqëzimi i tij). Lidhur me Jezus Krishtin, Jozefi shkroi:

“Tani, ekzistonte gjatë kësaj kohe një person i quajtur, Jezus, nëse mund ta quaj njeri, sepse ishte bërës i veprave të mrekullueshme... mësuës i personave të tillë që e pranonin të vërtetën me kënaqësi. Ai tërhoqi pas tij shumë prej judenjve, dhe shumë prej të huajve. Ai ishte “Krishti”; dhe kur Pilati nën supozimin e krerëve në mesin tonë, e dënoi atë në kryq, ata që e deshën atë në fillim nuk e braktisën atë, sepse ai iu shfaq atyre i gjallë në ditën e tretë, sikurse që profetët hyjnorë e kishin paralajmëruar këtë... dhe fisi i krishterëve, i ashtuquajtur përmes tij, nuk është i zhdukur në këtë ditë.”³

Jozefi kishte qasje ndaj individëve (të krishterë dhe jo të krishterë) që ishin dëshmitarë okularë ndaj ngjarjeve që e rrethonin jetën, vdekjen dhe ringjalljen e Jezus Krishtit. Si një historian modern i ditëve të tij, ai ishte përgjegjës për faktet e raportuara në shkrimet e tij. Raportet e tij qenë nën shqyrtimin e hollësishëm të fraksioneve diametralisht të kundërta. Gjer në këtë ditë, ai konsiderohet të jetë një historian me reputacion. Jozefi gjithashtu dokumentoi

përshkrimet e individëve që vërejtën mrekullitë e Jezusit, mësimet e tij, arrestin, gjykimin, dhe kryqëzimin dhe ringjalljen e tij.

JEZUSI U KTHYE PRAPA NGA VDEKJA!

Dishepujt e Jezusit besuan në ringjalljen e tij, sepse e panë atë të gjallë pas vdekjes së tij nëpërmjet kryqëzimit. Një përshkrim i ringjalljes së Jezusit gjendet në shkrimet pasuese të Mateut: “Por engjëlli duke iu drejtuar grave, u tha atyre: “Mos kini frikë, sepse unë e di se ju kërkonte Jezusin, që u kryqëzua. Ai nuk është këtu, sepse u ringjall, sikurse kishte thënë; e jani, shikoni vendin ku qe vënë Zoti. Shkoni shpejt t’u thoni dishepujve të tij se ai u ringjall së vdekuri; dhe ja, po shkon përpara jush në Galile; atje do ta shihni; ja, jua thashë.” (Mateu 28:5-7).

Qindra dëshmitarë e vërejtën Krishtin e ngritur pas një periudhe përgjatë katërdhjetë-pesëdhjetë ditëve nga ringjallja e tij, në lokacione dhe kohë të ndryshme (Luka 24:34-40; Gjoni 20:26-28; Veprat 1:3). Për shembull, Jezusi ishte parë me trupin e tij të ringjallur një herë nga më shumë se 500 veta. (1Korintasve 15:1-6) Ju lutem shikoni përshkrimet tjera të ringjalljes së Jezusit tek Gjoni 20:10-18 dhe 21:1-23; Marku 16:9-13.

Dy profesorë të besuar flasin në kuadër të dëshmime historike:

Profesor Thomas Arnold, pronar i Universitetit Rugby, autor i *Historisë së Romës* dhe udhëheqës i katedrës së Historisë Moderne në Universitetin e Oxfordit, ishte mirë i pajisur për të vlerësuar dëshmitë lidhur me përcaktimin e fakteve historike. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të dokumentacioneve antike të kryqëzimit dhe ringjalljes së Krishtit, ky dijetar modern dhe i respektuar në ditët tona, shkroi: “Kam punuar shumë vjet për të studiuar historitë e kohëve të kaluara dhe për të shqyrtuar dhe për të peshuar dëshmitë e atyre që shkruan lidhur me to. Nuk di për asnjë fakt në historinë e njëzimit që është vërtetuar me dëshmi më të mira dhe më të plota të çdo lloji, për të kuptuarit e një hetimi të drejtë, sesa një shenjë të madhe që Perëndia na ka dhënë se Krishti vdiq dhe u ngrit përsëri nga të vdekurit.”⁴

John Singleton Copley, profesor në Universitetin e Kembrixhit (dhe gjeneral i lartë i Britanisë së Madhe në vitin 1824), arriti në zyrën më të lartë si gjykatës në Angli. Ai ishte i njohur si një prej mendjeve më të mëdha legale në historinë e Britanisë. Pas vdekjes së tij, një dokument ishte gjetur në mes letrave të tij private në të cilën kishte shkruar: “Unë e di mjaft mirë çfarë dëshmie është dhe prandaj ju them, një dëshmi e tillë sikurse e ringjalljes nuk është thyer asnjëherë deri tani.”⁵

Historiku i ringjalljes:

Vëreni që disa fakte janë të padiskutueshme edhe nga historianët sekularë. Ato përfshijnë:

- Jezusi Krishti qe kryqëzuar.
- Varri i Jezusit ishte i thatë pas varrimit të tij.
- Qe një proklamim i Pashkës lidhur me ringjalljen e Jezusit.

Bazuar në Ungjill, pasi që Jezus Krishti vdiq nëpërmjet kryqëzimit, trupi i tij ishte tërhequr poshtë dhe qe shtrirë në varrin e Jozefit nga Arimatea. Një gur i madh me peshë në mes një dhe dy tonë qe vendosur në hyrje të varrit, dhe vula romake qe vendosur në atë gur. Gardianët e mirëtrajnuar romakë u kujdesën për varrin. Tre ditë më vonë, varri ishte i zbazur. Pas arrestit të Jezusit, dishepujt e tij qenë të frikësuar dhe u fshehën (Mateu 26:56). Sidoqoftë, brenda disa

ditëve pas ringjalljes, i njëjti grup u inkurajua mjaft. Ky transformim ndodhi jo vetëm që ata e vërejtën varrin bosh, por sepse ata e soditën dhe e përjetuan Krishtin e ngritur.

Kredibiliteti i dishepujve të Jezusit:

Nëse ndokush do pyeste, “A gënjen këta dishepuj?”, përgjigjja do të ishte e thjeshtë. Çfarë do të mund të përfitonin nga proklamimi i asaj se Jezusi u ngrit dhe që ata e vërejtën atë të gjallë? Prestigji? Pasuria? Përveç kësaj ata vdiqën me vdekje martire, të gjithë përveç njërit. Sipas një dokumenti të përshkruar: Juda dhe Simeoni u kryqëzuan; Lukën e varën në një lis ullinjësh; Palit i ishte prerë koka; Filipi qe fshikulluar dhe kryqëzuar; Jakobi (biri i Zebedeut) qe vrarë me shpatë; Marku ishte zvarritur nëpër rrugë nga këmbët e tij dhe pastaj digjet për së gjalli; Jakobi (gjysëm vëllai i Jezusit) dhe Barnaba qenë gurëzuar në vdekje. Ky trajtim ishte “shpërblimi” i tyre tokësor për proklamimin e Lajmit të Mirë: Jezusi është ngritur; Ai është i gjallë; Ai ofron faljen e mëkateve, dhe Ai dhuron jetën e përjetshme atyre që besojnë në të!

PJESA E TETË

NGRITJA DHE KTHIMI I JEZUS KRISHTIT

KAPITULLI 22 NGRITJA E JEZUSIT

Ngritja e Jezusit citohet në Kuran dhe sqarohet mirë në Bibël.

Ngritja e Jezusit sipas Kuranit:

Është e qartë nga disa vargje në Kuran se Jezusi qe ngritur për të qenë me Perëndinë dhe është i gjallë sot. Për shembull, S. 4:158 citon: “Allahu e ngriti atë pranë vetës...” Përveç kësaj, ekzistojnë shumë hadithe që e mbështesin ngritjen e Jezusit. Përgjithësisht, bota myslimane beson që Perëndia e ngriti Jezusin në qiell fizikisht dhe se u ngrit i gjallë në qiell.

Ngritja e Jezusit sipas Biblës:

Ungjilli përshkruan ngjitjen e Jezusit në Markun 16:19: “Zoti Jezus, pra, mbasi u foli, u ngrit në qiell dhe u ul në të djathtë të Perëndisë.” Shikoni përshkrimet e ngritjes edhe në Lukën 24:49-53 dhe Veprat 1:9-11, 7:55-56.

Krahasimi i doktrinës së tillë në Kuran dhe në Bibël:

Ne vërejmë se edhe Kurani dhe Bibla mësojnë se Jezusi u ngrit jo vetëm në qiell, por në të vërtetë në prezencën përfundimtare të Perëndisë. Kurani dhe Bibla pajtohen në faktin që Jezus Krishti është i gjallë deri në ditë të sotit.

Qëllimi i ngritjes sipas dijetarëve myslimanë:

Me gjithë këtë, përkundër fakteve biblike, arsyeja pse shumë dijetarë myslimanë i japin rendësi ngritjes së Jezusit është se Perëndia e ngriti Jezusin pranë vetës së tij për ta shpëtuar atë nga kryqëzimi i judenjve. Përsëri, është vështirë për ta pranuar teorinë që “Perëndia e ngriti atë pranë vetës” (S. 4:158) vetëm si një mënyrë shpëtuese nga duart e judenjve. Para se gjithash, Perëndia do të mund të shfrytëzonte një mënyrë më pak agresive për të shpëtuar Jezusin. Një shembull është Ungjilli sipas Mateut 2:13: “Një engjëll i Zotit iu shfaq në ëndërr Jozefit dhe i tha: “Çohu, mer fëmijën dhe nënën e tij dhe ik në Egjipt, dhe rri aty deri sa të të lajmëroj, sepse Herodi do ta kërkojë fëmijën për ta vvarë.” Për më tepër, Jezusi do të mund të shpëtonte veten e tij nga duart e judenjve po të dëshironte. Sepse sipas Biblës (dhe Kurani pajtohet):

- Jezusi posedonte aftësinë për ditur të panjohurën (S. 3:49).
- Jezusi posedonte aftësinë e bërjes së mrekullive (S. 5:110).
- Jezusi posedonte aftësinë për të ngritur të vdekurit (S. 3:49 dhe 5:110).

Arsyeja e ofruar nga dijetarët myslimanët nuk është i mjaftueshëm për të sqaruar faktin që Perëndia zgjodhi për t’u kënaqur me prezencën e Jezusit për gati 2000 vjet nga vdekja dhe ngritja e tij. Mik i nderuar mysliman, përfundimi logjik është se qe dëshira e Perëndisë Atë për të ngritur Jezusin të jetë me të. Ai me siguri nuk ka qenë i detyruar ta ngrisë atë për ta shpëtuar nga “synimet vrasëse të judenjve mosbesues.”

Jezusi qëndron në qiell me Perëndinë Atë:

Kurani nuk sqaron përse Perëndia dëshironte të banojë së bashku me Jezusin në qiell dhe në lavdi për 2000 vjet e fundit. Sipas Kuranit, Jezusi qe i vetmi njeri (i vetmi profet) të ngritet nga toka në prezencën e Perëndisë. Vëreni që ky mësim na bën të habitemi. Si mundet një njeri i

thjeshtë të ngritet për të qenë me Perëndinë dhe t'i bëj ballë madhësisë, fuqisë, dhe shenjtërisë së të Gjithëpushtetshmit?

Bibla e sqaron arsyen për ngritjen e Jezusit:

Sipas Ungjillit, Jezusi është Biri i Përjetshëm i Perëndisë dhe qielli është shtëpia e përhershme e tij. Prandaj, qe e pamundur për të, pasi e përmbushi misionin e tij në tokë, të kthehet në pluhur siç u ndodhi natyrisht profetëve dhe njerëzve tjerë. Më saktë, ai u ngrit në qiell. Gjoni 6:38 përshkruan Jezusin duke e cituar misionin e tij: “Sepse unë kam zbritur nga qielli jo për të bërë vullnetin tim, por vullnetin e atij që më ka dërguar.” Në Gjoni 3:13 Jezusi foli për veten e tij, “Askush nuk u ngjit në qiell, përveç atij që zbriti nga qielli, pra, Birit të njeriut që është në qiell.” Dhe, në Gjonin 8:23 Jezusi i tha judenjve: ”Ju jeni nga këtu poshtë, kurse unë jam nga atje lart; ju jeni prej kësaj bote, unë nuk jam prej kësaj bote.”

Biri i Përjetshëm i Perëndisë kthehet në qiell:

Mbaje mend, mik i nderuar mysliman, Kurani tha në s. 4:171 se Jezusi është “shpirti që rrjedh nga Ai”. Duket që përshtatet se i vetmi ai që erdhi nga Perëndia mund të shkojë prapa për të qenë me Perëndinë. Dhe, natyrisht, ngritja e Jezusit është logjike nëse ai është Biri i përjetshëm i Perëndisë. Sipas Biblës, pasi Jezusi vdiq dhe e komplotoi veprën e tij në kryq, ai u ribashkua me Atin. Ngritja e Jezusit nënkuptoi fundin e shërbesës tokësore dhe fillimin e shërbesës së tij qiellore. Gjithashtu nënkuptonte që Perëndia e pranoi shërbesën dhe sakrificën e Jezusit në vendin tonë në tokë. Dhe i motivuar nga dashuria, “ai gjithmonë rron që të ndërmjetësojë për ta.” (Hebrenjve 7:25)!

Mik i dashur, Jezus Krishti pa dyshim është më i lartë se të gjitha krijesat e tjera. Ai është i gjallë me Atin Qielor sot! A nuk është e mrekullueshme, lexues i dashur! Natyra hyjnore e Jezusit e bën atë në shtëpi me Madhësitinë dhe Shenjtërinë e Perëndisë Atë.

KAPITULLI 23 ARDHJA E DYTË E JEZUSIT

Derisa krishterimi dhe islami ndryshojnë në detaje, së bashku e pranojnë ardhjen e sërishme të Jezusit në tokë. Kjo ngjarje referohet si “Ardhja e Dytë” e Krishtit në tokë.

Kurani përshkruan Ardhjen e Dytë të Krishtit:

Në Kuran, S. 43:61 citon: “E ai (Isai) është parashenjje e momentit (e kijametit)...” Abdullah Jusuf Ali duke komentuar këtë varg në përkthimin e tij të Kuranit tha: “Kjo i referohet ardhjes së dytë të Jezusit në Ditët e Fundit para ringjalljes kur edhe do t'i shkatërrojë doktrinën false nën emrin e tij...”¹

Sipas Kuranit dhe Biblës Jezusi do të kthehet:

Gjatë shekujve, shumica e komentatorëve myslimanë e kanë interpretuar s. 43:61 si një profeci e zbritjes së Jezusit në tokë. Është interesante, mik i dashur mysliman, për të lexuar mu për këtë ngjarje në Dhiatën e Vjetër. Danieli 7:13-14 na tregon:

“Unë shikoja disa vegime nate, dhe ja mbi retë e qiellit po vinte dikush që i ngjante një Biri njeriu; ai arriti deri te i Lashti i ditëve dhe iu afrua atij. Atij iu dha sundimi, lavdia dhe mbretëria, me qëllim që të gjithë popujt, kombet dhe gjuhët t'i shërbenin; sundimi i tij është një

sundim i përjetshëm që nuk do të kalojë, dhe mbretëria e tij është një mbretëri që nuk do të shkatërrohet kurrë.”

Ky varg tek Danieli është një profeci e qartë e ardhjes së dytë të Jezus Krishtit që konfirmohet në Ungjillin e Markut 13:26: “Atëherë do ta shohin Birin e njeriut duke ardhur në re, me pushtet të madh e me lavdi.”

Sipas teologëve myslimanë, Jezus Krishti do të kthehet nga qielli për të lajmëruar klimaksin e periudhës njerëzore dhe do të merr nën kontroll gjithë botën. Jezusi i vetmi do të lajmëroj orën e gjykimit. Ibn-Atya, një komentator i dalluar mysliman, citon që: “Teologët myslimanë janë unanimit në luftimin e asaj që Jezus Krishti është i gjallë fizikisht në qiell në kohën e tashme dhe se është i caktuar për të ardhur në këtë botë... kur afrohet dita e fundit.”² Hadithi mëson me siguri se Jezusi do kthehet nga qielli në ditët e fundit. Ekzistojnë përafërsisht rreth 70 thënie të tilla në përkrahje të doktrinës së ardhjes së Jezusit në tokë. Të gjitha këto konsiderohen të jenë të besueshmërisë së padysuar. Muhamedi tha: “Me siguri (Jezusi), biri i Marisë do të zbresë në mesin tuaj dhe do të gjykojë njerëzimin me drejtësi (si një sundimtar i drejtë).”³ Tani unë pyes, kush është në mënyrë ekzakte ky “njeri” që mund të gjykojë çdo person me drejtësi? A nuk të bën përshtypje kjo, mik i dashur?

Jezusi do ta gjykojë botën:

Është e natyrshme dhe logjike të besohet se ai i zgjedhuri që do zbresë nga qielli për të sjellur gjykimin e Perëndisë të jetë Biri i Perëndisë. Bibla mëson që Biri i Perëndisë, duke ardhur në shëmbëlltëri të njeriut, e zbuloi Perëndinë ndaj njeriut, dhe e ka sjellë njeriun ballë për ballë me Perëndinë. Ai do të kthehet për ta gjykuar botën. Jezusi vetë deklaroi: “Sepse Ati nuk gjykon asnjë, por gjithë gjyqin ia dha Birit, që të gjithë ta nderojnë Birin ashtu siç nderojnë Atin; kush nuk nderon Birin, nuk nderon Atin që e ka dërguar.” (Gjoni 5:22-23).

Jezusi vazhdon të flasë: “Sepse, sikurse Ati ka jetë në vetvete, kështu ia ka dhënë dhe Birit të ketë jetë në vetvete; dhe i ka dhënë gjithashtu autoritet të gjykojë sepse është Bir i njeriut.” (Gjoni 5:26-27). (Lexo gjithashtu tek Mateu 24:30). Kur Jezusi të vijë përsëri në tokë, do të ndriçojë me gjithë shkëlqimin e lavdisë së tij qiellore. Vëreni që përshkrimet e Ungjillit të Mateut na tregojnë një moment të lavdisë hyjnore të Krishtit kur u “shpërfytyrua” momentalisht në tokë. Në një mal të lartë (para tre dishepujve të tij) “fytyra e Jezusit shkëlqeu si dielli dhe rrobat e tij u bënë të bardha si drita.” (Mateu 17:1-13). Në harmoni me këtë zbulim, Suyuti komenton rreth s. 6:158: “Pastaj toka do të shkëlqejë me dritën e Zotit të tij dhe Jezusi, biri i Marisë, do zbresë...” Jezusi do të shfaqet nga qielli me fuqi dhe madhësi.

Në Ungjill lexojmë: “Dhe kur të vijë Biri i njeriut në lavdinë e tij, bashkë me të gjithë engjëjt e shenjtë, atëherë do të ulet mbi fronin e lavdisë së vet.” (Mateu 25:31-46). Jezusi do të jetë drita më e lavdishme që njerëzit kanë parë ndonjëherë. “Shërbëtori përvuajtës” do të kthehet si një “Mbret Ngadhënjëmtar”. Ai do t’i jep fund të keqes dhe do të sundojë me drejtësi të shenjtë!

Besimtarët e vërtetë do të transformohen në imazhin e Jezusit:

Kur do vijë përsëri, Jezusi do të transformojë të “krishterët e vërtetë” (besimtarët e vërtetë të Jezusit) në imazhin e tij, për të ndarë lavdinë e tij me ta përjetë. Për këtë fakt madhështor mund të lexohet në Ungjill: “Siç është tokësori ashtu janë edhe tokësorët; dhe siç është qiellori të tillë do të jenë edhe qiellorët. Dhe sikurse mbartëm shëmbëllimin e tokësorit, do të mbartim edhe shëmbëllimin e qiellorit.” (1Korintasve 15:48-49). Jezusi do të na jep trupa të rinj të lavdishëm, të përshtatshëm për qiell. Në ardhjen e parë të Jezusit ai e bëri veten si ne, kurse gjatë ardhjes së dytë të Jezusit ai do të na bëjë si ai. Lexojmë në Bibël:

“Por e dimë se kur të shfaqet ai, do të jemi të ngjashëm me të, sepse do ta shohim se si është ai.” (1Gjoni 3:1-3).

“Sepse qytetëria jonë është në qiejt, prej nga edhe presim Shpëtimtarin, Zotin Jezus Krisht, i cili do të transformojë trupat tonë të përunjur, që të bëhet i ngjashëm me trupin e tij të lavdishëm.”

Jezusi do t’i merr besimtarët me vete në qiell:

Mik i dashur mysliman, qëllimi i ardhjes së Jezusit në këtë botë ishte për të na shpëtuar dhe për të na dhënë jetën e përjetshme. Një pjesë e Lajmit të Mirë të Biblës është se Jezusi do t’i grumbullojë të gjithë njerëzit që besojnë në të. Një ditë madhështore vetë Zoti do të zbresë nga qielli. Atëherë do t’i bashkohemi atij dhe “kështu do të jemi përherë bashkë me Zotin.” (1Thesalonikasve 4:16-17).

Ne shikojmë përpara në ditën kur do të jemi me Jezusin. Ai na ka premtuar:

“Zemra juaj mos u tronditë, besoni në Perëndinë dhe besoni edhe në mua! Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; përndryshe do t’iu thoja. Unë po shkoj t’ju përgatis një vend. Dhe kur të shkoj e t’iu përgatis vendin, do të kthehem dhe do t’iu marr pranë meje, që aty ku jam unë, të jeni edhe ju.” (Gjoni 14:1-3).

Sipas Islamit, Jezusi do të fitojë krishtin e rreme:

Bazuar në hadithe, Krishti i rremë (“Dexhalli”) do të shfaqet para Orës së Gjykimit. Dexhalli (“mashtuesi” në arabisht) do të pretendojë të jetë Krishti. (Vëreni që Bibla e indentifikon këtë individ si Antikrishti). Ai do të shfaqë shumë mrekulli. Sipas Hadithit, Krishti i rremë do të jetë manifestimi përfundimtar i së keqes. Ai do të shkaktojë sulmin më të madh ndaj besimit kundër të vetmit Perëndi të vërtetë. Ai do të tentojë të shkaktojë dëmtimin më të madh ndaj njerëzimit. Muhamedi tha: “Nuk do të ketë asnjë krijesë (që do shkaktojë më tepër fatkeqësi) sesa Dexhalli mu nga krijimi i Adamit e deri në orën e fundit.”⁴ Në njërin nga Hadithet ne lexojmë se Muhamedi rregullisht lutej: “O Allah! Kërkoj strehë tek ti nga dënimi në varr dhe nga dënimi i zjarrit të Ferrit dhe nga fatkeqësitë e jetës dhe vdekjes dhe nga fatkeqësitë e Al-Masih Dexhallit.”⁵

Në Hadithe, është përshkruar se Ajsha kishte thënë: “Kam dëgjuar apostullin e Allahut (Muhamedin) në lutjet e tij duke kërkuar strehë nga Allahu nga fatkeqësitë e Al-Masih Ad-Dajjal.”⁶ Gjithashtu në Hadith, Krishti (Isa) është i vetmi person të cilin Perëndia do ta dërgojë për ta mundur Krishtin e rremë, për ta shpëtuar njerëzimin, për ta rimëkëmbur besimin në Perëndinë e vërtetë, dhe për ta themeluar paqen në tokë!

Islami mëson se Jezusi vetë do ta shkatërrojë Dexhallin:

Bazuar në Hadith, Muhamedi kishte thënë: “Jezusi biri i Marisë do të zbresë... dhe do t’i udhëheq ata në lutje. Kur armiku i Allahut (Dexhalli) të shoh atë, ai do të shkrihet njëjtë sikurse kripa shkrihet në ujë...”⁷ Deklarata e tij, mik i dashur, është mjaft spekulative! Vetëm Jezusi, pa ndihmën e profetëve tjerë apo engjëjve, do të fitojë betejën më të tmerrshme dhe përfundimtare në historinë njerëzore. Muhamedi gjithashtu deklaroi: “Pastaj njerëzit të cilët Allahu i kishte mbrojtur do të vijnë te Jezusi, biri i Marisë, dhe ai do t’i pastrojë fytyrat e tyre dhe do t’i informojë për vendet e tyre në Parajsë.”⁸ Sa e mrekullueshme! Kush është ky person përgjegjës për njoftimin e njerëzve për nivelin e tyre në Parajsë para ditës së gjykimit? Këtu mësimi i Muhamedit harmonizohet me besimin e krishterë që Jezusi e din fatin e përjetshëm të të gjithë njerëzve. Kjo paralele është vetëm një shembull tjetër për të dëshmuar se Jezusi është unik dhe më tepër se një profet i thjeshtë! Lidhur me Dexhallin, Muhamedi tha: “Ju paralajmëroj për të dhe nuk ka pasur profet që nuk kishte paralajmëruar njërezit e tij për Dexhallin...”⁹ A nuk është

interesante, lexues im i dashur mysliman, që sipas Muhamedit, çdo profet erdhi për të paralajmëruar kombin e tij për mashtrimin e Dexhallit, por Krishti vetë do të vijë përsëri në tokë për të shkatërruar “krishtin e rremë” pa edhe ndihmën e ndonjë engjëlli apo profeti?

KAPITULLI 24

VEÇANTIA E JEZUSIT PËRMBUSH PËRFUNDIMIN

Mik i dashur mysliman, lutem që ju do të vazhdoni të kërkoni udhëheqjen e Perëndisë ndaj shtegut të drejtë që drejton tek ai. U jap kurajo fuqimisht të jeni të sinqertë në vlerësimin dhe pranimin e së vërtetës që iu zbulohet nga Ai.

Jezusi është më tepër se një profet:

Cilësitë unike të jetës së Jezusit dëshmojnë që ai është më tepër se një profet i thjeshtë. Profetët për të cilët kemi dëgjuar dhe lexuar ishin njerëz të zakonshëm. Ata qenë të lindur nga babai dhe nëna. Ata jetuan një jetë normale. Ndonjëherë bënë gjëra të mira e herave tjera mëkatuan ndaj Perëndisë dhe ndaj miqëve të tyre njerëzor. Kur përfundoi jeta e tyre, ata u kthyen në pluhur prej nga edhe erdhën.

Ne duhet të konsiderojmë përsëri që së bashku Kurani dhe Ungjilli i atribuojnë tre tituj të ngjashëm Jezusit që janë të përputhshëm me besimin e krishterë se Jezusi është Zot dhe Shpëtimtar. Këta tituj hyjnorë janë: “Fjala e Perëndisë”, “Mesia”, dhe “Shpirti nga Perëndia.” (Sipas krishterimit Shpirti i përjetshëm e veshi mishin njerëzor).

Nga Kurani dhe Bibla mësojmë që jeta e Jezusit ishte unike. Ai qe i dalluar edhe para ngjizjes. Lindja e virgjër e Jezusit dëshmon se Perëndia e bëri të vetmin përjashtim ndaj procesit natyral të lindjes, që Jezusi të ngjizet nëpërmjet fuqisë së Shpirtit të Perëndisë. Jezusi qe unik gjithashtu në pamëkatshmërinë e tij, në aftësinë e tij për të krijuar jetë dhe për të ngritur nga të vdekurit, unik në ngritjen e tij, dhe kthimin e tij të paevitueshëm për të gjykuar dhe sunduar botën. Prandaj, aftësitë dhe veçoritë e tij e përmbushin përfundimin se Jezusi është më tepër se një profet. Ai është Bir unik dhe i përjetshëm i Perëndisë që erdhi për të na shpëtuar!

Personaliteti i madhërishtëm dhe supernatyror i Jezusit:

Vëllezër dhe motra të nderuara myslimane, ju lutem pyesni veten: Pse këto veti unike dhe qiellore gjenden vetëm në Jezus Krishtin? Karakteri unik i Jezusit, misioni dhe marrëdhënia ndaj Perëndisë është plotësisht rezultat i vullnetit dhe fuqisë së Perëndisë. Të gjitha këto cilësi unike në jetën e Jezusit e gjejnë kuptimin dhe domethënien e plotë në dy doktrina esenciale të krishterimit, të cilat janë: “Jezusi është Bir unik dhe i përjetshëm i Perëndisë (është hyjnor), dhe ai është Shpëtimtar për njerëzimin. Është nëpërmjet zbulimit të veçantisë së tij që ne mund ta ftojmë atë në jetën tonë si Shpëtimtar dhe të pranojmë dhuratën e jetës së përjetshme!

Kur në formë lutjeesh i konsideroni vetitë unike të jetës së Jezusit, ju me siguri do të zbuloni që ekziston diçka madhështore dhe qiellore lidhur me Njeriun Jezus. Ka diçka veçanërisht të lavdishme dhe supernatyrore lidhur me Personin e Jezusit! Ideja se Jezus Krishti ishte thjeshtë një profet dhe dërgues me siguri është e paarsyeshme në dritën e dëshmimeve që e rrethojnë jetën e tij. Apeli im ndaj jush, mik mysliman, është t’i bluani dhe t’i vlerësoni mirë të gjitha faktet e prezentuara në këtë libër lidhur me Jezusin para bërjes së ndonjë gjykimi ndaj çështjes teologjike të natyrës dhe misionit hyjnor të tij!

PJESA E NËNTË

LEGJENDA E TRE PERËNDIVE NË KRISHTERIM

KAPITULLI 25 **A ADHUROJNË TË KRISHTERËT TRE PERËNDI?**

Bibla në mënyrë konsistente zbulon që ekziston vetëm një Perëndi. Tek Marku 12:29-30, Jezus Krishti vetvetiu citoi një varg të famshëm nga Tora, Ligjin e Përtërirë 6:4-5: “Dëgjo, Izrael, ZOTI, Perëndia ynë, është një i vetëm. Ti do ta duash, pra, ZOTIN, Perëndinë tënd, me gjithë zemër, me gjithë shpirt dhe me tërë forcën tënde.”

Bibla mëson se ekziston vetëm një Perëndi:

Urdhërin e parë që Perëndia ia dha Moisiut që: “Nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje” (Eksodi 20:3). Apostulli Jakob shkroi: “Ti beson se ka vetëm një Perëndi. Mirë...!” (Jakobi 2:19). Apostulli Pal shkroi: “...nuk ka Perëndi tjetër veç një.” (1 Korintasve 8:4). Dhe Mateu përshkruan fjalët e Krishtit para se të ngri tej:

“Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës. Amen” (Mateu 28;19-20).

Ky shkrim i referohet trinitetit (tre-uniteti) të një Perëndie. Vëreni që Jezusi e përdori “në emër” dhe jo “në emra”, njëjës in e jo shumësin. Vëreni gjithashtu që Jezusi i nderon në mënyrë të barabartë Atin, Birin, dhe Shpirtin e Shenjtë. Në mbarë Ungjillin, Biri dhe Shpirti i Shenjtë nuk janë shoqëruar apo partnerë me Perëndinë, por më tepër të tre Personat e konstituojnë të vetmin Perëndi. Bibla mëson se natyra e Perëndisë është komplekse, që nënkupton se ekziston një pluralitet në njëshmërinë e Perëndisë. Në librin e Zanafillës lexojmë: “Pastaj Perëndia tha: “Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne, dhe të ushtrojë sundimin e tij mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit, mbi kafshët e mbi gjithë tokën, mbi rrëshqanorët që zvarriten mbi dhe. Kështu Perëndia krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së *Vet*, simbas shëmbëlltyrës së Perëndisë; *Ai* krijoi mashkullin dhe femrën.” (Zanafilla 1:26-27). Shkronjat italike të shtuara në këtë varg theksojnë kombinimin e përemrave njëjës dhe shumës duke zbuluar unitetin kompleks të Perëndisë.

Perëndia është një esencë e zbuluar në tre Persona:

Ungjilli e mëson “Trinitetin” e Perëndisë. Perëndia është një esencë që e zbulon vetveten në tre Persona. Ata janë Ati, Biri (Jezusi Ai-Masih, Fjala e Perëndisë) dhe Shpirti i Perëndisë. Ndaj disa referencave të qarta për Trinitetin, mund të lexoni tek: 2Korintasve 13:14, Efesianëve 2:18, Mateu 3:16, dhe 1Gjoni 5:7. Mbani mend që të gjithë besimtarët e krishterë besojnë në një Perëndi, dhe ata i konsiderojnë “politeistë” (ata që besojnë në më tepër se një Perëndi) si jobesimtarë. Perëndia është një. Kjo “njëshmëri” e Perëndisë është karakteristika më esenciale e Trinitetit. Sipas besimit të krishterë në unitetin absolut të një Perëndie, Ati është hyjnor, Biri është hyjnor, dhe Shpirti i Shenjtë është hyjnor.

Keqkuptimet e doktrinës së krishterë të “Trinitetit”:

Shumë myslimanë gabimisht mendojnë se të krishterët besojnë në tri perëndi; Maria, Jezusi dhe Perëndia. Lidhur me këtë çështje, Ibn Abbas shkroi: “Çfarë nënkuptohet me Trini është Perëndia më i larti, bashkëshortja e tij, dhe Biri i tij.”¹

Lehtë mund t’i shohim dy arsye prapa këtij keqkuptimi:

1. Fjala arabe “thalatha” është keqpërkthyer: “Thalathah” shfaqet nëntëmbëdhjetë herë në Kuran dhe përkthehet në mënyrë korrekte si “tre”, duke e nënkuptuar numrin e thjeshtë “tre”. Fatkeqësisht, në të njëjtat shkrime Kuranore fjala “thalathah” është përkthyer

gabimishtë si “Trini”. Një shembull i këtij keqpërkthimi gjendet në s. 4:171: “Mos thuani trini (tre) (*thalatha* në arabisht)...” Përsëri, “*thalatha*” nënkupton vetëm “tre” dhe me siguri është i ndryshëm nga fjala “trini”, që nënkupton tre në unitetin e njërit. Dhe merrni në konsideratë problemin që shumica e botës myslimane nuk e kuptojnë gjuhën arabe të Kuranit. Dhe kur e lexojnë këtë varg në gjuhën angleze, ata automatikisht paramendojnë që Kurani e mohon besimin e krishterë në Perëndinë Trini (Trinitetin).

2. Kurani arab nuk përmban referenca ndaj doktrinë krishtere të Perëndisë Trini: As fjala “Trini” e as koncepti i trinitetit (të cilën do ta diskutojmë shkurt në kapitullin e ardhshëm) nuk shfaqet në tërësi në tekstin origjinal arab të Kuranit.

Kurani e mohon besimin në tre perëndi të ndarë:

Për shembull s. 5:73, deklaron: “Gjithashtu bënë kufër ata që thanë: “Allahu është i treti i treve (*thalatha*)...” Gjithashtu S. 5:116, citon “Dhe kur Allahu tha: “O Isa, bir i Merjemës, a ti njerëzve u the: “Më besoni mua dhe nënën time dy zota pos Allahut?”” Në s. 5:75 lexojmë që, “Mesihu, bir i Merjemës, nuk është tjetër, vetëm se i dërguar... Nëna e tij ishte e drejtë. Që të dy ata ishin që ushqeheshin...” Kurani sqaron se Jezusi dhe Maria nuk kanë mundur të jenë zotëra sepse ata hanin ushqim për të mbijetuar. Andaj sikurse çdo njeri tjetër, të dy ishin njerëz. Sepse Zoti nuk ka nevojë për ndonjë ushqim. Edhe pse Kurani e denoncon doktrinën e ekzistencës së tre zotërave, përsëri kjo nuk është doktrina krishtere e Trinisë së Shenjtë. Trinia e Shenjtë është një Perëndi, dhe brenda këtij Uniteti Hyjnor ekzistojnë tre Persona të përbërës të një substance dhe fuqie. Doktrina krishtere është mjaft e ndryshme nga mësimi se ekzistojnë tre zotra të ndarë, dhe kjo është blasfemi edhe për të krishterët.

Kurani mëson gjithashtu se të krishterët janë monoteistë:

Në anën tjetër, Kurani dëshmon se të krishterët (“ithtarët e librit”) janë monoteistë (adhurojnë një Perëndi) dhe nuk janë të pafe (idhujtarë). Shkrimi i mëposhtëm është një shembull:

S. 29:46: “Ithtarët e librit mos i polemizoni vetëm ashtu siç është më së miri... dhe thuajuni: “Ne i besuam asaj që na u zbrit neve dhe që u zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar atij...” S. 2:62 dhe 3:113-114 gjithashtu konfirmojnë se zbulimi të cilën judenjtë dhe të krishterët e pranuan që nga i vetmi Perëndi i vërtetë dhe i gjallë. Dhe vëreni që islami e ndalon mashkullin mysliman ta martojë një idhujtare, por nuk e ndalon të martojë një të krishtere sepse të krishterët janë njerëz që e njohin Perëndinë e vërtetë dhe e adhurojnë vetëm atë. Është me rëndësi të përmendet këtu që kisha krishtere nuk e ka shpikur doktrinën e Trinitetit. Megjithëse katolikët, ortodoksët, dhe denominacionet protestante (ungjilllore) nuk pajtohen në disa doktrina sekondare, ata kurrë nuk janë përputhur lidhur me këtë doktrinë. Arsyeja është se e tërë Bibla definitivisht e mëson këtë besim fundamental krishterë në natyrën Trinitare të Perëndisë.

KAPITULLI 26 **TË KUPTUARIT E TRE-UNITETIT (TRINISË) TË PERËNDISË**

Nuk ekziston asnjë simbol në universin fizik që mundet në mënyrë përkatëse të portretizojë Tre-Unitetin (Trininë) e Perëndisë siç mësohet në Bibël. Megjithë këtë, simboli që paraqitet më lart, përbëhet nga një vijë e vazhduar, përpjekje kjo e cila dëshiron të bëjë të njohur Hyjninë e përbërës me tre Persona të ndryshëm. Dhe që të tretë (Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë) janë të ndryshëm por të lidhur ndërmjet veti.

Perëndia Trini është i pafund dhe i papërshkrueshëm:

Pamundësia e shpjegimit të Trinisë së Perëndisë indikon që qeniet njerëzore nuk e kanë shpikur këtë doktrinë. Asnjë nuk mund të ofrojë një ilustrim të Trinitetit që me të vërtetë e bën të njohur Perëndinë që krijoi qiejt dhe tokën. Konsideroni vetëm sa kohë iu desh njerëzimit për të zbuluar dhe kuptuar disa fakte të thjeshta rreth universit, tokës, organizmit të njeriut, etj. Ne jemi ende mjaft larg nga të njohurit e çdo gjëje që na lidhë me botën tonë (ambientin tonë fizik). Nuk është habitës fakti se është e pamundur për ne të sqarojmë Perëndinë që e kontrollon botën. Natyra dhe esenca e Perëndisë nuk mundet në mënyrë të plotë të kuptohet nga ne, njerëzit e thjeshtë. Ne jemi të paafhtë të kuptojmë Perëndinë e pafund me mendjen tonë të kufizuar. Natyra e Perëndisë shtrihet jashtë eksperiencës dhe njohurisë sonë. Perëndia është transcendent. Derisa, njëshmëria e Perëndisë në islam përshkruhet në terma të kufizuar, njëshmëria e Perëndisë në krishterim përshkruhet në terma kompleks. Kisha e hershme nuk e ka shpikur doktrinën e Trinitetit. Qe pranuar vetëm ajo çfarë Perëndia kishte zbuluar rreth vetës së tij nëpërmjet tërë Biblës.

Ekziston një kompleksitet brenda unitetit:

Konsideroni këtë që çdo njeri është një, por uniteti i tij është më kompleks se ajo e bakteries njëqelizore. Nëse njëshmëria e njeriut e përfshin aspektin shpirtëror sikurse edhe atë fizik, atëherë koncepti i njëshmërisë së Perëndisë me siguri nuk zvogëlohet nga vështrimi i kompleksitetit brenda njëshmërisë së tillë. Në të vërtetë, kur Bibla thotë që jemi krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, nënkupton që ne jemi krijuar në trini në atë sens që ne jemi trup, shpirt dhe frymë. Mëqenëse e dimë që Perëndia është i pafund, ne duhet të pajtohemi se potenciali i tij është i pakufizuar. Mundësitë e natyrës së tij komplekse janë të pakapshme për mendjen tonë njerëzore. Nëse Ai është Perëndi Trini, kush jemi ne të themi se Ai nuk mund të jetë?

“Trini” domethënë tre në unitetin e njëshit:

Ati, Biri, dhe Shpirti i Shenjtë janë një në esencë, vullnet, fuqi, dhe përjetësi. Të krishterët besojnë në një Zot, duke ekzistuar përjetësisht si Atë, Bir, dhe Shpirt i Shenjtë. Shumë prej miqëve të mi myslimanë besojnë se kjo doktrinë e Trinitetit e kontradikton vetveten. Ata thonë: “Si mundet diçka të jetë tre dhe një në të njëjtën kohë?” Në përgjigje, dijetari i krishter Dean Halverson e ofron një sqarim: “Një doktrinë që ta kontradiktojë vetveten duhet patjetër të afirmojë dhe të mohojë të njëjtën gjë me të njëjtin respekt. A e bën këtë doktrina e Trinitetit? Përgjigjja është jo, sepse doktrina deklaron që Perëndia është një esencë (apo qenie, apo substancë) dhe tre në person. Esenca dhe personaliteti janë të ndryshëm. Perëndia është tre në person, dhe çdo person i Trinisë është i ndryshëm brenda hyjnisë. Perëndia është një, dhe në këtë çdo person i Hyjnisë e ndan të njëjtën esencë vetekzistuese dhe kualitetet tjera unike të Perëndisë. Ky dallim dhe ngjashmëri e njëkohshme mund të vërehet tek Gjoni 1:1.”¹ (Mbani mend kur i referohemi tre Personave në Perëndinë e vetëm Trini, kjo fjalë “person” përdoret në një sens tjetër nga përdorimi i zakonshëm në relacion ndaj qenieve njerëzore. Përsëri, Perëndia është i pakufishëm.)

Çdo person në Trini quhet “Zot”:

E shprehur matematikisht, koncepti i Trinitetit nuk është $1+1+1=3$. Por më saktë, është $1 \times 1 \times 1 = 1$. Në Gjoni 14:10, Jezusi deklaron që Ai është në Atin dhe Ati është në Të. Tek Ungjilli sipas Mateut kap. 10:20 përshkruan që Shpirti i Shenjtë është Shpirti i Atit. Tek Galatasve 4:6,

Shpirti i Shenjtë quhet Shpirti i Jezusit. Derisa çdonjëri prej personave brenda Perëndisë manifeston funksione specifike (të ndryshëm nga dy personat tjerë), fare më pak të tre së bashku janë të përfshirë vazhdimisht në çdo gjë së bashku. Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë janë të lidhur së bashku në një unitet aq të afërm sa që jeta e çdo njerit rrjedh nëpër secilin prej tjerëve. Bibla na mëson që çdonjëri prej Personave të ndryshëm quhet “Perëndi”. Së pari, Shpirti i Shenjtë quhet Perëndi. Për shembull, në Veprat 5:3,4, kuptojmë që Shpirti i Shenjtë identifikohet si Zot dhe gjithashtu konsiderohet si Person i ndryshëm (shiko gjithashtu në Veprat 13:2; Gjonin 3:5-6; Romakëve 8:9; 1Korintasve 2:10-11). Dhe Ati në mënyrë përsëritëse quhet Perëndi (1Pjetri 1:2, etj). Gjithashtu Jezusi quhet Perëndi (Romakëve 9:5; Titit 2:13; dhe Veprat 20:28).

Shpjegime ndihmëse myslimane:

Al-Gazali iu përgjigj pyetjeve të ngjashme lidhur me Tre Unitetin. Ai është një prej teologëve më të respektuar mysliman në historinë e islamit. Ai shkroi: “Si mundën disa të jenë një? Mbani mend që ky është caku i të gjitha zbulimeve, dhe sekretit i kësaj shkence nuk duhet të shkruhet në libër, sepse njerëzit e njohurisë thanë, moszbulimi i sekretit të Zotit është blasfemi... një gjë mund të jetë shumë në një kuptim, por gjithashtu mund të jetë një në sensin tjetër. Dhe kështu, sikurse njeriu mund të jetë shumë në një kuptim nëse shikoni në shpirtin dhe trupin dhe gjymtyrët dhe enët e gjakut dhe eshtërat dhe pjesët, por në kuptimin tjetër, ai është një njeri.”² Edhe teologu i famshëm mysliman, Imam Shaarani, pohon: “Pluraliteti konvencional nuk e mohon unitetin esencial, sikurse janë degët e lisit në raport me rrënjën e tyre apo gishtat në marrëdhënie me shputën.”³

Një ilustrim nga kimia:

Në Bibël Perëndia na zbulon se ekzistojnë tre persona të ndryshëm por të pandarë në një Hyjni. Meqë është e pamundur të ofrojmë një ilustrim përkatës të këtij koncepti, mund të jetë ndihmëse të konsiderojmë si më poshtë:

Në kimi, ju mund të bëni një eksperiment që njihet si pikë e trefishtë e ujit. Nëse e vendosim ujin në një gyp vakumi dhe nën presion gazor prej 230 milimetrash dhe e zvoglojmë temperaturën në zero, vëreni çfarë ndodh në atë gyp kur temperatura prek zero grad celzius. Menjëherë uji (H₂O) do të ngrihet në fund, qëndron në gjendje të lëngët në mes, dhe shndërrohet në gaz në maje. Në këtë rast do të keni një substancë që ekziston përnjëherë në gjendje të ngurtë, të lëngtë, dhe të gaztë. Kjo ndarje në tri forma paraqitet pa ndonjë shkelje apo kontradiktë të natyrës së tij. Të tri format ngelin ujë (H₂O).

Natyra e njëshmërisë së Perëndisë:

Të krishterët pajtohen me myslimanët që Perëndia është një, plotësisht i dalluar nga qeniet e krijuara. Por ne ende nuk kemi filluar të mirremi me çështjen se çfarë misterie mund të përmban brenda vetës Natyra Hyjnore. Misteret janë karakteristika të brendshme të natyrës supreme hyjnore të Perëndisë. Prandaj, çfarëdo qofshin besimet tona, qoftë nëse i përmbahemi besimit mysliman rreth “njëshmërisë singulare” të natyrës së Perëndisë apo besimin krishterë në “unitetin e përbërë” të natyrës së Perëndisë, asnjëra nuk është në konflikt me njëshmërinë e Perëndisë. Ne po mirremi thjeshtë me natyrën e “brendshme” të kësaj esence. Krishterimi, judaizmi dhe islami janë fe monoteiste. Ato në mënyrë të patundur dhe të barabartë mësojnë që Perëndia është një. Konflikti ka të bëjë me të kuptuarit dhe të definuarit e unitetit hyjnor të Perëndisë. Përsëri, natyra e Perëndisë e tejkalon kapacitetin e mendjes sonë për të mbërthyer apo kuptuar plotësisht. Të argumentosh se besimi i krishterë në Perëndinë është kundër arsyes është thjeshtë për të bërë dikë gjykatës të asaj çfarë Perëndia mund apo nuk mund të jetë, që është blasfemi. Perëndia është Poçari dhe ne jemi argjila!

Natyrë e Perëndisë nuk mund të shprehet apo kuptohet plotësisht:

Lexuesi jo i krishterë duhet të pajtohet që në shfrytëzimin e fjalëve të tilla si “Ati”, “Biri” dhe “Shpirti i Shenjtë”, Perëndia vetëm po përdor termat njerëzor për përfitimin tonë. Është Perëndia Ai që nëpërmjet hirit të tij e akomodon veten e tij në kufizimet dhe injorancën njerëzore, sikurse babai njerëzor për shembull që duhet të shfrytëzojë një gjuhë të thjeshtë në tentim për t’i sqaruar diçka komplekse fëmiut. Andaj, nuk ekziston gjuhë njerëzore e përshtatshme për të shprehur realitetin e natyrës hyjnore të Perëndisë. Marrëdhënia në mes Personave dhe Hyjnisë i tejkalon aq tepër të gjitha mendimet dhe gjuhët njerëzore saqë as që mund të kuptojmë e as të shprehim plotësisht. Shumë myslimanë flasin se ata nuk mund të besojnë në doktrinën e Trinitetit sepse nuk mund ta kuptojnë atë. Në mendjet e tyre nuk është e vërtetuar ende. Megjithë këtë, përsëri, problemi nuk është në vetë doktrinën por në kufizueshmërinë e mendjes sonë.

Zbulimet shpirtërore konsiderohen “të vërteta” edhe atëherë kur nuk janë të dëshmuara:

Më lejoni t’iu bëj një pyetje: Nëse një ateist kërkon dëshmi për shumë besime myslimane të mbajtura si “të vërteta”, a do të ishte e mundur për ju si mysliman t’i vërtetoni? Për shembull, merrni në konsideratë besimin mysliman të ringjalljes së të vdekurve. Nëse një ateist do t’iu pyeste si është e mundur për të vdekurit të ngriten prapë në jetë, a do të mundeni në mënyrë të kënaqshme të sqaroni dhe të dëshmoni për këtë? Është e pamundur të bëhet kjo vetëm nëpërmjet logjikës apo intelektit njerëzor. Caku im është se nëse do të lejoni vetveten të mohoni doktrinën e tre-unitetit të Perëndisë sepse nuk mund të kuptoni apo sepse të krishterët nuk mund absolutisht të dëshmojnë me argumente intelektuale, atëherë nuk mundeni të qortoni ateistin për mohimin e besimit në Perëndi apo çfarëdo zbulimi tjetër që nuk mund të dëshmohet. Esenca e Perëndisë nuk është materiale por frymore. Njerëzimi duhet të pranojë nëpërmjet besimit atë çfarë Perëndia ka zbuluar lidhur me natyrën e tij në Bibël.

Vëreni që sipas Kuranit dhe Hadithit, Allahu ka faqe, duar, gishta, këmbë, dhe sy (S. 55:27, dhe S. 38:75). Dhe një dijetar mysliman tejet ndikues, Imam Abu Hanifah, mëson: “Më i larti ka dorë dhe faqe dhe shpirt pa pyetur se si?”⁴ Logjika njerëzore dhe arsyeja vetvetiu janë të pamjaftueshme për të na dërguar deri te njohja e plotë e natyrës së Perëndisë. Siç lexojmë në Bibël: “A mundesh ti të hulumtosh thellësitë e Perëndisë? A mund të depërtosh në përsosmërinë e të Plotfuqishmit? Janë më të larta se qielli: çfarë mund të bësh? Janë më të thella se Sheoli (ferri): çfarë mund të dish?” (Jobi 11:7-8).

Funksionet e Personave brenda Trinitetit:

Kur bëjmë pyetjen përse Perëndia e zbuloi natyrën e tij Tre-unitare ndaj nesh, ne zbulojmë që çdonjëri person i Trinitetit luan rol të rëndësishëm në shpëtimin tonë. Për shembull, Ati na do dhe na ofron bekime shpirtërore dhe shumë dhunti (Efesianëve 1:3). Dhurata më e rëndësishme është Biri i tij, Jezus Krishti. Jezusi e dha jetën e tij për të shpëtuar të humburit (Luka 19:10). Shpirti i Shenjtë na regjeneron, na fuqizon (Veprat 1:8) dhe na pasturon (Galatasve 5:22-23). Shpirti i Shenjtë na ndryshon brendësisht dhe na mundëson t’i nënshtrohemi Perëndisë në bindje sepse e duam atë. Qëllimi i zbulimit të Perëndisë ndaj nesh në Ungjill është të na udhëheq që të njohim atë si Atë Qiellor, të jemi të falur nga ai nëpërmjet Jezus Krishtit, dhe të përjetojmë prezencën hyjnore të tij përmes Shpirtit të Shenjtë. Perëndia dëshiron që ne të kemi marrëdhënien e drejtë me të me qëllim që ta adhurojmë, ta duam, dhe t’i bindemi atij. Dijetari i krishterë G. Parrinder sqaron:

“Perëndia si krijues dhe furnizues mund të shihet në Atin që kujdeset për njerëzimin. Natyrë esenciale e Perëndisë si dashuri duke e manifestuar veten në veprim shihet në ‘Birin’,

(derisa qe në tokë) në veprimet dhe fjalët e dashura, në vuajtjen dhe në vdekjen e tij. Natyra e gjithëpranishme e Perëndisë shihet në Shpirtin (e Shenjtë). Dhe më tutje këta të tre janë një, një zbulim i trefishtë i Perëndisë ndaj njeriut.”⁵

Ju mund të njihni dashurinë, fuqinë dhe shpëtimin e Perëndisë në mënyrë empirike:

Zemra pikëllohet atëherë kur teologët myslimanë, duke u bazuar vetëm në Kuran (duke injoruar zbulimet biblike) mësojnë që Perëndia është një dhe njëjës. Kjo i lëshon njerëzit në një koncept të zbrazët dhe jo të plotë ndaj Perëndisë. Duke insistuar ngurtësisht në thjeshtësinë e natyrës së Perëndisë, ata në mënyrë tragjike (dhe duke mos e ditur) e sakrifikojnë përjetimin e shpëtimit, dashurisë dhe fuqisë së Perëndisë personalisht. Miq të dashur, ne duhet të adhurojmë Perëndinë në shpirt dhe në të vërtetë (Gjoni 4:23). Meqë Perëndia është një Zot i dashur dhe natyra e tij është e pandryshuar, atributi i tij i dashurisë është dashur të ekzistojë që nga përjetësia. Meqë dashuria duhet të ketë një objekt, ngritet një pyetje: Para se Perëndia të krijonte çdo qenie të gjallë, kë e deshi ai? Përgjigjja është e qartë: Brenda Unitetit Hyjnor, është dashur të ekzistojë së paku i dashuri dhe dashuruesi. Bibla sqaron se çdoherë kanë ekzistuar tre Persona brenda Perëndisë, duke e përjetuar dashurinë - të shprehur reciprokisht, të manifestuar dhe të përjetuar.

Një vështrim kalimthi i Trinitetit:

Vetëm doktrina e krishterë e Perëndisë Trini sqaron se si atributi i dashurisë ekziston brenda natyrës hyjnore të Perëndisë. Perëndia i Ungjillit nuk është njëjës dhe plotësisht i vetëm. Ai është i Plotfuqishmi Perëndi i aftë për të ekzistuar i vetëm në dashuri. Perëndia nuk qe i vetëm para se të krijonte njeriun. Ati, Biri, dhe Shpirti i Shenjtë ekzistonin në gjendje të një bashkësie të plotë përmbushëse. Historiani kishtar Philip Schaff e sqaron konceptin biblik të Trinitetit: “ Perëndia është një në tre persona (tre persona të ndryshëm të një natyre)... Personat hyjnorë janë në njëri - tjetrin dhe formojnë një ndërkomunikim të përhershëm dhe e karakterizojnë esencën hyjnore. Çdo person ka attribute hyjnore të cilat hyjnë në kuadër të esencës hyjnore, por çdonjëri ka gjithashtu karakteristika të individualitetit, që janë të posaçme për personin, por të tre personat janë të bashkëpërjetshëm dhe të barabartë.”⁶

Mik i dashur mysliman, duke përfutur shikimet e Trinitetit, shpresoj që tani do fillosh të çmosh thellësinë, fuqinë dhe bukurinë e besimit të krishterë.

KAPITULLI 27

JEZUSI ËSHTË BIR I PËRJETSHËM I PERËNDISË NË NJË KUPTIM UNIK SHPIRTËROR

Në Bibël, Jezusi është Bir i përjetshëm i Perëndisë në një kuptim unik shpirtëror.

Pikëpamja kuranore e Birërisë së Jezusit:

Bazuar në shumë shkrime në Kuran, siç është S. 2:116, S. 6:101, S. 9:30, S. 18:4, dhe S. 19:35, shumë myslimanë e keqkuptojnë besimin e krishterë në Atësinë e Perëndisë dhe Birërinë e Jezusit, duke e nënkuptuar në mënyrë jokorrekte që Perëndia është dashur të ketë bashkëshorte (partnere në marrëdhëniet seksuale). Ata pyesin, si Perëndia i ndarë nga përfshirja me një grua, mund të lind një bir dhe të bëhet baba. Në s. 6:101 pyetja bëhet: “Si mund të ketë fëmijë ai kur nuk ka grua....?” Atë çfarë Kurani e mohon si të pavërtetë është ideja kuptimuale që Perëndia

kishte bir nëpërmjet marrëdhënies fizike me një partner. Një ide e tillë është blasfemi edhe për të krishterët, të cilët e mohojnë një nocion të tillë. Prandaj, kini parasysh, ju lutem, që çdo mohim mysliman i birësisë së Krishtit bazohet në keqkuptimin e konceptit biblik të birësisë shpirtërore të Jezusit.

Pikëpamja biblike e Birësisë së Jezusit:

Kur Ungjilli thekson që Jezusi është Bir hyjnor i Perëndisë, nuk nënkupton që Krishti erdhi nëpërmjet lindjes. Birëria e tij nuk përfshin një marrëdhënie fizike apo lindje natyrale. Është e një lloji tjetër. Është një birëri e përjetshme, shpirtërore (në mes të Atit dhe Birit), i cili ekzistonte çdoherë.

Birësia e Jezusit nuk nënkupton një marrëdhënie fizike (tokësore):

Kur Ungjilli mëson se Jezusi është “Bir i Perëndisë”, kjo do të thotë që Perëndia që zbuluar (në natyrën esenciale të tij të dashurisë) në Krishtin. Dijetarë të krishterë si Kenneth Cragg prezenton një analogji: “Kur flasim për Bethovenin muzikantin, apo Leonardo Da Vinçin artistin, ne nënkuptojmë këta njerëz dhe personalitetin e tyre të plotë në një kapacitet të veçantë. Kapacitete këto të cilat nuk i përjashton ata të kenë të tjerë, por të përfshihen plotësisht.”¹

Meqenëse gjatë lindjes fizike ekziston një ndarje (ndërmjet nënës dhe fëmijut), kur ka të bëjë me Perëndinë Trini, nuk ekziston lindje dhe as ndarje. Siç tha Krishti tek Gjoni 10:30: “Unë dhe Ati jemi një.” Biri vjen nga Ati pa e lëshuar atë. Jezusi vjen nga Ai dhe edhe më tutje qëndron në të. Ju lutem konsideroni këtë analogji: Kur ju mendoni një mendim të cilin e transmetoni nëpërmjet zërit, ky mendim arrin në veshët e njerëzve derisa është ende në mendjen tuaj. Është gjithashtu e mundur për një mendim të transferohet nga mendja në një letër të shkruar dhe t’iu dërgohet të tjerëve në mbarë botën. Në atë kuptim, mendimi doli nga ju dhe qëndronte edhe më tutje në ju.

Nëpërmjet Ungjillit është zbuluar se Jezusi është Fjalë e Perëndisë dhe Bir i Perëndisë, që nënkupton se Krishti erdhi nga Perëndia. Në Ungjill lexojmë: “Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindur, që, kushdo, që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.” (Gjoni 3:16). Disa përkthime të Biblës lexojnë që Perëndia dha “Birin e tij të vetëmlindur.” Fjala greke që është përkthyer si “lindur” në tekstin origjinal është *monogēnae*, nënkupton “i vetëm” (mono...) dhe “rrjedh nga” (...*genae*) apo “i vetmi që rrjedh nga”. Me fjalë tjera, Jezusi erdhi nga Ati. Disa përkthyes të Biblës e përkthyen këtë fjalë si “i vetmi” derisa të tjerët “i vetëm linduri”. Të dy janë korrektë sepse kuptimi është i njëjtë - i vetmi Bir hyjnor që rrjedh nga Ati.

Kush tjetër do të mund të ishte Ati i Jezusit?:

Kurani dhe Bibla mësojnë si fakt se Jezusi që lindur nga një e virgjër, ngjizur nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë. Në Kuran lexohet që Jezusi quhet “Shpirti nga Perëndia.” Sipas Ungjillit dhe Kuranit, Jezusi nuk lidhet me asnjë baba “fizik” njerëzor. Ai është i lidhur me Perëndinë, Atin qiellor. Nëse kundërshtoni atë që Jezusi të quhet “Bir i Perëndisë” sipas Ungjillit, a mund të sqaroni atëherë kush tjetër mund të jetë Ati i Jezusit? Për të gjykuar se Perëndia nuk mund të ketë bir pa pasur grua, është t’i atribuosh Perëndisë limite njerëzore. Do të ishte e njëjtë si për të gjykuar që Perëndia nuk mund të ketë jetë pa marrë frymë. Ndonëse është e vërtetë se çdo gjë që jeton duhet marrë frymë, Perëndia normalisht që nuk merr frymë dhe ende jeton. Ungjilli na jep një sqarim se “Perëndia është Shpirt” (Gjoni 4:24) dhe i Plotfuqishëm. Fjala arabe “walad” nënkupton një bir të lindur nga marrëdhëniet seksuale. Sigurisht që Jezusi nuk është bir në këtë kuptim. Megjithatë këtë, ekziston edhe një fjalë arabe tjetër për birin, “ibn”. Kjo fjalë “Ibn” mund

të përdoret pa dhënë një bashkim seksual. Muhamedi bën një deklaratë të mahnitshme përse i përket adhurimit, nëse Allahu me të vërtetë kishte bir. Kurani thekson në s. 43:81: “Thuaj, sikur Allahu të kishte fëmijë, unë do të jem i pari adhurues.” Vëreni, që Kurani në këtë varg mëson që Perëndinë nuk është e pamundur të ketë fëmijë. Pastaj të lexojmë një koment domethënës nga Abdullah Yusuf Ali: “Profeti i Allahut nuk kundërshton ndaj adhurimit të vërtetë në asnjë formë. Por kjo duhet të jetë e vërtetë.”² Këto qëndrime të përbashkëta të Kuranit dhe A. Y. Aliut nënkuptojnë se nëse do të ishte një Bir i tillë, ai do të duhej të adhurohej.

JEZUSI MËSON QË AI ËSHTË “BIRI I PERËNDISË”

Është më se e qartë nga Bibla se Jezusi është Bir i përjetshëm, unik, dhe hyjnor i Perëndisë. Vetë titulli “Bir i Perëndisë” sugjeron menjëherë funksionin relativ të Jezusit. Konsideroni që një baba tokësor dhe biri i tij e ndajnë të njëjtën natyrë njerëzore, dhe më tutje biri është i nënshtruar babait të tij. Të njëjtën gjë, shprehja “Bir i Perëndisë” tregon marrëdhënien në mes dy personave të Trinitës së Perëndisë. Perëndia Atë dhe Jezusi ndajnë të njëjtën natyrë hyjnore, dhe akoma Jezusi e nënshtrroi veten ndaj autoritetit të Atit. Përsëri, Jezusi erdhi në tokë për ta kryer vullnetin e Atit dhe për të lavdëruar Atin e tij Qiellor. Prandaj, shohim që shprehja “Bir i Perëndisë” tregon të njëjtën natyrë apo njëshmërinë në natyrë.

Titulli “Bir i Perëndisë” është gjuha më e mirë e mundur për të shprehur marrëdhënien e afërt dhe unike që Jezus Krishti e ka me Atin Perëndi. Bibla na zbulon rreth Jezusit: “Sepse tek ai banon trupërisht gjithë plotësia e Hyjnisë.” (Kolozianëve 2:9). Jezusi është shëmbëllesa e Perëndisë së padukshëm (Kolozianëve 1:15, Hebrejve 1:3). Ne gëzohemi që Jezusi erdhi në tokë për të na e zbuluar Perëndinë, dhe se Perëndia nuk ka ngelur plotësisht i fshehur në madhësinë e lavdishme të tij larg nga krijesat e tij!

Shëmbëlltyra e Jezusit për të atin dhe të birin:

Le të shikojmë një shembull që demonstroi pohimin e Jezusit se është Bir i Perëndisë dhe që iu nënshtrua vullnetit të Atit të tij. Në Ungjill, kjo doktrinë ilustron më tej me “Shëmbëlltyrën e vreshtarëve të këqij.” Tek Luka, kapitulli 20, Jezusi mëson turmën e njerëzve lidhur me Atin Perëndi dhe vetvetën:

“Një njeri mbolli një vreshtë, ua besoi disa vreshtarëve dhe iku larg për një kohë të gjatë. Në kohën e të vjelave, dërgoi një shërbëtor tek ata vreshtarë që t'i jepnin pjesën e vet nga prodhimi i vreshtit; por vreshtarët e rrahën atë dhe e kthyen duarbosh. Ai dërgoi përsëri një shërbëtor tjetër; por ata, pasi e rrahën dhe e shanë edhe atë, e kthyen duarbosh. Ai dërgoi edhe një të tretë, por ata e plagosën edhe atë dhe e përzunë. Atëherë i zoti i vreshtit tha: Çfarë duhet të bëj? Do të dërgoj djalin tim të dashur. Ndoshta, duke e parë atë, do ta respektojnë! Por vreshtarët, kur e panë, thanë midis tyre: Ky është trashëgimtar; e jani e ta vrasim që trashëgimia të na mbetet neve. Kështu e nxorën jashtë vreshtit dhe e vranë. Ç'do t'u bëjë, pra, këtyre, i zoti i vreshtit? Ai do të vijë, do t'i vrasë ata vreshtarë dhe do t'ua japë vreshtin të tjerëve”. Por ata, kur e dëgjuan këtë, thanë: “Kështu mos qoftë”. (Luka 20:9-16).

Interpretimi i shëmbëlltyrës biblike:

Karakteristikat e indentifikuara të kësaj shëmbëlltyre janë me sa vijojnë:

- Pronari i vreshtës është Ati Perëndi, Ai i cili mbjelli vreshtën.
- Djali i pronarit është Jezus Krishti (Mesia).
- Vreshta është kombi i Izraelit.
- Vreshtarët janë liderët religjioz judenj.

- Shërbëtorët e pronarit janë profetët e dërguar në kombin e Izraelit.

Në shëmbëlltyrë, Jezusi përfaqësohet si biri i dërguar nga pronari i vreshtës. Vreshtarët në mbikëqyrje të vreshtës vrasin birin e pronarit. Udhëheqësit judenj e kuptuan fare mirë çfarë Jezusi po thoshte, sepse në disa vargje të ardhshme raportohet që: “Në këtë moment, krerët e priftërinjve dhe skribët kërkuar të vënë dorë në të, sepse e morrën vesh se ai e kishte treguar atë shëmbëlltyrë për ata, por kishin frikë nga populli.” (Luka 20:19). Shëmbëlltyra gjithashtu mëson që Perëndia Atë dërgoi shumë profetë popullit të Izraelit për të kërkuar nga ta që të prodhojnë “fryte të mira” të drejtësisë. Por udhëheqësia hebreje i mohoi profetët dhe i keqtrajtonte ata. Pastaj Perëndia Atë dërgoi Birin e vetëm të tij të dashur. Sidoqoftë, judenjtë e mohuan atë dhe e vranë. Jezusi shkoi në “vreshtë” në nënshtrim ndaj vullnetit të Atit. Ndonëse e dërgoi në vdekje, jeta dhe vepra e Jezusit në tokë që plotësisht në lavdi të Perëndisë (dhe për qëllime të përjetshme të tij).

Jezusi konfrontonte krerët religjioz judenj:

Në përshkrimet ungjillore të apostullit Gjon, Jezusi vetë e mbron pohimin e tij për të qenë Bir i Perëndisë. Ai deklaroi:

“Ju thoni se ai, që Ati e ka shenjtëruar dhe e ka dërguar në botë, blasfemon, sepse ka thënë: Unë jam Biri i Perëndisë? Nëse unë nuk bëj veprat e Atit tim, mos më besoni, por nëse i bëj, edhe po të mos më besoni mua, u besoni të paktën veprave, që të njihni e të besoni se Ati është në mua dhe unë në atë. Për këtë arsye ata kërkonin përsëri ta kapnin, por ai ikte nga duart e tyre...” (Gjoni 10:36-39).

Tek Gjoni 5:16-18 lexojmë që Jezusi e quante Perëndinë si Atin e tij. Ai manifestonte mrekulli në Ditën e Pushimit (E shtuna – Sabbathi), ashtu që judenjtë religjioz e përsekuatun atë. Jezusi iu tha atyre: “Im Atë vepron deri më tash, e edhe unë veproj.” Judenjtë deshën ta mbytnin Jezusin jo vetëm për thyerjen e Sabbathit, por edhe sepse “ai po e quante Perëndinë Atin e tij dhe, duke e bërë veten të barabartë me Perëndinë.”

Përfundimisht, qe thënia e Jezusit se ai ishte Bir i Perëndisë e që i bëri judenjtë ta kryqëzonin atë (Mateu 26:63-65; Marku 14:61-63; Luka 22:70 dhe Gjoni 19:7). Për disa shembuj tjerë të pohimit të Jezusit për të qenë Bir hyjnor i Perëndisë, shikoni te Mateu kap. 17:5 dhe Gjoni 5:16-18.

Është domethënëse që jo vetëm Jezusi theksoi vetë të jetë Biri i Perëndisë, por Gjon Pagëzuesi dhe Perëndia Atë e dëshmuar gjithashtu këtë të vërtetë të përjetshme. Gjon Pagëzuesi deklaroi:

“Dhe unë pashë e dëshmova se ai është Biri i Perëndisë” (Gjoni 1:34).

Ne gjithashtu mund të lexojmë në Bibël dëshminë e Atit Perëndi kur Gjon Pagëzuesi po e pagëzonte Jezusin:

“Dhe ja një zë nga qielli që tha: “Ky është Biri im i dashur, në të cilën jam kënaqur” (Mateu 3:17).

PJESA E DHJETË

Ç'PERËNDI SUNDON UNIVERSIN?

KAPITULLI 28 **JEZUSI E PRANONTE ADHURIMIN**

Është domethënëse që teologët e hershëm myslimanë pajtoheshin me mësimin e Ungjillit se Jezusi është i denjë për të pranuar adhurim. Ky privilegj hyjnor referohet në këto shkrime vijuese: Mateu 9:18, Mateu 14:33, Mateu 28:17, dhe Gjoni 9:35-38.

Jezusi i denjë për të pranuar adhurim:

Një dijetar i hershëm mysliman, Ibn Ishaq¹, citoi një letër të Muhamedit dërguar Negusit të Abisinisë. Muhamedi aty shkroi: “Unë jap dëshmi, që Jezusi, bir i Marisë, është Shpirti nga Perëndia dhe Fjalë e tij...”² Këta tituj e përshkruajnë natyrën hyjnore të Jezusit.

Profeti Jahja besonte që Jezusi të jetë Fjalë e Perëndisë:

Sipas mësimave të dijetarëve të hershëm dhe të nderuar myslimanë, Jezusi që i vetmi profet që besohej në të edhe derisa ishte në barkun e nënës. Komentatorët myslimanë pajtohen që profeti Jahja (Gjon Pagëzuesi) që personi i parë që besonte se Jezusi është Fjalë e Perëndisë. Tregimi pasues raportohet nga Al-Raxi, një dijetar i hershëm i mirënjohur: “...nëna e Jezusit takoi nënën e Jahjasë, paqja të jetë mbi ta. Që të dyja qenë shtatëzënë, njëra me Jezusin, tjetra me Jahjanë. Nëna e Jahjasë i tha Marisë: “A po e ndien se jam shtatëzënë?” Maria i tha, ‘Unë jam gjithashtu shtatëzënë.’ Gruaja e Zakarias tha: “Unë gjej që ai i cili është brenda meje i përkulet atij që është brenda teje.” Al-Razi sqaron: “Kjo është çfarë nënkuptohet me konfirmimin e Gjonit (të besuarit) në Fjalën e Perëndisë, që është Jezusi e që në Kuran gjindet tek s. 3:39: “...Jahjai do të vërtetojë fjalën (Isain) e ardhur nga Allahu...”³

Jahjai iu përkul Jezusit:

Sipas të dhënave më të besueshme islame, Abdullah Ibn Abas (shiko shtojcën) që personi më i informuar në mesin e myslimanëve përse i përket zbulimeve të Perëndisë dhënë Muhamedit. Ibn Abasi bëri të njohur që përgjigjja përkatëse ndaj të qenurit e Jezusit Fjalë e Perëndisë është *t'i përkulesh atij* dhe profeti Jahja që i pari që e njohu se Jezusi është Fjalë e Perëndisë. Ibn Abasi thotë: “Përkulja e tij ndaj Jezusit në barkun e nënës është shprehje e besimit të tij në Jezusin.”⁴ Ibn Abasi thekson më tutje: “Përkulja e Jahjait në barkun e nënës së tij është të besuarit e tij se Jezusi është Fjala e Perëndisë.”⁵ Ibn Abasi gjithashtu flet se Jahjai që i vetmi që besoi dhe konfirmoi se Jezusi është “Fjala e Perëndisë” dhe “Shpirti i tij”.⁶ Vëreni që *Jahjai iu përkul Jezusit* edhe pse ishte një profet i nohur sipas Kuranit dhe Biblës.

Përkulja është një formë e qartë e adhurimit:

Mik i dashur mysliman, përkulja është formë e qartë dhe e fortë e të adhuruarit. Të adhuruarit i përket vetëm Perëndisë, i cili nuk ka partner. Përkulja e profetit Jahja ndaj Jezusit si Fjalë e Perëndisë konfirmon se Jezusi është Fjalë e përjetshme, e pakrijuar, dhe hyjnore e Perëndisë sepse profeti Jahja nuk do t'i përkulej Jezusit nëse do të ishte i krijuar. Përndryshe, profeti do të bënte “shirk”, që është një mëkat i shoqërimin të Perëndisë me dikë. Jahjai ishte gjashtë muajsh në barkun e nënës kur iu përkul Jezusit. Andaj ishte Perëndia Ai që e frymëzoi dhe lëvizti Jahjain t'i përkulej Jezusit (shiko gjithashtu Lukën 1:46). Pra, mik i nderuar, ky është një konfirmim i qartë nga vetë Perëndia se Jezusi në të vërtetë është Fjala e përjetshme e tij.

Zemra e Jahjait u gjallërua:

Në vijim, dijetari i madh mysliman Al Razi sqaron pse profetit Jahja i është dhënë emri i tillë, “Yahja” që është marrë nga folja “i gjallë.” Al Razi shkruan: “Jahjai ishte i pari që besoi në Jezusin, ashtu që zemra e tij u gjallërua nga besimi i tillë.”⁷ A nuk është e mrekullueshme! Zemra e profetit të madh Jahjait u gjallërua nga besimi i tij në Jezusin. Ndjekësit e vërtetë të Jezusit e dinë që vetëm Perëndia dhe Fjala e tij janë të aftë për t’i dhënë jetë një shpirti të vdekur. Vetëm Perëndia dhe Fjala e tij mund ta bëjë një person të rilindet përsëri dhe të jetë shpirtërisht i gjallë. Lexues i dashur mysliman, nëse besoni dhe adhuroni Jezusin si Fjalë hyjnore të Perëndisë, ju do të ndiqni shembullin e profetit të mirënjohur Jahja. Ju do të jeni në harmoni me dëshminë dhe veçorën e Perëndisë, i cili e frymëzoi dhe e lëvizi Jahjanë në barkun e nënës që t’i përkulet Jezusit.

Çdo gjuhë do të përkulet para Jezusit:

Në Ungjill, tek Filipianëve kap. 2:9-11 informohemi: “Prandaj edhe Perëndia e lartësoi madhërisht dhe i dha një emër që është përmbi çdo emër, që në emër të Jezusit të përkulet çdo gju e krijesave qiellore, tokësore dhe nëntokësore, dhe çdo gjuhë të rrëfejë se Jezus Krishti është Zot, për lavdi të Perëndisë Atë.” Mik i nderuar, mënyra për të njohur Perëndinë personalisht, të cilën e kam ndarë me ju në këtë libër, nuk ka qenë dedikuar nga Perëndia vetëm për një grup të veçantë njerëzish. Të kuptuarit dhe zbatimi personal i kësaj të vërtete është e drejtë e përgjithshme për tërë njerëzimin - për t’u ndriçuar dhe gjallëruar shpirtërisht!

Jezusi pranon adhurimin në tërë Biblën:

Nga Bibla shohim se Jezusi pranonte adhurim në shumë raste. Le t’i përmendim pesë shembuj nga Ungjilli sipas Mateut:

1. Kur dijetarët ndiqnin yllin që i udhëhiqte për te fëmija, ata “ranë përmbys dhe e adhuruan.” (Mateu 2:9-11).
2. Jezusi qe adhuruar nga një leproz, të cilin e pastroi (Mateu 8:2).
3. Kur Jezusi eci nëpër ujë dhe stuhia pushoi, dishepujt e adhuruan duke thënë: “Me të vërtetë ti je Biri i Perëndisë” (Mateu 14:33).
4. Nëna e bijëve të Zebedeut erdhi te Jezusi, “duke rënë përmbys para tij dhe i kërkoi diçka” (Mateu 20:20).
5. Disa prej dishepujve e “adhuruan atë” pas ringjalljes së tij, në malin e Galilesë (Mateu 28:16-17).

Në vijim, le t’i shikojmë tre shembuj kur Jezusi pranonte adhurimin në përshkrimet tjera ungjillore:

1. Një grua “u hodh para këmbëve të tij” dhe iu lut Jezusit që ta dëbonte demonin prej së bijës. (Marku 7:25, 26).
2. Kur Jezusi u ngrit në qiell, dishepujt e tij “e adhuruan” dhe pastaj u kthen në Jerusalemin me gëzim të madh. (Luka 24:52).
3. Pasi Jezusi i hapi sytë njeriut të lindur i verbër, njeriu tha: “Unë besoj, o Zot, dhe e adhuroj” (Gjoni 9:32-38).

Të përkujtojmë se në të gjitha këto raste Jezusi u adhurua, ai asnjëherë nuk e refuzoi adhurimin, apo nuk mohoi se ai është Biri hyjnor i Perëndisë. Mik i dashur, ky Jezus i njëjtë është vetëm një lutje larg nga ju. Ai dëshiron të jetë Shpëtimtari dhe Miku juaj personal. Dhe ai është i denjë për t’u adhuruar çdo ditë si Zot!

KAPITULLI 29 PERËNDIA ËSHTË DASHURI

Një zbulim tjetër madhështor në Bibël është se Perëndia e do çdo person në mënyrë të pakushtëzuar. Çdo person mund ta njohë këtë Perëndi të dashurisë dhe të përjetojë dashurinë dhe shpëtimin e tij! “Sepse Perëndia e deshi (ahab) aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.” (Gjoni 3:16).

Shëmbëlltyra e djalit plangprishës:

Ndërsa Kurani thekson që Perëndia nuk i do plangprishësit apo “shkapërderdhësit” (S. 6:141; 7:31), ne shohim një figurë të ndryshme në Ungjill ku lexojmë për dashurinë e mahnitshme të Perëndisë madje edhe për plangprishësit, që janë shpenzues të paarsyeshëm. Tek Luka kap. 15, Jezusi na mëson shëmbëlltyrën e birit të humbur plangprishës dhe vëllait të tij të madh. Jezusi së pari përshkruan veprimet ofenduese të djalit të vogël, i cili vendosi të lëshonte fermën familjare dhe i kërkoi babait ndarjen e trashëgimisë. Qe një dëshirë egoiste dhe e pabesë. Sipas traditës, djali kishte përgjegjësi të qëndronte dhe t’i ndihmonte familjes derisa babai të vdiste. Atëherë mundej të pranonte trashëgiminë.

Ashtu që djali plangprishës mori paratë, lëshoi shtëpinë e babait të tij, dhe udhëtoi larg për t’i shpenzuar paratë në shkretëtirë. Por kur skamja u paraqit, ai i kishte harxhuar paratë. Shëmbëlltyra pastaj vazhdon: “Atëherë erdhi në vete dhe tha: Sa punëtorëve mëditës të atit tim u tepron buka, kurse unë po vdes nga uria! Do të çohem dhe do të shkoj tek im atë dhe do t’i them: Atë, mëkatova kundër qiellit dhe para teje; nuk jam më i denjë të quhem yt bir; trajtomë si një nga mëditësit e tu. U çua, pra, dhe shkoi tek i ati. Por kur ishte ende larg, i ati e pa me dhembshuri; u lëshua vrap, ra mbi qafën e tij dhe e puthi. Dhe i biri i tha: “O atë, mëkatova kundër qiellit dhe para teje dhe nuk jam më i denjë të quhem biri yt”. Por i ati u tha shërbëtorëve të vet; “Sillni këtu rrobën më të bukur dhe visheni, i vini një unazë në gisht dhe sandale në këmbë. Nxirrni jashtë viçin e majmur dhe thereni; të hamë dhe të gëzohemi, sepse ky biri im kishte vdekur dhe u kthye në jetë, kishte humbur dhe u gjet përsëri”. Dhe filluan të bënin një festë të madhe. Djali i tij i madh ishte në ara; dhe kur u kthye dhe iu afrua shtëpisë, dëgjoi këngë e valle. Atëherë thirri një shërbëtor dhe e pyeti ç’ishte e gjitha kjo. Dhe ai i tha; “U kthye yt vëlla dhe yt atë theri viçin e majmur, sepse iu kthye djali shëndoshë e mire”. Kur i dëgjoi këto, ai u zemërua dhe nuk deshi të hynte; atëherë i ati doli dhe iu lut të hynte. Por ai iu përgjigj të atit dhe tha: “Ja, u bënë kaq vjet që unë të shërbej dhe kurrë s’kam shkelur asnjë nga urdhërat e tu, e megjithatë kurrë s’më dhe një kec për të bërë një festë me miqtë e mi. Por, kur u kthye ky djali yt, që prishi pasurinë tënde me prostituta, ti there për të viçin e majmur”. Atëherë i ati i tha: “O bir, ti je gjithmonë me mua, dhe çdo gjë që kam është jotja. Por duhet të festojmë dhe të gëzohemi, sepse ky vëllai yt kishte vdekur dhe u kthye në jetë, kishte humbur dhe u gjet përsëri.” (Luka 15:17-32).

Interpretimi i shëmbëlltyrës biblike:

Para se gjithash, vëllai i madh simbolizon personin “religjioz” i cili mendon që ka marrëdhënie me Perëndinë me anë të veprave të mira. Ai në të vërtetë kurrë nuk e përjetoj se çfarë do të thotë të jesh bir. Madje as nuk i çmoi mendimet dhe ndjenjat e babait të tij të dashur. Ai nuk kishte dashuri të vërtetë për vëllain apo babain e tij. Ai i shërbeu babait të tij jo nga dashuria, por fillimisht nga dëshira për shpërblim. Djali i madh e meritonte të dënohej për ligësinë dhe egoizmin e tij; sidoqoftë, babai e zëvendësoi këtë me hir në mënyrë të dashur duke e mbrojtur dhe duke kërkuar t’i bashkohej festës. Kjo shëmbëlltyrë gjithashtu mund të quhet “shëmbëlltyra e Atit të dashur”. Në kulturën hebreje të shekullit të parë, një njeri në moshë të

thyer dhe me respekt nuk do të vraponte për të takuar djalin e pabesë, i cili i solli turp familjes dhe fshatit. Nuk prishte punë për të që shumë njerëz në fshat do të qeshnin me të. Dashuria e të atit nuk filloi me kthimin e të birit. Babai kurrë nuk pushoi së dashuri atë. Ai e deshi birin edhe atëherë kur djali po e shkapërderdhte pasurinë në botë. Dhe nëse babai do të këmbëngulte në gjykimin e birit të vogël varësisht nga veprat e tij, ky tregim do të përfundonte me një funeral dhe jo me një festim të tillë! Vëreni që babai nuk kërkonte nga djali i tij i vogël për të “fituar” faljen e tij sepse Jezusi në këtë shëmbëlltysë na mëson që asnjë nivel i veprave të mira nuk mund të na shpëtojë nga veprat e këqija për të na bërë të pranueshëm tek Perëndia si fëmijë të tij. Ne jemi të pranuar vetëm nga hiri! Me siguri Jezusi na mëson që dashuria e Perëndisë është papritmëri e madhe dhe e pamërituar. Perëndia i do mëkatarët dhe pret me padurim kthimin e tyre! Ati qiellor pret për kthimin madje edhe të mëkatarëve më të mëdhenj sepse ai i do njerëzit pavarësisht nga padenjësia e tyre. Ne gjithashtu mësojmë që Perëndia e demonstroi dashurinë e tij në veprim, dhe ky demonstrim që i kushtueshëm. Perëndia dëshiron që ne të jemi edhe më të afërt sesa shërbëtorët. Ai dëshiron të jemi fëmijë të tij!

Dashuria e Perëndisë në Kuran është kushtëzore dhe arbitrare:

Në të kundërtën, Kurani nuk thekson që Perëndia do (*ahab*) çdo person të gjallë në mënyrë të pakushtëzuar. Një fjalë arabe shpesh e përdorur për dashurinë është “ahab”. Kurani e përdor këtë fjalë për të zbuluar dashurinë e Perëndisë vetëm për “ata që veprojnë mirë” (S. 2:195). Perëndia nuk i do ata që “veprojnë keq” (S. 3:57). Vëreni këtë shfrytëzim të kufizuar të fjalës arabe “ahab” në Kuran. Në Kuran shohim një pamje mjaft të ndryshme me atë të shëmbëlltysës së Jezusit lidhur me birin plangprishës. Kurani deklaroi: “Allahu e lë të humbur atë që do, dhe e udhëzon në rrugë të drejtë atë që do (S. 14:4).

Ç’ËSHTË FORMA E PËRSOSUR E ADHURIMIT?

Lexues i nderuar, jam i sigurt që pajtohesh se është e rëndësishme për të hulumtuar cila është forma e përsosur e adhurimit që Krijuesi ynë meritues e kërkon dhe e dëshiron për ne!

A është një shfaqje e dukshme e obligimeve fetare?

Natyrisht që Perëndia kupton që manifestimet tona të thjeshta të obligimeve fetare nuk nënkuptojnë që ne e njohim atë, madje nuk nënkuptojnë që ne i nënshtrohemi atij! Sepse është e mundur për dikë të kryejë të gjitha detyrat fetare ndërsa zemra dhe mendja e tij të mos jenë përkushtuar plotësisht Perëndisë. Trupat tonë mund t’i përkulen Perëndisë ndonëse në të njëjtën kohë zemrat tona mund të jenë të rebeluara. Njerëzit mund të tentojnë t’i binden dhe t’i shërbejnë Perëndisë nga frika, tradita, apo nga një shpresë për shpërblim. Andaj veprimet tona pa qëndrim të drejtë dhe motiv të pastër nuk mund ta kënaqin Perëndinë.

Forma e përsosur e adhurimit është të duash Perëndinë me gjithë qenien tënde:

Në Ungjill mund të lexohet që një mësues fetar jude e kishte pyetur Jezusin: “Mësues, cili është urdhërimi më i madh i ligjit? Dhe Jezusi i tha: “Duaje Zotin Perëndinë tënd me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde.” (Mateu 22:35-38). Jezusi na mëson që ta adhurojmë Perëndinë me gjithë zemrën, shpirtin dhe mendjen tonë është krejt çfarë Perëndia dëshiron nga ne në të adhuruarit tonë ndaj tij. Jezusi gjithashtu na mëson që nëse e duam Perëndinë në të vërtetë, do ta shprehim dashurinë tonë nëpërmjet bindjes sonë ndaj tij. Në Ungjill, Perëndia nuk kërkon nga ne vetëm t’i zbatojmë urdhërimet e tij, por para se gjithash ta duam atë me gjithë zemër, shpirt dhe mendje. Dhe si rezultat i natyrshëm ne do të dëshirojmë t’i bindemi atij. Ta duash Perëndinë në mënyrë se si Jezusi na mësoi nënkupton të nënshtroarit, të dorëzuarit

e plotë ndaj tij, dhe të dëshiruarit për të jetuar çdo ditë të jetës sonë për ta kënaqur Atë. Prandaj, mik i nderuar, fjalët e Jezusit të përshkuara në Ungjillin e Mateut zbulojnë mendjen dhe vullnetin e Perëndisë. Nuk ekziston ndonjë formë më e lartë apo më e mirë e të adhuruarit që mund t'i ofrojmë Perëndisë sesa të duam atë në një mënyrë aq complete. Kjo dashuri është forma më e përsosur e adhurimit që e kënaqë, Krijuesin tonë sepse kjo nënkupton të dhënurit Perëndisë të gjitha emocionet, mendimet, dëshirat, dhe caqet tona (vullnetin tonë).

A ËSHTË E MUNDUR PËR NJË BESIMTAR T'I OFROJË PERËNDISË KËTË FORMË TË PËRSOSUR TË ADHURIMIT?

Le t'i analizojmë dy pyetje të rëndësishme. Së pari, a është e mundur për një besimtar që ta dojë Perëndinë me gjithë zemrën, shpirtin dhe mendjen e tij? Së dyti, a është Perëndia me të vërtetë i denjë për të pranuar këtë dashuri? Mik i nderuar, për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, është ndihmëse për besimtarin t'i konsiderojë këto tri aspekte të dashurisë:

- E vërtetë: A është marrëdhënia ime me Perëndinë e bazuar në një dashuri të vërtetë?

Që dashuria juaj ndaj Perëndisë të jetë e vërtetë, ju duhet së pari të përjetoni faljen e përsosur dhe të përjetshme të Perëndisë. Atëherë zemra juaj do të jetë e lirë nga frika dhe faji dhe ju do të mundeni ta doni Perëndinë. Personi që nuk ka siguri të faljes nga Perëndia nuk ka mundësi t'i shërbejë Perëndisë dhe t'i zbatojë urdhërimet e tij nga dashuria. Në vend të kësaj, ai do t'i bindet Perëndisë me qëllim parësor të fitojë faljen e tij dhe të pakësojë zemërimin e tij.

- Mjaft ekstravagante: A është dashuria i Perëndisë për mua "mjaft manifestues" që të më motivojë për ta dashur atë me të njëjtën ekstravagancë.

Motivimi juaj për ta dashur Perëndinë varet nga ajo sesa të vetëdijshëm jeni ju për dashurinë e Perëndisë ndaj jush. Besimtarët që shohin dhe kuptojnë se si Perëndia e shfaq dashurinë e tij përsosur drejt tyre do të përgjigjen në një mënyrë më të zjarrtë në dashuri dhe falënderim drejt Perëndisë.

- Reciproke: A mund ta përjetojë dashurinë e Perëndisë në zemrën time?

Me qëllim të përjetimit të dashurisë së Perëndisë në mënyrë reciproke, ju duhet të përjetoni një prekje nga dashuria hyjnore e Perëndisë në zemrën tuaj. Atëherë do të keni mundësi për të përjetuar dëshirën natyrore nga brendia e shpirtit tuaj për të dashur Perëndinë si "kompenzim".

A ËSHTË E MUNDUR PËR NJË BESIMTAR MYSLIMAN QË ME GJITHË ZEMËR TA DOJË PERËNDINË?

Çfarë flet Kurani për Dashurinë e Perëndisë? Përgjigjja në këtë pyetje përfshin të tri konsiderata e rëndësishme: 1) A është marrëdhënia e besimtarit me Perëndinë e bazuar në një dashuri të vërtetë? 2) A është dashuria e Perëndisë për besimtarin "mjaft manifestuese" që e motivon atë për ta dashur në të njëjtën mënyrë? 3) A mund të përjetojë besimtari dashurinë e Perëndisë në zemrën e tij? Le t'i shqyrtojmë këto tre aspekte të dashurisë.

Në Kuran, Perëndia është Zot ndërsa besimtari një skllav:

Bazuar në Kuran, dashuria e Perëndisë është e kushtëzuar me kryerjen e detyrave të besimtarit mysliman, dhe besimtari trajtohet si një skllav. S. 19:93 thekson: "Nuk ka tjetër, vetëm se të gjithë çka është në qiej e në tokë ka për t'iu paraqitur Zotit si rob". Abdullah Yusuf Ali, kur përktheu këtë varg, në mënyrë jokorrekte përktheu fjalën origjinale arabe "abd" si "shërbëtor", duke e ditur se fjala "abd" nënkupton vetëm "skllav". Perëndia në Kuran është Zoti ndërsa "besimtari" vetëm një skllav. Skllavi (sikurse edhe shërbëtori) punon të fitojë një vend në shtëpinë e Zotit. Skllavi nuk punon për shkak të Zotit, por fillimisht për përfitimet dhe shpërblimet e tij.

Jo vetëm që pranimi i besimtarit mysliman nga Perëndia varet plotësisht nga zbatimi i detyrave, por madje edhe nëse do t'i zbatonte të gjitha detyrat religjioze, Zoti Perëndi edhe më tutje e posedon të drejtën t'i dëbojë ata. Kjo marrëdhënie nuk drejtohet nga ndjenja e dashurisë në zemër. Dashuria e vërtetë nuk mund të vijë nga një mentalitet shërbëtor/skllav.

Sipas Kuranit, Perëndia është një gjykatës i paparashikueshëm:

Perëndia në Kuran është i njohur në përgjithësi si një gjykatës i cili kurrë nuk premtion një falje të plotë të mëkateve të besimtarëve. Dhe madje nuk u garanton besimtarëve jetën e përjetshme në parajsë. Andaj, është e pamundur për besimtarin mysliman të përjetojë paqen e vërtetë në zemrën e tij. Ai nuk mund të jetë i lirë nga frika duke e ditur se gjykimi i Perëndisë mund të jetë kundër tij. S. 5:18 citon lidhur me Perëndinë: “Ai falë atë që do dhe dënon atë që do...” Këtu Aliu e keqpërktheu fjalën origjinale arabe “*uazebo*” si “*dënon*”, kurse fjala “*uazebo*” nënkupton “*torturë*”. Ebu Bekri, të cilët myslimanët besojnë të ketë qenë personi më i lartësuar pas profetëve, që i frikësuar për fatin e tij. Në *Mësimet e Islamit*, në kapitullin e titulluar *Frika nga Allahu*, ai që kishte shkruar: “Do të dëshiroja të ishja një gjethe bari, jeta e së cilës përfundon nga një kullotë e ndonjë kafshe.”¹ Ai gjithashtu tha: “O ju zogj! Sa të fatshëm që jeni! Ju hani, pini dhe fluturonin nën hijen e pemëve dhe ju nuk frikoheni nga llogaritja e Ditës së Gjykimit! Do të dëshiroja të isha si ju.”²

Omari, që lideri i dytë në botën islame i cili ishte tejet i nderuar nga Muhamedi dhe dijetarët tjerë myslimanë: “Kur myslimanët në fillim ishin shumë të dobët, profeti (Muhamedi) iu lut Allahut t'i forconte myslimanët me Islamin e Omarit.”³ Por edhe Omari, i frikësuar mjaft nga ferri, do të mbante shpesh një fije kashte në dorë dhe do thoshte: “Do të doja të isha një fije kashte si kjo.” Dhe ndonjëherë do të thoshte: “Do të doja që nëna ime të mos më kishte lindur.”⁴

Dashuria duhet të jetë e çiltër:

Në s. 23:60, lexojmë: “Dhe atë të cilët japin (sadaka) nga ajo që u është dhënë, pse dinë se do të kthehen te Zoti i tyre, andaj zemrat e tyre i kanë të frikësuar.” Muhamedi vetë e sqaroi çka nënkupton ky varg: “Ajsha tha: “O apostull i Zotit, a është ai i cili frikohet nga Perëndia ai që shkel kurorën, vjedh, pinë verë, dhe në këtë mënyrë i frikësohet dënimit? Muhamedi i tha asaj: “Jo, bija e Sedikut, është ai i cili falet, agjëron dhe jep sadaka, dhe frikësohet që Perëndia nuk do të pranojë këto gjëra nga ai.”⁵ Prandaj, besimtari mysliman, nuk mund të dojë me të vërtetë Perëndinë jo për shkak të Tij, por për shkak që të zvogëlojë zemërimin e Perëndisë dhe të tentojë të fitojë faljen dhe pranimin e Perëndisë. Sidoqoftë, dashuria e vërtetë duhet të jetë një manifestim i dashurisë më të pastër së zemrës ndaj Perëndisë. Normalisht, Perëndia dëshiron një përgjigje të vullnetshme të dashurisë ndaj atyre që e adhurojnë atë.

Dashuria duhet të jetë “tepër manifestuese”:

Mik i nderuar, Kurani flet pak lidhur me manifestimin e dashurisë të Perëndisë ndaj teje dhe meje. Kurani nuk na tregon për një veprim të madh të dashurisë në historinë e trajtimit të Perëndisë me njerëzimin. Kurani është i heshtur për sa i përket ndjenjave të thella dhe të forta të dashurisë që Perëndia mund të ketë për ne. Nëpër të gjitha faqet e Kuranit, nuk shohim citim apo demonstrim të masës së plotë të dashurisë së Perëndisë drejt nesh.

Dashuria duhet të jetë reciproke:

Sipas Kuranit, nuk është e mundshme, për një besimtar mysliman të përjetojë në fakt dashurinë e Perëndisë në zemrën e tij. Ne lexojmë në Kuran emra të shumtë dhënë Perëndisë: “Ai është Allahu... Të tij janë emrat më të bukur...” (S. 59:24). Sipas dijetarëve myslimanë ekzistojnë

nëntëdhjetë e nëntë emra të bukur të Perëndisë. Mund të vëreni që në këta emra të bukur nuk përfshihen emrat si “Ati” apo “Perëndia është dashuri”. Emri më i afërt që tregon mirësinë e Perëndisë në Kuran është “Al-Wadud” (S. 85:14), që do të thotë: “Falësi apo i mirëdashuri”. Megjithë këtë, ky emër nuk zbulon kualitetin më të lartë të dashurisë hyjnore, që është vetë-sakrifica.

Të kuptuarit e dashurisë së Perëndisë:

Një prej teologëve më të mëdhenj mysliman në historinë e islamit, Al-Gazzali, sqaron që shprehja “*Al-Wadud*” nënkupton shumë më pak se titulli që indikon. Ai shkroi një libër rreth nëntëdhjetë e nëntë emrat e Perëndisë, *Al Maqсад al Asna*, në të cilën ai thekson që titulli “Al Wadud” është më i vogël në nivel se titulli “I Mëshirshmi” (“Al- Rahim”). Të gjithë dijetarët mysliman pajtohen me këtë opinion. Sepse Perëndia është quajtur në Kuran “I mëshirshmi” më tepër se njëqind herë, dhe është quajtur “Al Wadud” vetëm dy herë (S. 11:90 dhe 85:14). Është e pakontestueshme që dashuria sakrifikuese është shumë më e fortë, më e pasur dhe më e thellë se mëshira. Dashuria është virtyti më i madh dhe karakteristika që ndokush mund ta ketë. Ju mund të jeni të mëshirshëm ndaj një të varfëri duke i dhënë disa dollarë apo diçka për të ngrënë. Në anën tjetër, dashuria e atit për fëmijën e tij e motivon atë për të sakrifikuar për të. Al-Gazzali e sqaron dashurinë e Perëndisë duke u përbërë vetëm nga veprat synuese të mirësisë dhe manifestimet e miratimit. Ai mohon nëse dashuria e Perëndisë përfshin ndonjë ndjenjë personale. Ai mohon nëse Perëndia ndien ndonjë dashuri në zemrën e tij për njerëzimin. Al-Gazzali thekson: “Perëndia qëndron lartë ndjenjave të dashurisë.”⁶ Ai e konfirmon këtë mësim fatkeq në Kuran duke e përshkruar dashurinë e Perëndisë, “Dashuria dhe Mëshira janë të dëshiruara në respekt të synimeve të tyre vetëm për shkak të fryteve dhe përfitimeve të tyre e jo për shkak të ndjenjave.”⁷ Me fjalë të tjera, kur Perëndia thotë që ju do, atë çfarë ai nënkupton është se ai do të shfaqë mëshirë ndaj jush duke ju dhënë gjëra të mira, por kjo nuk mund të interpretohet që ai ndien ndonjë gjë në zemrën e tij për ju.

Mik i dashur mysliman, Perëndia të cilin Kurani e paraqet dhe pëshkruan nuk e përmbush etjen dhe përmallimin e shpirtit tonë. Ai nuk mund të ofrojë paqe dhe gëzim zemrave tona dyshuese. Për shembull: Një grua e caktuar e deshi një mashkull me gjithë zemrën e saj, dhe ajo deshi ta kënaqë atë dhe të kalojë tërë jetën me të. Fatkeqësisht, ai i dhuroi dhurata asaj vetëm kur e kënaqte atë. Ai refuzoi ta njoftonte atë nëse e donte apo jo. Dhe ai refuzoi ta martonte atë. Ai madje nuk do të garantonte që do të ishte çdoherë me të. Ky njeri dëshironte ajo të jetë vetëm shërbëtorja (skllavja) e tij. Tani unë të pyes, nëse ju do të ishit ajo grua si do të ndiheshit? Do të ndiheshit e dashur? A do të ndiente zemra juaj një dashuri reciproke, devocionale për të?

Prandaj, është e pamundur për një mysliman t’i ofrojë Perëndisë formën më të përsosur të adhurimit, që përsëri është të duash Perëndinë me gjithë zemër, shpirt dhe mendje. Ai nuk mundet të shprehë një dashuri të tillë Perëndisë nëpërmjet një nënshtrimi të vullnetshëm dhe të gëzuar (bindje) ndaj urdhërimeve të tij.

PËR NJË BESIMTAR TË KRISHTERË ËSHTË E MUNDUR QË ME GJITHË ZEMËR TA DOJË PERËNDINË?

Në krahasim, Perëndia i Biblës e bën të mundur për një besimtar që ta dojë atë me gjithë zemër, shpirt dhe mendje duke i dhënë në këtë mënyrë Perëndisë “adhurimin e përsosur”.

Perëndia në Bibël shpeshherë quhet “Atë”:

Perëndia na ofron (lejon) të hyjmë në një marrëdhënie të mrekullushme me të si fëmijë të tij. “Por të gjithë atyre që e pranuan atë, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e tij, të cilët nuk janë lindur nga gjaku, as nga vullneti i mishit, as nga vullneti i

burrit, por janë lindur nga Perëndia.” (Gjoni 1:12-13). Në momentin kur personi beson në Jezusin, ai lindet nga Shpirti i Perëndisë dhe bëhet fëmijë i Perëndisë. Kjo marrëdhënie e re në mes besimtarit dhe Perëndisë shpie në një dashuri intime. Perëndia e bëri të mundur për besimtarët e tij të ngriten në nivelet më të larta si fëmijët e tij më të dashur! Në Bibël tek Mateu 6, Jezusi udhëzon dishepujt e tij se si t’i luten Perëndisë. Si model të lutjes, ne duhet ta thërresim Perëndinë “Ati ynë.” Perëndia deklaroi në Ungjill dëshirën e tij për t’u afruar afër me ne, si një atë i dashur që u afrohet afër fëmijëve të tij.

Në Bibël lexojmë:

“Shikoni ç’dashuri të madhe na dha Ati, që të quhemi bij të Perëndisë...” (1Gjoni 3:1).
Dhe qielli do të jetë shtëpia jonë sepse Perëndia na bëri fëmijë të tij:

Jezusi tha: “Mos ki frikë, o tufë e vogël, sepse Atit tuaj i pëlqen t’iu japë mbretërinë.”
(Luka 12:32).

Lidhur me natyrën e Perëndisë si gjykatës, meqenëse ne si ndjekës të vërtetë të Krishtit jemi fëmijë të tij, ai nuk do të na dënojë kurrë për të kaluar përjetësinë në ferr, apo edhe për të na dërguar atje edhe vetëm për një ditë. Sidoqoftë, këtu në tokë Perëndia na qorton ndonjëherë me qëllim të korrigjimit tonë (Hebrenjve 12:5-11). Dhe ne e kemi sigurinë që e gjithë disiplina e tij është e shoqëruar nga dashuria dhe falja. Dashuria e pakushtëzuar dhe gatishmëria për të na falur çdo herë e karakterizon marrëdhënien tonë me të si fëmijë të tij (1Gjoni 4:16, 5:14-15). Mbani mend që besimtarët dhe jobesimtarët do të ballafaqojnë një gjykim plotësisht të ndryshëm. Jobesimtarët janë të përcaktuar për ferr. Ndërsa, besimtarëve u premtohet, dhe do të kenë, jetën e përjetshme në qiell me Perëndinë.

Zbulesa e dashurisë së Perëndisë në Jezus Krishtin:

Në Ungjill, karakteristika mbizotëruese e zbuluar rreth Perëndisë është se “Perëndia është dashuri.” (shih tek 1Gjoni 4:8). Ai nuk është një Perëndi që vepron ndonjëherë në një mënyrë të dashur dhe të mëshirshme. Zemra e tij është plotë me emocione dashurie për ty dhe për mua. Mbani mend, Perëndia i kërkoi Abrahamit ta sakrifikoje birin e tij për të dëshmuar dashurinë e tij për Perëndinë. Dhe Perëndia e zbuloi dashurinë e tij për ne në të njëjtën mënyrë sakrifikuese! Andaj, mik i dashur mysliman, ç’Perëndi mendon se sundon mbi këtë univers? Është ai një lloj Perëndie që të thotë se ti duhet të më bindesh mua, të më shërbesh, të më ofrosh jetën tënde, gjersa ai në largësi në qiell nuk ka kurrfarë ndenje dashurie për ne? Në Ungjill ne nuk kemi një figurë të tillë të Perëndisë. Perëndia e ofroi Birin e tij për të vërtetuar dashurinë e tij sakrifikuese dhe të pasionuar. Në Bibël lexojmë: “Por Perëndia e tregoi dashurinë e tij ndaj nesh në atë mënyrë që kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne.” (Romakëve 5:8). Përsëri, Perëndia e bëri gjënë më të madhe që do të kishte mundur të bënte për të zbuluar dashurinë e madhe dhe të përsosur për ju dhe mua (shih tek Gjoni 15:13). Jo vetëm që mund të shohim dashurinë e mahnitshme të tij për ne në dhuratën e Birit të tij, por Bibla na zbulon që jeta e Jezusit dhe vdekja e mundimshme e tij “shprehën në mënyrë të plotë” dashurinë e Perëndisë për ne. Jezusi na e zbuloi vetë Perëndinë ndaj nesh. Jezusi tha: “Ai që më ka parë mua, ka parë Atin” (Gjoni 14:9).

Mund ta përjetojmë dashurinë e Perëndisë nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë:

Perëndia na jep Shpirtin e Shenjtë të banojë në ne dhe të na bëjë të vëmendshëm ndaj dashurisë së Perëndisë për ne. Shpirti i Shenjtë bëhet qytetar i zemrës sonë në momentin kur vendosim besimin tonë në Krishtin si Shpëtimtarin tonë, që na mundëson të përjetojmë dashurinë atërore të Perëndisë në zemrat dhe shpirtërat tanë. Romakëve 5:5 premtonte: “Dhe shpresa nuk turpëron, sepse dashuria e Perëndisë është derdhur në zemrat tona me anë të Frymës së Shenjtë që na është dhënë.”

Lidhur me Shpirtin e Shenjtë në Bibël lexojmë:

Meqë e kemi identifikuar vetën tonë plotësisht si bij të Perëndisë, ai e dërgon Shpirtin e Birit të tij në zemrat tona. Shpirti i thërret Perëndisë “Aba, Atë” (Galatasve 4:4-6).

Dashuria e Atit Qiellor, e manifestuar në Jezus Krishtin, bëhet realitet në zemrat tona dhe jeton nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë të cilin e vendosi në zemrat tona. Në Bibël lexohet: “Sepse ju nuk keni marrë një frymë robërie, që të keni përsëri frikë, po keni marrë frymën e birërisë, me anë të së cilës ne thërrasim: "Aba, o Atë!". Vetë Fryma i dëshmon frymës sonë se ne jemi bij të Perëndisë.” (Romakëve 8:15-16).

PËRFUNDIMI KRAHASUES I DASHURISË SË PERËNDISË NË KRISHTERIM DHE ISLAM

Qartazi në këtë kapitull mund të shihet se vetëm Bibla përmban zbulimet e vërteta të Perëndisë sepse:

1. Perëndia i Biblës krijoi krijesat e tij për t’i ofruar atij formën e përsosur të adhurimit, që sipas fjalëve të Jezusit është “të duash Perëndinë me gjithë zemër, shpirt dhe mendje”. Kjo me siguri ka kuptim pasi që Krijuesi e meriton ta pranojë formën më të përsosur të adhurimit nga ne si krijesa të tij.
2. Perëndia, të cilin Bibla na e zbulon, ka karakterin më të mrekullueshëm. Ai është absolutisht Perëndi i përsosur. Ai me pasion e zbulon dashurinë madhështore të tij për ne nëpërmjet veprës së Jezus Krishtit (sakrificë e vullnetshme) në kryq. Ai dëshiron të bëhemi fëmijë të tij dhe ai ka bërë të mundur të përjetojmë dashurinë atërore të tij përmes Shpirtit të Shenjtë që banon në ne.
3. Perëndia i Biblës mundësoi që ne t’i japim mënyrën e përsosur të adhurimit si përgjigje natyrore të asaj çfarë Perëndia ka bërë për ne, në ne, dhe do të bëjë çdoherë si besimtar. Çfarë dashurie dhe hiri! Të krishterët e vërtetë mund sinqerisht t’i thonë Perëndisë: “Nuk ka kufizim ndaj potencialit të dashurisë për ju. Unë dëshiroj të të dua, të të kërkoj ty, dhe të të shërbej gjithë ditët e jetës sime.”

Vëmendje personale të dëshmisë së autorit:

Lexues i dashur, mbaj mend qartë momentin kur vendosa për Jezusin. Ndjeva që Perëndia po më përqaftonte dhe po më jepte një shtrëngim të fortë. Unë mundem lehtë të them që jam në dashuri me Perëndinë. Ai është i denjë për jetën dhe dashurinë time. Unë e dua atë me gjithë zemrën time. Unë dua ta njoh atë më afërsisht, t’i shërbejë atij më tepër, dhe të lavdërojë atë më tepër. Kënaqësia dhe përmbushja ime gjendet në të dhënurit atij çdo ditë të jetës sime. Mund të them sikurse apostulli Pal tha: “Sepse dashuria e Krishtit na shtrëngon” (2Korintasve 5:14). Kjo është pse, dashuria e Krishtit më detyron të harroj veten time dhe ta nënshtroj me gëzim jetën time, madje edhe si një skllav në dorën e Perëndisë.

Këto vërejtje nuk janë fjalë të thata apo teori. Ata përputhen me të vërtetën e Perëndisë në Ungjill. Qëllimi im për shkruarjen e këtij libri është për të të ndihmuar që të përjetosh në zemrën tënde dashurinë e thellë dhe personale të Perëndisë për ju. Ju, gjithashtu, miku im, mund ta përjetoni atë në jetën tuaj si një Atë të dashur Qiellor. Mund ta ndieni në zemrën tuaj përqaftimin e tij dhe të përjetoni prezencën e tij brenda jush nëse shkoni tek ai nëpërmjet Jezus Krishtit. Nëse bëni hapin e besimit dhe shkoni te Perëndia dhe i thuani që nuk doni të jetoni më në mëkate, dhe besoni se Jezus Krishti vdiq për faljen e mëkateve tuaja, ju do të përjetoni faljen e Perëndisë. Kur ai hynë në jetën tuaj, ju do të gëzoni paqen dhe dashurinë e tij menjëherë, aty ku jeni që tani!

Dashuria e Atit për ju, mik i dashur mysliman, nuk është e çuditshme. Në momentin kur ju e pranoni Jezusin si Shpëtimtar dhe Zotin tuaj, ju do të rilindeni shpirtërisht përsëri dhe do të përjetoni krahët e dashurisë së Atit Qiellor duke ju tërhequr drejt krahërorit të tij. Atëherë do të gjeni veten tuaj të tërhequr pranë tij me tërheqjen më të parëzistueshme. Do të bini në dashuri me të nga thellësia më e madhe e qenies suaj!

KAPITULLI 30 **JEZUSI ËSHTË UNIK SEPSE ËSHTË SHPËTIMTARI YNË**

Bibla mëson që ne të gjithë jemi të ndarë nga Perëndia në gjendje mëkati dhe të nevojshëm për një Shpëtimtar. Ne të gjithë kemi nevojë të pajtohemi me Perëndinë.

Ne jemi mëkatarë të nevojshëm për një Shpëtimtar:

Përsëri problemi është se mëkati tani është pjesë e pandarë e natyrës sonë njerëzore. Të gjitha format e paudhësisë banojnë në zemrën e njeriut: epshi, xhelozia, krenaria, urrejtja, egoizmi, dhe veti tjera të shoqëruara me qeniet e rëna të gjalla dhe me botën e rënë. Mëkati ka një kontrollë të ashpër përbrenda çdo personi. Të gjithë qeniet njerëzore janë të robëruara ndaj fuqisë së mëkatisë dhe tundimeve të vazhdueshme të saj.

Jezusi fitoi betejën ndaj Satanit dhe mëkatisë:

Ungjilli na tregon se i vetmi person i pastër nga mëkati është Jezus Krishti. Ai erdhi “në shëmbëllim të mishit mëkatar” dhe “e dënoi mëkatin në mish” (Romakëve 8:3). Ai jetoi duke mos e bërë edhe një mëkat të vetëm. Natyra hyjnore e Jezusit i garantoj fitimin e betejës kundër Satanit dhe mëkatisë. Lajm i mahnitshëm është se Jezusi erdhi dhe e mundi fuqinë e mëkatisë në vendin e tij banues brenda trupit tonë njerëzor.

Ne mund të jemi të lirë nga dashuria dhe fuqia e mëkatisë:

Lajmi i mrekullueshëm i Ungjilit është se Perëndia mundësoi të bashkohemi me Jezusin nëpërmjet Shpirtit të tij, i cili do banojë ndër ju në momentin kur ju vendosni besimin tuaj në Jezusin si Shpëtimtarin tuaj. Si një pasojë natyrore e të qenurit të bashkuar me të, ju do t’i gëzoni frytet e fitorës së tij. Mund të përjetoni për herë të parë në jetën tuaj lirinë ndaj skllavërisë së mëkatisë. Jezusi tha: “...kush bën mëkat është skllav i mëkatisë.” (Gjoni 8:34). Ai më tutje shtoi: “Pra, nëse Biri do t’iu bëj të lirë, do të jeni më të vërtetë të lirë.” (Gjoni 8:36). Mesazh mjaft i bukur i Ungjilit është që Biri i Perëndisë erdhi si një njeri unik, Jezusi, për t’iu shpëtuar dhe t’iu bëj të lirë nga robëria dhe dashuria e mëkatisë (ju lutem lexoni Romakët 6:4-14). Shikoni tani, miku im, Jezus Krishti erdhi për të bërë atë çfarë ligji dhe profetët nuk arritën ta bëjnë. “Arsyeja përse Biri i Perëndisë u shfaq është për të shkatërruar veprat e djallit.” (tek 1Gjoni 3:8 dhe Hebrenjve 2:14). Dhe Jezusi Shpëtimtari ynë na paralajmëron, “Prandaj ju thashë se do të vdisni në mëkatet tuaja, sepse po të mos besoni se unë jam, ju do të vdisni në mëkatet tuaja.” (Gjoni 8:24). Kjo do të thotë, që nëse personi nuk beson në Jezusin si Shpëtimtar dhe Bir të Perëndisë (Perëndia që erdhi në mish), ai në të vërtetë do vdesë në mëkatet e tij.

Jezusi pagoi dënimin për mëkatet tona:

Jezusi erdhi për të vuajtur pasojat më të tmershme të mëkatisë tonë, e kjo është, vdekja. Ai duroi kryqin në vendin tonë, duke vuajtur zemërimin e Perëndisë drejt nesh. Jezusi pagoi për mëkatin dhe vdekjen e çdo personi. Lajm i mirë i Biblës është se Jezusi erdhi për të na shpëtuar

dhe liruar nga pagesa e dënimit tonë personal. Dënimi është paguar. Dhe sipas principit të rrezikut të dyfishtë, personi nuk mund të gjykohet dy herë për të njëjtin krim. Jezusi “vdiq për mëkatin njëherë e përgjithmonë.”! (Romakëve 6:10).

Mund ta ndiejmë faljen e Perëndisë në zemrat tona:

Lajm i mrekullueshëm i Biblës është se në momentin kur ju besoni në Jezusin si Shpëtimtar dhe Zot dhe jeni të bashkuar me të, mund të përjetoni për herë të parë në jetën tuaj, mu në brendi të zemrës suaj, faljen e Perëndisë për të gjitha mëkatet tuaja. Ju do të përjetoni paqen e mrekullueshme me Perëndinë. Ligjërisht, Perëndia do të shikojë në ju ashtu sikur natyra e juaj e vjetër ka vdekur me Krishtin. Ju do të jeni “krijesa të reja” (2 Korintasve 5:17).

Jezusi pushtoi vdekjen:

Lajm madhështor i Biblës është se Jezusi erdhi dhe pushtoi vdekjen. Kur Jezusi në mënyrë fizike u ringjall nga të vdekurit dhe u ngrit që të jetë me Perëndinë Atë. Ai deklaroi fitoren mbi vdekjen. Jezusi anuloi pasojën më të madhe të mëkatit, që është ndarja e përjetshme nga prezenca e Perëndisë. Ringjallja e Krishtit është e para nga një vijë e gjatë e ringjalljeve që do vijnë prej atyre që besojnë në të. Besimtarët e vërtetë nuk do vdesin kurrë shpirtërisht, por do të përjetojnë jetën e përjetshme me Perëndinë përjetë. Ne lexojmë: “Por tashti Krishti u ringjall prej së vdekurish, dhe është fryti i parë i atyre që kanë fjetur” (2Korintasve 5:20).

Mund të kemi sigurinë se Qielli është shtëpia jonë:

Mund të kemi siguri në shpirtin tonë se do shkojmë në qiell. Lajmi i mahnitshëm i Ungjillit është se që në momentin kur ju besoni në Jezusin dhe dilni para Perëndisë me pendim; Shpirti i Shenjtë i Perëndisë do të vijë të banojë tek ju, dhe ai do ju sigurojë se tani do të shkoni në qiell. Parajsa do bëhet shtëpia dhe ardhmëria juaj. “Sepse, nëse u bashkuam me Krishtin në një vdekje të ngjashme me të tijën, do të jemi edhe të ringjalljes së tij.” (Romakëve 6:5). (shikoni gjithashtu tek kap. 1Pjetri 1:3,4 dhe Efesianëve 2:6). Arsyeja që do ta dini se keni për të banuar në qiell është se i njëjti Jezus që jeton në qiell do të vijë dhe do banojë në ju nëpërmjet Shpirtit të tij të përjetshëm. Ungjilli deklaron: “Dhe në qoftë se Fryma i atij që ringjalli Krishtin prej së vdekurish banon në ju, ai që e ringjalli Krishtin prej së vdekurish do t’u japë jetë edhe trupave tuaj vdekatarë me anë të Frymës së tij që banon në ju.” (Romakëve 8:11). Shpirti i gjallë dhe jetëdhënës i Krishtit u kumton jetën e përjetshme. Jezusi na thotë në Ungjill, “Sepse unë jetoj, edhe ju do të jetoni.” (Gjoni 14:19).

Jezusi e mbylli hendekun në mes qiellit dhe tokës:

Mund të shihni tani, mik i dashur, përse Biri i Perëndisë Jezusi erdhi si Njeri-Perëndi unik. Ai është Shpëtimtari ynë sepse mbylli plotësisht hendekun në mes qiellit (Perëndisë) dhe tokës (njeriut). Ai bëri të mundur pajtimin në mes njeriut mëkatar dhe Perëndisë së Shenjtë. Për këtë arsye, Ungjilli deklaron, “Dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtohemi.” (Veprat 4:12). Jezusi theksoi qartë: “Unë jam dera; nëse dikush hyn nëpërmjet meje, do të shpëtohet.” (Gjoni 10:9). Jezusi më tutje deklaroi: “Unë jam udha e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje.” (Gjoni 14:6). Bibla na siguron: “Mbasi qëndron për jetë të jetës... prandaj edhe mund t’i shpëtojë plotësisht ata që me anë të tij i afrohen Perëndisë, sepse gjithmonë rron që të ndërmjetësojë për ta.” (Hebrenjve 7:24-25).

Jezusi e përmbush etjen tonë shpirtërore:

Jezusi tha: “Unë kam ardhur që të kenë jetë dhe ta kenë me bollëk.” (Gjoni 10:10). Perëndia na ka krijuar në një mënyrë të tillë që kurrë nuk do të jemi të kënaqur, të kemi një kuptim të plotësisë apo përjetimit të jetës në tërësi, derisa të kemi marrëdhënien e drejtë me të. Pastaj do të përjetojmë prezencën dhe shpëtimin e tij në jetët tona në një mënyrë të vërtetë, të thellë dhe personale.

Jezusi gjithashtu deklaroi se mund të përmbushë përmallimin tonë më të thellë shpirtëror. Ai tha: “Unë jam buka e jetës; kush vjen tek unë nuk do të ketë më kurrë uri dhe kush beson në mua, nuk do të ketë më kurrë etje.” (Gjoni 6:35). “Nëse dikush ka etje, le të vijë tek unë e të pijë.” (Gjoni 7:37).

CILI ËSHTË VENDIMI JUAJ?

Jezusi u flet të gjithë njerëzve nëpërmjet Ungjillit. Ai të fletë ty, miku im mysliman, sepse të do. Jezusi premtoi: “Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t’iu jap çlodhje.” (Mateu 11:28).

Jezusi vetë është “drita” për ata që e kërkojnë. Jezusi dëshiron t’iu udhëheq dhe ndihmojë në zbulimin e qëllimit të jetës suaj. “Dhe Jezusi u foli atyre përsëri duke thënë: "Unë jam drita e botës; kush më ndjek nuk do të ecë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës.” (Gjoni 8:12).

Jezusi na ofron ty dhe mua: “Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: Kush beson në mua ka jetë të përjetshme.” (Gjoni 6:47).

Dashuria supreme e Perëndisë na tërheq pranë tij:

Mik i nderuar, qëllimi i shkruarjes së këtij libri është për të të ndihmuar të zbulosh që dashuria është atributi më i lartë i Perëndisë. Unë ju lutem që të besoni fjalën e Perëndisë dhe të bëni një hap besimi. Unë nuk mundem në mënyrë adekuate të përshkruaj apo të përkufizoj dashurinë e thellë dhe të përjetshme për ju. Unë e di nga përvoja ime personale se në momentin kur ju besoni në Jezusin si Shpëtimtarin dhe Zotin tuaj, ju gjithashtu do të përjetoni dhe shijoni brenda zemrës dhe shpirtit tuaj dashurinë e tij të madhe dhe të mrekullueshme për ju. Perëndia dëshiron t’u bëjë të lumtur. Ai dëshiron ta mbushë jetën tuaj me gëzim, dashuri, shpresë dhe paqe. Perëndia dëshiron të ketë marrëdhënie me ju, për të përmbushur qëllimin e përjetshëm të tij. Perëndia është duke të folur ty në këtë moment: “Po, të kam dashur me një dashuri të përjetshme; prandaj të kam tërhequr me dashamirësi.” (Jeremia 31:3).

Shkrimi më i përmendur në mbarë Biblën është Gjoni 3:16, që i flet çdo zemre:

“Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.”

Sepse Perëndia -----dashuruesi më i madh
E deshi aq -----shkalla më e lartë
Botën ----- shoqërimi më i madh
Sa dha ----- vepra më e madhe
Birin e tij të vetëmlindurin ----- dhurata më e madhe (Jezusi)
Që kushdo ----- mundësia më e madhe
Beson ----- thjeshtësia më e madhe
Në të ----- atrakcioni më i madh
Të mos humbasë ----- premtimi më i madh
Por ----- ndryshimi më i madh
Të ketë ----- siguria më e madhe

Jetë të përjetshme ----- posedimi më i madh

Miku im, Perëndia ynë i dashur është i përmalluar për shoqërimin tënd. Ai të zgjodhi ty – tani zgjedhja është *jojae*. Romakëve 10:8-9 na tregon si të shpëtohemi: “Fjala është pranë teje, në gojën tënde dhe në zemrën tënde”. Kjo është fjala e besimit, që ne predikojmë; sepse, po të rrëfesh me gojën tënde Zotin Jezus, dhe po të besosh në zemrën tënde se Perëndia e ngjalli prej së vdekurish, do të shpëtohesh.” Shpëtimi juaj varet nga vendimi juaj. Nëse vendosni të vëni besimin tuaj në Jezusin si Zot dhe Shpëtimtarin tuaj, këtu është një lutje e sugjeruar personale dhe specifike. Thuaje nëse e mendon me gjithë zemrën tënde:

Lutja e sugjeruar për ta pranuar Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar:

“Perëndi dëshiroj të të njoh ty dhe dashurinë tënde të mrekullueshme për të cilën kam lexuar. Dëshiroj ta përjetoj dashurinë tënde. Unë e di që jam mëkatar. Falemnderit, Jezus, që vdiqe dhe more vendin tim në kryq për mëkatet e mia. Jezus, unë besoj që ti je Perëndia i manifestuar në mish. Unë lutem që të vish në zemrën time. Më fal dhe më pastro nga mëkatet e mia, dhe bëhu Shpëtimtari, bëhu Zoti im. Më ndihmo të ec me Perëndinë, dhe t’i nënshtrohem vullnetit të tij çdo ditë. Unë lutem për këtë me gjithë zemrën time. Amen.”

Nëse e ke bërë këtë lutje, më lejoni që të jem i pari t’iu uroj mirëseardhje në familjen e përjetshme të Perëndisë. Dëshiroj t’iu uroj për kryerjen e vendimit më të mirë dhe më të rëndësishëm në jetën tuaj - për ta pranuar mrekullinë e jetës së përjetshme me Perëndinë!

Ecja në jetën e re me Perëndinë:

Vëlla apo motër e nderuar në Krisht, tani pasi jeni rilindur, ju lutem keni vëmendje ndaj këtyre gjërave mjaft të rëndësishme. Së pari, gjeni një kishë në të cilën në mënyrë besnike mësohet fjala e Perëndisë. Është esenciale t’i bashkohesh një kishë rilindëse (ungjillore), që mëson se një person duhet të rilindet përsëri nëpërmjet Shpirtit të Perëndisë. Dhe të lutem ji i kujdesshëm se ekzistojnë grupe kishtare të cilët proklamojnë të jenë të krishterë por janë ndjekës të Jezusit jobiblik. Këta të ashtuquajtur “të krishterë” nuk i ndjekin mësimet fundamentale biblike. Bibla i quan ata “ujq në veshje të deleve.”

Në vijim, është e rëndësishme të lexosh Biblën çdo ditë. Është Fjalë e plotë e Perëndisë, e frymëzuar dhe e besueshme! Dhe mbani mend të kaloni kohë në prezencën e Zotit në lutje që të rriteni shpirtërisht.

Edhe pse të gjithë do të ballafaqohemi me vështirësi në jetë, Perëndia premton se do jetë me ne, dhe ai do bëjë që të gjitha gjërat të bashkëveprojnë për të mirën tonë. (Romakëve 8:28).

Në përfundim, mik i krishterë, tani jeni në fillim të udhëtimit të të zbuluarit të jetës frytdhënëse, kuptimdhënëse dhe të një jete të pasur të cilën Perëndia e krijoi për ju që ta jetoni. Duke ecur me Perëndinë çdo ditë ju do të përjetoni premtimet e Perëndisë për ju.

Dhe ju do të përjetoni bekimet e mrekullueshme që Perëndia ka për ju dhe d-a-s-h-u-r-i-n-ë m-a-h-n-i-t-ë-s-e !

SHTOJCË

Abdullah Ibn Abas

(Shoqërues i Muhamedit)

Ai ia dedikoi veten e tij shërbimit të profetit Muhamed. Ai ishte i vëmendshëm dhe vigjilent ndaj çdo gjëje që vepronte dhe thoshte Muhamedi. Ai u bë njëri prej shoqëruesve më të mësuar të profetit. Profeti lutej që Abdullah Ibn Abasit të jepej jo vetëm njohuria dhe të kuptuarit por edhe urtësia. Profeti do të lutej shpesh: “O Zot, mundësoi atij që të fitojë kuptim të thellë të religjionit të islamit dhe udhëzoje atë në nënkuptimin dhe interpretimin e gjërave.” Kalifi, Umar Ibn Al-Khatab, shpesh shquante këshillat e tij ndaj çështjeve të rëndësishme të shtetit dhe përshkruante atë si “djalë të pjekurisë.”

(*Companions of the Prophet #2*, publikuar nga MELS, 61
Alexandra Road, Hendon, London, NW42RX. Abdul Wahid Hamid 1995, 1998).

Al-Bukhariu

(Përshkrues i Hadithit, që përmban fjalët dhe veprimet e Muhamedit)

Përkujtoni që ne po e përdorim përkthimin e volumit të nëntë të Hadithit (nga Al-Bukhariu) bërë nga Dr. Muhammad Muhsin Khan të titulluar *Përkthimi i kuptimeve të Sahih Al-Bukhariut*, botuar nga Dar AHYA US-Sunnah Al NabbaWiya. Ky përkthim është i rekomanduar dhe i aprovuar nga të gjitha autoritetet myslimane, duke nënkuptuar edhe prijësit shpirtëror të Mekës dhe Medinës. Parathënia e përkthimit të Dr. Khanit (Volumi 1) thekson që është pajtuar unanimisht që vepra e Al-Bukhariut është më autentike nga të gjitha veprat e literaturës së Hadithit të vendosura bashkë. Autenciteti i veprës së tillë shprehet edhe nga dijetarët e islamit në lidhje me të: “Libri më autentik pas librit të Allahut (Kuranit) është Sahih Al-Bukhariu.” (faqja XV e Vol. 1).

LITERATURA

Kujtoni që të gjitha referencat e librave islamike të përshkruara më poshtë janë të njohura ndërkombëtarisht në botën myslimane. Ato janë ribotuar çdo vit dhe shpërndarë në bibliotekat muslimane mbarëbotërore.

- Abdul-Haqq. Abdiyah Akbar. *Christ in the New Testament and the Qur'an*, Abdul-Haqq, Evanston, USA (1975)
- Abdul-Haqq. Abdiyah Akbar. *Sharing Your Faith With a Muslim*, Bethany Fellowship, Minneapolis, USA (1980)
- Abi Hanifah. Imam, *Al-Fiqh al-Akbar*, Dar al-Kutub al-Elmeyah, Beirut (1979)
- Al-Ahadith Al-Qudsiyyah. *Divine Narratives*, Translated by Dr. Abdul Khaliqkazi and Dr. Alan B. Day, Dar Al-Iman Publishing House, Tripoli-Lebanon
- Al-Baidawi. *Commentary on the Qur'an*, Dar Al-Kotob Al-Ilmiyah, Beirut, Lebanon (1999)
- Al-Ghazzali. *The Ninety-Nine Beautiful Names of God (AL-Maqsad AL-Asna)*, Translators David Burrell and Nazih Daher, Cambridge, U.K., The Islamic Texts Society (1992)
- Al-Qartaby. *Commentary on the Qur'an*, Dar Al-Kotob Al-Ilmiyah, Beirut, Lebanon (1996)
- Al-Qasemi. *Tafsir (Commentary) of the Holy Qur'an*, Abbreviation to Tafsir Al-Qasemi (Mahasen At-Ta aweel), Dar Al-Nafaas, Beirut, Lebanon (1993)
- Al-Razi. *Tafsir-Al Kabir*, vol. 3, section 7,8, & 9, pub. Dar Ehia Al-Tourath Al-Suyuti Al-Arabi, Beyrouth, Liban (Lebanon) , Rue Dakkache (1999)
- AL-Itqan in Qur'an's Science (AL-Itqan)*, dar Al-ketab-Al-Araby, Beirut, Lebanon (1999)
- Alam, Maulana Syed Mohammad Badre. *Descension of Jesus Christ*, Dini Book, Urdu Bazaar, Dehli, India (1974)
- ALIM. Release 4.5, ISL Software Corporation (1996) — *The Hadith*
- Ali, Abdullah Yusuf. *The Meaning of the Holy Qur'an*, Eighth Edition, Amana Publications, Beltsville, Maryland, USA, (1996)
- Al-Zamkhashri, *The Kash-Shaf*, Dar Al-Ketob Al-Elmiyah, Beirut, Lebanon (1990)
- Anderson, M. *Jesus, the Light and Fragrance of God*; Three Volumes, Pioneer Book Company, Caney, Kansas, USA (1994)
- Anderson, M. *The Trinity*; Pioneer Book Company, Caney, Kansas, USA (1994)
- Arberry, A.J. *Revelation and Reason in Islam*, George Allen & Unwin Ltd., London, United Kingdom
- Assfy, Z. *Islam and Christianity*, William Sessions Ltd., York, United Kingdom (1977)
- AT Tabari. *The Book of Religion and Empire*, Law Publishing Company, Lahore, Pakistan.
- AT Tabari. *Commentary on the Qur'an*, dar Al-ketob-Al-Ilmiyah, Beirut, Lebanon (1999)
- Bevan, J. *Christianity Explained to Muslims*, YMCA Publishing House, Calcutta, India (1952)
- Bhai, Abdullah. *AL-Masih - the Anointed One*; CMM, Springfield, Missouri, USA
- Boice, James Montgomery. *Foundations of the Christian Faith*; Intervarsity Press, Owners Grove, Illinois, USA (1981)
- Brown, D. *The Divine Trinity, Christianity and Islam*, Sheldon Press, London, United Kingdom (1967)
- Broyles, C.C. "The Redeeming King: Psalm 72's Contribution to the Messianic Ideal," in Evans, C.A. and Flint, P.W., *Eschatology, Messianism and the Dead Sea Scrolls*, ed., Williams B.Eerdmans Publishing Company, Grand Rapids, Michigan USA (1997)
- Bruce, F.F. *The New Testament Documents: Are They Reliable?*, Inter Varsity Press, Downers Grove, Illinois (1943, rev. 2000)
- Burrows, Millar. *The Dead Sea Scrolls*, The Viking Press, New York, New York, USA (1955)
- Chapman, Colin. *You Go and Do the Same: Studies in Relating to Muslims*, CMS, London, United Kingdom, 1983.
- Cragg, K. *Jesus and the Muslim*, George, Allen and Unwin, London, United Kingdom (1985)
- Crawford, Craig. *The Prophecies: A Journey to the End of Time*, Prophecy Press (1999)
- Durrani, Dr. M.H. *The Qur'anic Facts About Jesus*, International Islamic Publishers, Karachi, Pakistan (1983)
- Enns, Paul P. *The Moody Handbook of Theology*; Moody Press, Chicago, USA (1989)
- Ersen, Ishak. *Jesus Christ in the Traditions of Islam*; Light of Life, Villach, Austria (1992)
- Fadi, Abd Al. *Sin and Atonement in Islam and Christianity*, Markaz-ash-Shabiba, Beirut, Lebanon
- Geisler, Norman and Nix, William. *From God To Us: How We Got Our Bible*, Moody Press, Chicago, Illinois (1974)
- Ghabril, Nicola Jacob. *Themes for the Diligent: The Good Way*, Rikon, Switzerland
- Gilchrist, John. *The Christian Witness to Muslims*, Roodepoort Mission Press, Roodepoort, Republic of South Africa (1988)
- Goldsock, W. *Christ in Islam*, The Christian Literature Society, Madras, India (1905)
- Guillaume, A. *Life of Muhammad*, A Translation of Ibn Ishaq's SIRAT ARASUL, London, United Kingdom (1955)
- Hafiz, Sheikh-Ul-Hadith Maualana and Kandhalwi, Muhammad Zakariyya. *Teachings of Islam: Stories of the Sahaabah* (rev. Trans. of the Urdu book *Hikayat-e-Sahaabah*) (from five books) Translated by Abdul Rashid Arshad, library of Islam, Des Plaines, IL 60017 (pub. date unknown)
- Hahn, E. *Jesus in Islam*, (publishing house not available), Vaniyamki, India (1975)

Halverson, Dean C. (general editor), *The Compact Guide to World Religions*, International Students, Inc., Bethany House Publishers, Minneapolis, Minnesota, USA (1996)

Hanifah, Imam Abi. *Al-Fiqh al-Akbar*, Dar AL-Kutub al-elmeyah, Beirut, Lebanon (1997)

Harman, Henry, M. *Introduction to the Study of the Holy Scriptures*, Volume I, Hunt and Eaton, New York, New York, USA (1878)

Hughes, Thomas P. *A Dictionary of Islam*, Lahore, Pakistan: ThePremier Book House (reprint, 1986)

Imran, Maulana Muhammad. *The Teachings of Jesus in the Light of A-Qur'an*, Malik Sirajuddin and Sons, Kashmiri Bazar, Lahore, Pakistan (1980)

Jadeed, Iskander. *Did God Appear in the Flesh?* The Good Way, Rikon, Switzerland

Jadeed, Iskander. *How to Share the Gospel with Our Muslim Brothers*, Light of Life, Villach, Austria

Jadeed, Iskander. *The Cross in the Gospel and Qur'an*, Markaz-ash- Shabiba, Beirut, Lebanon

Jalalan, AL. *Commentary of AL Jalalan*, Al Azhar – supervision (1983)

Josephus, Flavius. *The Complete Works of Josephus*, translated by Whitson, W., edition 1981 (original translation dated 1960), Kregel Publications, Grand Rapids, Michigan, USA (1981)

Kateregga, Badru D. and Shenk, David W. *A Muslim and A Christian in Dialogue*, Herald Press, PA, USA (1997)

Kateregga, Badru D. and Shenk, David W. *Islam and Christianity*, Uzima Press Ltd., Kenya (1980)

Khalid Muhammad Khalid. *The Successor of the Prophet*, DarThabet (1986)

Khalikqazi, Abdul, and Day, A.B. *Al-Ahadith AL-Qudsiyyah*, Dar Al-Iman Publishing House, Tripoli-Lebanon

Khan, Muhammad Muhsin. *The Translation of the Meanings of Sahih Al-Bukhari* (Arabic-English, 9 Volumes), pub. by Dar AHYA Us-Sunnah (1971)

Kramers, J.H. *Shorter Encyclopedia of Islam*, (publishing house not noted), New York, New York, USA (1961)

Larson, Gary N. *The New Unger's Bible Handbook*, revised, Moody Press, London, United Kingdom (1984)

Lockyer, Herbert. *All the Messianic Prophecies of the Bible*, Zondervan Publishing House, Grand Rapids, Michigan (1973)

Maurer, Andreas. *Illustrations, Parables and Stories*, MERCSA, Republic of South Africa (1994)

McDowell, Josh. *The New Evidence That Demands A Verdict*, Thomas Nelson Publishers, Nashville, Tennessee (1972, rev. 1999)

Morin, Harry. *Responding to Muslims*, CMM, Springfield, Missouri, USA (1994)

Morris, Henry M. *Science and the Bible*, Moody Press, Chicago, Illinois (1986)

Nurbakhash, Javad. *Jesus in the Eyes of the Sufis*, Khaniqahi-Nimatullahi Publications, London, United Kingdom (1983)

Obaray, A.H. *Miraculous Conception, Death, Resurrection and Ascension of Jesus as Taught in the Kuran*, Kimberley, Republic of South Africa (1962)

Orethke, J.P. *A Christian Approach to Muslims*, William Carey Library, Pasadena, USA (1979)

Parrinder, G. *Jesus in the Qur'an*, Oxford University Press, New York, New York, USA (1977)

Payne, J. Barton, *Encyclopedia of Biblical Prophecy*, Fifth Edition, Baker Book House, Grand Rapids, Michigan, USA (1987)

Pfander, C.G. *Balance of Truth*, Light of Life, Villach, Austria (1986)

Pickthall, Mohammad Marmaduke. *The Meaning of the Glorious Qur'an*, DAR AHYA US-Sunnah AL-Nabawiya (1930)

Qaradawi, al-. Yousef, Elewah Mostafa and Ali Gammar, *t-Twahid*, Qatar, (1968)

Register, R.G. *Dialogue and Interfaith Witness with Muslims*, Moody Books, Inc., Chicago, Illinois, USA (1979)

Robertson, K.G. *Jesus or Isa*, Vantage Press, New York, New York, USA (1983)

Robson, J. *Christ in Islam*, John Murray, London, United Kingdom (1929)

Ryrie, Charles C. *Basic Theology*, Moody Press, Wheaton Illinois, USA (1981)

Schaff, Philip. *The Creeds of Christendom: with History and Critical Notes*, Schaff, David, S., ed., *The History of the Creeds*, Volume 1, Baker Book House, Grand Rapids, Michigan, USA (1983)

Shahid, Dr. Samuel. *The Fallen Nature of Man in Islam and Christianity*, AL-Nour, Colorado Springs, Colorado, USA (1989)

Smith, Chuck. *Answers for Today*, The Word for Today, Costa Mesa, California, USA (1993)

Smith, John Pye. *The Scripture Testimony to the Messiah*, William Oliphant and Company, Edinburgh, Scotland (1859)

Smith, Wilbur M. *Therefore Stand: Christian Apologetics*, Grand Rapids: Baker Book House (1965)

Tisdail, William St. Clair. *Christian Reply to Muslim Objections*; Light of Life, Villach, Austria (1904)

Walfson, Harry Austryn. *The Philosophy of the Kalam*, Harvard University Press (1976)

Walvoord, John F. *Every Prophecy of the Bible*, Cook Communications, Colorado Springs, Colorado (1990, rev. 1999)

Wismer, D. *The Islamic Jesus*, Gerland Publishing, Inc., New York, USA (1977)

Zwemer, S. *The Moslem Doctrine of God*, Oliphant, Anderson and Ferrier, London, United Kingdom (1905)

Zwemer, S. *The Moslem Christ*, Oliphant, Anderson and Ferrier, London, United Kingdom (1912).

REFERENCAT

Siç u citua më herët, të gjitha referencat e librave Islamikë të radhitura më poshtë janë të pranura ndërkombëtarisht në botën myslimane. Ato janë ribotuar çdo vit dhe shpërndarë në bibliotekat mbarëbotërore myslimane.

Kapitulli një:

1. Hadithi (Traditat) janë gojëdhënat e përshkruara, dhe veprimet e Muhamedit, profetit të Islamit. Përshkrimet janë nga gratë e tij, shoqëruarit, antarët e familjes, dhe prijësit Islamikë. Shumica e dijetarëve myslimanë të botës besojnë që koleksionet e Hadithit, të Al-Bukhariut dhe Muslimit, konsiderohen si të shenjta në vijim të Kuranit. Prandaj, Hadithi është burimi i dytë i autoritetit religjioz Islamik pas Kuranit.
2. Chapman, Colin. *You Go and Do the Same: Studies in Relating to Muslims*. CMS, London, United Kingdom, 1983, fq.53.

Kapitulli dy:

1. Hughes, *Hughes' Dictionary of Islam*, fq. 62.

Kapitulli tre:

1. Shenk dhe Kateregga, *A Muslim and A Christian in Dialogue*, fq. 142
2. Shiko Literaturën (McDowell).
3. Geisler dhe Nix, *From God to Us: How We Got Our Bible*, fq. 139
4. Shiko Literaturën (Bruce, Geisler dhe Nix).
5. McDowell, Josh, *The New Evidence That Demands a Verdict*, fq.193.
6. Shiko Literaturën (Morris).
7. See Literaturën (Walvoord).
8. Harman, H.M., *Introduction to the Study of the Holy Scriptures*, fq.488.
9. Ibid, fq. 465.
10. Ibid, fq. 464-465
11. Ibid, fq.463-464
12. Barrows, M., *The Dead Sea Scrolls*, fq. 73-101.
13. Broyles, C.C., *The Redeeming King: Psalm 72's Contribution to the Messianic Ideal*, fq. 23-25.
14. Harman, fq. 52

Kapitulli pesë:

1. Abdullah Yusuf Ali, në shënimin 47 të tij sqaron që fuqia e vullnetit e shfrytëzuar drejt e sjellë njeriun më afër natyrës së Perëndisë. (Kujtoni që përkthimi i Abdullah Yusuf Ali është bërë pa mëdyshje përkthimi më i popullarizuar gjer tani i Kuranit në gjithë anglize në botën myslimane.)
2. Kassis, *A Concordance of the Qur'an*, fq. 483
3. Pickthall, *The Meaning of the Glorious Qur'an*, fq. 47
4. Abdullah Yusuf Ali, *The Meaning of the Holy Qur'an*, Shënimi 53
5. Kassis, *A Concordance of the Qur'an*, fq. 595
6. Kujtoni që *Hadithi* është i njohur si *Traditë* myslimane dhe është një rrëfim i asaj çfarë tha dhe bëri Muhamedi. Konsiderohet si një shprehje e zbulësës hyjnore. Është pranuar si burim kryesor i besimit dhe praktikës Islamike dhe është i dyti në autoritet vetëm ndaj Kuranit.
Sahih AL-Bukhari, Vol. 8, Hadith No. 611 (përkthimi i Khanit dhe ALIM'it).
Sahih AL-Bukhari, Vol. 9, Hadith No. 423 (përkthimi i Khanit dhe ALIM).Ibid, 4:552

Kapitulli gjashtë:

1. Smith, Chuck, *Answers for Today*, fq.. 128
2. *Sahih AL-Bukhari*, Vol. 8, Hadith No. 238 (përkthimi i Khanit dhe ALIM).
3. Ibid, 4:501

Kapitulli tetë:

1. AT Tabari, *Commentary on the Qur'an*, shënimet 29466-29468
2. Abdullah Yusuf Ali, *The Holy Qur'an*, faqe 1149, shënimi 4096

Kapitulli dhjetë:

1. McDowell, Josh, *The New Evidence That Demands a Verdict*, fq.201.

2. Shiko Literaturën (Lockyer).
3. SHËNIM: Fjala arabe “Injeel” nënkupton “Lajm i Mirë,” dhe shfaqet shpeshherë në faqet e Kuranit. Fjalë tjetër për ungjillin është “evangjel” që është një fjalë ardhur nga greqishtja “evangelion.” Në gjuhën arabe është Ingjil. Prandaj, “Ingjili” apo “Lajmi i Mirë” është Libri i Shenjtë lidhur me Al-Masih Isa.
4. AL-Baidawi komenton rreth s. 2:253

Kapitulli njëmbëdhjetë:

1. Al-Razi, komentim rreth s. 3:39
2. Yousef al-Qaradawi dhe të tjerët, *t-Twahid*, fq. 98
3. Subki, *At-tabaqat al Shafe' eiah al-Kubr*, Vol. 6. fq. 235
4. Harry Austryn Walfson, *The Philosophy of the Kalam*, Harvard University Press, 1976, fq. 251; cituar nga Vëllimi Fisal, II, fq.5-6; dhe Vol. III, fq. 5.
5. Ibid, fq. 240-241 cituar nga AL-Tabari, *Annals*, Fq. 118, Volumi II. fq. 10-11

Kapitulli dymbëdhjetë:

1. *Al-Ahadith Al-Qudsiyyah, Divine Narratives*, Hadith 112, faqe 156-157
2. Abdullah Yusuf Ali, Shënim 5365

Kapitulli trembëdhjetë:

1. Fjala shpërblim “shpërblim” nënkupton “të blesh prapa.” Është një pagesë e kërkuar për lirimin e të robëruarit.
2. “Shpengim” është definuar në fjalor: të lirohesh apo shpëtohesh duke paguar një çmim apo të lirohesh nga pasojat e mëkatit.
3. Halverson, D.C., *The Compact Guide to World Religions*
4. Sahih Al-Bukhari, Vol. 2, Hadith No. 51 (Përkthimi i Khan'it).
5. Al-Qasemi, *Commentary of the Holy Qur'an* (në s. 3:45).

Kapitulli katërbëdhjetë:

1. *Sahih AL-Bukhari*, 4:501 (Përkthimi ALIM dhe Khan).
2. *Al-Itqan*
3. Sahih Al-Bukhari, Vol.5, Tradition No. 266 (Përkthimi i Khanit).
4. Referohu në *The Successors of the Apostle*, Khalid Muhammad, Khalid, fq. 93.
5. AL Jalalan
6. Sahih Al-Bukhari, Vol. 8, Tradition No. 470 (Përkthimi i Khan'it).
7. Sahih Al-Bukhari, Vol.7, Tradition No. 577 (Khan's Translation)

Kapitulli pesëmbëdhjetë:

1. Assfy, *Islam and Christianity*, fq.6
2. Halverson, Ibid.
3. Kateregga dhe Shenk, *Islam and Christianity*, fq. 19
4. Ibid, fq. 97, 98
5. John Gilchrist, *The Christian Witness to Muslims*, fq. 337.

Kapitulli shtatëmbëdhjetë:

1. *Sahih AL-Bukhari* 6:71 (Përkthimi ALIM dhe Khan).

Kapitulli tetëmbëdhjetë:

1. *Sahih Al-Bukhari*, 4:506 (Përkthimi ALIM dhe Khans.)
2. *Sahih AL-Bukhari*, Vol. 8, Hadith No. 891 (Përkthimi Khan).
3. *Sahih AL-Bukhari*, 4:501 (Përkthimi ALIM dhe Khan).
4. *Sahih AL-Bukhari*, 8:319 (Përkthimi ALIM dhe Khan).
5. Ibid, 8:379 (Përkthimi ALIM dhe Khan).
6. Ibid, 5:715: “O Allah! Më fal mua, dhe vendose mëshirën tënde mbi mua...” (Përkthimi ALIM dhe Khan).
7. *Towards an Islamic Christology II*, The Muslim World, Vol. LXX, No. 2, April 1980, P. 93
8. AL-Baidawi, komentim rreth s. 5:110

Kapitulli nëntëmbëdhjetë:

1. Shukani, *Fath al-Qadir*.
2. AL-Razi, *AL-Tafsir Al-Kabir*.

Kapitulli njëzet:

1. Parrinder, G. *Jesus in the Qur'an*, fq. 121
2. Abdullah Yusuf Ali, Shënim 2469

3. Obaray, *Miraculous Conception, Death, Resurrection and Ascension of Jesus as Taught in the Qur'an*, fq. 45
4. Universiteti i Azharit në Egjipt është konsideruar si dritë e Islamit për mbarë botën Islame.
5. Dr. Mahmud Shaltut, *Quoted in the Muslim World*, xxxiv, fq. 214f
6. Abdullah Yusuf Ali, Shënimi 663
7. Ibid, Shënimi 664
8. Maududi, *The Meaning of the Qur'an*, fq.390
9. Daryabadi, *The Holy Qur'an*, Volume 1, faqe 96-A

Kapitulli njëzetënjë:

1. *DAR AL HALAL*
2. Flavius Josephus, *The Complete Works of Josephus*, p. VI-IX, *Antiquities of the Jews*, Book XVIII, Kapitulli III, Pjesa 3
3. Ibid, p. 379.
4. McDowell, Josh, *The New Evidence that Demands a Verdict*, Fq. 216-217.
5. Shiko Literaturën (Smith, W.) fq. 425-426.

Kapitulli njëzetetre:

1. Abdullah Yusuf Ali, Shënimi 4662
2. Alam, Nuzul Esa: *Descencion of Jesus Christ*, fq. 37
3. *Sahih AL-Bukhari*, Vol. 4, Hadith No. 657, gjithashtu Vol. 3, No. 425 (Përkthimi ALIM dhe Khan).
4. *Sahih Muslim*, Përkthimi Anglez, Hadith No. 7037
5. *Sahih Al-Bukhari*, Anglisht-Arabisht, 2:459
6. Ibid, 9:243 (Përkthimi ALIM dhe Khan).
7. *Sahih Muslim*, Hadith No. 6924 (ALIM).
8. *Sahih Muslim*, Hadith No. 7015 (ALIM).
9. Ibid; Hadith No. 7000

Kapitulli njëzetepesë:

1. Al-Qartaby, komentim rreth s. 4:171

Kapitulli njëzetegjashtë:

1. Halverson, D.C., *The Compact Guide to World Religions*
2. AL-Ghazzali, *Ihya' Ulumed-Din*, 4:263
3. Shaarani, *Book of Yamakeet*, fq. 11
4. Imam Abi Hanifah, *Al-Fiqh al-Akbar*, fq.33
5. Parrinder, G., *Jesus in the Qur'an*.
6. Schaff, Philip, *The Creeds of Christendom: with a History and Critical Notes*.

Kapitulli njëzeteshtatë:

1. Cragg, A. Kenneth, *The Call of the Minaret*, fq. 290
2. Abdullah Yusuf Ali, Shënimi 4679

Kapitulli njëzetetetë:

1. Ibn Ishak ishte një dijetarë i hershëm Islamik. Ai la prapa dy vepra të rëndësishme rreth jetës së Muhamedit. Vepra e tij edhe sot konsiderohet një burim esencial për këdo që dëshiron të mëson lidhur me jetën e Muhamdit dhe shoqëruesit e tij.
2. A. Guillaume, *Life of Muhammad*, Përkthim i Ibn Ishak SIRAT ARASUL, fq. 657
3. Al-Razi, *AL-Tafsir AL-Kabir*, komentim rreth 3:39, fq. 211
4. Ibid
5. Ibid
6. Ibid
7. Al-Razi, *AL-Tafsir AL-Kabir*, komentim i s. 19:7.

Kapitulli njëzetentë:

1. Hafiz dhe Kandhalwi, *Teachings of Islam*, kap. II, fq. 41.
2. Ibid
3. Ibid (kap. VII, fq. 128)
4. Ibid (Umar, kap. II, fq. 42).
5. *The Kash-Shaf* of the AL- Zamkhashri, vol. 3, fq. 187 (Shiko gjithashtu AL Jalalan).
6. Al-Ghazzali, *Ninety-Nine Names of God in Islam*, fq.91.
7. Al-Ghazzali, *Ninety-Nine Names of God in Islam*, fq.91.

MIRËNJOHJET

Fjalët e mia nuk mund ta përshkruajnë mirënjohjen dhe falënderimin ndaj Perëndisë tim të Gjallë, i cili më udhëhoqi dhe më mundësoi t'i shërbej nëpërmjet këtij libri. Gjithashtu falënderoj Chuck Smith-in, Pastor Senior i Calvary Chapel të Costa Mesa-së, dhe Pastorin ndihmës Brian Broderson, për asistencën e tyre në shërbimin tim ndaj njerëzve të çmuar myslimanë. Gjithashtu falënderoj Perëndinë për Udhëheqjen e Southern Baptist, për partneritetin e tyre në shërbesë.

Të falënderoj Marilyn Taner, për përpunimin, korrekturën dhe redakturën e tekstit. Shpirti juaj gëzimplot, karakteri juaj, dhe dëshira e sinqertë për të shërbyer Zotin e bëri këtë libër të këndshëm.

Falënderoj Gabriel Straight-in për sigurimin e përkrahjes teknike të këtij libri dhe shërbesës sonë. Falënderit Carl Westerlund, Drejtor i Shkollës Shërbesore të Calvary Chapel, dhe Pastor Brian Broderson për redaktimin përfundimtar të këtij libri.

Falënderime të veçanta Bob Baldwinit për kontributin e tij bujar për kryerjen e këtij libri.

LIDHUR ME AUTORIN

Samy Tanagho tani shërben si drejtor i “Good Shepherd World Evangelism,” një organizatë krishtere protestante jodenominacionale. Ai ligjëron rreth temës, “Si ta komunikojmë Lajmin e Mirë të Shkrimeve krishtere në mënyrë efektive ndaj myslimanëve.” Ai ka dhënë seminare dhe në kisha të shumta të Amerikës dhe vende tjera. Zoti është duke vazhduar t’i sigurojë mundësi Samy-t për të ndarë njohurinë dhe pasionin e tij.

Ftesë

Edhe sot premtimi i Zotit mbetet i vlefshëm:

Unë do të derdh ujë mbi atë që ka etje dhe rrëke mbi tokën e thatë; do të derdh Frymën time mbi pasardhësit e tu dhe bekimin tim mbi trashëgimtarët e tu.

Jezus Krishti tha:

“Nëse dikush ka etje, le të vijë tek unë e të pijë. Ai që beson në mua, siç ka thënë Shkrimi, nga brendësia e tij do të burojnë lumenj uji të gjallë.”

Por këtë ai e tha për Frymën, që do të merrnin ata që do të besonin në të. Gjoni 7:37-39

Zoti fton shqiptarët kudo - në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Greqi, dhe në mërgim - të vijnë tek Ai dhe të pinë:

“Ai që ka etje, le të vijë; dhe ai që do, le të marrë si dhuratë ujin e jetës.” Zbulesa 22:17

Lexues, a pive ti prej Atij?

UNGJILLI

JEZUS KRISHTI THA: *Unë jam i Pari dhe i Fundit, i Gjalli! Isha i vdekur dhe, ja, jam i gjallë për shekuj të shekujve dhe unë i kam çelësat e Vdekjes dhe të Nëntokës.*

Dhe: Unë jam Ringjallja dhe Jeta: *kush beson në mua, edhe nëse vdes, do të jetojë. Edhe kush jeton e beson në mua, nuk do të vdesë kurrë.*

A e beson ti këtë?

Jezusi është Biri i Perëndisë, Mesia. Shpëtimtari ynë duhet të jetë Biri i Perëndisë, jo vetëm njëfarë shpëtimtar njerëzor. Përse?

Në Bibël lexojmë: "Paga e mëkatit është vdekja." Kur Perëndia flet për vdekjen, shpeshherë kuptohet vdekje e përjetshme, e përhershme, në të cilën njeriu është i ndarë prej Perëndisë në ferr; kjo vdekje është dënimi i mëkatit. Dhe të gjithë mëkatuan.

Por Perëndia aq fort e deshi botën sa që e dha një të vetmin Birin e vet kështu që, secili që beson në të, mos të humbet, por ta ketë jetën e pasosur. E dërgoi Birin që bota të shpëtojë përmes të. Kush beson në të, nuk dënohet, por ka jetën e pasosur.

Ne jemi njerëz; është njeriu që ka mëkatuar, pra duhet që një njeri të vdesë për mëkatin njerëzor. Jezusi, burrë i vërtetë dhe plotësisht njerëzor (por pa mëkat), e mori vendin e mëkatarëve kur vdiq mbi kryq, dhe e pranoi dënimin dhe gjykimin e Perëndisë kundër mëkateve të tyre. Ja përse është e mundur për Perëndinë, i cili është krejtësisht i drejtë, që të falë mëkate. Besimtarët pranojnë ndjesë, me anë të besimit në Jezusin, sepse të gjitha mëkatet e tyre u dënuan plotësisht kur vdiq Zoti Jezus mbi kryq. Ai është Zëvendësi i tyre.

Ndoshta në teori, do të kishte qenë e mundur që një burrë i përsosur, d.m.th. pa mëkat, të vdiste në vend të një mëkatarit të vetëm; nëse Jezusi kishte qenë *vetëm* njeri, vetëm *një* mëkatar do të kishte shpëtuar me anë të vdekjes së tij nën gjykimin e Perëndisë: një jetë për një jetë.

Por Perëndia donte të shpëtonte me miliona mëkatarë: kjo që e mundur, vetëm nëse vlefte e vdekjes së ofruar në vendin tonë që e pakufishme, e pasosur - d.m.th. aq e madhe sa Perëndia vetë. Për këtë arsye, ishte e nevojshme që Ai të vdiste në vend të mëkatarëve të ishte jo vetëm njeri por edhe Perëndi: Biri i Perëndisë.

Ja përse ishte patjetër e nevojshme që Dikush të vdiste në vendin tonë i cili ishte edhe njeri edhe Perëndi: pa Birin e Perëndisë s'do të kishte qenë e mundur që me miliona mëkatarë të pranojnë ndjesën e mëkateve dhe jetën e pasosur pranë Perëndisë. S'mund ta shpëtojmë veten prej dënimit të mëkateve: Ai mund të na shpëtojë falas, sepse Ai është Zot dhe Biri i Perëndisë, i cili vdiq dhe u ngjall prej së vdekurish, dhe jeton përgjithmonë.



Marrë me leje nga shtëpia botuese TENDA, Prishtinë.

© Përgjigje Islamit 2008. Të gjitha të drejtat e rezervuara.